

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË



S T U D I M E

H I S T O R I K E

2

REDAKSIA

KRYEREDAKTOR

Prof. dr. Hamit KABA

SEKRETAR SHKENCOR

Prof. asoc. dr. Sali KADRIA

BORDI I REVISTËS

Prof. dr. Afrim KRASNIQI (Shqipëri)	Prof. dr. Noel MALCOLM (Britani e Madhe)
Prof. dr. Aurel PLASARI (Shqipëri)	Prof. dr. Oliver Jens SCHMITT (Austri)
Prof. dr. Beqir META (Shqipëri)	Prof. dr. Nathalie CLAYER (Francë)
Prof. dr. Frashër DEMAJ (Kosovë)	Prof. dr. Elias G. SKOULIDAS (Greqi)
Prof. dr. Gjon BERISHA (Kosovë)	Prof. dr. Matteo MANDALÁ (Itali)
Prof. dr. Marenglen VERLI (Shqipëri)	Prof. dr. Martin BERISHAJ (Slloveni)
Prof. dr. Romeo GURAKUQI (Shqipëri)	Prof. dr. Katerina TODOROSKA (Maqedoni e Veriut)
Prof. dr. Sabit SYLA (Kosovë)	Prof. dr. Abdülhamit KIRMIZI (Turqi)
Prof. dr. Teuta SHALA-PELI (Kosovë)	Prof. dr. Fehari RAMADANI (Maqedoni e Veriut)
Prof. dr. Valentina DUKA (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Ledia DUSHKU (Shqipëri)
Prof. asoc. dr. Edmond MALAJ (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Sonila BOÇI (Shqipëri)
Prof. asoc. dr. Gjon BORIÇI (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Elidor MËHILLI (SHBA)
Prof. asoc. dr. Hasan BELLO (Shqipëri)	Prof. asoc. dr. Anton PANCHEV (Bullgari)

Korrektore gjuhësore: Mimoza KONOMI

Përpunimi teknik & Arti grafik: Mirela MIHALI

ISSN: 3005-8481 (E printuar)

ISSN: 0563-5799 (Online)

Del çdo gjashtë muaj

© Copyright:

Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Adresa e redaksisë: Rruga “Naim Frashëri”, nr.7, Tiranë

PASQYRA E LËNDËS

faqe

ARTIKUJ SHKENCORË

Edmond MALAJ	Kërcënimi turk dhe dorëzimi i Shkodrës te venedikasit në vitin 1396 nga Gjergj II Strazimir Balsha.....	5
Gjon BERISHA	Armatimi dhe kapacitetet ushtarake në zotërimet e Balshajve gjatë shek. XIV-XV	29
Alvin SARAÇI	Tregtia ndërmjet Durrësit dhe Venecies në vitet 1707-1714	63
Haxhi ADEMI	Pushtimi i Shqipërisë nga Italia dhe reflektimi te shqiptarët në Kosovë (1939-1941)	85
Romeo GURAKUQI	Dëshmi zyrtare britanike mbi tragjedinë e popullsisë shqiptare në Epirin e Jugut në vitet 1944-1945	117
Gjon BORIÇI	Një vështrim në terma politiko-ekonomikë ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë në periudhën 1945-1949 (Pjesa e tretë, prill-shtator 1948)	153
Erjon PAPAGJONI	“Goditja” në letërsi, arte dhe kulturë në vitin 1973	177

MATERIALE SHKENCORE E KUMTESA

Eduart CAKA	Literatura e udhëpërshkrimeve në histori-shkrimin e hapësirave kufitare: Një analizë e burimeve perëndimore dhe lindore për Elbasanin e shek. XVI-XVII	201
-------------	--	-----

NEKROLOGJI

Marenglen VERLI	Hysen Kordha (6 shkurt 1941 – 3 korrik 2024)	217
Skënder LUTFIU	In memoriam: Prof. dr. Liman Rushiti (1942-2024)	221

TABLE OF CONTENT

page

SCIENTIFIC ARTICLES

Edmond MALAJ	The Turkish threat and the surrender of Shkodra to the Venetians in 1396 by George II Strazimir Balsha	5
Gjon BERISHA	Armament and military capacities in the principality of the Balshaj during the 14th-15th centuries	29
Alvin SARAÇI	The trade relations between Durrës and Venice in the years 1707-1714	63
Haxhi ADEMI	The Italian occupation of Albania and its impact on the Albanians of Kosova	85
Romeo GURAKUQI	Official British testimony on the tragedy of the Albanian population in the Southern Epir during 1944-1945	117
Gjon BORIÇI	A view in political-economic terms between Albania and Yugoslavia in the period 1945-1949 (Part three, April -September1948)	153
Erjon PAPAGJONI	The “purges” in the field of literature, arts and culture in 1973	177

DOCUMENTS AND MATERIALS

Eduart CAKA	Travelogue literature in the historiography of borderlands: An analysis of Western and Eastern sources for the city of Elbasan in the 16 th -17 th centuries.....	201
-------------	---	-----

NECROLOGY

Marenglen VERLI	Hysen Kordha (February 6, 1941 – July 3, 2024)	217
Skënder LUTFIU	In memoriam: Prof. dr. Liman Rushiti (1942-2024)	221

EDMOND MALAJ

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

edmond.malaj@asa.edu.al

<https://doi.org/10.61773/yz01n937>

**KËRCËNIMI TURK DHE DORËZIMI I SHKODRËS TE
VENEDIKASIT NË VITIN 1396 NGA GJERGJ II STRAZIMIR
BALSHA****Abstrakt:**

Në këtë artikull përpiqemi që të hedhim dritë në mënyrë të detajuar në një periudhë historike të Shkodrës në fund të shek. XIV, që fillon me kërcënimet turke e vazhdon deri në dorëzimin e qytetit me rrethina në duart e venedikasve nga Gjergj II Strazimir Balsha. Si rrjedhim, do të mundohemi të ndriçojmë një periudhë të vështirë të historisë së Shkodrës mesjetare, siç janë 15 vitet e fundit të shek. XIV. Ne do të përqendrohemi në dy momente të kësaj historie: fillimisht me pushtimin e Shkodrës nga osmanët në vitet 1393-1395 si dhe kalimin e saj në sundimin venedikas në vitin 1396. Për t'i paraqitur këto ngjarje do të mbështetemi kryesisht në dokumente të Arkivit të Venedikut dhe të Raguzës, në disa dokumente osmane, si dhe në punime të autorëve të ndryshëm.

Fjalë kyçe:

Shkodra, Drishti, Durrësi, Savra, Balsha II, Gjergj II Strazimir Balsha, Shahini, turqit, Radiq Cërnojeviq, Topiajt, Karl Topia, Kojë Zaharia, Dhimitër Jonima.

Kërcënimi turk dhe Balshajt

Në gjysmën e dytë të shek. XIV Shkodra ishte në sundimin e Balshajve. Por shpejt situata nisi të ndryshonte, kur në trojet arbërore u shfaqën turqit, të cilët do të përbënin një rrezik gjithnjë e më të madh e më të shpeshtë për trojet arbërore duke filluar qysh në gjysmën e dytë të shek. XIV. Sipas disa autorëve, turqit erdhën në trojet arbërore të ftuar nga vetë arbitrit. Ishin pikërisht Topiajt, ose më saktë Karl Topia që i ftoi

ata për ndihmë kundër rivalëve të tyre, Balshajve.¹ Autorë të tjerë janë të mendimit se ata qenë thirrur për herë të parë, jo nga Karl Topia, por nga despoti serb i Janinës Tomas Preljuboviç (i njohur edhe me emrin *Thomas Komnenos Palaiologos*)² në vitin 1380 kundër shqiptarëve.³ Tomas Preljuboviç njihet në historiografi edhe si vrasësi i shqiptarëve “Ἀλβανιτοκτόνος”.⁴ Kështu, me dobësimin e Principatës së Balshajve, e cila po humbiste gjithë e më shumë pushtet – dhe një ndër shkaqet për këto zhvillime ishte edhe Beteja e humbur e Savrës – turqve iu hap rruga e depërtimit në brendësi të trojeve shqiptare.

Në lidhje me Betejën e Savrës do të ndalemi shkurtimisht, duke e pasqyruar me disa rreshta. Ajo u zhvillua në shtator të vitit 1385, ndërmjet turqve dhe koalicionit⁵ të Balshës II, i cili mbeti i vrarë më 18 shtator. Autori i shek. XVI, Mario Orbini na tregon edhe ngjarjen se si ndodhi vrasja e Balshës II në atë betejë. Orbini shkruan, se Balsha II po qëndronte në Durrës, kur i erdhi lajmi që turqit kishin shkelur territoret e tij dhe po kryenin plaçkitje. Ai u nis menjëherë nga Durrësi, pa pritur që të organizonte një ushtri me shumë forca. Ushtria turke, e përbërë kryesisht prej kalorësish, komandohej nga një oficer i quajtur Timurtash Beu, që njihej si një ndër prijësit më të sprovuar ushtarakë osmanë. Ushtria e Balshës synonte që t’i mbyllte rrugën depërtimit të forcave osmane, të cilat, që kur kishte rënë në duart e tyre Manastiri (1383) dhe Thesalia, po godisnin pareshtur tokat shqiptare dhe për këto plaçkitje e

¹ Peter Bartl, “Thopia, Karl”, në *Biographisches Lexikon zur Geschichte Südosteuropas*, Bd. 4. Hgg. Mathias Bernath / Karl Nehring (München: 1981), 312.

² Thomas Preljubović ose Thomas Komnenos Palaiologos (gr. Θωμάς Κομνηνός Παλαιολόγος, serb. Тома Прељубовић; † 23. dhjetor 1384) ka sunduar si princ i Epirit nga viti 1366 deri në vitin 1384. Ai ishte i biri i Preljubit (vojvodë serb i Stefan Dushanit) dhe i Irenës, së bijës së Stefan Dushanit, por në lidhje me nënën e tij thuhet gjithashtu se ishte greke. Për më tepër, shih: John Van Antwerp Fine, *The Late Medieval Balkans: A Critical Survey from the Late Twelfth Century to the Ottoman Conquest* (Michigan: University of Michigan Press, 1994), 346.

³ Oswald Brenner, “The Ethnic Composition of Medieval Epirus”, në *Imagining frontiers, contesting identities*, edited by Steven G. Ellis, Lud'a Klusáková (Pisa: Pisa University Press / Edizione Plus, 2007), 135.

⁴ Donald MacGillivray Nicol, *The despotate of Epiros, 1267-1479. A contribution to the history of Greece in the Middle Ages* (Cambridge/London/ New York/ New Rochelle/ Melbourne/ Sydney: Cambridge University Press 1984), 147.

⁵ Jean W. Sedlar, *East Central Europe in the Middle Ages, 1000-1500* (Seattle/ London: University of Washington Press, 1994), 385.

sulme flasin edhe kronikat osmane, sidomos ajo e Ashik Pashazades⁶ dhe e Idres Bitlisit.⁷ Ja si e përshkruan edhe kronisti osman Hoxha Sadeddin fushatën e Timur Tashit kundër trojeve shqiptare:

“Si rrjedhim Timur Tash beu vajti në vilajetin e shqiptarëve, pushtoi disa kështjella që ndodheshin në shtigjet e atij vendi dhe dërgoi akënxhijtë për të plaçkitur. Luftëtarët shtinë në duar nga popullsia shqiptare vajza dhe djem tërheqës me fytyra të freskëta e të pashembullt në bukuri dhe hijeshi. Çdo luftëtar mori nga një zanë të tillë me fytyrë të bukur që të ledhatonte zemrën si dhe lloj-lloj plaçkash. Timur Tash beu mori një të pestën e plaçkës dhe u drejtua për në selinë e Sulltanit, mbrojtës i botës, me ushtrinë ngadhënjimtare dhe me trofe të pakufizuar ashtu siç u përshkrua më lart. Atë dimër ata pushuan në Edërne ...”⁸

Tani, lidhur me sulmin që do t’u bëhej turqve, të cilët ndodheshin në afërsi të Lushnjës, Balsha II u këshillua nga fisnikët e tij që të priste, derisa të kishte një numër më të madh trupash. Por, ngaqë ai ishte shumë trim dhe ndoshta disi edhe kokëkrisur, nuk e dëgjoi këshillën e fisnikëve dhe nuk mori në konsideratë as rrezikun që po i kanosej. Kështu, ai nisi sulmin ndaj turqve dhe u vërsul brenda trupave armike. Por, qysh në mësymjen që u bëri atyre pranë lumit, sipas Orbinos “*Voiusha*”^{*}, në *Provincën e ashtuquajtur Grekot, në Fushën e Popovës*”, ai u thye nga turqit dhe u vra në betejë, në të cilën së bashku me disa nga njerëzit e tij luftoi me shumë trimëri, dhe për njëfarë kohe i qëndroi forcës së armikut që shkonte deri në pesë mijë, shumë prej të cilëve vdiqën. Edhe Balsha pati humbje të mëdha në njerëz dhe disa u zunë rob. Midis të tjerëve u vranë edhe Gjergj Cervavçiq (Giurag Cheruaucich), vojvoda i tij, i shquar për trimëri dhe Ivanishi (Ivaniš Mrnjavčević), i biri i Mbretit Vukashin. Turqit ia prenë kokën Balshës II dhe e çuan me karrocë ... te Murati, Princi i turqve.⁹ Megjithatë, Orbini e vendos datën e ngjarjes gabim duke

⁶ “Ashik Pashazade (1400 – pas vitit 1484)”, në *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV – Burime osmane*, përgatitur për shtyp nga Selami Pulaha (Tiranë: Helga’s Secets, 2016), 76-78.

⁷ “Idrisi Bitlisis (?-1520)”, në *po aty*, 128-139.

⁸ “Hoxha Sadeddin (1536-1599)”, në *po aty*, 228.

^{*} Shënim i autorit: Në fakt, këtu Orbini përmend një emër lumi mbase Vjosën, e cila ndodhet më në Jug. Në Savër ndodhet një lumë tjetër që quhet Lumi i Zi ose Perrino.

⁹ Mavro Orbini, *Il Regno degli Slavi hoggi corrottamente detti Schiavoni Historia di Don Mavro Orbino Rauseo Abbate Melitense*. Nella quale si vede l’Origine quasi di tutti i Popoli, che furono della Lingua Slava, con molte, & varie guerre, che fecero in

dhënë vitin 1383, si vit i kësaj ngjarjeje. Ushtria osmane ishte në komandën e Hajredin Pashës.¹⁰

Me vrasjen e Balshës II, Gjergj II Strazimir Balsha trashëgoi Shkodrën së bashku me Drishtin e Lezhën dhe me disa krahina të Zetës. Ai e kishte selinë e tij në qytetin e Ulqinit. Pas vrasjes së ungjit të tij në betejën kundër osmanëve, Gjergji që i detyruar të bëhej vasal i turqve deri në vitin 1387¹¹ dhe me sa duket, ai i dha fund këtij vasaliteti, kur u martua me princesshën serbe, Jelenën, të bijën e Mbretit serb Lazar po atë vit.¹² Pas Luftës së Savrës, kur u bë sundues i Zetës së Epërme, nisi edhe armiqësia kundër Cërnojeviqve, të cilët nuk e njohën zotërimin e tij. Ata i thanë Gjergjit se ato troje ishin nën Mbretin boshnjak Tvërtko.¹³ Gjatë kësaj kohe, Balshajt po kalonin edhe njëfarë periudhe të vështirë për sa u përket marrëdhënieve të tyre me Tvërtkon – Mbretin e Bosnjës dhe të Serbisë,¹⁴ por edhe me sundimtarë të tjerë. Për të zbutur e për të paqëtur mosmarrëveshjet, që ishin krijuar ndërmjet Tvërkos dhe Balshajve,

Europa, Asia, & Africa; il progresso dell'Impero, l'antico culto, & il tempo della loro conversione al Christianesimo. E in particolare veggonsi i successi de'Rè, che anticamente dominarono in Dalmatia, Croatia, Bosna, Servia, Russia, & Bvlgaria (In Pesaro, Appresso Girolamo Concordia. Con Licenza de'Superiori, MDCI (1601)), 292-293.

¹⁰ Sedlar, *East Central Europe in the Middle Ages, 1000-1500*, 385.

¹¹ Alexandru Madgearu, *The wars of the Balkan Peninsula: Their medieval origins* (Lanham/ Toronto/Plymouth: Scarecrow Press, 2008), 83.

¹² Martesa e Gjergj Strazimir Balshës me Jelenën, të bijën e Llazarit, nuk ka një datë të saktë. Sipas A. Fine-s, ajo mund të ketë ndodhur gjatë viteve 1386-1387. John Van Antwerp Fine, *The Late Medieval Balkans: A Critical Survey from the Late Twelfth Century to the Ottoman Conquest* (Ann Arbor: University of Michigan Press, 2006), 389.

¹³ “*Et andando in Zenta, fù ricevuto per Signore; quantunque alcuni di Zenta Superiore, e di Zarnoeuichi non gli prestassero vbediëza, fingendo di riconoscere per suo superiore Tuartco Rè di Bosna.*” Orbini, *Il Regno degli Slavi*, 293.

¹⁴ Gjatë gjysmës së dytë të vitit 1385 flitet për mosmarrëveshje ndërmjet Mbretit serb Tvërtko dhe Balshës: “*1385 ante X 5: littere privatae de Discordia inter Raxie Regem et dominum Balsam*”. Shih *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*, Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Parstis Primae: Saeculum XIV complectentis. Tomus Secundus: Ab anno MCCCCLXXXIV ad annum MCCCXCVI. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale di Napoli/ Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini di Venezia/ Pontificio Istituto di Studi di Orientali Roma/ Albanien Institut, Universität München/ Südost Institut, München 1968, nr. 304. (Në vijim cituar si: AAV II, dok. nr.).

venedikasit kishin dërguar dy ambasadorë: Georgious Loredano-n (Giorgio Loredan) dhe Andreas de Bernardo-n (Adrea Bernardo).¹⁵

Kjo armiqësi ishte krijuar që nga vitet '60 të shek. XIV, kur Balshajt ishin përpjekur që të zgjeronin kufijtë e tyre në të gjitha drejtimet, duke prishur aleancat që kishin pasur deri atëherë.¹⁶ Ndër këta armiq bënte pjesë edhe Karl Topia, i cili ua kishte ndaluar atyre vrullin e ekspansionit në drejtim të Jugut fillimisht në vitin 1364.¹⁷ Ai madje kishte arritur që të kapte rob edhe vëllezërit Balshaj (duke e mbajtur Gjergj Balshën si rob për disa muaj¹⁸), por që më vonë në vitin 1384 arritën t'ia merrnin Durrësin, edhe pse ata kishin bërë krushqi me Karl Topinë duke i dhënë atij për grua motrën e tyre Katerina Balshën,¹⁹ apo siç quhet ndryshe tek autorët e tjerë Vojsava Balsha, e bija e Balshës I.²⁰

Siç e thamë edhe më sipër, turqit me sa duket ishin thirrur për ndihmë nga Karl Topia,²¹ i cili ia kishte kërkuar këtë asistencë Sulltan Muratit I,²² me qëllim që të shtinte Durrësin sërish në duart e veta. Kështu Hajredin Pasha u shfaq në Shqipërinë e Mesme, ua mori Durrësin Balshajve dhe ia riktheu sërish Karl Topisë,²³ por edhe ky më pas qe i

¹⁵ "Et vtile sit. Et pro hnore nostril dominj faciat interponere nos et tractare pacem et concordiam inter, domins prdictos, cum hoc sit de mente et beneplacito domini Regis raxhie, qui nobis scripsit cum maxima Instantia, super hoc, vadit pars, pro faciendo doctos dominos, elligiantur duop Ambaxiatores, per duas manus ellectionum in isto consilio...". Po aty, dok. nr. 304.

¹⁶ Pëllumb Xhufi, *Nga Paleologët tek Muzakajt. Berati dhe Vlora në shekujt XII-XV* (Tiranë: Shtëpia botuese 55, 2009), 248.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Giuseppe Gelchich, *La Zedda e la Dinastia dei Balšidi, Studi storici e documenti* (Spalato: Tipografia Sociale Spalatina (G. Laghi), (1899)), 47.

¹⁹ Po aty, 50.

²⁰ Bartl, "Thopia, Karl", 312.

²¹ Po aty.

²² Bojka Djukanović, *Historical Dictionary of Montenegro* (Lanham: Rowman & Littlefeld, 2023), 27.

²³ Karl Hopf, "Griechenland. - B. Griechenland im Mittelalter und in der Neuzeit. Geschichte Griechenlands vom Beginn des Mittelalters bis auf unsere Zeit.", në *Allgemeine Encyclopädie der Wissenschaften und Künste: in alphabetischer Folge von genannten Schriftstellern bearbeitet und herausgegeben von J. S. Ersch und J. G. Gruber*. Mit Kupfern und Charten. Erste Section A-G. Herausgegeben von Hermann Brockhaus. Sechsendachtzigster Theil (86). (Geschichte Griechenlands vom Beginn des Mittelalters bis auf unsere Zeit. II. und III. Periode, griechisch-römisches Recht im Mittelaler und in der Neuzeit. I. und II. Periode) (Leipzig: F. A. Brockhaus, 1868), 43.

detyruar që t'i nënshtrohej hegjemonisë së osmanëve.²⁴ Kështu turqit erdhën, mësuan shtigjet dhe rrugët, dhe nuk u larguan më kurrë për më tepër se pesë shekuj, sepse, pikërisht ardhja e tyre me atë rast shënon edhe fillimin e së ashtuquajturës periudhë e turqve, sipas Bartl-it (Türkenzeit), në trojet jugore arbërore.²⁵

Disa vjet më vonë, sidomos në vitin 1387, Karl Topia u vu në pozitë të vështirë dhe kërkoi ndihmën e venedikasve për mbrojtjen e Durrësit, të cilët i prematuan se do ta ndihmonin. Fillimisht, ai bëri një marrëveshje. Më datë 17. 04. 1387, ata i kthyen përgjigje se ishin të lumtur që do t'i dërgonin një anije (të tipit *galedellum*) dhe një ambasador, i cili do të shihte të ardhurat e doganës, prej të cilave një e treta do të përdorej për pagesën e balistiarëve dhe njerëzve të tjerë që do të viheshin në dispozicion të mbrojtjes së qytetit. Më pas, Venediku porositi edhe kapitenin e Gjirit që në raste të nevojshme të nxitonte për në Durrës për t'i ardhur në ndihmë Karlit dhe territoreve të tij.²⁶ Karl Topia vdiq në janar të vitit 1388 dhe la të birin, Gjergj Topinë, si pasardhës dhe zot të Durrësit.²⁷ Le të kthehemi tani sërish te Balshajt.

Për sa u përket zotërimeve të Balshajve, turqit nuk po kërcënonin vetëm pjesët në Arbërinë Veriore dhe në atë Qendrore të zotërimeve të tyre, por edhe në Jug. Kështu, Balshë Balsha, zot i Zetës, Kaninës dhe Vlorës (*Balse Balsich Zente, Canine et Avalone domini*), në gusht të vitit 1385 kërkoi ndihmë ushtarake nga venedikasit, ngaqë turqit po e shqetësonin ditë për ditë.²⁸ Ai u kërkoi atyre katër galera të armatosura që

²⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet '20 të shek. XIX) Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2002), 290; shih edhe: Madgearu, *The wars of the Balkan*, 83.

²⁵ Bartl, "Thopia, Karl", 312.

²⁶ "1387, 17. aprilis. Venetiis. Ad requisitionem Caroli Thopiae mittetur expensis eiusdem "galedellus" unus paratus alias, iam promissus cum sufficientibus hominibus usque Durachium. – Nemo mittetur ad "intratas doanne" Durachii videndas, quarum tertia pars deputanda esset pro stipendio ballistiarum pro custodia Durachii, sed dominus Carolus ad beneplacitum suum solvet ballistarios et alias gentes habitatores Venetiarum. — Mandatur capitaneo culphi, ut "in casibus opportunis succurrere debeat dicte terre Durachii per mare" sitque "in omne auxilium et favorem domini Caroli et locorum suorum". Misti del Senato 40, fol. 68," AAlb II, nr. 408; Shih edhe një version më të zgjeruar të dokumentit te: po aty, dok. nr. 329.

²⁷ Bartl, "Thopia, Karl", 312.

²⁸ "1385, 8. augusti. Venetiis. Ad petitionem "Balse Balsich Zente, Canine et Avalone domini", civis et amici Veneti, Veneti se paratos esse declarant dare quattuor galeas

do t'i shërbenin për katër muaj, ndihmë e cila i jepet.²⁹ Rreziku turk bëhet edhe më i madh me Luftën e Kosovës, në të cilën forcat turke dolën fitimtare, edhe pse atje gjeti vdekjen vetë Sulltan Murati I. Gjergj II Strazimir Balsha ishte nisur që t'i vinte në ndihmë Mbretit Lazar, vjehrrit të tij, por gjatë kohës kur ishte në rrugë e sipër i mbërrin lajmi i katastrofës dhe si rrjedhojë ai kthehet dhe vendos që të mbrojë tashmë territoret e tij.³⁰ Sipas autorëve të tjerë dhe kronikave osmane, Gjergj II Strazimir Balsha kishte marrë pjesë vetë në këtë luftë.³¹ Pikërisht gjatë kësaj kohe, pas Luftës së Kosovës, në territorin e Zetës pati një dyndje të madhe të serbëve, të cilët erdhën dhe u vendosën aty, sepse preferonin më mirë që të iknin sesa t'u nënshtroheshin turqve.³²

Pra Zeta, një vend malor dhe i përshtatshëm për t'u mbrojtur, u bë vendstrehimi për shumë serbë, dhe mendojmë se ky proces duhet të ketë mbështetur edhe sllavizmin e mëtejshëm të krahinave të Malit të Zi dhe të shumë fiseve shqiptare, që më vonë e identifikonin veten si sllavë. Si rrjedhojë, sllavizmin e një pjese të trojeve të Malit të Zi duhet ta shohim jo vetëm te ndikimi i Kishës Ortodokse Sllave, por edhe si pasojë e dyndjeve serbe të shkaktuara sidomos nga luftërat kundër turqve, siç e tregon edhe rasti i Luftës së Fushë-Kosovës, më 15 qershor 1389. Përveç këtyre krahinave ishte i kërcënuar edhe Durrësi, për të cilin Senati më 8 mars 1392 porosi kapitenin e përgjithshëm të Gjirit që të shkonte me kujdes në qytet dhe të shihte e të merrte masa që ai të mos binte në duart e turqve.³³

Pushtimi i parë i Shkodrës nga turqit (1392-1393) dhe çështje të tjera

Shkodra dhe rrethinat e saj duke përfshirë edhe qytetet si Danja, Drishti etj., qenë gjithashtu shumë të kërcënuara nga turqit, të cilët kishin

contra Turchos, a quibus contratae dicti Balsae "cotidie opprimuntur et molestantur". Po aty, dok. nr. 389.

²⁹ Po aty, dok. nr. 300.

³⁰ William Denton, *Montenegro: Its People and Their History*, by the Rev. W. Dentin, M.A. (London: Daldy, Isbister & Co., 1877), 190.

³¹ Madgearu, *The wars of the Balkan*, 83.

³² Denton, *Montenegro*, 190.

³³ "Mandetur capitaneo nostro Culphi ut diligenter uadat at Ciuitatem Durachij, et uideat, ut ipsam Ciuitatem (sic) non cadat in Mannibus Turcorum salutando parte nostra Dominum Dorachij". AAV II, dok. nr. 438.

mundur të kapnin rob edhe vetë Gjergjin II Strazimir Balshën gjatë një beteje në vitin 1392, pasi më parë ai kishte bërë bisedime me Pasha Jegjit Beun (i njohur edhe me emrin Bazait Beu) dhe ishte munduar të bënte marrëveshje, porse ata i kishin kërkuar atij gjysmën e territoreve, duke përfshirë ndër to edhe Ulqinin, selinë e tij por edhe Shkodrën.³⁴ Kështu, si rrjedhim i kapjes së tij rob, Shkodra ra në duart e turqve,³⁵ sipas mendimit tonë gjatë vitit 1392, ndërsa sipas Ndoc Nikajt në fund të vitit 1393.³⁶ Për këtë, më 7 tetor të vitit 1392 pati këshillime të qeverisë së Venedikut, sepse kjo çështje bëri që venedikasit të tregoheshin të gatshëm të ndihmonin gruan e Gjergjit, me qëllim që Shkodra dhe Ulqini bashkë me krahinat e tyre të mos mbeteshin në duart e turqve.³⁷ Kështu, kapitenit venedikas të Gjirit i jepet urdhër që të shkonte sa më shpejt që të ishte e mundur në Ulqin dhe të fillonte bisedimet me zonjën Helena Balsha (Lazarevici) (*Helena lazarevichia, Georgii Balshae uxore*), dhe nëse do ta kërkonte nevoja që të zhvilloheshin bisedime të shumta, ai duhej që të përfshinte në to edhe fisnikun Nikola Belenjo (Nicolam Belegnum) që ishte zëvendëskapiten. Këta duhej ta paralajmëronin e ta bindnin zonjën Helena që të ishte e fortë dhe e qëndrueshme, e që nuk duhej t'i lëshonte trojet dhe qytetet e saj në dorën e turkut, sepse po ta bënte një gjë të tillë, për të dhe për bijtë e saj do të ishte shkatërrimi i shtetit të saj.³⁸ Madje, nëse Helena do të dëshironte, venedikasit do t'i ofronin asaj edhe ndihmë në forca ushtarake, duke i vënë asaj në

³⁴ “*Cum per noua que habentur, multis nodis et vijs., de Retentione domini dulcigni et cuiusdam consanguinei sui, facta per Bayasit turchum, Et de conuentionibus factis inter dominum turchum et dictos dominos, videlicet de dando et ponendo ducignum et Scutari ac alia loca sua, sub potentia et domino dicti bayasit, pro liberatione et relaxatione eorum.*” Po aty, dok. nr. 455.

³⁵ Për këtë shih: Listine o odnošajih između južnoga slavenstva i mletačke republike, Skupio Sime Ljubić, Knjiga IV (Od godine 1358 do 1403) (Zagreb: Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, 1874), 295-296. (Më tej cituar si: Ljubić, Listine IV).

³⁶ Ndoc Nikaj, *Historija e Shqypnis*, vëllimet I-II (Lezhë: Botimet Fishta, 2015), 81.

³⁷ Giuseppe Valentini & Fulvio Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh për historinë e Shqipërisë (1200-1500)*, përktheu nga origjinali: Vladimir Bregu (Tiranë: Plejad, 2013), dok. nr. 194.

³⁸ “*Ad hortandum et suadendum, quod sit Constans e t fortis ad manutenendum et conseruandum terras et loca sua, ne perveniant ad manus turchorum, quia si pervenierent esset totalis destructio status sui et suorum filiorum.*” AAV II, dok. nr. 455.

dispozicion 20 deri në 30 balisterë venedikas, të cilët ajo do t'i mbante me shpenzimet e saj.³⁹

Balsha u lirua nga turqit kundrejt pagesës, por kërcënimi turk ishte i pranishëm vazhdimisht. Kjo gjendje e vështirë dhe ky kërcënim, e bindi Gjergj II Strazimir Balshën t'ua dorëzonte Shkodrën dhe Drishtin venedikasve. Ai donte t'ua jepte këto dy qytete venedikasve, sepse më pas do t'i kishte shpatullat e sigurta në rast se turqit do të ndërmerrnin sulme përsëri. Përveç kësaj, ai kishte mundësi të sulmonte kundërshtarin e tij më të padurueshëm Radiq Cërnojeviqin (Radić Crnoević), i cili mbante të pushtuar Zetën, vendin e origjinës së dinastisë së Balshajve.⁴⁰ Radiq Cërnojeviq i kishte pushtuar territoret e Balshës përreth Kotorrit, krahinën e Pastroviqëve dhe Gërbaljin në kohën kur Gjergj II Strazimir Balsha kishte qenë i zënë rob nga turqit, dhe e kishte shpallur veten sundimtar të Zetës dhe të Budvës.⁴¹ Në territorin e Shkodrës, ai kishte mundur të shtinte në dorë fshatin Oblikë në afërsi të Bunës dhe Grishën e Samrishin.⁴² Në fakt, Radiq Cërnojeviq kishte qenë i lidhur me derën e Balshajve, sepse ishte i martuar me njërën prej vajzave të Gjergj I Strazimir Balshës.⁴³

Sipas Spiridon Gopçeviqit, Gjergj II Strazimir Balsha kishte pasur kundërshtarë gjatë asaj periudhe edhe dy prijës të tjerë sllavë, vëllezërit Andrija Zahet dhe Nikola Zahet, të cilët së bashku me Radiq Cërnojeviqin⁴⁴ kishin ngritur krye kundër tij, duke njohur si zot Mbretin Tvërtko të Bosnjës. Gjatë kësaj kohe, Zahetët dhe Cërnojeviq ishin

³⁹ *“Et per verba dicte domine, et conditionem Jllarum partium, videret, quod dicta loca sua subiacerent illj periculo, quod dicitur, debeat dictus capitaneus, ostendendo dicere pur a se. offerre et dare dicte domine si voluerit viginti usque triginta ballistarios nostros, ad expensas dicte domine, pro custodia illius uel illorum suorum locorum, pro quo uel quibus dicto capitaneo videbitur ipsos ballistarios fore magis necerrarios”* AAV II, dok. nr. 455.

⁴⁰ Gelchich, *La Zedda*, 185.

⁴¹ Djukanović, *Historical Dictionary*, 87.

⁴² *Po aty*.

⁴³ Qerim Dalimi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355-1443)* (Tetovë: Ars-ZZ, 2012), 78.

⁴⁴ Historiani dhe studiuesi serb Spridon Gopçeviq jep gabimisht emrin Stefan Cërnojeviq si kundërshtar të atëhershëm të Balshës, por jemi të mendimit që bëhej fjalë për Radiq Cërnojeviqin, të atin e Stefanit I Cërnojeviq. Shih: Spiridon Gopčević, *Geschichte von Montenegro und Albanien* (Gotha: Friedrich Andreas Pertes A.– G, 1914), 57.

mbështetur edhe nga Dukagjinët, por edhe nga Venediku,⁴⁵ i cili pak a shumë në të njëjtën kohë, më 30 nëntor 1392, i jep Gjergj II Strazimir Balshës edhe statusin e qytetarisë së trashëgueshme.⁴⁶ Kështu, Gjergj II Strazimir Balsha para se të merrej me Radiq Cërnojeviqin, të cilit ia duroi përkohësisht zotërimin e Zetës, u hakmor mbi vëllezërit Zahet (sipas Hopf-it Zahetai), të cilët i mundi, i zuri rob dhe pastaj u nxori sytë.⁴⁷ Zahetët ishin kushërinj dhe trashëgimtarë të njëfarë Nikollë Zaccaria nga Budva.⁴⁸ Sipas Hopf-it, Gjergj II Strazimir Balsha luftoi afërsisht dy vjet kundër Radiq Cërnojeviqit derisa e mundi atë në një betejë të përgjakshme, më 25 prill 1395. Ai e vrau,⁴⁹ dhe më pas pushtoi një pjesë të territoreve të tij.⁵⁰ Fëmijët e vegjël të Radiqit mundën të iknin dhe të fshiheshin në malet e Cetinës.⁵¹

Për të pasur një mbështetje të fortë ndaj Dukagjinëve, ai qe martuar pastaj me Jelenën e sipërpërmendur, të bijën e Mbretit serb Lazarit, e cila nëpër këngët popullore sllave përmendet edhe me emrin Juvelica dhe që duhet të ketë qenë bija e gjashtë e Lazarit.⁵²

Le të kthehemi tani sërish në Shkodër, e cila ishte nën sundimin e turqve edhe gjatë vitit 1394. Pikërisht gjatë kësaj kohe, më 16 korrik 1394 njihet një marrëveshje ndërmjet Shahinit, qeveritarit turk të Shkodrës dhe Dukagjinëve, me anë të së cilës Dukagjinët zotoheshin se do ta furnizonin Shahinin me kripë.⁵³ Nënshkruesi i marrëveshjes së kripës për Dukagjinët ishte Progon II Dukagjini, i cili sapo ishte martuar me Vojsava Topinë dhe kishte tashmë një muaj që ishte vendosur në Durrës, ku atij dhe gruas së vet i ishin njohur edhe privilegje të ndryshme. Ndër këto privilegje ishte edhe përfitimi i një të tretës së rentës së qytetit të Lezhës, të cilën do ta tërhiqte një nëpunës i

⁴⁵ Sipas Hopf-it, me ndihmën e Venedikut Radiq Cërnojeviq arriti t'i merrte Gjergj II Strazimir Balshës edhe Lezhën dhe Budvën. Më pas, Gjergji ia doli që ta dëbonte nga Lezha Radiq Cërnojeviqin dhe në mars të vitit 1393 Lezha kaloi në duart e venedikasve (Giovanni Mianit). Hopf, "Griechenland", 96. (Misti XLII, fol. 159).

⁴⁶ Po aty.

⁴⁷ Gopčević, *Geschichte von Montenegro*, 57.

⁴⁸ Hopf, "Griechenland", 43.

⁴⁹ Po aty, 96 (Commemorali. Vol. IX, fol. 31.).

⁵⁰ Djukanović, *Historical Dictionary*, 87.

⁵¹ Hopf, "Griechenland", 43.

⁵² Gopčević, *Geschichte von Montenegro*, 57.

⁵³ Hopf, "Griechenland", 96. (Misti XLIII, fol. 35, 185v, 195)

Dukagjinëve, dhe se atyre u lejohej në vitin 1398 që të ndërtonin një kështjellë në bregun e djathtë të Drinit.⁵⁴

Më 28 shtator 1394, në Shkodrën e pushtuar dërgohet nga turqit zëvendëskapiteni i Gjirit, i cili më pas duhej të shkonte në Durrës që të merrej vesh me bailin e atij qyteti për lirimin e disa personave që ishin zënë rob në krahinën e Durrësit prej turqve [të ndihmuar] edhe nga Dhimitër Jonima,⁵⁵ i cili ishte bërë me turqit pas pushtimit të Shkodrës. Në rast se robërit nuk ishin liruar akoma, atëherë një galerë venedikase duhej të vinte deri në portin lumor të Shën Shirqit dhe më pas duhej të dërgohej te Shahini në Shkodër një lajmëtar me fjalët e duhura dhe me kërkesën e lirit. Nëse Shahini nuk do të pranonte, ata duhej të dëgjonin ose duhej të merrnin me shkrim kushtet me anë të cilave mund të bëhej lirimi i tyre, duke u thënë turqve që venedikasin donin të rrinin në paqe me ta (*de volendo stare in pace secum*).⁵⁶ Gjatë atij udhëtimi nëpër lumin Bunë, venedikasin duhej të hetonin mundësinë se si Gjergj II Strazimir Balsha mund ta rifitonte Shkodrën, por këto hetime duhej të bëheshin me kujdes, pa zbritur në tokë pjesëtarë të tjerë të ekuipazhit të galerës dhe pa vënë në rrezik vetë galerën.⁵⁷ Mëkëmbësi osman Shahini kishte edhe mbështetjen e fuqishme të Jegjit Pashës së Shkupit. Siç e pamë edhe më sipër, në rastin e marrëveshjes së kripës, Progon II Dukagjini i kishte marrëdhëniet e mira me turqit dhe qeveritari Shahin në fund të vitit 1395 u mundua që ta rriste ndikimin e Progonit në Shkodër dhe kontribuoi për këtë gjë, në kurriz të Gjergj II Strazimir Balshës.⁵⁸ Duhet të përmendim këtu që Dukagjinët kishin në Shkodër edhe një degë të tyre, mbi të cilën Progon II Dukagjini mund të mbështetej. Progon II Dukagjini bëhet edhe më i fuqishëm duke u lidhur edhe me Topiajt. Ai gjatë kësaj periudhe, më saktë në vitin 1394 martohet me Vojsava (ose Voislava) Topinë, të motrën e Gjergj Topisë, zotit të Durrësit, sipas kërkesës së saj (*domina*

⁵⁴ Po aty. (Misti XLIV, fol. 219.)

⁵⁵ AAV II, dok. nr. 567; shih edhe *po aty*, dok. nr. 527.

⁵⁶ *Po aty*.

⁵⁷ “*Et si in ista via, quam facient galee intra flumeriam, viderent et cognoscerent, quod Georgius Strazimiri postet recuperare dictum locum Scutari, tunc cauto et dextro modo notificent hoc sibi, ut possit potere se in ordine et intelligere se cum eis, non ponendo modo aliquo gentes galearum in terram nec eundo cum galeis ad locum, ubi subiacerent alicui perieulo.*” *Po aty*, dok. nr. 567; shih edhe *po aty*, dok. nr. 527.

⁵⁸ Hopf, “Griechenland”, 97.

Voislava soror quondam domini georgij Topie domini durachij).⁵⁹ Leja nga venedikasit për martesë me Progonin i jepet Vojsavës më 16. 07. 1394.⁶⁰ Kjo martesë dëshmon edhe për lidhjet që Dukagjinët kanë pasur me familje të tjera të fuqishme fisnike, siç ishin në këtë rast Topiajt.

Shkodra bie sërish nën zotërimin e Balshajve

Nga materiali që kemi në dispozicion nuk mund të verifikojmë nëse turqit ishin akoma në Shkodër apo ishin larguar. Se si Shkodra ra sërish në dorë të Balshajve, kjo shpjegohet në mënyra të ndryshme. Sipas Spiridon Gopçeviqit, Shkodrën dhe Durrësin turqit ia dorëzuan përsëri Gjergj II Strazimir Balshës, pasi ky kishte çuar në harem in e Sulltan Muratit II një kushërirë (një e afërme e tij) së cilës nuk i përmendet emri.⁶¹ Kjo e dhënë e Spirodon Gopçeviqit në fakt na duket e pamjaftueshme dhe mund të jetë e logjikshme vetëm nëse Gjergji mund të ketë pranuar për momentin ndonjë vasalitet, për të cilin nuk kemi të dhëna. Ndoc Nikaj na jep një version tjetër të kësaj ngjarjeje. Ai thotë që Gjergj II Strazimir Balsha, duke mos pasur ndihmën e pritur nga venedikasit, bashkoi ushtrinë me atë të Konstandin Balshës dhe kështu të dy së bashku e rrethuan Shkodrën e si rrjedhim Shahini turk, duke parë se ishte e padobishme që të rezistonte, doli nga qyteti.⁶² Data e saktë se kur ikën turqit nga Shkodra nuk dihet, por ajo që dihet është se më 30 tetor 1395 Raguza ktheu në Ulqin gruan bashkë me fëmijët e Gjergj II Strazimir Balshës.⁶³ Se kur saktësisht iu mor Shkodra turqve, kësaj pyetjeje nuk mund t'i japim një përgjigje. Gelçiq thotë se një problem i tillë në lidhje me saktësimin e datave haset edhe për çështje dhe ngjarje të

⁵⁹ *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*, Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Pars Prima: Saeculum XIV complectens. Tomus Primus (1): Ab initio ad usque annum MCCCCLXXXIV. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale Napoli/ Istituto di Studi Albanesi del' Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini Venezia/ Ponteficio Istituto di Studi Orientali Roma 1967, dok. nr. 549. (Më tej cituar si: AAV I, dok. nr.)

⁶⁰ "1394, VII, ante 16: *Litterae dominae Voislave Topiae, Progono Ducagino nubendi licentiam petentis, atque Progono de eodem negotio*" AAV II, 549; shih edhe tekstin e plotë të kësaj lejeje tek: AAV II, dok. nr. 553.

⁶¹ Gopčević, *Geschichte von Montenegro*, 58.

⁶² Nikaj, *Historija e Shqypnis*, 82.

⁶³ *Po aty*.

tjera kryesore të historisë së Shtëpisë së Balshajve, zotërve të Zetës.⁶⁴ Balshajt u morën vesh me njëri-tjetrin e kështu Gjergji shkoi dhe u vendos në Ulqin, kurse sundimin e Shkodrës ia la Konstandin Balshës.⁶⁵ Shkodrës iu deshën edhe disa muaj që të kalonte sërish në duart e Balshajve. Sipas Gelçiqit, Shkodra u mor përsëri nga Balshajt diku ndërmjet muajve shtator-tetor, ose në ditët fundit të shtatorit, ose në ditët e para të tetorit të vitit 1395.⁶⁶

Duhet të përmendim këtu që Konstandin Balsha një vit më parë (1394) ishte bashkuar me turqit dhe ishte vendosur prej tyre si qeveritar i Krujës. Ai ishte martuar me Helena Topinë (të bijën e Karl Topisë, dhe motrën e Gjergj Topisë⁶⁷), ish-bashkëshorten e Marco Barbarigo-s. Helena në fakt ishte kushërirë e parë e tij (vajza e hallës), sepse i ati i Konstandinit, Gjergj I Balsha ishte i vëllai i Vojsavës, nënës së Helenës.

Konstandin Balsha, i cili gjatë vitit 1395 kishte qenë edhe zot i Danjës, bëri në atë kohë në Shkodër edhe një marrëveshje me raguzanët.⁶⁸ Pikërisht në këtë datë, më 13 nëntor 1395 (sipas kalendarit julian 6904) nëpërmjet një diplome të bërë në Uljarë të Shkodrës, Konstandini e shpalli veten si mik të raguzanëve dhe u garantoj atyre liri për të bërë tregti në territoret e tij.⁶⁹ Gjatë kësaj periudhe, Konstandini i ishte kushtuar krejtësisht tregtisë duke e përhapur veprimtarinë tregtare nga bregdeti i Zetës deri në Prizren e Novobërdë.⁷⁰ Me qëllim që të kishte

⁶⁴ “*Qui si vorrebbe ora domandare, quando precisamente Scutari sia stata ritolta ai Turchi ; ma si è già veduta le tante volte la impossibilità di fissare le date nemmeno dei principali avveni-menti del Casato dei signori della Zedda.*” Gelchich, *La Zedda*, 179.

⁶⁵ Nikaj, *Historija e Shqypnis*, 82.

⁶⁶ Gelchich, *La Zedda*, 181.

⁶⁷ “*Helene uxoris dicti Constandini, que Helena fuit soror domini Georgii, qui nobis dedit civitatem Durachii...*” Ljubić, *Listine IV*, 437.

⁶⁸ Gelchich, *La Zedda*, 179.

⁶⁹ “*(1395) 6904, 13. novembris. Ulijari super Scutaro (u Ulijareh1) vise Skodra). Dominus Constantinus se Raguseis amicis futurum esse promittit; potestatem dat eisdem mercaturam libere faciendi in terra sua. „Homines eiusdem civitatis alibi iudicium ne habeant nisi coram Raguseis semper (?) coram Latinis et nusquam alibi in terra mea” [teks në sllavisht ...] Scripsit huius rei milostnik logotheta Radič Žilić Vinuzilić.*” AAlb. II, dok. nr. 543.

⁷⁰ Giuseppe Gelchich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*. Përktheu nga origjinali: Laura Leka (Tiranë: Shtëpia botuese 55, 2009), 190.

përfitime sa më të mëdha, doganën e Danjës në vitin 1395⁷¹ ua dha me marrëveshje vëllezërve fisnikë Mark e Vlladissllav Dragos nga Kotorri, të cilët i rritën taksat dhe i rënduan shumë tregtarët që kalonin andej. Kështu, Republika e Raguzës i ndaloi tregtarët e saj që të vinin në Zetë dhe të frekuentonin tregjet e këtij vendi.⁷²

Tashmë Konstandin Balshës i kishte hyrë vetja në qejf dhe mendonte se ishte aq i fortë sa nuk mund të kthehej edhe një herë në zero, ashtu siç kishte qenë dikur.⁷³ Ai i vendosi vetes tituj të tillë, si despot dhe mbret, madje shtypi edhe monedha të vetat duke vendosur në njërën anë protomartirin Shën Shtjefnin, patronin e Shkodrës që mban në dorën e majtë një ungjill, kurse në dorën e djathtë një temjanicë ku shkruhej “S. STEFANVS – SKVTARENSI ose S. SCVTARI” dhe në anën tjetër paraqitet sunduesi Konstandin i ulur, me një kurorë të hapur në kokë, i cili në dorën e majtë mban mollën perandorake me kryq, kurse në dorën e djathtë mban skeptrin. Anash shkruhet: “M· Rex· COST-TANTINVS ose D· REX· COSTAND-TINUS”.⁷⁴ Megjithatë për këto monedha nga studiues të ndryshëm, si për shembull nga Jireček, mendohet se nuk kanë të bëjnë fare me Konstandin Balshën, por me Konstandinin, të birin e Uroshit II, i cili ka jetuar po ashtu në Shkodër.⁷⁵ Se deri kur e mbajti Konstandin Balsha Shkodrën, as për këtë nuk kemi një datë. Por fill menjëherë, po atë vit fillojnë edhe tratativat për dorëzimin e Shkodrës te venedikasit, siç e vërteton edhe dokumenti i datës 10 nëntor 1395 i përpiluar në kështjellën e Ulqinit,⁷⁶ sikurse do ta shohim edhe më poshtë. Gjergj II Strazimir Balsha e kishte të qartë se nuk do të mund ta mbante gjatë Shkodrën, sepse ushtritë turke do të ripërtëriheshin e do të vinin përsëri, e do t’ia merrnin, kështu rruga më e mirë mbetej që t’ia dorëzonte Shkodrën me rrethina Republikës së Venedikut, se kështu do të përfitonte të paktën diçka.

⁷¹ Marijan Premović, “Banditry in Zeta in the Balšić Period (1360-1421)”, në *Acta Histriae* 30 (2022), 4, 805.

⁷² Gelchich, *Zeta dhe Dinastia*, 190.

⁷³ Gelchich, *La Zedda*, 179.

⁷⁴ Karl Stockert, “Die Münzen der Städte Nordalbanien”, në *Numismatische Zeitschrift*. Hrsg. von den numismatischen Gesellschaft in Wien. Neue Folge, Band III. Der ganzen Reihe XLIII. (Wien: Selbstverlag der Numismatischen Gesellschaft, 1910), 80.

⁷⁵ Constantin Jireček, *Geschichte der Serben*. Erster Band (bis 1371) (Gotha: Friedrich Andreas Perthes A.-G., 354-355, 1911) ref. 2.

⁷⁶ AAII, dok. nr. 542.

Kalimi i Shkodrës me rrethina nën sundimin venedikas

Përpjekjet për ta kaluar Shkodrën nën zotërimin e venedikasve kishin filluar vite më parë. Gjergj II Strazimir Balsha, sapo ishte liruar nga osmanët, ua kishte ofruar Shkodrën venedikasve qysh në vitin 1392-1393, në një kohë kur ky qytet ishte akoma nën pushtetin osman.⁷⁷ Gjergji II Strazimir Balsha në lidhje me dorëzimin e Shkodrës dhe të zonave përreth kishte dërguar për bisedime vetë ipeshkvin e Shkodrës, të cilit nuk i përmendet emri në dokument,⁷⁸ por mendojmë se duhet të ketë qenë ndoshta Henriku që i përkiste Urdhrit Françeskan Minorit (OFM), i cili ishte emëruar si ipeshkëv i Shkodrës në vitin 1390.⁷⁹ Megjithatë në veprën “Illyricum Sacrum”, së cilës i jemi referuar, nuk jepet koha se sa qëndroi në detyrë ky ipeshkëv. Venedikasit, siç vërehet në dokument, e pritën me bezdi këtë propozim dhe dhanë një përgjigje të tillë:

“Shtrohet për vendim se, duke konsideruar që vendet e thëna nuk janë në bregdet, por madje shumë larg tij do të ishin më shumë në dëm se sa të dobishme për ne, dhe duke konsideruar që vendi i sipërthënë Shkodra është akoma në duart e turqve, nuk mund të futet në dorë pa përplasje. Kështu pra me këto arsyetime të shumta e me fjalë të tjera të mira, t’i jepet përgjigjja vetë atij zotit Ipeshkëv”.⁸⁰

⁷⁷ Po aty, dok. nr. 513.

⁷⁸ “*Quod repondetur Domino Episcopo Scutari ad oblationem suam nobis factam de danto in minibus nostris locum Scutari.*” Po aty, dok. nr. 530.

⁷⁹ “*Henricus Episc. Scodrensis XI. Sæculo XIV. ad exitum vergante huic Ecclesiæ præpositus usque ad postremos fere ejusdem sæculi annos præfuit; idque colligitur ex tabulis Romanis annorum insequentium, in quibus semel, iterum Ac tertio nominator.*” Daniele Farlato, *Illyrici Sacri*. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. (Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio, 1817), 310.

⁸⁰ “*1394 II 3 [...] Vadt pars, considerato quod dicta loca non sunt ad Marinam immo ualde remota et forent pocius damnosa nobis, quam utilia considerate etiam quod dictus Locus Scutari principaliter est in mannibus Turcorum, ita quod malè sine scandalo instromitti posset, et quampluribus, et rationibus, que Dominio uidebuntur fiat responsio ipsi Domino Episcopo, Lutanando se à facto pro utilitate agendorum npostrum.*” AAV II, dok. nr. 530.

Pra, siç e pamë më sipër, zotërimi venedikas nuk i pranoi menjëherë qytetet Shkodër dhe Drisht nga Balshajt,⁸¹ dhe këtë çështje e shtyu në fund të vitit 1395, edhe pse mbi dorëzimin e këtyre dy qyteteve ishin bërë diskutime rreth propozimit të dorëzimit nga Gjergj II Strazimiri që më 21 janar dhe më 9 shkurt të vitit 1395, madje qenë vendosur edhe kushtet e dorëzimit.⁸²

Më 10 nëntor të vitit 1395 për t'u dorëzuar Shkodrën me rrethina venedikasve, u paraqitën frati Nikolo de Samaksiis (*Nicolò de Samaxiis*) nga Shkodra që ishte doktor i teologjisë dhe profesor, së bashku me dy përfaqësues të tjerë që quheshin Helia, i biri i Martinit dhe njëfarë Kineso, shërbëtor besnik,⁸³ të cilët, nga ana e Gjergj II Strazimir Balshës, i ofruan Republikës Shkodrën dhe Drishtin me territoret përreth, të cilat Balsha ua kishte hequr turqve nga zotërimi i tyre.⁸⁴

Sipas Milutinoviqit, shqyrtime të tjera rreth kësaj çështjeje u bënë edhe gjatë periudhës dhjetor 1395 – prill 1396.⁸⁵ Bisedimet për dorëzimin, Venediku vendosi t'i zhvillonte më 30 dhjetor 1395⁸⁶ dhe i vazhdoi ato deri në muajt janar dhe shkurt të vitit 1396.⁸⁷ Pastaj nga marsi i vitit 1396 e deri në prill të po këtij viti, u morën vendimet për marrjen e qyteteve të ofruara.⁸⁸ Rreth diskutimeve që u bënë dhe kushteve të vendosura për dorëzimin në literaturën dhe materialet

⁸¹ Giuseppe Valentini, *Kontribute në kronologjinë e historisë së Shqipërisë 1060-1560*, Tiranë: Plejad, 2010, 138. Dokumenti: Ib CCCCLX.

⁸² Valentini & Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh*, dok. nr. 238, 239.

⁸³ “*Georgius de Straciomeri de Balsiis dei gratia dominus Zente etc.*” “*fratrem Nicolaum Samarixiis de Scutero sacre theologie dignissimum professorem absentem tanquam presentem et nobilem virum et fidelissimum dominum Heliam quondam Marini et Chinesium fidelem servitorem, nostros cives, presentes*” *Apud dominium Venetiarum procuratores Instituit pro factis Scutari. - Testes praesentes et subscripti: Marinus canonicus, Matheus archidiaconus cathedralis ecclesiae Dulcignensis. - Scripsit “Johannes de Morigiis quondam Antonii de Mediolano imp. Auctoritate notaries publicus ac caneellarius nobilis viri Johannis Gauro castellani Lesii.s”* AAlb. II, dok. nr. 542.

⁸⁴ Gelchich, *La Zedda*, 185.

⁸⁵ Branisllav Millutinoviç, “Drishti nën sundimin e Venedikut”, në *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, 15/1985 (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1986), 43.

⁸⁶ Valentini & Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh*, dok. nr. 247.

⁸⁷ *Po aty*, dok. nr. 249, 253; shih edhe: AAlb. II, dok. nr. 547; *po aty*, dok. nr. 608, 609, 611.

⁸⁸ Millutinoviç, “Drishti”, 43.

dokumentare që disponojmë jepen shumë informacione.⁸⁹ Në vazhdim po japim disa të dhëna për sa i përket marrëveshjes ndërmjet Gjergjit II dhe Venedikut të nxjerra nga dokumenti i saj i gjatë prej shumë faqesh. Sipas kësaj marrëveshjeje të bërë më 14 maj, Gjergj II Strazimiri tërhoqi të gjitha drejtat e zotërimit që kishte mbi qytetin e Shkodrës, Shën Shirqin, liqenin e Shkodrës dhe ishujt që ndodheshin në të. Kufiri ndërmjet pjesës që kishte mbetur nën zotërimin e tij dhe truallit venedikas u vendos të ishte lumi Buna. Më tej, nën sundimin e Venedikut ranë edhe qyteti e kështjella e Drishtit, kështjella e Shatit (Satti) dhe stacioni doganor i Danjës me të gjitha të drejtat dhe fitimet.⁹⁰ Gjergj II Strazimiri i mbeti nën zotërim krahina e Zabojanës,* pra vendi që ndodhej më përtej bregut perëndimor të lumit Buna deri në Tivar. Përgjatë lumit Buna u caktua një zonë e çmilitarizuar me një gjerësi prej një miljeje.⁹¹

Për sa i përket përfitimit që do të nxirrte nga kjo marrëveshje Gjergj II Strazimiri, u përcaktuan këto kushte: ai, të bijtë dhe pasardhësit e tij do të pranoheshin si fisnikë në Këshillin e madh të Venedikut, dhe Venediku zotohej se hiqte dorë nga çdo ndërhyrje në punët e “shtetit” që i kishte mbetur Gjergjit dhe i jepte atij të drejtën që të ngrinte aty flamurin e Shën Markut, ngaqë ishte shtetas venedikas.⁹² Në vendimet e tjera parashihej edhe një pagesë vjetore prej 1 000 dukatesh që do t’u jepej Balshajve. Personat që arratiseshin nga këto vende Venediku dhe Balshajt duhej t’ia dorëzonin njëri-tjetrit në mënyrë reciproke. Gjergj II Strazimir Balshës iu zeruan edhe borxhet dhe iu falën edhe shkeljet që kishin bërë ndaj Venedikut paraardhësit e tij.⁹³

Më vonë Balshajt kërkuan t’i kishin këto troje sërish nën sundimin e tyre, por nuk i patën kurrë më.⁹⁴

⁸⁹ Në lidhje me këtë, shih disa të dhëna p.sh. te dokumentet e datës 15.1.1396 në: AAV II, dok. nr. 608; dhe të datës 8 shkurt 1396 në AAV II, dok. nr. 611.

⁹⁰ Schmitt, *Das venezianische Albanien*, 238. Shih edhe marrëveshjen origjinale tek: AAV II, dok. nr. 628.

* Krahina e Zabojanës (Tejbunës) me fshatrat e saj shqiptare sot i përket Republikës së Malit të Zi.

⁹¹ Schmitt, *Das venezianische Albanien*, 238. Shih edhe marrëveshjen origjinale tek: AAV II, dok. nr. 628.

⁹² Po aty. AAV II, dok. nr. 628.

⁹³ Po aty, 238. Shih edhe marrëveshjen origjinale tek. AAV II, dok. nr. 628.

⁹⁴ Në lidhje me përpjekjet e Balshës III, për t’i shtënë nën kontroll këto troje shih artikullin: Edmond Malaj, “Përpjekja e dytë e Balshës III gjatë viteve 1408-1421 për rivendosjen e sundimit të tij në Shkodër e rrethina”, në *Hylli i Dritës*, 1 (2023), 105-

Instalimi i sundimit venedikas

Në mars të vitit 1396, Republika kishte zgjedhur proveditorët që do të niseshin bashkë me familjet e tyre (*portandum eos cum sua familia ad locum predictum*) në drejtim të Arbërisë dhe do të merrnin në dorëzim qytetet e Shkodrës⁹⁵ dhe të Drishtit, për ruajtjen e të cilit vunë në dispozicion persona të caktuar.⁹⁶ Sinjoria kishte përcaktuar edhe rregullat, të cilave do t'iu nënshtroheshin këta proveditorë. Ata nuk duhej të merreshin me tregti as për vete e as për të tjerët në vendet ku do të shkonin, se përndryshe do të humbnin të gjitha ato që kishin fituar ose përdorur për këto veprime të paligjshme, duke u dënuar edhe me një gjobë prej njëqind dukatesh.⁹⁷ Rroga e tyre ishte rreth 50 (.L.) dukate në muaj, por nëse dikush shprehte vullnetin që të nisej me dëshirën e vet, do t'i jepej që në fillim rroga e dy muajve plus edhe pagën e muajit të tretë.⁹⁸ Sipas dokumentit të mësipërm, koha e qëndrimit ishte provizore dhe shkonte deri në tre muaj të detyrueshëm, por mund të zgjatej me dëshirën e tyre, duke vazhduar me të njëjtën rrogë mujore.⁹⁹ Pra, duket se zyrtarët venecianë nuk ishin shumë të ngazëllyer që të vinin në Shkodër e rrethina me qëllim që të kryenin shërbimin.

Proveditorët e parë që u zgjodhën për Shkodrën nga Këshilli i Madh (*Maggior Consiglio*) qenë fisnikët Giovanni Capello dhe Giovanni

130; dhe Edmond Malaj, "The first Efforts of Balsha III and his mother to take Shkodra and its Surrounding at the Beginning of the XV Century", në *Albanian Studies*, vol. 2, No. 2 (2023), 29-58.

⁹⁵ "Vadit Pars Quod in bona Gratia Eligantur de presenti in hoc consilio tres nostri prouisoires sufficientes, per quatour manus electionum, qui possint accipi de omni loco et officio, Judicatu petitionum, non accipiedno ultra vnum pro domino et vnum pro officio..." Po aty, dok. nr. 615.

⁹⁶ "Prouisoires predicti possint accipere unam personam sufficientem pro custodia castri del driuasto, et quod uadant cum una galea super quam ascendat zurma ligni riapriae Marchie et alie prouisiones pro subuentione eorum qui erunt in illis partibus." Po aty, dok. nr. 621.

Në lidhje me instalimin e sundimit venedikas në Drisht, shih më gjerë tek: Edmond Malaj, *Drishti. Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar* (Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, 2015), 52-56.

⁹⁷ AAV II, dok. nr. 616.

⁹⁸ "Vadit pars, vt omnes libentius se diesponant ad eundum, quod sicut ipsis prouisoribus dabatur paga duorum mensium in ratione ducatorum .L. in mense, ita dari debeant ante suum recessum paga trium mensium." Po aty, dok. nr. 617.

⁹⁹ Po aty.

da Canal,¹⁰⁰ por këta sipas një dokumenti të datës 9 prill 1396, fillimisht nuk e pranuan detyrën dhe si pasojë u dënuan me nga një gjobë prej 100 librash. Si rrjedhojë, ata u zgjodhën sërish nga Këshilli i Madh dhe, me sa duket, kësaj here qenë të detyruar që të pranonin të shkonin në Shkodër në shërbim të zotërimit venedikas. Ata i bënë kërkesë këtij Këshilli që, meqenëse e kishin pranuar detyrën dhe po niseshin për atje, t'u hiqej ndëshkimi me gjobën e 100 librave, kërkesë që iu plotësua.¹⁰¹

Akti për kalimin Shkodrës me rrethina në duart e venedikasve u bë nga Senati më 14 prill 1396.¹⁰² Në gusht të vitit 1396, Venediku dërgoi për këto qytete një kont dhe një dhomëtar.¹⁰³ Instalimi i forcave venedikase në krahinë zgjati deri në muajin shtator. Megjithatë, me instalimin e administrimit të vet në Shkodër e rrethina, Venediku nuk i kishte evituar të gjitha rreziqet që i kanoseshin qeverisjes së tij. Sipas Hopf-it, një rival tjetër për Shkodrën tashmë venedikase ishte edhe Kojë Zakaria (Coja Zaccaria), zoti i Shatit (Satti), i cili ashtu si të tjerët ishte bërë gjithashtu vasal i turqve. Ai arriti që t'ua merrte Shkodrën përkohësisht venedikasve në vitin 1401, duke pasur dakordësinë edhe të vetë Gjergj II Strazimir Balshës dhe u bëri ballë venedikasve për katër vjet me radhë.¹⁰⁴ Vetëm me vdekjen e Gjergj II Strazimir Balshës më 1404, Venediku që në gjendje që ta kishte Shkodrën të sigurt nën sundimin e vet, duke pasur edhe mbështetjen e Helena Balshës, të bijës së

¹⁰⁰ Hopf, "Griechenland", 97. Në lidhje me këto zhvillime, Hopf na jep edhe këto burime: (Commemoriali, Vol. IX, fol. 40, 44v; Misti XLIII, fol. 37v; Cronaca veneta – 1427 [Cod. Foscari. Vindob. N. 6831]; Sanudo XXII, p. 780; Cronaca Zancaruola Vol. II, fl. 529; Amad. Valier, Cronaca Vol. II, fol. 228v).

¹⁰¹ "1396 IV 9. Maggior Consiglio, Leona (R° 21), c. 91 (87) Die nono Aprilis. Consiliarij Campa. Cum nobiles uiri ser Johannes capello et ser Jphannes de canali electi fuissent in consilio Rogatorum prouisoires ad partes Scutari, et quia terminus accpetandi erat altera die ad tertiam ipsi non potuerunt deliberare super hoc et propterea refutaverunt. Et ideo ceciderunt ad penam librarum .C. pro quolibet. Et postea iterato electi fuerunt prouisoires de dictas partes scutari et illariter acceptauerunt et obtulerunt ire ad seruicium dominij, Et requirant quod absoluantur a dicta pena librarum .C. Et iustum sit postquam uadunt ad nostrum seruicium quod non paciantur penam, vadit pars. Quod pars que prohibet, quod de dictis penis uel similibus non possit fieri gratia, Reuocetur in tantum quod dictis ser Johanni capello et ser Johanni de Canali possit fieri gratia de dicta pena, cum consilij ordinatis." AAV II, nr. 624.

¹⁰² Po aty, dok. nr. 628. (Commemoriali. LIX, c. 12t. – 13 (n°15)).

¹⁰³ Hopf, "Griechenland", 97. (Misti XLV, fol. 110v).

¹⁰⁴ Po aty, 97. (Misti XLV, fol. 189v).

Lazarit, e cila i kërkoi Republikës ndihmë pas vdekjes së të shoqit.¹⁰⁵ Venedikasit mbajtën këtë qëndrim, ngaqë, me sa duket, nuk donin të dëmtonin bisedimet që po bënin me Bajazitin.¹⁰⁶ Venedikasit e mbajtën Shkodrën për 83 vjet, pra nga viti 1396 deri në vitin 1479, nën pushtetin e tyre duke e vënë atë nën organet e tyre administrative.

Përfundime

Si përfundim, mund të themi se gjatë periudhës 1384 deri në vitin 1404, Shkodra kaloi një ndër fazat më të trazuara e më të vështira të historisë së saj, duke kaluar nëpër disa pushtete të ndryshme. Si fillim kemi Balshajt, pastaj pamë shkurtimisht se si ajo u bë pre e pushtimit turk për afro dy vjet dhe më pas ra sërish nën sundimin e Balshajve, të cilët, duke parë se nuk mund t'u bënin më ballë kërcënimeve turke, menduan se për ta ishte më e leverdishme ekonomikisht që t'ua jepnin me tribut venedikasve sesa ta mbanin vetë e përfundimisht ta humbnin sërish te turqit. Balshajt u munduan edhe më vonë që ta rifitonin sërish Shkodrën, por nuk ia dolën kurrë më dhe me vdekjen e Balshës III përfundoi edhe përpjekja e fundit për ta pasur qytetin sërish nën sundimin e tyre.

Burime dhe bibliografi:

Botime dokumentare:

Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Pars Prima: Saeculum XIV complectens. Tomus Primus (1): Ab initio ad usque annum MCCCLXXXIV. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale Napoli/ Istituto di Studi Albanesi dell' Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini Venezia/ Ponteficio Istituto di Studi Orientali Roma, 1967 (AAV I).

Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Parstis Primae: Saeculum XIV complectentis. Tomus Secundus: Ab anno MCCCLXXXIV ad annum MCCCXCVI. Centro internazionale di Studi Albanesi

¹⁰⁵ Po aty.

¹⁰⁶ Valentini, *Kontribute në kronologjinë*, 159.

Palermo/ Istituto Universitario Orientale di Napoli/ Istituto di Studi Albanesi dell'Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini di Venezia/ Pontificio Istituto di Studi di Orientali Roma/ Albanien Institut, Universität München/ Südost Institut, München, 1968 (AAV II).

Farlato, Daniele. *Illyrici Sacri*. Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio, 1817.

Giuseppe, Valentini. & Fulvio Cordignano, *Përmbledhje dokumentesh për historinë e Shqipërisë (1200-1500)*. Përktheu nga origjinali: Vladimir Bregu. Tiranë: Plejad, 2013.

Listine o odnošajih između južnoga slavenstva i mletačke republike, Skupio Sime Ljubić, Knjiga IV (Od godine 1358 do 1403). Zagreb: Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, 1874.

Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV – Burime osmane, përgatitur për shtyp nga Selami Pulaha. Tiranë: Helga's Secets, 2016.

Valentini, Giuseppe. *Kontribute në kronologjinë e historisë së Shqipërisë 1060-1560*. Tiranë: Plejad, 2010.

Literaturë historiografike:

Bartl, Peter. "Thopia, Karl". Në *Biographisches Lexikon zur Geschichte Südosteuropas*, Bd. 4. Hgg. Mathias Bernath / Karl Nehring. München: 1981.

Brenner, Oswald. "The Ethnic Composition of Medieval Epirus". Në *Imagining frontiers, contesting identities*, edited by Steven G. Ellis, Lud'a Klusáková. Pisa: Pisa University Press / Edizione Plus, 2007.

Dalimi, Qerim. *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355-1443)*. Tetovë: Ars-ZZ, 2012.

Denton, William. *Montenegro: Its People and Their History*, by the Rev. W. Denton, M.A. London: Daldy, Isbister & Co., 1877.

Djukanović, Bojka. *Historical Dictionary of Montenegro*. Lanham: Rowman & Littlefield, 2023.

Fine, John Van Antwerp. *The Late Medieval Balkans: A Critical Survey from the Late Twelfth Century to the Ottoman Conquest*. Michigan: University of Michigan Press, 1994 (ribotim Michigan: University of Michigan Press, 2006).

Gelchich, Giseppe. *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*. Përktheu nga origjinali: Laura Leka. Tiranë: Shtëpia botuese 55, 2009.

- Gelchich, Giuseppe. *La Zedda e la Dinastia dei Balšidi, Studi storici e documenti*. Spalato: Tipografia Sociale Spalatina (G. Laghi), 1899.
- Gopčević, Spiridon. *Geschichte von Montenegro und Albanien*. Gotha: Friedrich Andreas Pertes A-G, 1914.
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet '20 të shek. XIX). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: Toena, 2002.
- Hopf, Karl. "Griechenland. - B. Griechenland im Mittelalter und in der Neuzeit. Geschichte Griechenlands vom Beginn des Mittelalters bis auf unsere Zeit." Në *Allgemeine Encyclopädie der Wissenschaften und Künste: in alphabetischer Folge von genannten Schriftstellern bearbeitet und herausgegeben von J. S. Ersch und J. G. Gruber*. Mit Kupfern und Charten. Erste Section A-G. Herausgegeben von Hermann Brockhaus. Sechsendachtzigster Theil (86). (Geschichte Griechenlands vom Beginn des Mittelalters bis auf unsere Zeit. II. und III. Periode, griechisch-römisches Recht im Mittelalter und in der Neuzeit. I. und II. Periode). Leipzig: F. A. Brockhaus, 1868.
- Jireček, Constantin. *Geschichte der Serben*. Erster Band (bis 1371). Gotha: Friedrich Andreas Perthes A.-G., 1911.
- MacGillivray Nicol, Donald. *The despotate of Epiros, 1267-1479. A contribution to the history of Greece in the Middle Ages*. Cambridge / London / New York/ New Rochelle/ Melbourne/ Sydney: Cambridge University Press 1984.
- Madgearu, Alexandru. *The wars of the Balkan Peninsula: Their medieval origins*. Lanham/ Toronto/Plymouth: Scarecrow Press, 2008.
- Malaj, Edmond. "Përpjeka e dytë e Balshës III gjatë viteve 1408-1421 për rivendosjen e sundimit të tij në Shkodër e rrethina". Në *Hylli i Dritës*, 1 (2023): 105-130.
- Malaj, Edmond. "The first Efforts of Balsha III and his mother to take Shkodra and its Surrounding at the Beginning of the XV Century". Në *Albanian Studies*, vol. 2, No. 2 (2023): 29-58.
- Malaj, Edmond. *Drishti. Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar*. Instituti i Historisë / QSA. Tiranë: Botimet Albanologjike, 2015.
- Millutinoviç, Branislav. "Drishti nën sundimin e Venedikut". Në *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, 15/1985. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1986.
- Nikaj, Ndoc. *Historija e Shqypnis'*, vëllimet I-II. Lezhë: Botimet Fishta, 2015.
- Orbini, Mavro. *Il Regno degli Slavi hoggi corrottamente detti Schiavoni Historia di Don Mavro Orbino Rauseo Abbate Melitense*. Nella quale si vede l'Origine quasi di tutti i Popoli, che furono della Lingua Slava, con molte, & varie guerre, che fecero in Europa, Asia, & Africa; il

- progresso dell'Impero, l'antico culto, & il tempo della loro conversione al Christianesimo. E in particolare veggonsi i successi de'Re, che anticamente dominarono in Dalmazia, Croatia, Bosna, Servia, Russia, & Bvlgaria. In Pesaro, Appresso Girolamo Concordia. Con Licenza de'Superiori, MDCI (1601).
- Premović, Marijan. "Banditry in Zeta in the Balšić Period (1360-1421)". Në *Acta Histriae* 30 (2022), 4.
- Sedlar, Jean W. *East Central Europe in the Middle Ages, 1000-1500*. Seattle/London: University of Washington Press, 1994.
- Stockert, Karl. "Die Münzen der Städte Nordalbaniens". Në *Numismatische Zeitschrift*. Hrsg. von den numismatischen Gesellschaft in Wien. Neue Folge, Band III. Der ganzen Reihe XLIII. Wien: Selbstverlag der Numismatischen Gesellschaft, 1910.
- Xhufi, Pëllumb. *Nga Paleologët tek Muzakajt. Berati dhe Vlora në shekujt XII-XV*. Tiranë: Shtëpia botuese 55, 2009.

EDMOND MALAJ

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
edmond.malaj@asa.edu.al

S u m m a r y

THE TURKISH THREAT AND THE SURRENDER OF SHKODRA TO THE VENETIANS IN 1396 BY GEORGE II STRAZIMIR BALSHA

In this article we are trying to present in detailed way a historical period of Shkodra at the end of the 14th century that begins with the Turkish threats and continues until the surrender of the city and its surroundings to the Venetians by George II Strazimir Balsha. As a result, we will try to bring light on a difficult period in the history of medieval Shkodra, such as the last 15 years of the 14th century. We will focus on two moments of this history: First, at the time of the conquest of Shkodra by the Ottomans in the years 1393-1395, as well as its transit of the city to the Venetian rule in 1396. To present these events, we will focus mainly on documents from the Archives of Venice and Ragusa, on some Ottoman chronicles, as well as on the works of various authors.

GJON BERISHA

Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë

gj.n.berisha@gmail.com

<https://doi.org/10.61773/6dkxvr63>

**ARMATIMI DHE KAPACITETET USHTARAKE NË
ZOTËRIMET E BALSHAJVE GJATË SHEK. XIV-XV****Abstrakt:**

Bazuar kryesisht në burime të shkruara, në këtë punim kemi trajtuar armët dhe potencialin ushtarak brenda Principatës së Balshajve. Qëllimi i studimit është trajtimi i armëve të përdorura, prodhimi, rrethanat historike dhe mënyra e sigurimit, prejardhja, lloji i armëve sulmuese dhe mbrojtëse, të përdorura nga Balshajt dhe ushtritë e tjera të zonës.

Vlerësuar në bazë të burimeve të kohës dhe krahasuar me fondin e armëve që përdoreshin në vendet e rajonit dhe ato të Europës mesjetare, Balshajt nuk qëndronin prapa. Ata kishin në përdorim të gjitha llojet e armatimit që përdornin edhe vendet e përmendura, duke ndjekur teknikën dhe teknologjinë e kohës.

Ndër armët e ftohta më të rëndësishme të sulmit gjatë Mesjetës ishin shpatat, thikat, harqet, shigjetat, shtizat, balestrat etj., si edhe armët e zjarrit artileria (bombardat/topat) dhe një lloj i pushkëve të dorës me fitil për këmbësori. Ndër armët më të rëndësishme të përdorura për mbrojtje gjatë Mesjetës ishin: armatura, mburoja dhe helmata. Këto armë u siguruan përmes rrugëve të ndryshme: prodhimit në punëtoritë vendëse, përmes blerjes, huazimit dhe plaçkitjeve. Nga vendet që furnizuan me armatim Balshajt dallohet Republika e Raguzës, e cila përveç interesave ekonomikë nuk kishte konteste territoriale me arbërorët dhe Balshajt. Në kuadër të zhvillimit dhe zgjerimit të zotërimeve, Balshajt krijuan dhe forcuan edhe flotën e armatosur detare, për të cilën kohë pas kohe patën konflikte edhe me Venedikun, i cili tentonte të luante rolin e mbikëqyrësit të Adriatikut.

Fjalë kyçe:

Armët mesjetare, Principata e Balshajve, shqiptarët, Arbëri, Zeta, Arkivi Shtetëror i Dubrovnikut.

Hyrje

Burimet e shkruara për studimin e historisë së armëve mesjetare në trevat në shtetin e Balshajve janë shumë të kufizuara. Këto burime kryesisht vijnë nga dokumentet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut, Kotorrit, si dhe ato të Venedikut. Ndihmë për këtë temë japin edhe katalogët e armëve të ruajtura në muze të ndryshme, si dhe disa të dhëna arkeologjike, numizmatike dhe etnografike. Kjo mungesë burimesh vjen edhe nga fakti se bashkë me rënien e principatave feudale mesjetare, me zhdukjen e ushtrive mesjetare u zhdukën edhe armët e tyre. Luftërat e shumta dhe pushtimet e gjata shkatërruan gjurmët e kësaj trashëgimie kulturore materiale.

Të rralla janë të dhënat që mundësojnë studimin e njëkohshëm të origjinës, zhvillimit dhe përdorimit të një arme të caktuar mesjetare. Njohuritë dhe interesimi i studiuesve mbi armët mesjetare të principatave arbërore kanë qenë, kryesisht të koncentruar në studimin e armëve të përdorura gjatë periudhës së luftës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut (1405-1468), kurse për principatat e tjera, pothuajse mungon krejtësisht. Njoftimet për armët dhe artin ushtarak të Skënderbeut dhe ushtrisë së tij fillojnë nga Marin Barleti, i cili konsiderohet se mori personalisht pjesë me armë në mbrojtjen e Shkodrës gjatë rrethimit të parë nga ushtria osmane.¹ Këto njoftime vazhdojnë deri te studiuesit e kohëve tona, duke përfshirë edhe katalogë të ndryshëm nga muzetë shqiptare dhe të huaja.²

¹ Marin Barleti, *Historia e Skënderbeut* (origjinali latinisht, përkthyer nga Stefan Prifti), Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë (Tiranë: 1964), 200, 208, 237, 317, 347, 374-375, 408, 477; *Po ai, Rrethimi i Shkodrës*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë (Tiranë: 1962), 50-58.

² *Kunsthistorisches Museum Wien*, Hofjagd- und Rüstkammer, Inv.-Nr. HJRK_A_550; Fan S. Noli, *Historia e Skënderbeut, kryzotit të Arbërisë (1405-1468)* (Tiranë: Naim Frashëri, 1962), 59, 64, 67, 73-74, 77-84, 90, 110, 116; Kristo Frashëri, *Skënderbeu: jeta dhe vepra* (Tiranë: Toena, 2002), 258-263; Riza Drishti, *Armët dhe armëtarët shqiptarë në muzetë e Shqipërisë* (Tiranë: Mali Pleshti, 2018); Luan Malltezi, *Armët e Skënderbeut në Shqipëri* (album), Muzeu Historik Kombëtar (Tiranë: Ilar, 2014); Dritan Egro, "A janë armët e Skënderbeut në Vjenë? Fillimi i një studimi mbi armët e heroit tonë kombëtar të ekspozuara në Muzeun e Vjenës", *Shekulli*, nr. 56 (Tiranë, 28 shkurt 2005), 20; *Armët të mjeshtërve shqiptarë në Muzeun Historik Kombëtar / Guns of Albanian craftsmen at the National Historical Museum* (katalog), përgatiti tekstin Dorian Koçi, Ledio Xhoxhi; redaktor Hajri Shehu, Muzeu Historik Kombëtar (Tiranë: 2017).

Studime më të detajuara për armët, tipologjinë, vendpunishtet dhe esnafet e tyre rezultojnë të jenë ato për shek. XVII-XIX.³

Natyrisht që Skënderbeu kishte trashëguar një traditë të njohur të arbërorëve në posedimin, prodhimin dhe në artin e përdorimit të armëve të dorës, atyre të zjarrit dhe artilerisë gjatë periudhave të mëhershme. Këtë e dëshmon edhe Barleti, i cili na thotë se Skënderbeu, kur u kthye në Arbëri, e gjeti popullin të armatosur dhe në gojën e heroit ai vuri këto fjalë: “*Armët nuk jua solla unë, por ju gjeta të armatosur...*”.⁴

Materiali fillestar i studiuar në këtë punim përfshin të dhëna dokumentare mbi armatimin, tipologjinë, mënyrën e sigurimit, punimin dhe rrethanat e përdorimit të tyre nga territori i Arbërisë, Zetës dhe Kosovës, të përfshira në zotërimet e Balshajve. Megjithatë, për faktin se ky material mund të kuptohet vetëm brenda një konteksti më të gjerë, kemi përfshirë edhe përdorimin e armëve të Mesjetës së Vonë nga territori i gjithë Ballkanit (Europa Juglindore) dhe më tej. Ngjarjet që u zhvilluan në kuadër të Principatës së Balshajve ishin të ndërlidhura me zhvillimet politike, ekonomike e ushtarake jo vetëm të princërve ballkanikë por edhe të fuqive të kohës, siç ishin Venediku, Raguza, Hungaria e Perandoria Osmane, andaj edhe armët dhe përdorimi i tyre është i lidhur drejtpërdrejt me këto vende. Në këto kushte, që nga gjysma e dytë e shek. XIV e në vazhdim, Balshajt në kuadër të forcimit dhe të zgjerimit të principatës së tyre bënë përpjekje të shumta, jo vetëm për prodhimin e armëve nga punishtet vendëse apo të rajonit, por shfrytëzuan edhe arritjet teknologjike të Europës me shpikjen e barutit dhe armëve të zjarrit.⁵

Sa u përket vendeve të rajonit, ndër studimet më të hershme dhe më të kompletuara që trajtojnë në detaje sasi të mëdha armësh të gjetura në territorin e gjerë ballkanik është ai i studiuesit Gavro Shkrivaniq, i cili rreth shtatëdhjetë vjet më parë në botimin e tij për armët e *Zetës mesjetare, Serbisë, Bosnjës dhe Dubrovnikut*, përfshiu armatimin

³ Për përdorimin e armatimit nga Skënderbeu, shih: Riza Drishti, *Armët dhe armëtarët shqiptarë* (Tiranë: 8 Nëntori, 1976), 71-94.

⁴ Shih: Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut* (botimi i tretë) (Prishtinë: Rilindja, 1989), 74.

⁵ Drishti, *Armët dhe armëtarët*, 23.

mesjetar nga shek. XII deri në shek. XV.⁶ Po ashtu, vepra e Gjurgjica Petroviqit, *Armët e Dubrovnikut në shekullin XIV*,⁷ është një studim gjithëpërfshirës i shumë gjetjeve në rajonin e Ballkanit, sidomos ato që kishin raporte me Raguzën, duke përfshirë edhe trevat arbërore.

Nga studimet më të hershme shqiptare për armët është studimi monografik i Riza Drishtit, *Armët dhe armëtarët shqiptarë*,⁸ botuar në vitin 1976, në të cilin trajton rrugëtimin e prodhimit dhe të përhapjes së armëve të ftohta dhe atyre të zjarrit në trevat arbërore, të prodhuara nga armëtarët vendës dhe ato të importuara gjatë shek. XV-XX. Në këndvështrimin etnografik, një studim për armët mesjetare shqiptare është publikuar në vitin 2006 nga etnologu Bashkim Lajçi me titull “Armët e shqiptarëve gjatë mesjetës”, në të cilin trajton në mënyrë të përgjithshme zhvillimin e zejes së armëtarisë dhe historikun e armëve mesjetare nëpër botë dhe pjesërisht edhe te shqiptarët.⁹

Sigurimi i armëve (tregtia, huamarrja, dhuratat dhe kontrabanda)

Në fillim të viteve '60 të shek. XIV, në kohën kur Balshajt u bënë faktor në jetën ekonomike, politike e ushtarake edhe për fuqitë e huaja fqinje, si për Venedikun e Raguzën, Principata e Balshajve doli në skenë si formacion shtetëror feudal i konsoliduar dhe i rëndësishëm.¹⁰

Territori mbi të cilin shtriheshin zotërimet e Balshajve në shek. XIV emërohej prej vetë Balshajve apo edhe prej të huajve *Zetë*, emërtim që përfshinte një hapësirë të gjerë të Shqipërisë Veriperëndimore dhe të Malit të Zi të sotëm deri në Gjirin e Kotorrit.

Zgjerimi i zotërimeve dhe forcimi i Principatës së Balshajve u shoqërua edhe me konflikte e luftëra të shumta, si me feudalët vendës,

⁶ Gavro A. Škrivanić, *Oružje u srednjovekovnoj Srbiji, Bosni i Dubrovniku*, Srpska akademija nauka i umetnosti, Posebna izdanja; Odeljenje društvenih nauka; knj. 24 (Beograd: Naučno delo, 1957).

⁷ Đurđica Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku* (Posebna izdanja – Vojni muzej, knj. 5) (Beograd: Vojni Muzej, 1976).

⁸ Riza Drishti, *Armët dhe armëtarët shqiptarë* (Tiranë: 8 Nëntori, 1976).

⁹ Bashkim Lajçi, *Armët e shqiptarëve gjatë mesjetës* (Pejë: Kuvendi Komunal, 2006).

¹⁰ Pranvera Bogdani, *Balshajt: Lufta e Principatës së Balshajve dhe sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e parë të shekullit XIV*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2018), 25.

me ata të vendeve fqinje (me feudalët boshnjakë) ashtu dhe me ata të jashtëm (Venediku, Perandoria Osmane, Serbia dhe Raguzë). Për t'i shtrirë zotërimet e tyre, Balshajt ndërmorën edhe ekspedita ushtarake. Ushtri dhe armatime të shumta u përqendruan në Zetë edhe nga ana e Venedikut, si një ndër aktorët kryesorë të “*Arbërisë Venedike*”.¹¹

Veçanërisht në këtë kohë, kur luftërat dhe trazirat ishin të pandërprera në zotërimet e Balshajve, kërkesa për kapacitete ushtarake dhe armatim rritej vazhdimisht dhe mundësitë e sigurimit të tyre bëheshin përmes rrugëve të ndryshme – tregtisë, prodhimit të tyre, plaçkës, kontrabandimit e deri te sigurimi i tyre përmes marrëveshjeve të ndryshme. Në situata të tilla, trafiku i armëve duhej të ishte një degë fitimprurëse për tregtarët. Megjithatë, ne kemi pak informata të drejtpërdrejta për këtë lloj tregtie. Andaj është shumë e vështirë që nëpërmjet këtyre dokumenteve të pakta të bëhet vlerësimi i impaktit të kësaj tregtie në zonën e Balshajve.

Sa i përket sigurimit të armëve përmes dhuratave, ndër njoftimet më të hershme është ai i majit të vitit 1363 në një dokument, kur i dërguari i Raguzës, Junius Bisti de Bona erdhi te vëllezërit Balsha me dhurata armësh dhe me një kërkesë: “...të hapte rrugën për në Skllavoni për tregtarët...”.¹²

Në korrik të vitit 1372, një qytetar raguzan paraqet një padi kundër Karl Topisë para autoriteteve të Raguzës. Sipas akuzës, në qershor të vitit 1371, ai kishte sulmuar në det me një varkë të armatosur dhe kishte konfiskuar, përveç të tjerash, edhe armë dhe vetë varkën.¹³ Janë dy dokumente, të cilat përmendin armët në mesin e këtyre mallrave. Më 18 shtator të vitit 1372, mësojmë se marinari raguzan Jurça u ankua se nga dy vlonjatë nga Saseno i ishin vjedhur 15 dukate ari, dy shpata, tri

¹¹ Më gjerësisht për Arbërinë venedike, shih: Oliver Jens Schmitt, *Arbëria venedike: 1392-1479* (Tiranë: K&B, 2007).

¹² “...mittendi i ambaxiadorem ad illos de Balsa, ut apperiat inter Sclavonie pro mercatoribus”, *Monumenta Ragusina: libri reformationum. Tomus III, Ann. 1359-1364*, collegit et digessit Josephus Gelcich (Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium, knj.27), Zagrabiae: Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium, 1895, 259; Konstantin Jireček, “Srpski car Uroš, kralj Vukašin i Dubrovčani”, *Zbornik Konstantina Jirečeka*, I (Posebna izdanja knj. CCXXVI, Odeljenje Društvenih Nauka: nova serija- knj.33) (Beograd: Naučno delo, 1959), 365.

¹³ “...suorum et arma et multas alias res, et abstulit similiter nobis barcham cum omnibus rebus, que erant intus”, *Hrvatska-Državni Arhiv u Dubrovniku* (më tej: HR-DADU), *Lamenta de foris*, vol. I (1370 -1373), fol. 64.

mburoja dhe një hark.¹⁴ Megjithatë, nuk saktësohet se këto armë të gjetura në anijen e tregtarit në fjalë ishin një mall apo shërbenin vetëm për mbrojtjen e anijes. E njëjta gjë vlen edhe për armët e konfiskuara nga Dandolo dhe Kontarini në mars të vitit 1376, të cilat mund të jenë armët e tyre personale.¹⁵

Kështu, më 13 mars 1376, kur me urdhër të Balshës II vlonjatët vranë fisnikët venedikas Girardo Dandolo-n dhe Pankracio Kontarini-n, si edhe plaçkitën shtëpitë e tyre, mes mallrave të grabitura përmenden edhe armët, pa dhënë detaje të tjera por me vlerë prej 5 mijë dukatesh.¹⁶ Prandaj, këto armë mund të planifikoheshin për shitje, por po ashtu mund të ishin në pronësi të këtyre tregtarëve, të përdorura për mbrojtje. Megjithatë, dihet se qytetet e mëdha tregtare si Venediku dhe Ragusa siguruan zotërinjtë lokalë apo edhe qytetet për mbrojtjen e tyre. Kështu, gjatë konfliktit të Balshajve dhe Raguzës me zhupanin Nikolla Altomano-n, në fillim të vitit 1371, komuna e Kotorrit, me gjithë traktatin e paqes që kishte lidhur me Gjergj Balshën dhe premtimin se nuk do t'i jepte kurrë armë Nikollës, kotorrrasit blenë një sasi të madhe armësh në Venedik, Marka dhe në Lombardi, të cilat ia dërguan Nikolla Altomano-s, armikut të zotit të Zetës (Balshës).¹⁷

¹⁴ *Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*, college L. Thalloczy, C. Jiriček, E. Sufflay, vol.II (Vindobonae: 1918), dok. nr. 300 (70), 18 septembre 1372. "...acceperunt michi ducatos auri XV, spata II et scutos III, archum I fulcitum..." (më tej: *Acta Albaniae*).

¹⁵ Alain Ducellier, *La Façade maritime de L'Albanie au moyen age Durazzo et Valona du XI au XV siecle*, Institute for Balkan Studies (Thessaloniki: 1981), 602.

¹⁶ *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, vol. I, Josephi Valentini (Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, 1967), dok. nr. 259 (231-232), 13 mars 1376. (më tej: *Acta Albaniae Veneta*); *Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium - Listine o odnošajih između južnoga Slavenstva i mletačke republike*, vol. 4 (od godine 1358 do 1403), skupio Šime Ljubić (Zagreb: HAZU, 1874), 111.

¹⁷ "...Et in ultima nostra ambasiata pro ipsorum concordia ad dictos dominos transmissa coram dicto ambasiatore nostrom mobili diti Catharenses promiserunt Georgio de Balsa, eorum inimico, non dare arma Nicolao çuppano, suo inimico, et certa alia pacta observare... dicti Catharenses fecerunt emi arma ab uno consive in magna quantitate Veneciis et in Marchia et Lombardia et transmitti çuppano predicto...", Jorjo Tadić, *Pisma i uputstva Dubrovačke republike*: knjiga 1 (Zbornik za istoriju, jezik i književnost srpskog naroda, treće odeljenje, knj. IV, Srpska Kraljevska Akademija (Beograd: 1935), dok. nr. 213 (222-224) (mai 1371).

Në kohën (më 1380) kur në vende të ndryshme të Ballkanit kishte filluar të përhapej një epidemi, e cila po vriste njerëz në masë, vendet e sunduara nga Balsha II nuk u prekën nga epidemia, prandaj ky i fundit filloi përgatitjen e ushtrisë së vet, e cila herët a vonë do të përballej në fushë të betejës. Me qëllim që t'i furnizonte sa më mirë depot e armëve, ai dërgoi në Raguzë një njeri të vetin për të blerë armë të reja. Ishte e paqartë nëse bëhej fjalë për një lëvizje politike dhe taktike apo për një mungesë të vërtetë armësh. Marrëdhëniet e Raguzës me Balshën II për vitin në fjalë i ilustrojnë më tej aktet e Këshillit të Rogatëve, më 24 gusht, ku Balshës nuk i jepen armë, por i ofruan mundësinë të ngarkuarit të Balshës II që me një galerë të tyren raguzanët ta transportonin por vetëm deri në Zarë, e cila pikërisht më 24 gusht 1380 po nisej drejt atij qyteti.¹⁸ Ajo çka bënë raguzanët për Balshën II ishte kërkesa e tyre për kapitenin e ushtrisë gjenoveze që t'i ruante nënshtetasit e tij, dhe veçanërisht qytetin e Ulqinit. Meqë raguzanët nuk i furnizuan me armë të dërguarit e Balshës, një tregtar raguzan me banim në Ulqin u grabit.¹⁹ Në përpjekje për të qetësuar situatën, më 10 tetor raguzanët i dhuruan Balshës II disa dhurata; më 6 nëntor, një varkë me tetë rrema iu dha Pjetër de Gondulës, ambasadorit raguzan te Balshajt; më 11 nëntor, po përmes këtij ambasadori i konfirmohet Balshës një shumë prej 30 perperësh.²⁰

Në korrik të vitit 1381, Balsha II shprehu vullnetin e tij për të blerë armë të tjera dhe kësaj radhe raguzanët jo vetëm që ia plotësuan kërkesën, por u treguan të gatshëm që të gjitha armët e dëmtuara nga përdorimi t'i pranonin në Raguzë për t'i riparuar.²¹

¹⁸ HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXXI (1380-1382), fol. 126.

¹⁹ Po aty, fol. 142; Giuseppe Gelcich, *Zeta dhe dinastia e Balshajve* (Tiranë: Shtëpia botuese 55, 2009), 132.

²⁰ “*Relationes Ragusii cum Balsa II, hoc anno insuper sequentibus illustrantur actis consilii rogatorum: die 24. augusti "Balse de Balsa" arma non conceduntur; "ambassiator Balse in galea nostra" vehatur "usque Jadram"; die 10. octobris emuntur dona pro Balsa de Balsa; die 6. novembris Petro de Gondula ambassiatori nostro ad Balsam datur barca octo remorum; die 11. novembris dona Balse valoris ypp. 30; die 14. novembris commissio Petri de Gondola firmatur...*”, *Acta Albaniae II*, dok. nr. 370. not. 1, 88.

²¹ “11 juillet 1381. “...Baise de Balsa possit emere seu facere emi a coraçaris...arma XXX quod ipsa arma possit extrahere de Raguse et quod possit certia mittere ragusio pro aptando certa sua arma...”. HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXXI (1380-1382), fol. 179; *Acta Albaniae II*, dok. nr. 374, in note.

Në kohën e konfliktit të Balshës II me Karl Topinë dhe sulmeve të herëpashershme të turqve në zotërimet e Balshës II, pa humbur kohë ai i kërkoi ndihmë në armë dhe ushtri Republikës së Venedikut. Duke pasur synime të tjera të fshehta (Balshajt kishin synim të merrnin masa kundër Tvërkos, Mbretit të Bosnjës) përveç luftës me turqit, zoti i Zetës kërkoi ndihma aq të mëdha saqë Senati venedikas mendoi të mos i jepte pa i paraqitur më parë arsyet e vërteta përse i nevojiteshin.²²

Meremetimi i armëve të vjetra dhe blerja e armëve të reja nga Balshajt në Raguzë u bë edhe në vitin 1398. Kështu, në kohën kur Gjergj II Strazimiri mbërriti në Raguzë më 27 janar 1398, i kërcënuar gjithashtu nga sulmet osmane, po atë ditë, Këshilli i qytetit i ofroi Gjergjit një shtëpi që gruaja dhe familja e tij të strehoheshin në Raguzë, nga frika e turqve. Po ashtu, ata i lejuan atij të riparonte armët e vjetra me paratë e tij dhe të blinte dhe të eksportonte fshehurazi armë të reja nga Raguzë.²³

Ka shumë mundësi që tregtarët raguzanë të kenë filluar tregtinë me armë, duke qenë të sigurt se do të gjenin në këto rajone një kërkesë të madhe për to. Por nuk ka gjurmë domethënëse për një tregti të përmasave të mëdha. Sidoqoftë, një raport nga një incident i ndodhur më vonë tregon për një tentativë tregtie me armë midis një tregtari raguzan dhe osmanëve, e cila u pengua nga rektori venedikas i Shkodrës. Duke pasur parasysh statusin e Raguzës në raport me Perandorinë Osmane, tregtari raguzan, Marino Zinzalunoli (Marinum Çinçalunoli) i kishte kërkuar kontkapitenit të Shkodrës, leje për të bartur armë në territorin e këtij qyteti, për vendet që ishin nën sundimin e sulltanit.²⁴ Fakti që ai ishte duke e parashtruar këtë kërkesë, tregon se ai priste të merrte një përgjigje pozitive nga ai. Por, përballë tensionit ekzistues midis turqve dhe Venedikut dhe ndalimit për të krishterët të mbajnë armë në vendet e “të pafeve”, kapiteni i kontit e refuzoi këtë kërkesë. Kjo përgjigje nuk e dekurajoi tregtarin e lartpërmendur raguzan, i cili nuk iu bind dhe pavarësisht ndalesës, më pas filloi kontrabandën e armëve. Ai gjeti një formë tjetër dhe fshehurazi vazhdoi të kalonte rregullisht nëpër territorin e Shkodrës arka të mbushura me armë të destinuara për turqit. Por kontrabandimi i tyre u zbulua dhe një pjesë e armëve u sekuestruan. Ky

²² Gelcich, *Zeta dhe dinastia e Balshajve*, 114.

²³ HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXXII (1401-1404), fol. 109^r.

²⁴ “*mercatores ragusinum nomine Marinum Çinçalunoli... si concederetur ei licentia portandi per territorium Scutari, arma, ad partes subiectas turchis ...*”, *Acta Albaniae Veneta*, vol. III, dok. nr. 880 (238).

tregtar guximtar raguzan e sfidoi ndalimin që i bënë autoritetet venedikase për të vazhduar tregtinë e tij, gjë që dëshmon se ajo duhet të ishte shumë fitimprurëse. Ka shumë të ngjarë që nën Balshajt është zhvilluar ky aktivitet i tregtimit të armëve po aq fitimprurëse, por tashmë në formë zyrtare.²⁵

Në një rajon të trazuar si Arbëria e atëhershme, Raguzat gjeti treg për një produkt shumë fitimprurës: armët. Nëse i përjashtojmë disa raste sporadike të përmendjes së armëve të plaçkitura apo të konfiskuara në portet shqiptare, të dhëna më të plota për blerjen e armëve nga raguzanët rezultojnë për shek. XV. Kështu, në fillim të shek. XV, në kohën e fillimit të konflikteve me venedikasit, raguzanët u shisnin armë Balshajve.²⁶

Të dhënat dokumentare sporadike mbi tregtinë në Zetë, saktësojnë se ky rajon eksportonte produkte natyrore, si: dru, drithëra ose kripë, ndërsa importonte mallra të përpunuara duke zbuluar kështu një ekonomi tregtare të tipit "kolonial". Në mesin e kësaj tregtie, nuk mungonte edhe ajo e armëve, e cila me shumë gjasa, në shumicën e rasteve, kryhej fshehurazi nga tregtarët. Për më tepër, të gjitha bizneset e suksesshme, del se ishin në duart e tregtarëve të huaj, raguzanë dhe venedikas, të cilët prandaj mbanin një monopol tregtar.

Lidhur me qëndresën dhe luftën e fisnikëve shqiptarë kundër sundimit të Venedikut, për shkak të rrezikut serb si dhe nga rreziku osman që u qëndronte mbi krye, në vazhdimësi ndeshim kërkesa nga banorë të komunave (Shkodra, Drishti, Tivari, Ulqini, etj.) drejtuar pushtetit qendror për furnizimin e tyre me armë e mjete të tjera mbrojtëse, për rekrutimin e ushtarëve, për ushtarët mercenarë, për fortifikimin e qyteteve etj. Të gjitha këto masa kërkoreshin në të mirë të mbrojtjes së qyteteve.²⁷ Tivarasit, më 1452, kërkonin nga Sinjoria pos tjerash që të merreshin masa për të sjellë në Tivar balestra, shigjeta,

²⁵ "...quod dictus mercator ragusinus voluit prius se informari si concederetur ei licentia portandi per territorium scutari, arma, ad partes subiectas turchis, fuit ei responsum quod non. Et non obstante hoc, dictus ragusinus in quibusdam capsis portabat per territorium scutari, dicta arma oculte contra ordines...que quidem arma sic inventa portari per fraudem et contra bannum...", Po aty, dok. nr. 880 (238-239), 14 juin 1401.

²⁶ HR-DADU, *Diversa Cancellariae*, Vol.XXXV (1403-1405), fol. 184^v (21.05.1405).

²⁷ Luan Malltezi, *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas 1392-1478*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: 1988), 125-127, 133.

bombarda të vogla, pushkë (schiopeti), barut për bombarda në mënyrë që kështjella e Tivarit t'u bënte ballë sulmeve të mundshme.²⁸ Kjo kërkesë u përsërit më 18 tetor të vitit 1494, ku komuna e Tivarit kërkoi nga Venediku të dërgonte së paku 50 ushtarakë për arsye se në qytete nuk kishte “*as bombarda as spinarda dhe askush që t'i riparonte balestrat*”.²⁹

Llojet armëve: punëtoritë e zejtarëve dhe farkëtarët

Armët e ftohta

Një vend të rëndësishëm për nevojat e luftës në shoqërinë mesjetare në Arbëri e Zetë, zinin mjeshtërit dhe punishtet e farkëtarit, të vendosur në lagje të veçanta dhe të organizuar në shoqëri zejtare. Farkëtarët, përveç punimit të objekteve të ndryshme nga metali, punonin edhe thika, shpata, shtiza, shigjeta, parzmore, mburoja, hobeja me shkop, topuzë, helmata etj., për nevojat e ushtrisë. Në mesin e farkëtarëve, një pozicion të rëndësishëm ekonomik dhe shoqëror në Kotorr e zinin ata që dalloheshin mes tyre si mjeshtër të prodhimit të shpatave, shigjetave, heshtave, mburojave dhe parzmoreve. Shpatëpunuesit e Kotorrit ishin të njohur në të gjithë Zetën dhe në qytete të tjera arbërore. Shpatarët e shquar u kërkonin farkëtarëve të zakonshëm të bënin punë përgatitore (fillestare) për ta, kurse ata në fakt punonin për shkëlqimin e shpatave, mprehtësinë e tyre, si dhe zbukurimin e armëve me shenja të ndryshme, shpesh prej argjendi dhe ari. Kërkesat për shpata ishin të mëdha, saqë, ndonjëherë, porositeshin edhe deri në gjashtëqind shpata hekuri vetëm nga një farkëtar i zakonshëm.³⁰ Përveçse në Kotorr, një numër i madh armëpunuesish përmenden në fshatrat e Pashtroviqëve, Palabardhëve (Bjelopavliqët), Tivarit, Budues dhe disa në fshatrat e rajonit të Shkodrës.³¹ Më 1 korrik 1359, mësohet se Këshilli i Raguzës kishte vendosur të linte të lirë një shpatar nga Tivari, të quajtur “*Bratoe shpatari nga Tivari, i cili qe kapur me ata në Budua*”. Shpatarë të tjerë përmenden: në Shkodër më 1386 (*Nikollë farkëtar* prej Shkodre), në

²⁸ *Po aty*, 135.

²⁹ *Po aty*, 134; *Dokumente për historinë e Shqipërisë 1479-1506*, Pjesa II (1499-1506), përgatiti Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: 1979).

³⁰ *Istorija Crne Gore, II/2: od kraja XII do kraja XV vijeka* (Titograd: Redakcija za Istoriju Crne Gore, 1970), 238.

³¹ *Po aty*.

Ulqin më 1399, një tjetër me emrin *Nikollë shpatari*, më 1406, një tjetër *Nikollë kovaçi* etj.³²

Armëpunuesit e Kotorrit nuk arrinin të siguronin të gjitha armët që u përdorën në shek. XIV-XV, as nuk synonin t'i plotësonin nevojat lokale. Brenda biznesit të tregtarëve kotoras, ata punonin për tregun dhe furnizonin klientët pavarësisht se nga vinin. Në anën tjetër, në Kotorr shiteshin armë të ardhura nga vende të tjera, veçanërisht kur u sillnin fitime të mira tregtarëve. Pra, veprimtaria e tyre nuk drejtohej nga motive patriotike apo politike, ndonëse Kotorri si komunë ishte pothuajse vazhdimisht në konflikt me zotërinjtë e Zetës.³³

Nga fundi i shek. XIV dhe fillimi i shek. XV, në Kotorr njiheshin më shumë se 90 farkëtarë. Mjeshtri i shpatave, Radonja, arriti një marrëveshje me farkëtarin Andrea Mileti nga Tivari, në fillim të shtatorit 1436, për të punuar së bashku në prodhimin e shpatave një vit më pas, më 1437. Sipas dokumentit, Andrea kishte për detyrë të farkëtonte shpatat, të bënte doreza dhe këllëfë, ndërsa Radonja duhej të kryente punimet përfundimtare mbi shpatat e zeza (nigras), t'i lustronte dhe të vendoste yje e lëkurë në këllëfë. Për më tepër, marrëveshja e vitit 1436 tregon se farkëtarin Andrea duhej t'i paguante Radonjës 1 dukat ari për 7 shpata të përfunduara. Gjashtë vjet më vonë, disa shpata janë përmendur pas një mosmarrëveshjeje. Farkëtarin Andrea, në atë kohë një qytetar nga Tivari, i dha Radonjës disa shpata për qëllime shitjeje dhe shlyerje borxhi prej 100 dukatesh veneciane.³⁴

Të dhënat dokumentare që i përkasin pjesës së parë të shek. XIV tregojnë për një armëpunues në Prizren. Bëhet fjalë për një shpatar nga fshati Çabiq i Kosovës, i cili përmendet në Krisobulën e manastirit të Deçanit të vitit 1330. Dy vjet më vonë, një shpatar Martelo nga Raguza dhe djali i tij përmenden se kishin një punishte armësh në Prizren.³⁵ Lidhur me shpatat në zotërimet e Balshajve, përkundër mungesës së

³² *Acta Albaniae*, II, dok. nr. 140, 395, 622.

³³ *Istorija Crne Gore, II/2: od kraja XII do kraja XV vijeka*, 239.

³⁴ *Crne Gore - Državni Arhiv, Istorijском Arhivu Kotor* (CG DA 1, IAK) - Sudsko Notarski Spisi-Kotor (*Acta notarilia*), vol. VI, fol.13; Marko Aleksić, *Mediaeval swords from Southeastern Europe: material from 12th to 15th century* (Belgrade: Dedra, 2007), 16-17.

³⁵ Miloš S. Milojević, "Dečanske hrisovulje", *Glas Srpsko Učeno Društvo* knj. XII (Beograd: 1880), 91; Đurđica Petrović, "Oružje", *Istorija primenjenih umetnosti kod Srba*, Knjiga 1 (Beograd: Muzej primenjene umetnosti, 1977), 128.

konfirmimeve konkrete, mund të supozohet se disa prej tyre të përmendura në Raguzë në gjysmën e dytë të shek. XIV ishin të njëjta ose të ngjashme me shpatën e pikturuar në manastirin e Deçanit (rreth vitit 1350), të cilat janë identike me shpatat e quajtura “pallë”, që shpesh përshkruhen në Biblën e ilustruar të Mbretit çek Venceslaus IV nga fundi i shek. XIV. Të dyja shpatat, ajo çeke dhe ajo e pikturuar në Deçan kanë një teh të lakuar, me karakteristikat e tehut të shpatës persiane e mprehur vetëm nga njëra anë dhe një dorezë që përfundon në një mollëz të rrumbullakët, si në dorezat e shpatave të tjera.³⁶

Kanë qenë të dalluara sidomos pallat, të cilave fundi i dorezës u përfundonte me kokë luani apo zogu. Meqë këto ishin koka me sy, në popull njiheshin si “*palla me sy*” apo “*shpata me sy*”.³⁷

Krisobula e Deçanit jep të dhëna për disa armëpunues të tjerë. Sipas saj, gjatë viteve 1305-1447 në Kotorr kishte rreth 90 farkëtarë dhe në mesin e tyre, 14 ishin shpatarë, 4 punues të parzmoreve, 2 të mburojave dhe vetëm 1 mjeshtër që punonte në dekorimin e mburojave dhe të helmetave.³⁸

Sipas studiuesit kroat Ciro Truhelka, një lloj shpate e quajtur “*shpata shqiptare*” ishte shumë e njohur gjatë shek. XV dhe u përdor gjerësisht në Arbëri, Zetë, Kosovë, Bosnjë dhe Serbi. Një ekzemplar i kësaj shpate ruhet në Muzeun Kombëtar të Bosnjës dhe të Hercegovinës, në Sarajevë.³⁹

Lidhur me përdorimin e gjerë që kishin këto shpata (shpata shqiptare) gjatë kësaj kohe, dëshmon edhe regjistri i armëve të qyteteve të Dalmacisë dhe Bokës së Kotorrit, të regjistruara vite më vonë, më 1683. Në këtë regjistrë një numër i këtyre shpatave është regjistruar si *spade albanesi*. Në Zarë janë regjistruar 410 shpata të tilla, në Shibenik 889, në Split 21 etj. Nga ky numër i konsideruar i ruajtur i *spade albanesi*, del se përdorimi i tyre ishte më i popullarizuar sesa shpatat italiane.⁴⁰

Fatkeqësisht, të dhënat burimore nga arkivat e qyteteve të Adriatikut Lindor nuk japin informacion për importet nga disa rajone

³⁶ Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku*, 37; Škrivanić, *Oružje u srednjovekovnoj*, 44.

³⁷ Lajçi, *Armët e shqiptarëve*, 7.

³⁸ Milojević, “Dečanske hrisovulje”, 90-91, 96.

³⁹ Ciro Truhelka, “Osvrt na sredovječne kulturne spomenike Bosne”, *Glasnik Zemaljskog Muzeja Bosne i Hercegovine*, no.XXVI (Sarajevo: 1914), 242 + fig. 49.

⁴⁰ Lajçi, *Armët e shqiptarëve*, 9.

europiane që me siguri kanë ndodhur, kryesisht nga punishtet gjermane apo punishte të tjera që shpërndanin produktet e tyre në të gjithë Europën. Mungojnë edhe të dhënat për tregtinë e armëve, përkatësisht për shpatat e prodhuara në vend dhe ato të prodhuara në rajonet e tjera të Europës Juglindore.

Në disa raste specifike, për shkak të nevojës për të ndarë ekspertizën e caktuar, disa armëpunues dërgoheshin me mision të sundimtarët e tjerë, ose silleshin nga vende të tjera, veçanërisht kur kishin të bënin me teknologjinë e luftës.⁴¹

Sidoqoftë, në gjysmën e dytë të shek. XIV, shtiza të zakonshme u prodhuan në Raguzë, dhe kjo, natyrisht, në një kohë kur Republika e Shën Vlashit kishte frikë se do të sulmohej. Gjatë luftës midis Venedikut dhe Gjenovës, në prill të vitit 1379, Këshilli i qytetit përcaktoi që fitimi i nxjerrë nga farkëtarët të përdorej për majat e hekurta të shtizave. Trembëdhjetë vjet më vonë, kur turqit depërtuan në zotërimet e Gjergj Strazimir Balshës, raguzanët Rafael Guçetiq dhe Pashko Rastiq u zgjodhën si mbikëqyrës që duhej të kujdeseshin për të prodhuar maja për shtizat. Ato koka shtizash sigurisht që ishin bërë për komunën nga farkëtarët, dhe pasi ishin mjeshtëri private, *jo salarë*, ata mbetën të papërmendur në dokumente. Pa dyshim, ata farkëtonin edhe koka për shtizat (*ferrum ad lanceam*), të cilat patronët e anijeve tregtare ishin të detyruar që për shtizat e shtetit të huazuara më herët t'i kthenin në komunë.⁴²

Mjeshtër shqiptarë të shtizave në periudhën e sundimit të Balshajve, përkatësisht në vitet 1388-1399 përmenden Stojan Shkodrani dhe Martin Balistari, për punimin e balistrave dhe 20 000 shtizave të shkurtra prej hekuri.⁴³

Vetëqitësi, balistra apo *balestra* ishte, po ashtu, armë e veçantë që shërbente për hedhjen e shigjetave në luftë dhe kishte përdorim të gjerë si në kalorësi, ashtu edhe në këmbësori. Arrinte largësi dhe depërtueshmëri më të madhe se harku e shigjeta. Ushtarët e armatosur me armë të tilla u quajtën *balestarë*. Në kohën kur Venediku nuk po siguronte paqen me Balshën (më 7 maj 1409), Sinjoria mori vendim të dërgonte përforcime të

⁴¹ Mihailo Dinić, "Prilozi za istoriju vatrelog oružja u Dubrovniku i susednim zemljama", *Glas Srpske Kraljevske Akademije*, no. CLXI (Beograd: 1934), 83-84.

⁴² Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku*, 50.

⁴³ "Armëtarët", *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë (Tiranë: Shtypshkronja e Re, 1985), 1196.

reja ushtarake në Arbëri, në qytetet e pushtuara prej tij. Në mesin e ushtarëve që do të dërgoheshin në anët e Arbërisë përmenden njëqind të armatosur, d.m.th. burra me ushta pa kuaj, por që duhej të kishin shalat me vete, si dhe njëqind këmbësorë, ndër të cilët të ishin nja pesëdhjetë deri në gjashtëdhjetë balestarë.⁴⁴

“Për më tepër, meqenëse në Tivar janë disa burra të armatosur që vlejné pak dhe nuk janë në rregull ashtu siç kërkohet, duhet të dërgohen në qytetin e sipërthënë të Tivarit, në vend të atyre të armatosurve, 500 këmbësorë, ndër të cilët të jenë 30 balestarë që duhet të qëndrojnë aty dhe të punojnë për nderin tonë”.⁴⁵

Helmeta mbante një pozicion specifik midis armëve mbrojtëse; u përdor për të mbrojtur pjesën më vitale të trupit – kokën. Si mjet mbrojtës, helmeta përdorej gjerësisht nga të gjitha radhët e ushtarëve. Në trevat arbërore përdorshin disa lloje helmetash. Krahës përkrenares, mbulesa e kokës prej hekuri është përdorur në Mesjetë me qëllim mbrojtjen e kokës. Pjesa e brendshme e helmetës zakonisht mbulohej nga një kapuç lëkure, që synonte të mbronte kokën nga dëmtimet e mundshme gjatë përdorimit të përkrenares. Lloji i përkrenares, e cila u përdor deri në fund të shek. XIV ishte e gdhendur në monedhën e Balshajve, dhe kjo dëshmon faktin se përkrenarja ishte përdorur gjerësisht në zotërimet e Balshajve.⁴⁶

Përmirësimi i harqeve dhe i shigjetave u shoqërua me ndryshimin edhe të formës së helmetës. Kështu, helmeta e formës konike gjithnjë e më shumë u shndërrua në një formë sferike me kallo sipërfaqësore ose gjysmë të thella. Një përkrenare konike, me buzë të mprehta dhe prerje për shikimin dhe vrima për ajrin, u shfaq gjatë viteve 1360-1430.⁴⁷

Nga mesi i shek. XIV, Raguza ishte orientuar drejt burimeve të veta dhe që atëherë, të paktën një mjeshtër i armëve mbrojtëse ishte vazhdimisht në dispozicion të shërbimit komunal (veshje nga metali,

⁴⁴ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV*, vëll. II, Pjesa 2 (1406-1410), transkriptuan dhe përkthyen Injac Zamputi, Pranvera Bogdani, redaktoi dhe përgatiti për botim Edmond Malaj, Instituti i Historisë / ASA (Tiranë: Botimet albanologjike, 2019), dok. nr. 65 (199-200).

⁴⁵ *Po aty*, 200-201.

⁴⁶ Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku*, 98.


⁴⁷ Škrivanić, *Oružje u srednjovekovnoj*, 153; Bashkim Lajçi, “Të dhëna për armët e shqiptarëve gjatë mesjetës”, *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, nr. 37/2007 (Prishtinë: 2008), 226.

shq.: *parzmore*, *pancir*, lat.: *coracia*, *coraga*, *collare*, *collarium*); përveç disa mjeshtërive të pancirëve që ishin zejtarë të qytetit, kishte edhe mjeshtër armësh, të cilët kishin krijuar një marrëdhënie gjysmëzyrtare me komunën, e që paguanin për të marrë me qira një punëtor. Pjesa e brendshme e parzmores mbulohej nga disa pllaka hekuri dhe shërbente për mbrojtjen e organeve vitale të trupit. Parzmoret e thurura, të mëngët dhe gjunjët, forcoheshin me pllaka të vogla për mbrojtjen më të mirë të këtyre pjesëve. Këto pllaka quheshin *plastron* dhe u përdorën gjatë shek. XII-XIV. Përveç *plastronit*, në fund të shek. XIV parzmores iu shtua një pjesë shtesë për mbrojtjen e shpinës.⁴⁸

Për më tepër, vlera dhe rëndësia e parzmoreve metalike apo këmishëve metalike si mjet mbrojtës vërtetohej nga interesimi i madh i drejtuesve ushtarakë për t'i marrë ato në sasi të mëdha. Shembull i këtij interesimi ishte rasti kur Balshajt morën qeverisjen në Prizren. Shteti i Balshajve arriti një zgjerim të madh territorial më 1371 dhe më 1373. Pas vdekjes së Mbretit Vukashin në lumin Marica (26 shtator 1371), Gjergji I Balsha mori nën zotërim Prizrenin (1371) dhe më pas edhe Pejë. Territori i Kosovës për Balshajt në këtë kohë ishte i një rëndësie të veçantë në përputhje me nevojat objektive të zhvillimit të mëtejshëm ekonomik të shtetit të tyre. Ndërmjet Kosovës dhe viseve të tjera arbërore, që gjendeshin në kuadrin e shtetit të Balshajve në atë kohë, ekzistonin lidhje të rëndësishme ekonomike tregtare. Në këtë frymë, Prizreni ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm për tregtinë e Raguzës, meqë në të jetonin dhe vepronin shumë tregtarë raguzanë. Me synimin për t'u afruar me Balshajt, përfaqësues të shquar të familjeve të Raguzës në Prizren dhanë si dhuratë parzmore. Kështu, sipas një dokumenti të Raguzës të 10 shtatorit 1372, rektori dhe gjyqtarët e Republikës së Raguzës vendosën që secila shtëpi e tregtarëve raguzanë me banim në Prizren të paguante një vlerë prej 5 libra argjendi (*librarum V de argento*) për të blerë katër parzmore si dhuratë për Gjergj I Balshën, për marrjen e Prizrenit. Përveç tre vëllezërve, një parzmore iu dha edhe djalit të vëllait të madh, nga tre sundimtarët, Gjergj II Strazimir. Dhurata konsiderohej jashtëzakonisht e vlefshme në aspektin diplomatik, dhe me të donin të shprehnin gëzimin për suksesin e tij.⁴⁹

⁴⁸ Škrivanić, *Oružje u srednjovekovnoj*, 136.

⁴⁹ "...*determinantum fuit coracias IIII, que fuerunt donate Jure de Balsa vallis librarum V de argento coracia sine panceria, per mercatores in Prisreno, quando dictus Jura cepit castrum dictrum dicti loci, debeant solui per capita domorum*



*Tregtarët raguzanë në Prizren u dhurojnë Balshajve parzmorë
(10 shtator 1372)*

Këta mjeshtër armësh të qytetit gëzonin një reputacion të caktuar, saqë Këshilli i qytetit u detyrua t'u tërhiqte vëmendjen të dërguarve të Balshës II në korrik të vitit 1381, në mënyrë që të ishin në gjendje të blinin armatim *a coracariis comunis Ragusii et non a civibus*. Të dyja kategoritë e zejtarëve të përmendur i plotësonin mjaftueshëm nevojat sa i përket armatimit për komunën dhe për banorët e Republikës së Raguzës.⁵⁰ Kështu, Senati i Raguzës në korrik të vitit 1381 i lejoi Balshës II të blinte në Raguzë mjete të blinduara mbrojtëse – parzmorë ose mjete të tjera metalike – 30 parzmorë (*Balsa de Balsa postit emere arma XXX a coraçariis*), si dhe të lejonte transportin e llojeve të tjera të armëve; popullit të Balshës II iu lejua të riparonte armët në Raguzë.⁵¹

Në inventarin e mjeteve mbrojtëse të arbërorëve dhe të tjerëve, një vend të rëndësishëm zë mburoja. Mburoja i është nënshtruar transformimit të formës gjatë zhvillimit të saj, si për shembull, forma sferike ose ovale. Përveç këtyre, shqiptarët përdornin forma të tjera

mercatorum, qui tunc habitabant in Prisreno, et hoc ad petitionem Dymitri de Benessa tamquam procuratoris Pocre de Benessa”, HR-DADU, *Diversa Cancellariae*, vol. XXIII (1371-1372), fol. 138r (10.IX.1372); Škrivanić, *Oružje u srednjovekovnoj*, 148; Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku*, 103; Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, 94.

⁵⁰ HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXIV (1378-1381), fol. 179^r (11.VII.1381); Škrivanić, *Oružje u srednjovekovnoj*, 148; Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku*, 100.

⁵¹ HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXIV (1378-1381), fol. 179^r; *Acta Albaniae*, vol. II, dok. nr. 374 (89); Škrivanić, *Oružje u srednjovekovnoj*, 148; Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku*, 100.

mburojash, si ato në formën e trekëndëshit që ishte gdhendur edhe në një monedhë të Balshajve.⁵²

Mburojat e Raguzës (*pavesius*) ishin prej druri cilësor, të cilat në sasi dhe përmasa të mëdha vinin nga Ulqini, Durrësi dhe Lezha – druri dhe skeleti ishin të mbuluara mirë me lëkurë kali dhe të pajisura me brezat e nevojshëm, pllaka hekuri dhe piktura me ngjyra. Madhësia e një mburoje varej nga qëllimi i saj: mburoja në formë të zakonshme, mburoja për postin e rojeve, mburoja për ekuipazhin e anijeve dhe mburoja të vogla. Çmimi i mburojës varej nga madhësia e saj. Mburojat për rojet ishin më të shtrenjta (4 copë për 4,5 dukate), të ndjekura nga mburojat e zakonshme – 1 dukat për copë, ato të voglat – 4 copë për 3 dukate, si dhe ato për anije (17 copë për 11 dukate e 10 groshë).⁵³

Armët e zjarrit dhe artileria

Krahas armëve të ftohta, kjo periudhë shënon përdorimin e armëve të zjarrit, si armë sulmuese për luftime në largësi. Fuqia e sulmit të tyre ishte kimike, ndërsa fuqia e armëve të ftohta ishte mekanike. Fillimisht ishte një armë unike, por prodhimi i përmirësuar i mjeteve dhe i barutit dha mundësi të reja për të shkrepur armët; detyrat e reja ishin përpara armëve të zjarrit. Përparimet e reja i ndanë armët e zjarrit në artileri (bombarda) dhe pushkë me fitil (schiopi). Bombardat, bombardelat, mortirat, si edhe mjetet për hedhje (manganët dhe spingardat) ishin të përmasave, kalibrit dhe peshave të mëdha, ndërsa pushkët ishin të një kalibri të vogël. Në gjysmën e dytë të shek. XIV, dhe konkretisht në vitin 1364, u shfaqën për herë të parë armët e zjarrit të dorës, të cilat më vonë do të quheshin armë të këmbësorisë. Armët e zjarrit të dorës në Francë u shfaqën në vitin 1375, kurse në Gjermani në vitin 1379.⁵⁴ Duke u mbështetur në dokumentet e vendeve fqinje, me të cilat arbërorët patën marrëdhënie diplomatike e ekonomike, mund të thuhet pa përjashtim se, që nga shek. XIV ato armë u përdorën edhe nga Balshajt.

Fokusi i lajmeve për prodhimin e bombardave apo topave, si edhe shpeshësia e shfaqjes së tyre në burime dokumentare, tregon se vjeshta e vitit 1378 dhe, në përgjithësi, kohëzgjatja e luftës me Venedikun, mund

⁵² Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku*, 98.

⁵³ *Po aty*, 98-99.

⁵⁴ Drishti, *Armët dhe armëtarët*, 25.

të shënohet si një periudhë kur u prodhuan bombardat me gjuajtje më të largëta të kohës. Për më tepër, mund të pretendohet se shek. XIV shënon një periudhë të prodhimit kryesor të armëve të zjarrit dhe se fondi kryesor për bombardat i krijuar në atë kohë, më vonë u përdor nga qeveria e Raguzës sipas gjykimit të saj.⁵⁵

Për sa i përket teknikës së armëve, venedikasit kishin një avantazh në armët e lehta ndaj vendeve të tjera ndërluftuese, por jo ndaj Balshajve. Që në fillim të shek. XV, Balshajt kishin artilerinë e tyre. Raguzë i furnizonte Balshajt me armë moderne.⁵⁶

Sipas burimeve të Raguzës, më 18 prill 1379 Këshilli i Rogatëve të Raguzës, pasi e peshoi çështjen e kërkesës për armë, hodhi poshtë kërkesën e Balshës II (Balsa de Balsa) për t'i dhënë atij një bombardë.⁵⁷ Një vit më vonë, më 1380, Balsha II iu drejtua me një kërkesë të re për armë (ndoshta edhe topa), por ai u refuzua përsëri me pretekstin se komuna e Raguzës kishte nevojë për armë. Më në fund, në vitin 1381 Republika e Raguzës i dha hua 3 bombardat dhe barut Gjergj II Strazimirit, duke përfshirë edhe detyrimin për t'i kthyer ato. Me sa duket i rikuperuar nga sëmundja, tashmë në shkurt të vitit 1384, ai, përsëri i kërkoi Raguzës një top (bombardë) dhe një sasi të caktuar baruti, sepse ndihej në telashe me turqit në Jug, në Arbëri. Më 1384, përsëri Senati i Raguzës e hodhi poshtë kërkesën e Balshës për bombardat dhe barut, por në vend të kësaj vendosi t'i jepte 1 mburojë (parzmore) dhe 1 helm të çeliku (barbut).⁵⁸

Prodhimi i këtyre bombardave në shek. XIV, që përmenden për herë të fundit në janarin e vitit 1393, lidhej gjithashtu me situatën politike, përkatësisht, me depërtimin e turqve në zotërimet e Gjergj II Strazimirit. Reagimi i Raguzës ndaj këtyre zhvillimeve ishte vendimi për

⁵⁵ Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku*, 98-99, 127.

⁵⁶ "2 octobre 1397, *De armando nostrum brigintinum pro domina Theodora Jure de Balsa, que est hic, pro conducendo et portando illam usque ad Avalonam, expensis nostri Communis*", Nicolae Jorga, *Notes et extraits pour servir à l'histoire des croisades au XVe siècle*, vol. 2 (Paris: E. Leroux, 1899), 71.

⁵⁷ "Prima pars est de concedendo unam bumbardam Balse de Balsa. Secunda pars est de non concendo", *Monumenta Ragusina: libri reformationum*, Tomus IV, Ann. 1364-1396, collegit et digessit Josephus Gelcich (*Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium*, knj. 28) (Zagrabiae: Sumptibus Academiae scientiarum et artium, 1896), 207.

⁵⁸ HR-DADU, *Reformationes*, vol. XXIV (1378-1381), fol. 139^v.

të filluar prodhimin e dy bombardave të mëdha, të cilat në atë kohë paraqisnin gamën më të madhe të armëve të zjarrit.

Ndryshe nga lloji i parë i bombardave të mëdha (*bombarde cum crochis*), lloji i dytë që u prodhuan në Raguzë ishin disa bombardat të vogla (*bombarde parve*), forma e të cilave nuk ndryshonte nga forma e topave më të mëdhenj. Gjatësia e tyre, pra gjatësia e mostrave të ruajtura, ishte deri në 40 cm. Edhe kësaj radhe, përmendja e tyre lidhet me Balshajt. Këto bombardat të vogla ishin një lloj i armëve të vogla të dorës, një pararendës i pushkëve të mëvonshme. Ato përmenden për herë të parë në Raguzë më 6 maj 1391, kur Këshilli i Vogël miratoi kërkesën e Gjergj II Strazimitrit dhe i huazoi atij armë zjarri të dorës.⁵⁹ Në marrëveshje, autoritetet e Raguzës shprehnin besimin e tyre se sundimtarit të Zetës i duheshin armët për të mbrojtur territorin nga sulmet osmane apo nga fisnikëria e pakënaqur. Formulimi i marrëveshjes për huadhënien, dëshmon për ekzistencën e tyre edhe para datës në fjalë. Më 7 maj të vitit 1397, ato dëshmohen përsëri me rastin e dhënies së një bombarde tjetër të vogël për të armatosur një anije tregtare.⁶⁰

Republika e Raguzës, më 6 maj 1398, vendosi në Këshillin e Vogël t'i huazonte Gjergj II Strazimitrit tri nga topat (bombardat) e saj, me 30 libra barut, me kusht që ato të riktheheshin në formë huaje nga ana e Gjergjit.⁶¹ Ndërsa më 4 gusht 1401, rektori i Shkodrës bëri përsëri përpjekje për të marrë nga Venediku rreth 100 arka me shtiza të shkurtra (verentona), 50 balista, mjeshtër për riparimin e tyre dhe 50 fuçi me barut për topa.⁶²

Për përdorimin e armëve të zjarrit një rëndësi të veçantë kishte sigurimi i materialit ndezës, barutit. Bazuar në burimet që kemi në dispozicion për përdorimin e armëve të zjarrit nga principatat arbërore dhe shkëmbimin reciprok në mes të mjeshtërve zejtarë të ndryshëm, sidomos gjatë shek. XIII-XV, kryesisht në Raguzë nga Balshajt dhe

⁵⁹ Nella Lonza, Zdravko Šundrica, *Odluke dubrovačkih vijeća 1390-1392* (Zagreb – Dubrovnik: Zavod za povijesne znanosti HAZU u Dubrovniku, 2005), 159.

⁶⁰ Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku*, 103, 129-130.

⁶¹ "...captum fuit de prestando domino Georgio de Strazimir tres de bombardis nostris de parvis, facta prius promissione de restituendo ipsas communi nostro, et libras XXX pulveris a bombardis", *Acta Albaniae* II, dok. nr. 468.

⁶² Po aty, dok. nr. 672; *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëll. I (1401-1405), përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi (Tiranë: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1987), dok. nr. 124 (213-214); Drishti, *Armët dhe armëtarët*, 26.

feudalët e tjerë arbërorë, del se baruti me tym në zotërimet arbërore është përdorur në armët e zjarrit që nga mesi i shek. XIV, i prodhuar edhe në trevat shqiptare.⁶³

Për sa u përket armëve apo pajisjeve për hedhje, ato ndaheshin në të mëdha dhe të vogla “*machinas ... magnas et ... parvas*”. Por, kur bëhej fjalë për krijimin, riparimin apo vendosjen e tyre në vende të veçanta, atëherë përmendeshin emrat e tyre. Sipas burimeve arkivore të Raguzës, në shek. XIV janë përdorur tri lloje mjetesh hedhëse: spingardë, mangan dhe trabuki. Predha për spingardën ishin shigjeta (veretones spingardarum) të rënda prej hekuri, shigjeta me sharrë etj. Ka shumë mundësi që nga tri spingardat e punuara gjatë vitit 1361, gjatë luftës në Ston, në fillim të janarit 1362, njëra t’i jetë dërguar Balshajve në kështjellën e tyre në Budua. Këtë dërgesë e kishin kërkuar Balshajt nga qeveria e Raguzës që në korrik 1361, kurse dy të tjerat përmenden në kalanë e Stonit më 1376.⁶⁴ Nga mangani dhe trabuki, nga ana tjetër, u hodhën gurë, madhësia e të cilave varej nga dimensionet e vetë pajisjes. *Manganët* (gurëhedhëse) si armë e rëndë hedhëse u përdorën nga Balsha III në luftë kundër Venedikut, gjatë rrethimit të qytetit të Shkodrës në vitin 1405.⁶⁵

Fuqia ushtarake e Balshajve përballë Venedikut

Rritja e forcës së ushtrisë dhe armatosja e Balshajve ishte bërë shqetësim për Republikën e Shën Markut. E gjendur në vazhdimësi para rezistencës së feudalëve shqiptarë, sidomos nga Balshajt, në gusht të vitit 1405, kapiteni venedikas i Gjirit, Marino Karavello bënte vlerësime për mënyrën se si do të ishte në gjendje të qetësonte rajonet e sapopushtuara, domethënë Ulqinin, Tivarin dhe Buduan. Në vlerësimet e tij, ai llogariste se për ta dëbuar Balshën III i nevojiteshin të kishte në këtë rajon, në dispozicion të tij, të paktën 300 kalorës dhe 200 këmbësorë. Prej këtyre, gjatë tetorit të të njëjtit vit, për në Arbërinë venedikase u nisën vetëm 100 këmbësorë. Në luftën e tij përballë Venedikut, Balsha III përdori turqit

⁶³ Drishti, *Armët dhe armëtarët*, 164.

⁶⁴ Petrović, *Dubrovačko oružje u XIV veku*, 83-85.

⁶⁵ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëll. I (1400-1405), përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: 1987), dok. nr. 526 (590-591).

dhe sllavët.⁶⁶ Nuk ishte medoemos thjesht potenciali ushtarak i Balshajve që kanoste këtu Venedikun, por përkrahja që gjetën Balshajt brendapërbrenda provincës venedikase. Ndihma që u dhanë osmanët Balshajve me trupa apo së paku me mjete diplomatike, e rëndoi gjendjen e venedikasve. Përballë këtij rreziku, shumë shpejt, Venediku vendosi nisjen e 100 *heshtarëve* dhe 100 *këmbësorëve* të planifikuar më parë.⁶⁷

Me kërcënimin e vazhdueshëm që vinte nga Balsha III, besnikëria e vendësve por edhe e rekrutëve të huaj në ushtrinë venedikase vihej në dyshim. Gjithashtu, Republika e Venedikut ishte e vetëdijshme se ajo duhej të siguronte pagat e tyre. Në shtator të vitit 1412, proveditori venedikas, Bertuccio Diedo, informonte se Ulqini ishte në varfëri të madhe dhe se banorët e tij po përballeshin me vështirësi të shumta për të jetuar atje, por disa prej tyre, nëse do të paguheshin, do ta mbronin me forcë këtë qytet. Senati urdhëroi rektorin e qytetit, që për ruajtjen e tij të shpërblente 50 shqiptarë ndër më besnikët dhe më të përshtatshmit për profesionin e armëve, për t'i nxitur ata në mbrojtjen e këtyre zotërimeve.⁶⁸

Në fillim të vitit 1418, Balsha III filloi disa sulme ushtarake mbi zotërimet e Republikës. Për mbrojtje, ajo vendosi të dërgonte një kompani prej 25 deri në 30 ushtarësh, për t'u koncentruar në kështjellën e Shkodrës. Ai ngarkoi rektorin e tij t'i shkarkonte këmbësorët që nuk kishin treguar mjaftueshëm besnikëri, kurse një pjesë tjetër të ushtarëve të tjerë që ishin caktuar për mbrojtjen e qytetit dhe ishin të dyshimtë, urdhëroi që duhej të dërgoheshin në kufijtë e rrethinave të Shkodrës, në mënyrë që ata të mos gjendeshin në mbrojtjen e një pozicioni strategjik. Nëse ndonjëri prej tyre shpallej fajtor për tradhti, atëherë ndaj tyre do të merreshin masa të nevojshme. Në të vërtetë, njësitë e këmbësorisë së dërguar nga Republika në vitin 1418 në Shkodër kur u pushuan nga shërbimi më 1419, në vend që të ktheheshin në Venedik, kaluan në shërbim të Balshës dhe morën pjesë në sulmet e tij kundër zotërimeve të Venedikut.⁶⁹

⁶⁶ “...ad minus eques trecentos et pedites ducentos...”, *Acta Albaniae Veneta*, vol.III, dok. nr. 1136 (479); *Acta Albaniae Veneta*, vol. IV, dok. nr. 1722 (202-203).

⁶⁷ *Acta Albaniae Veneta*, vol. V, dok. nr. 1238 (16-17).

⁶⁸ *Acta Albaniae Veneta*, vol. VI, dok. nr. 1769 (245-246).

⁶⁹ *Acta Albaniae Veneta*, X, dok. nr. 2225 (8-9); dok. nr. 2305 (103-104).

Flota ushtarake e Principatës së Balshajve

Krahas rritjes e fuqizimit të principatës, Balshajt gjithnjë e më shumë po investonin në ngritjen e një flote detare me karakter luftarak e tregtar që do t'u shërbente atyre për mbrojtjen dhe zgjerimin e principatës, si dhe në forcimin e lidhjeve dhe të shkëmbimeve tregtare brenda e jashtë vendit. Gjatë Mesjetës, sipas burimeve, përdorim më të gjerë kishin anijet e tipit *sagina*, *brigantina*, *galera*, *pedota* dhe disa lloje barkash më të vogla, të cilat quheshin me emrin e përbashkët *fusta*.⁷⁰

Sipas dokumenteve të vitit 1383, mësojmë se në anijet e tipit brigantinë kishte deri në 18 ulëse dhe në të mund të vendoseshin deri në 70 persona, kurse në 4 barkat, që shkonin krahas me brigantinën, ndodheshin 13 persona: dy lundrues dhe një këmbësor në secilën barkë, kurse një person mbetej rezervë.⁷¹ Si mjet lundrimi brigantinat kishin përdorim të gjerë edhe në radhët e Balshajve, dhe punoheshin edhe nga mjeshtërit arbërorë në kantieret e vendit. Nuk ka shumë informacion për madhësinë e brigantinës, por në një rast thuhej se një brigantinë me 12 ulëse mund të lundronte lehtësisht të gjithë rrjedhën e Bunës (*un fiume navigabile*). Kur kushtet për lundrim ishin të favorshme (niveli më i lartë i ujit dhe ngarkesa më e ulët në anije), brigantinat, galerat, galetat, fustat, barotet (anijet e mbuluara të ngarkesave) dhe barkat arrinin në liqenin e Shkodrës. Kështu, në një dokument të vitit 1412 thuhej shprehimisht se shkodranët sipas orarit bënin rojë në liqen me galera dhe brigantina “*cum galeota vel brigantino seu zopolis*”.⁷²

I gjithë ky potencial i Balshajve për t'u forcuar ushtarakisht edhe në det, shkaktoi me kohë reagimin e Republikës së Venedikut që e konsideronte Adriatikun si gji të saj të mbyllur, mbi të cilin ushtronte prej më se dy shekujsh kontrollin e lundrimit dhe qarkullimit tregtar të mallrave. Në këtë drejtim, Venediku, në disa raste paraqiste vërejtje e shqetësime kundrejt princërve arbërorë, Topiajve e Balshajve.

Në përpjekje për të ruajtur kontrollin e lundrimit, shqetësimet e Venedikut mbi praninë e anijeve të armatosura shqiptare filluan të ndihen që më 1368, kur u njoftua nga tregtarët venedikas që tregtonin në

⁷⁰ *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëll. I, 650, 651 (Terminologji).

⁷¹ *Po aty*, 184.

⁷² Ivan Božić, *Nemirno pomorje XV veka* (Beograd: Srpska književna zadruga, 1979), 238.

zotërimin e Balshajve se kështjellari i qytetit të Budues (që përfshihej në Principatën e Balshajve), “*mbante në det disa barka*”.⁷³ Të njëjtin shqetësim Venediku e kishte paraqitur që më 1364, ku kërkohej që në asnjë mënyrë shqiptarët të mos mbanin anije të armatosura në det dhe për këtë, sipas Sinjorisë, ata [shqiptarët] duhej të hiqnin dorë sa më parë nga kjo armatosje e anijeve dhe:

“në rast se arbërorët e lartpërmendur gjenden nëpër det me anije të armatosura..., atëherë t’i kapin ata me gjithë anijet e tyre dhe t’u jepni dënimin e merituar sikur të ishin kusarë dhe armiqtë tanë”.⁷⁴

Ky insistim u përsërit më 29 mars 1368 edhe ndaj Karl Topisë, i cili kishte marrë nën zotërim Durrësin dhe mbante disa anije të armatosura në det. Sinjoria porosiste kapitenin e Gjirit [Adriatikut] që gjatë udhëtimeve të përpiqej për t’u takuar me Karlin dhe ta porosiste që në asnjë mënyrë të mos mbante në det ndonjë anije të armatosur në dëm të tyre. Por, në rast se do të lundronte pa shkaktuar dëme, pa shqetësuar apo pa cenuar venedikasin, atëherë kjo do të ishte e pranueshme, në të kundërtën kapiteni i kërcënonte Topiajt me ndërmarrje të masave ushtarake kundër anijeve të tyre.⁷⁵

Më 29 mars të po atij viti, Sinjoria urdhëroi kapedanin e përgjithshëm të flotës së detit Adriatik që të vrojtonte anijet e Balshajve “*t’i kapte barkat e thëna dhe t’i digjte ato*”, si dhe të mos lejonte tani e tutje kështjellarin e Budues të mbante “*barka apo anije të armatosura në det*”.⁷⁶ Ndërhyrja e këtij kapedani duket se ka qenë e fortë sepse katër muaj më pas, më 31 korrik 1368, Gjergji I Balsha, u detyrua të dërgonte përfaqësuesit e tij në Venedik për të kërkuar lejen e Sinjorisë që “*të armatoste në det barka dhe anije*”. Nën presionin dhe kundërshtimin

⁷³ “*...a domino et castelano Bude nomine poueresco in quadam galea...*”, *Acta Albaniae Veneta*, vol. I, dok. nr. 212 (192-193).

⁷⁴ “*... si predicti albanenses cum aliquibus nauigiis armatis in mari ... tunc eos et nauigia sua capiatis et dannificetis tamquam manifestos cursarios et inimicos nostros verum...*”, *po aty*, dok. nr. 196 (178).

⁷⁵ “*... non teneat in mari aliqua nauigia armata, ad dannum aliquorum...*”, *po aty*, dok. nr. 213 (194).

⁷⁶ “*Quod committatur capitaneo culfi, Quod per omnem viam, et modum quo poterit, faciendo id cum securitate armate, det sibi operam, de intromittendo et capiando dictas barchas, quas comburi faciat, omni causa remota, dicendo dicto castellano, quod decetero non teneat aliquas barchas uel navigia armata in mari, ad dannum aliquorum, alioquin procedemus contra eum, gentem et loca sua...*”, *po aty*, dok. nr. 216 (196).

edhe të carit serb, kërkesa nuk u miratua. Me gjithë qëndrimin negativ të Venedikut dhe carit serb, Balshajt vazhduan ta fuqizonin flotën e tyre luftarake. Gjergji I Balsha njoftonte tregtarët venedikas dhe qendrën e tyre, se “*po armatoste në Budua, Ulqin dhe Tivar disa anije dhe barka*”, me të cilat zotëronte detin dhe kontrollonte lëvizjet e anijeve.⁷⁷ Ky insistim i Balshajve për ta armatosur flotën ushtarake përkonte me kohën e përgatitjeve të tyre për të sulmuar dhe nënshtruar qytetin e Kotorrit. Andaj, pas kërkesës së përsëritur për të ndërtuar anije lufte, më 8 qershor të vitit 1369, Sinjoria e miratoi kërkesën e Gjergjit I “*që të armatosej në det vetëm, për t’i përdorur në dëm të armiqve të tij*”. Leja kishte karakter të përkohshëm; ajo kishte vlerë sa kohë që Balshajt do të luftonin kundër Kotorrit. Kështu pas paqes që arritën Balshajt me Kotorrin, Sinjoria hezitoi përpara kërkesës që parashtroi më pas Gjergji I që të mos i revokohej leja e dhënë dhe nuk e shihte të udhës ta rikonfirmonte atë sa kohë që kotorrrasit nuk do të prishnin marrëveshjen e paqes. Megjithatë, duke marrë në konsideratë qëndrimin e mirë që mbante Gjergji I Balsha ndaj tregtarëve venedikas, Sinjoria e lejoi atë “*që të lundronte me anijet e tij në det, por me kusht që të mos i shkaktonte dëm me anijet e tij*” tregtarëve venedikas.⁷⁸

Në shtator të vitit 1369, Balshajt demonstuan forcën e flotës së tyre ushtarake përmes rrethimit të Kotorrit nga deti dhe toka. Përsëri, Venediku nëpërmjet përfaqësuesve të saj te Balshajt kërkonte të kontrollonte situatën në det. Në këtë situatë, fillimisht, Sinjoria kërkonte që të zgjidheshin mosmarrëveshjet mes Balshajve dhe Kotorrit përmes rrugëve paqësore. Nëse kjo ishte e pamundur, kapiteni venedikas i Gjirit porositej që galerat, barkat dhe anijet e tjera të armatosura të Balshajve në det “*në dëm dhe për të zezë të vet kotorrrasve*” t’i largonte dhe t’i çarmatoste. Nëse për këtë Gjergj Balsha nuk bindej, atëherë të ndërhyhej me forcë dhe ato galera, barka e anije të armatosura me gjithë personelin në të, “*të shkatërroheshin sikur të ishin kusarë të vërtetë*”.⁷⁹ Në letrën

⁷⁷ Luan Malltezi, “Flota luftarake-tregtare e Principatës së Balshajve”, *Studime për epokën e Skënderbeut*, III, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: 1989), 15-16.

⁷⁸ “*quo postit armare in mari ad dannum solum suorum inimicorum, dummodo non dannificet, nec offendat, aliquem nostrum venetum, uel fidelem, nec aliquem mercatorem uel alium navigantem per mare...*, *Acta Albaniae Veneta*, vol. I, dok. nr. 219 (199).

⁷⁹ *Po aty*, dok. nr. 220 (199-202).

kthyesë të datës 17 shtator, të po të njëjtit vit, kërkohej që nëse Gjergji nuk e çarmatoste flotën e tij, atëherë “*galerat, barkat dhe anije të digjeshin duke ua vënë zjarrin, kurse personeli përkatës le të lihej i lirë*”, me kusht që të mos e përsërisnin veprimin.⁸⁰

Në kohën kur Balshajt po përballeshin me rrezikun e sulmeve të njëpasnjëshme turke, në gusht të vitit 1385, atyre u nevojiteshin anije të armatosura. Për këtë, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Venedik, iu drejtuan autoriteteve venedikase me këmbëngulje që t’u jepnin patjetër katër galera, të cilat kishin ndërmend t’i armatosnin në Venedik brenda katër muajve dhe me ato planifikohej që të përballeshin me dhunën turke në rritje. Lidhur me këtë kërkesë, autoritetet venedikase kërkuan nga Balsha që të informonte mbi vendin se ku dëshironte t’i mbante këto galera për të vepruar dhe të njoftonte se sa kohë do t’i nevojiteshin.⁸¹

Nën një kontroll të tillë të rreptë është e qartë se flota e Balshajve nuk mund të rritej e të fuqizohej në masën që ofronin mundësitë e vendit. Dokumentet bëjnë të ditur se përpjekje për të mbajtur flotë bënë edhe pasardhësit e Gjergjit I Balsha, Balsha II dhe Gjergji II Balsha por edhe këta ndeshën në qëndrimin armiqësor të Republikës së Venedikut. Në korrik të vitit 1389, Sinjoria refuzoi kategorikisht kërkesën e Gjergjit II për të “*mbajtur të armatosur në det në lumenjtë e tij dy brigantina për sigurinë e viseve të tij dhe të lumenjve për çështjen e kripës*” që tregtohej në Principatën e Balshajve. Mbikëqyrja e rreptë që ushtronte shteti venedikas mbi flotën e Balshajve pati pasoja veçanërisht të rënda për principatën e tyre në periudhën e fillimit të sulmeve osmane.⁸²

Marrëdhëniet me zotërimet e Zetës dhe përpjekjet e venedikasve për të penguar fuqizimin e Balshajve në det, lë të kuptohet për konflikte të pashmangshme luftarake në vetë zonën e Bunës. Gjatë kryengritjes së Shkodrës më 1399-1402, anijet e armatosura venedikase hynë në Bunë për të demonstruar fuqinë e Republikës ose për të transferuar ushtarë dhe

⁸⁰ Po aty, dok. nr. 220 (201-202), (letra kthyesë: 1396, indikti 7 – data 17 shtator).

⁸¹ “*Ad quorum turchorum perfidiam reprimendam necesse esset, ut haberet galeas armatas, quas a se minime habere posset, et propterea recurrat ad dominacionem nostram, requirens cum magna instantia per dictos suos Ambaxiatores, ut concedere debeamus sibi quatuor galeas quas intendit armari facere in venetiis per quatuor menses et cum ipsis resistere iniquitali dictorum turchorum*”, po aty, dok. nr. 300 (f. 13).

⁸² Malltezi, “Flota luftarake-tregtare e Principatës së Balshajve”, 17; Rrok Zojzi, *Tradita e lundrimet detar të popullit shqiptar* (Tiranë: Mihal Duri, 1959), 24-25.

pajisje. Në këtë kohë kapiteni i Shkodrës operonte në liqenin e Shkodrës me një brigantinë të vogël dhe varka që i kishte blerë nga njerëzit e Raguzës. Vetëm në vitin 1410 ai mori një galerë nga Venediku (më e vogël se sa kërkoi) dhe me të do të luftonte kundër anijeve me të cilat Balsha III po shfaqej në liqen.⁸³

Shpërthimi i Luftës së Parë të Shkodrës, nxori në sipërfaqe edhe më shumë kapacitetet luftuese detare të Balshajve. Disa muaj pas fillimit të këtij konflikti, në vitin 1406, autoritetet venedikase i njoftuan autoritetet turke se kundër Balshajve, të cilët nuk pranonin të lëshonin Shkodrën kishin nisur një flotë të fuqishme galerash dhe anijesh.⁸⁴ Po kështu, venedikasin dërguan një inxhinier të ujërave për të hetuar se si rrjedha e sipërme e lumit Buna mund të bëhej e përshtatshme për lundrim nga galerat ose galeotat. Venedikasin donin që Buna të mund të lundrohej deri në liqenin e Shkodrës për të gjitha anijet dhe në çdo stinë, por kjo nuk u arrit meqë duhej të prisheshin peshkatorët dhe për këtë llogaritej se do të shkaktoheshin dëme të mëdha. Po ashtu, disa fisnikë venedikas vunë në dyshim anën ekonomike dhe ligjore të ndërmarrjes: sa të ardhura do të humbte qyteti duke prishur anësoret e lumit (guada) dhe nëse individët privatë do të kënaqeshin me kompensimin për terrenet e humbura të gjuetisë.⁸⁵

Dihet gjithashtu se në Luftën e Parë të Shkodrës (1405-1412), përballë sulmit të anijeve të Balshës, venedikasve iu desh të tërhiqeshin. Venedikasin e thyen drejtpërdrejt marrëveshjen e paqes (të vitit 1409) që nënshkruan me Helenën kur refuzuan t'i paguanin dispozitat e dakorduara për Balshën III, i cili në këmbim sulmoi zotërimet e tyre në fillim të vitit 1410.⁸⁶ Kështu, në kohën kur Venediku bëri përpjekje për të forcuar fortifikimet e Shkodrës, Tivarit dhe Durrësit, si masë parandaluese kundër pushtimeve të papritura, Balsha III, në krye të një force të konsiderueshme ushtarake, pa asnjë hezitim sulmoi në fillim të marsit të vitit 1410 qytetet e përmendura më sipër. Ajo që bie në sy, në këtë rast,

⁸³ Božić, *Nemirno pomorje XV veka*, 221.

⁸⁴ *Listine o odnošajih između južnog Slavenstva i Mletačke Republike*, vëll. V (1403-1409), skupio Sime Ljubić (Zagreb: Jugoslavenska akademija znanosti i umjetnosti, 1875), 70-74.

⁸⁵ "...unus magister ingeniarius ab aquis ad videndum et examinandum, si possent destrui guada, et reducere acuas a sancto Sergio usque in locum per talem modum, quod possent intrare in illum galee vel galeote", po aty, 69.

⁸⁶ *Istorija Crne Gore, II/2: od kraja XII do kraja XV vijeka*, 101.

është një ngjarje që nuk kishte ndodhur më parë për sa u përket Balshajve. Nën flamurin e Balshës, u shfaq për herë të parë një anije luftarake e armatosur mirë dhe kjo paraqitje përbënte një rrezik real për zonat bregdetare. Kontkapedani venedikas i qytetit, Benedikt Kontareno, kërkoi prej Senatit t'i njiheshin shpenzimet që po bënte për të ruajtur sundimin mbi atë vend, i cili po përballej me sulmet e ushtrisë së Balshajve nga toka dhe flota e tyre. Veç kësaj, ai kërkoi që në liqenin e Shkodrës të kishte një *galeotë* prej tridhjetë-dyzet rremash (lopatash), sepse brigantini që kishte ai në dispozicion ishte i vogël.⁸⁷ Gjithashtu, ai kërkoi të

“dërgohej në viset e sipërthëna një galerë prej 20 ulësesh si anije e madhe, në atë mënyrë siç do ta shohë me vend kolegji; dhe ajo [galeotë] do të mund të armatosej në Shkodër, për tmerrin e atyre njerëzve të atyshëm dhe për sigurinë e vendeve tona dhe të viseve të sipërthëna”.⁸⁸

Shfaqja e forcës përmes së cilës Balsha III përuroi fushatën e re, ishte shumë e fuqishme. Garnizonet venedikase duhej të ishin shqetësuar seriozisht, sepse edhe prania e thjeshtë e një flote të armatosur, që deri atëherë nuk e kishte pasur asnjë anëtar i familjes Balshaj, e bëri Venedikun të mendonte për surpriza të rrezikshme. Flota e tij pushtoi të gjithë liqenin e Shkodrës dhe i detyroi fustat veneciane të tërhiqeshin.⁸⁹ Edhe për sa u përket trupave ushtarake, ushtria e Balshës III po shtoej çdo ditë, sepse një pjesë e madhe e popullsisë po aderonte në anën e tij.⁹⁰

Sido që të jetë, ekzistenca e një flote luftarake edhe tregtare në Principatën e Balshajve dëshmon për një traditë në fushën e marinës ushtarake dhe një forcë shtesë në fushën e armatimit dhe rritjes së fuqisë ushtarake në përgjithësi.

⁸⁷ “die. xv. Marcij [Mccccdecimo] Et Nouitates factas per gentes balse territorio ac subditis et fidelibus nostris deinde tam per terram, quam per aquam, faciendo armata in lacu... et vltierius requirat habere vnam galeotam remorum triginta in XL quia ille brigentinus, quem habet est paruus, etc”, *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV*, vëll. II (1406-1410), Pjesa II, dok. nr. 172 (394).

⁸⁸ “... preterea mitti debeat ad partes predictas vna galeota banchorum xx. ad nauarescam, per illum modum qui videbitur Collegio que poterit armari deinde ad terrorem illorum deinde et securitatem locorum nostrorum et partium predictarum”, *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV*, vëll. II (1406-1410), dok. 172, f. 395.

⁸⁹ *Istorija Crne Gore, II/2: od kraja XII do kraja XV vijeka*, 101-102.

⁹⁰ Gelcich, *Zeta dhe dinastia e Balshajve*, 295-296.

Ngritja dhe armatosja e kësaj flote bëhej edhe në vendpunishtet e ndryshme të vendit, mbi bazën e një tradite që vinte me sa duket e pandërprerë qysh nga kohët më të lashta, duke shfrytëzuar lëndën drusore të vendit, një pjesë e mirë e së cilës siç dëshmojnë dokumentet e kohës tërhiqej edhe nga shtete të tjera (si p.sh. Raguza etj.). Për këtë qëllim, Balshajt kanë shfrytëzuar edhe kantierin e Prevllakës (një gadishull i vogël në Kroacinë Jugore, afër kufirit me Malin e Zi, në hyrje të Gjirit të Kotorrit në bregun lindor të Adriatikut), ku i kanë ndërtuar dhe i kanë armatosur anijet e tyre.⁹¹

Burime dhe bibliografi:

Arkiva:

Crne Gore - Državni arhiv, Istorijском arhivu Kotor (CG DA 1, IAK)

Hrvatska-Državni Arhiv u Dubrovniku – Dubrovnik (HR-DADU)

Kunsthistorisches Museum Wien, Hofjagd- und Rüstkammer, Inv.-Nr. HJRK_A_550.

Botime dokumentare:

Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV. Josephi Valentini, vol. I. Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, 1967.

Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV. Josephi Valentini, vol. III. Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, 1968.

Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV. Josephi Valentini, vol. IV. Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, 1968.

Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV. Josephi Valentini, vol. V. Palermo-Napoli-Roma-Venezia-München: Archivio di Stato di Venezia, 1970.

Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia. College L. Thalloczy, C. Jiriček, E. Sufflay, vol.I. Vindobonae: Adolph Holzhausen, 1913.

⁹¹ Maksim Zloković, “Razvoj brodograđevne industrije u tivatskoj opštini”, *Godišnjak Pomorskog Muzeja u Kotoru*, br.18 (Kotor: 1970), 130.

- Acta et diplomata res Albaniae mediae aetatis illustrantia*. College L. Thalloczy, C. Jiriček, E. Sufflay, vol.II. Vindobonae: Adolph Holzhausen, 1918.
- Dokumente për historinë e Shqipërisë 1479-1506*, pjesa II (1499-1506).Përgatiti Injac Zamputi. Tiranë: Akademia e Shkencave e R.P.S.Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1979.
- Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV. Vëll. I (1401-1405)*. Përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, Tiranë: Akademia e Shkencave të RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1987
- Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV. Vëll. II, Pjesa 2 (1406-1410)*. Transkriptuan dhe përkthyen Injac Zamputi, Pranvera Bogdani, redaktoi dhe përgatiti për botim Edmond Malaj. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, 2019.
- Jorga, Nicolae. *Notes et extraits pour servir à l'histoire des croisades au XVe siècle*. Vol. 2. Paris: E. Leroux, 1899.
- Lonza, Nella & Šundrica, Zdravko. *Odluke dubrovačkih vijeća 1390-1392*. Zagreb – Dubrovnik: Zavod za povijesne znanosti HAZU u Dubrovniku, 2005.
- Milojević, Miloš S. “Dečanske hrisovulje”. Në *Glas Srpsko Učeno Društvo* knj. XII (1880): 1-142.
- Monumenta Ragusina: libri reformationum*. Tomus III, Ann. 1359-1364, collegit et digessit Josephus Gelcich (Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium, knj.27). Zagrabiae: Academia Scientiarum et Artium Slavorum Meridionalium, 1895.
- Monumenta Ragusina: libri reformationum*. Tomus IV, Ann. 1364-1396, collegit et digessit Josephus Gelcich (Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium, knj. 28). Zagrabiae: Sumptibus Academiae scientiarum et artium, 1896.
- Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium - Listine o odnošajih između južnoga Slavenstva i mletačke republike*, vol. 4 (od godine 1358 do 1403). Skupio Šime Ljubić. Zagreb: HAZU, 1874.
- Monumenta spectantia historiam Slavorum meridionalium - Listine o odnošajih između južnog Slavenstva i Mletačke Republike*, vol. V (od godine 1403 do 1409). Skupio Sime Ljubić. Zagreb: Jugoslavenska akademija znanosti i umjetnosti, 1875.
- Tadić, Jorjo. *Pisma i uputstva Dubrovačke republike*: knjiga 1 (Zbornik za istoriju, jezik i književnost srpskog naroda, treće odeljenje, knj. IV. Beograd: Srpska Kraljevska Akademija, 1935.

Literaturë historiografike:

- Aleksić, Marko. *Mediaeval swords from Southeastern Europe: material from 12th to 15th century*. Belgrade: Dedra, 2007.
- Armë të mjeshtërve shqiptarë në Muzeun Historik Kombëtar / Guns of Albanian craftsmen at the National Historical Museum* (katalog), përgatiti tekstin Dorian Koçi, Ledio Xhoxhi; redaktor Hajri Shehu. Tiranë: Muzeu Historik Kombëtar, 2017.
- Barleti, Marin. *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut* (botimi i tretë). Prishtinë: Rilindja, 1989.
- Barleti, Marin. *Historia e Skënderbeut* (origjinali latinisht, përkthyer nga Stefan Prifti). Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë: 1964.
- Barleti, Marin. *Rrethimi i Shkodrës*. Universiteti Shtetëror i Tiranës. Tiranë: 1962.
- Bogdani, Pranvera. *Balshajt: Lufta e Principatës së Balshajve dhe sundimtarëve të tjerë shqiptarë kundër Venedikut në 20 vjetët e parë të shekullit XIV*. Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2018.
- Božić, Ivan. *Nemirno pomorje XV veka*. Beograd: Srpska književna zadruga, 1979.
- Dinić, Mihailo. *Prilozi za istoriju vatrene oružja u Dubrovniku i susednim zemljama* (Glas SKA, no. CLXI). Beograd: Srpske Kraljevske Akademije, 1934.
- Drishti, Riza. “Armëtarët”. Në *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë (1985): 1196.
- Drishti, Riza. *Armët dhe armëtarët shqiptarë në muzetë e Shqipërisë*. Tiranë: Mali Pleshti, 2018.
- Drishti, Riza. *Armët dhe armëtarët shqiptarë*. Tiranë: 8 Nëntori, 1976.
- Ducellier, Alain. *La Façade maritime de L’Albanie au moyen age Durazzo et Valona du XI au XV siecle*. Thessaloniki: Institute for Balkan Studies, 1981.
- Egro, Dritan. “A janë armët e Skënderbeut në Vjenë? Fillimi i një studimi mbi armët e heroit tonë kombëtar të ekspozuara në Muzeun e Vjenës”. Në *Shekulli*, nr. 56 (2005): 20.
- Frashëri, Kristo. *Skënderbeu: jeta dhe vepra*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë: Toena, 2002.
- Gelcich, Giuseppe. *Zeta dhe dinastia e Balshajve*. Tiranë: Shtëpia botuese 55, 2009.
- Istoriya Crne Gore, II/2: od kraja XII do kraja XV vijeka*. Titograd: Redakcija za Istoriju Crne Gore, 1970.

- Jireček, Konstantin. "Srpski car Uroš, kralj Vukašin i Dubrovčani". Në *Zbornik Konstantina Jirečeka*, I (Posebna izdanja knj. CCXXVI, Odeljenje Društvenih Nauka: nova serija- knj.33) (1959): 341-385.
- Lajçi, Bashkim. "Të dhëna për armët e shqiptarëve gjatë mesjetës". Në *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, nr. 37/2007 (2008): 223-232.
- Lajçi, Bashkim. *Armët e shqiptarëve gjatë mesjetës*. Pejë: Kuvendi Komunal, 2006.
- Malltezi, Luan. "Flota luftarake-tregtare e Principatës së Balshajve". Në *Studime për epokën e Skënderbeut*, III (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1989): 15-16
- Malltezi, Luan. *Armët e Skënderbeut në Shqipëri* (album). Muzeu Historik Kombëtar. Tiranë: Ilar, 2014.
- Malltezi, Luan. *Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas 1392-1478*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1988.
- Noli, Fan S. *Historia e Skënderbeut, kryzotit të Arbërisë (1405-1468)*. Tiranë: Naim Frashëri, 1962.
- Petrović, Đurđica. "Oružje". Në *Istorija primenjenih umetnosti kod Srba*, Knjiga 1 (1977): 122-128.
- Petrović, Đurđica. *Dubrovačko oružje u XIV veku* (Posebna izdanja – Vojni muzej, knj. 5). Beograd: Vojni Muzej, 1976.
- Schmitt, Oliver Jens. *Arbëria venedike: 1392-1479, shqip nga Ardian Klosi*. Tiranë: K&B, 2007.
- Škrivanić, Gavro A. *Oružje u srednjovekovnoj Srbiji, Bosni i Dubrovniku*. Srpska akademija nauka i umetnosti, Posebna izdanja; Odeljenje društvenih nauka; knj. 24. Beograd: Naučno delo, 1957.
- Truhelka, Čiro. "Osvrt na sredovječne kulturne spomenike Bosne". Në *Glasnik Zemaljskog Muzeja Bosne i Hercegovine*, no.XXVI (1914): 6-61.
- Zloković, Maksim. "Razvoj brodograđevne industrije u tivatskoj opštini". Në *Godišnjak Pomorskog Muzeja u Kotoru*, br.18 (1970): 127-152.
- Zojzi, Rrok. *Tradita e lundrimit detar të popullit shqiptar*. Tiranë: Mihal Duri, 1959.

GJON BERISHA

Institute of History "Ali Hadri", Prishtinë

gj.n.berisha@gmail.com

*S u m m a r y***ARMAMENT AND MILITARY CAPACITIES IN THE PRINCIPALITY OF THE BALSHAJ
DURING THE 14TH-15TH CENTURIES**

The events that took place within the Principality of Balsha were related to the political, economic and military developments not only of the Balkan princes but also of the powers of the time, such as Venice, Ragusa, Hungary and the Ottoman Empire, hence the weapons and their use is directly connected to these countries. In these conditions, since the second half of the century. XIV and onward, the Balsha feudal lords, within the framework of strengthening and expanding their principality, made numerous efforts, not only to produce weapons from local or regional workshops, but also took advantage of the technological achievements of Europe with the invention of gunpowder and firearms .

Estimated on the basis of the sources of the time and compared to the fund of weapons that were used in the countries of the region and those of medieval Europe, Balsha's did not stand behind. The weapons used in the possessions of Balsha belong to the types of weapons that were known in the territory of the Balkans, Central and Eastern Europe in the Middle Ages.

Among the most important melee weapons of attack during the Middle Ages were swords, knives, bows, arrows, spears, crossbows, etc., as well as artillery firearms (bombardas/cannons) and a type of infantry rifle. Among the most important weapons used for protection during the Middle Ages were: armor, shields and helmets. Especially at this time when wars and unrest were incessant in the possessions of the Balsha, the demand for military capacities and armaments was constantly increasing and the possibilities of providing them were made through different ways - through trade, their production, looting, smuggling and even insurance theirs through various agreements. In such situations, arms trafficking was supposed to be a profitable branch for merchants.

The local arms manufacturers could not meet all the needs in arms, especially in the most modern and abundantly equipped ones, so some arms were imported. The Republic of Ragusa stands out from the countries that supplied the most weapons to the Balsha, which, apart from economic interests,

had no territorial disputes with the Albanians and the Balshas. This made it clear that the types of weapons made and those bought in medieval Arberia respected the European standards of that time and also confirm an already known fact that Albanian rulers, like those of other Balkan countries, in the 14th century imported the most advanced types of weapons. sophisticated weapons from the best local workshops, from Italian workshops or from southern European workshops that existed in Ragusa, Kotor, Novobërdë or in Hungary. Axes, spears and arrows, the forms of which remained unchanged over a fairly long period of time, are almost products of local armourers. Medieval written sources confirm the existence of such shops on the Adriatic coast, in the north and in the interior of the country.

In the framework of the development and expansion of their possessions, the Balshas also created and strengthened the armed naval fleet, for which from time to time they had conflicts with Venice, which tried to play the role of the supervisor of the Adriatic.

ALVIN SARAÇI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

saracialvin@hotmail.com

<https://doi.org/10.61773/rd63k253>

**TREGTIA NDËRMJET DURRËSIT DHE VENECIES NË VITET
1707-1714****Abstrakt:**

Në këtë artikull trajtohen marrëdhëniet tregtare me Venecien nëpërmjet portit të Durrësit në vitet 1707-1714 që arrijnë deri në prag të luftës së Moresë (1714-1718), periudhë në të cilën tregtia u ndërpre për t'u rihapur në vitin 1719 pas paqes së arritur me Traktatin e Pasarovicit (Pozharevacit). Pati një sërë faktorësh që ndikuan negativisht mbi tregtinë në këtë periudhë, si: konkurrenca me konsullatat franceze dhe holandeze, e cila u reflektua edhe në konkurrencën ndërmjet anijeve, kalimi i mallrave drejt destinacioneve të tjera, si Ankona dhe Ragusa, largimi i tregtarëve, lajmi për nisjen e luftës së Moresë në vitin 1709, ligji i ndalimit të tregtisë së drithërave për venecianët dhe anijet ulqinake e perashtine në vitet 1709 dhe 1714, sasia e paktë e mallrave, reduktimi i ngarkesave të anijeve, zhvillimi i lundrimit vendës ulqinak dhe durrsak. Për ta gjallëruar tregtinë, Venecia ndërmori dy reforma doganore për portet shqiptare në vitet 1705 dhe 1710. Në vitet në vijim, konsullit venecian iu desh t'i bënte ballë shmangies së mallrave me destinacion Venecien, numrit në rritje të anijeve të huaja si edhe uljes së çmimeve të mallrave të importit dhe taksave doganore nga ana e vendeve të tjera.

Fjalë kyçe:

Tregtia, Durrësi, Venecia, 1707-17014, konsullata veneciane e Durrësit.

Duke u bazuar në raportet konsullore të konsullatës së Venecies në Durrës dhe statistikat tregtare të doganave veneciane të tri mallrave kryesore të eksportit, artikulli ka si qëllim të bëjë një panoramë të shkëmbimeve tregtare nga porti i Durrësit me Venecien në vitet 1707-1714. Kjo periudhë përkon me periudhën që i paraprin Luftës Veneto-Turke të Moresë (1714-1718). Shqipëria gjendej në kufijtë juglindorë me

Republikën e Venecies në një zonë që, megjithëse nuk zotërohej nga venecianët, ishte nën ndikimin ekonomik dhe tregtar të Venecies.¹

Periodha e begatë e pesë viteve të para të shek. XVIII pati një ndikim pozitiv mbi tregtinë. Reforma doganore ose dalja e tarifave të reja doganore më të ulëta për mallrat dhe qiratë e anijeve (navllimit) për portet shqiptare në vitin 1705, i dha një shtytje të re marrëdhënieve tregtare që kishin mbetur në vend. Efekti i saj u ndie më tepër në vitet 1707-1708. Megjithatë, tregtia nuk arriti nivelin e mëparshëm.² Venecia, e cila deri në atë moment kishte pasur vëllimin më të madh të tregtisë në Durrës, ishte në konkurrencë me konsullatat e huaja, që donin ta zgjeronin tregtinë në portin e Durrësit.³ Përballë fuqive tregtare atlantike që zotëronin tregtinë ndërkombëtare, Venecies i duhej tashmë të ruante pozitën në Adriatik, që e konsideronte si detin e saj.⁴ Gjithashtu, pikërisht në këtë periudhë nisi zhvillimi i lundrimit vendës që vërehet në shtimin e numrit të anijeve durrsake dhe ulqinake.

Pietro Roza (Pietro Rosa) u zgjodh konsull venecian i Durrësit nga mesi i vitit 1705, kur tregtia veneciane e ndiente nevojën që të rigjallërohej. Përveç problemeve të cilat lidheshin me tregtinë si heqja e taksimit të tregtisë veneciane nga konsullatat franko-holandeze, që ndërhyjnë në sistemin e taksave doganore veneciane, atij iu desh të largohej përkohësisht në vitin 1709 për shkak të situatës së rënduar nga konflikti detar ndërmjet një anijeje perashtine dhe një anijeje korsare

¹ Vera Costantini, "Commerci e economie nell'Adriatico d'età moderna", në *Balcani occidentali, Adriatico e Venezia fra XIII e XVIII secolo / Der westliche Balkan, der Adriaraum und Venedig (13-18. Jahrhundert). Schriften der Balkan Kommission*, 50, ed. Oliver Jens Schmitt, Gherardo Ortalli (Venezia: Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti / Wien: Österreichische Akademie der Wissenschaften Philosophisch-historische Klasse, 2009), 363.

² Rossana D'Alborton Vitale, "La scala di Durazzo negli anni del console Rosa (1705-1733)", në *Studi veneziani*, vol. XXXIV (Pisa, Roma: Istituti editoriali e poligrafici internazionali, 1997), 239.

³ Zija Shkodra, "Hyrje", në *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII: Letra të konsujve venedikas të Durrësit (1696-1707)*, përktheu dhe përgatiti për botim Zija Shkodra (Tiranë: Akademia e Shkencave, 1975), 8; Costantini, "Commerci e economie", 372.

⁴ Giovanni Costantini, "Commercio e Marina", në *Storia di Venezia, l'Ultima fase della Serenissima*, ed. Paolo del Negro e Paolo Preto, vol. VIII (Roma: Giovanni Treccani, 1998), 555-558.

tripoline në Durrës, në një kohë kur Perandoria Osmane po përgatitej për rimarrjen e Moresë që ishte në duart e venecianëve.⁵

Produktet bazë të tregtisë së Durrësit me Venecien ishin: leshi, lëkurët, dylli, duhani, vaji i ullirit, gruri, lëkurët e kafshëve të egra, kërmëza, pambuku etj.⁶ Tregtia varej nga vëllimi i mallrave që kalonin në Durrës, ku vendin kryesor e zinte leshi. Kështu, në shtator 1707, konsulli venecian Pietro Roza informonte se nuk kishte ardhur sasia e leshit që pritej.⁷ Ndryshe paraqitet situata në gjysmën e dytë të vitit 1708, kur konsulli venecian raportonte se sasia e leshit ishte e mjaftueshme “*per essere sufficienti le lane*” dhe se po ngarkoheshin tri anije.⁸ Në fakt, leshi dërgohej në Venecia në manifakturat e leshit “*tessidio delle lane nuove*”.⁹

Ndër faktorët që ndikuan në marrëdhëniet tregtare ishte edhe konkurrenca ndërmjet konsullatave të huaja. Nga fillimi i vitit 1707, Nicola Pulimeno, që ishte kthyer përsëri në postin e konsullit të Holandës, arriti t’i bindte disa tregtarë të cilët tregtonin sasi të mëdha dylli nga Vallakia me Venecien, që t’i dërgonin ato drejt Ankonës dhe Raguzës me anijet e konsullatës franceze, gjë që pati ndikim në tregtinë e dyllit.¹⁰ Kjo i krijonte çrregullime tregtisë veneciane, sepse jo vetëm e reduktonte atë, por peshën e ndienin edhe tregtarët porositës në Venecia, si për mallrat industriale, ashtu edhe për veshjet e markës veneciane, që u jepeshin në formën e kredive tregtarëve të përtejdetit, të cilat këmbëheshin me mallrat e eksportit që kalonin nga Shqipëria. Duke mos iu përmbajtur kontratave tregtare dhe të qiramarrjes së anijeve, ato u sillnin humbje tregtarëve venecianë që e kishin parapaguar navllimin. Kjo bëhej shkak për pritje të gjata nga ana e anijeve perashtine për ardhjen e mallrave në portin e Durrësit, të cilat zgjatnin nga 3-4 deri në 6-8 muaj në radhë për t’u ngarkuar.¹¹

Për sa u përket statistikave tregtare për këtë periudhë mungojnë shifrat e ngarkesave të anijeve, të cilat mund të përqasen me shifrat e

⁵ D’Alberton Vitale, “La scala di Durazzo”, 239.

⁶ Ulpian Hoti, “An overview of trade aspects between Albania and Western Countries”, në *European Academic Research*, vol. III, Issue 2 (maj 2015), 2597-2598.

⁷ *Archivio dello Stato di Venezia* (më tej: ASV), Cinque Savi alla Mercanzia (CSM), 1. S, busta (b.) 661, 21 shtator 1707. “... *per non essere calato quest’anno la somma di lane, che solea recapitar*”.

⁸ *Po aty*, 22 gusht 1708.

⁹ *Po aty*, 8 shtator 1708.

¹⁰ *Po aty*, 23 mars 1707; Shkodra, “Hyrje”, 16.

¹¹ ASV, CSM, 1. S, b. 661, 28 prill 1707.

përgjithshme të tregtisë që përmbajnë peshën e mallrave kryesore dhe taksën doganore në dukate të doganës veneciane.¹²

Kështu, sipas tabelës në vijim, në vitin 1708, tregtia e leshit u rrit me 12,8% dhe tregtia e dyllit me 39,1% në krahasim me vitin 1707, ndërkohë që tregtia e lëkurëve pësoi një rënie prej 8,5 %.

Tabela 1 për të tria produktet kryesore të tregtisë së portit të Durrësit në dyvjeçarin 1707-1708.¹³

Viti	1707		1708	
Malli	Sasia në libra	Dukate	Sasia në libra	Dukate
Leshi	830.192	1.845,14	952.139	2.094,5
Saftjan dhe lëkurë dashi	43.348	433,16	39.656	396,16
Dylli	225.400	2.727,12	370.334	4.531,17
Taksa në dukate për të tria produktet	5.005,42		7.021,83	

Anijeve perashtine iu desh të përballeshin edhe me konkurrencën e anijeve franceze. Në maj 1707, ngarkesat me mallra u bënë mollë sherri ndërmjet anijeve perashtine dhe anijeve të konsullit francez të Durrësit. Për këtë u bënë shkak tregtarët e Siatistës, të cilët për kalimin e mallrave në Kastelnovo menduan që një pjesë të ngarkesave t'i dërgonin me anijen perashtine të kapitenit Grubas dhe pjesën tjetër prej rreth 15 pakosh për secilin ta merrnin me vete me një anije tjetër. Kur mori vesh qëllimin e tyre, konsulli francez i Durrësit u bëri si ofertë tregtarëve të Siatistës që t'i ngarkonin të gjitha mallrat me 2-3 felluga franceze pa taksa doganore. Në këtë mënyrë, tregtia veneciane do të kishte një humbje prej 400 pakosh me dyllë pa llogaritur mallra të tjera më të lehta.¹⁴ Kapitenët perashtinë nuk e pranuan një gjë të tillë, prandaj protestuan dhe i qortuan tregtarët e Siatistës për veprimin e tyre. Megjithatë, me ndërhyrjen e kancelarit të konsullatës veneciane Giovanni Cumano, ata u dakordësuan me ta që ta ndanin ngarkesën me anijet e konsullatës franceze. Por në

¹² Stavri Naçi, "Rreth tregtisë së Sanxhakut të Shkodrës me Republikën e Venedikut gjatë shekullit të XVIII", në *Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, nr. 1 (Tiranë: 1963), 7.

¹³ ASV, CSM, 2° S, b. 48, 11 shkurt 1714.

¹⁴ *Po aty*, CSM, 1. S, b. 661, 20 maj 1707.

fund, tregtarët nuk e mbajtën fjalën dhe e dërguan ngarkesën në mol për ta ngarkuar me anijet franceze. Atëherë, marinarët perashtinë të papërmbajtur, pa i dëgjuar fjalët e kapitenit dhe të konsullit që u bënë thirrje për qetësi, nisën t'ia merrnin ngarkesën njëërës prej anijeve franceze. Konsulli francez nuk qe dakord me këtë veprim dhe megjithëse konsulli venecian i detyroi marinarët perashtinë që t'ua kthenin ngarkesën francezëve, u ndikua nga Pulimeno dhe kërcënoi se do të ngrinte padi e madje do të kërkonte shpërblim për dëmet. Ai mendonte se një gjë të tillë do ta bënin edhe tregtarët e Siatistës. Në fakt, venecianët u shmangeshin kontradiktave me konsullatat e tjera dhe sidomos gjykatave për shkak të shpenzimeve të larta. Konsulli venecian u përpoq ta bindte konsullin francez që kjo të mos konsiderohej si çështje tregtare, sepse kontradiktat ishin ndërmjet kapitenëve perashtinë dhe tregtarëve, por kapiteni francez ngriti padi te konsulli francez kundër kapitenit perashtin dhe i tha se do t'ia dorëzonte kopjen e saj Gjykatës së Francës dhe ambasadorëve francezë në Venecia e Stamboll.¹⁵ Konsullata franceze ashtu si ajo veneciane kishte edhe funksionin e një gjykate të shkallës së parë.¹⁶ Zmadhimi i kësaj çështjeje, së cilës i dhanë një ngjyrim të dhunshëm, u shkonte për shtat francezëve për të frenuar konkurrencën tregtare veneciane.¹⁷ Ata e përshkruan sikur ishin kërcënuar nga perashtinët e armatosur me shpata dhe revole, të cilët u kishin marrë banderolën franceze.¹⁸ Madje, konsulli francez kishte ndërmend të ndërhynte te doganierët e Durrësit dhe t'i akuzonte venecianët se po krijonin pështjellim për sa i përket sistemit të taksave doganore osmane, për ta përdorur si burim kontradiktash me Portën dhe po bëheshin shkak për largimin e tregtarëve nga porti. Por konsulli venecian, i cili kishte dijeni për hapat që po ndërmerrnin, e ndali një veprim të tillë me anë të një ndërmjetësi me disa dhurata. Ai, gjithashtu, ishte kundër kontradiktave që mund të krijonin perashtinët, sepse tregtia mund të dëmtohej nëse tregtarët i braktisnin shkëmbimet me Venecien.¹⁹

¹⁵ *Po aty*, 21 maj 1707.

¹⁶ Umberto Signori, "Reti consolari veneziane nell'Impero ottoman del Seicento", në *Isole e frontiere nel Mediterraneo moderno e contemporaneo*, ed. Arturo Gallia, Lavinia Pinzarrone, Giannantonio Scaglione, Studi e ricerche (Palermo: Infieri, 2017), 28-29.

¹⁷ ASV, CSM, 1. S, b. 661, 5 qershor 1707.

¹⁸ *Po aty*, 19 maj 1707.

¹⁹ *Po aty*, 5 qershor 1707.

Ngarkesat për anijet perashtine ishin reduktuar dhe u duhej të përballeshin me vështirësitë e krijuara nga konkurrenca “...*i Perastini vano mormorando vedendosi levar quel poco di profitto, che tanti anni peravanti hano sempre goduto...*”.²⁰ Arsyeja për këtë ishte shtimi i numrit të anijeve të huaja në portin e Durrësit. Ekzistonte gjithashtu edhe një konkurrencë e brendshme ndërmjet kapitenëve perashtinë që i kishin monopolizuar ngarkesat në Durrës dhe nuk lejonin të ngarkoheshin anijet dalmato-veneciane.²¹ Madje, kur disa anije erdhën në Durrës për t’u ngarkuar me drithëra, ata i kërcënuan me zjarrvënie.²² Kjo situatë vazhdoi edhe në vitin 1712, kur konsulli u bënte thirrje Pesë të Urtëve që ta rregullonin këtë gjë, sepse venecianët nuk mund të ngarkonin mallra në portin e Durrësit.²³

Në mars 1707, pati një shtim të numrit të anijeve franceze. Numri i tyre shkoi në 6 dhe në transportin e mallrave vazhdonte të përfshihej anija e kryeartiljerit të Durrësit, Mustafa Topçibashi, një tregues që tregtia franceze ishte në rritje.²⁴ Madje, francezët kishin ndërtuar dy anije të reja në portin e Durrësit (një tartanë dhe një fellugë të madhe, e cila ishte destinuar për tregtinë me Ankonën). Ky shtim i anijeve erdhi për shkak të idesë së zgjerimit të tregtisë drejt porteve të tjera si ai i Livornos dhe po të mos kishte qenë lufta ndërmjet anijeve anglo-austro-franceze edhe në Adriatik, si pasojë e Luftës për Fronin e Spanjës (1701-1713) që kishte sjellë si rrjedhim fenomenin e korsarisë, kjo rrugë detare do t’i kishte favorizuar edhe më shumë marrëdhëniet tregtare “*e se non fossero i pericoli de corsari nella presente guerra, già sarebbero stati introdotti i carichi per Livorno*”.²⁵ Edhe raguzanët në prill 1710 kishin nisur dy anije nga Durrësi për në Livorno dhe një të tretë që e kishin siguruar në Venecia me mallra nga Durrësi, që ishte nisur nga porti i Raguzës, duke i këmbyer paraprakisht mallrat e eksportit me veshje londrinë.²⁶ Por në shtator 1710, një anije raguzane që do të transportonte lesh nga Durrësi

²⁰ *Po aty*, 23 mars 1707.

²¹ *Po aty*, 21 shtator 1707.

²² *Po aty*, 4 dhjetor 1707.

²³ *Po aty*, 1 maj 1712.

²⁴ *Po aty*, 23 mars 1707.

²⁵ *Po aty*, 4 prill 1707.

²⁶ *Po aty*, 23 gusht 1710; Valeriu Papahagi, “Les Roumains de l’Albanie et le commerce vénitien aux XVIIe et XVIIIe siècles”, në *Mélanges de l’École roumaine en France* (Paris: 1931), 49-50.

drejt Livornos, u njoftua që ta ndryshonte itinerarin e saj për në Ankonë.²⁷

Nga ana e tyre, edhe holandezët donin të sillnin në Adriatik anije tregtare me flamurin e Provincave të Bashkuara të Holandës, por i trembeshin konkurrencës franceze. Kompania Pulimeno-Neranzi kishte blerë një fellugë të madhe, ekuipazhi i së cilës ishte ulqinak. Kjo i kishte shtyrë edhe durrsakët që të shtonin numrin e anijeve për faktin se ishin vendës “*goder loro questo beneficio come paesani*”, gjë që mund të krijonte njëfarë konkurrence me ulqinakët.²⁸

Dalja në skenë e anijeve të Ulqinit si fuqi detare i krijonte shqetësim Venecies, sepse ndryshonte raportet në Adriatik, duke rritur konkurrencën me anijet veneciane. Anijet ulqinake të transportit, të shumta në numër dhe të mirëpajisura edhe për transportin e çfarëdolloj sasive malli, kishin si pikësynim angazhimin në portet shqiptare dhe më gjerë. Por, ndërsa ato preferoheshin dhe merreshin me qira nga konsullatat e huaja në Durrës, hasnin në qëndrimin protektiv të Venecies, e cila angazhonte një numër të vogël prej tyre, sepse ua kishte lënë transportin e mallrave kryesore në Durrës anijeve perashtine dhe dalmato-veneciane. Në ndryshim nga anijet ulqinake, të cilat ishin të lira që të transportonin në të gjitha portet e Gjirit, venecianët i kishin destinuar anijet perashtine vetëm për portet shqiptare dhe ua kishin ndaluar transportin e mallrave në portet jashtë territorit të saj. Ky fakt i detyronte anijet ulqinake që të shfrytëzonin hapësirat e lira dhe në shumicën e rasteve t'i dërgonin mallrat drejt Kastelnovos (Herceg Novit) ose drejt Venecies pa kaluar nëpërmjet konsullit venecian, i cili hartonte policë-ngarkesat. Kjo ndodhte kur vinte një sasi e madhe mallrash në port dhe kur kapitenët e anijeve dhe tregtarët nuk binin dakord për çmimet e qiramarrjes së anijeve.²⁹

Prandaj kur arrinin në Venecia jo gjithmonë ato ndiqnin të njëjtën procedurë si anijet veneciane deri në doganë. Madje, pati një rast kur tri anije ulqinake të ngarkuara me lesh që ishin nisur nga Shkodra me destinacion Herceg Novin nuk u mirëpritën në portin venecian dhe kjo i detyroi ato që të vazhdonin udhëtimin për në Raguzë. Një situatë e tillë ishte në dëm të tregtisë me Venecien, sepse, sipas konsullit venecian, do

²⁷ ASV, CSM, 1. S, b. 661, 15 shtator 1710.

²⁸ *Po aty*, 22 korrik 1708.

²⁹ Papahagi, “Les Roumains”, 81.

t'u jepte mundësi autoriteteve raguzane për t'iu rikthyer marrëdhënieve tregtare me Shkodrën “*d'aprir nuova scala con Scutari*”.³⁰

Në relacionin e 21 shkurtit 1709, konsulli Roza shkruan se zhvillimi i lundrimit ulqinak erdhi si rezultat i tregtisë së drithërave, e cila që në fillim pas Paqes së Karlovicit (Karlovac) të vitit 1699 kishte qenë vetëm në duart e perashtinëve dhe kotorrasve. Por në vijim, kësaj tregtie iu përkushtuan edhe ulqinakët, të cilët i dërgonin drithërat në Dalmaci, Istria, Friuli dhe Kaorle.³¹ Më pas, ata ndërmorën edhe transportin e disa mallrave të tjera si kripa, vaji dhe duhani drejt tyre dhe Venecies, por kjo krijoi kontradikta me anijet perashtine pikërisht në një periudhë krize të drithërave në vitet 1708-1709.³²

Në fakt, konsulli venecian i Durrësit u propozoi Pesë të Urtëve për tregtinë si zgjidhje për të ekuilibruar situatën një taksë prej gjysmë dukati për starë drithi për anijet e huaja, që sigurisht nënkuptonte ato ulqinaqe dhe krijimin e një porti të lirë në Grykën e Kotorrit, ku anijet të mund të sillnin drithërat, të cilat do të kishin çmime më të mira për tregtarët venecianë sesa në Shqipëri. E njëjta gjë, sipas tij, vlente edhe për portin e Durrësit, ku për të stimuluar marinën perashtine duhej të dyfishoheshin taksat për anijet e huaja. Ndërsa ulja e taksave për tregtarët në Durrës që nga lufta e Moresë (1664-1699) do të ishte në dobi të tregtisë.

Lundrimi shqiptar u përgjigjej më së miri kërkesave për transportin e mallrave që kalonin nga Shqipëria. Kështu, Ulqini dhe Durrësi dolën në pah si dy porte me lundrim të zhvilluar që do t'u bënë konkurrencë porteve të Grykës së Kotorrit.³³ Në portin e Durrësit kishte një numër të madh anijesh ulqinaqe, që transportonin edhe drithërat dhe vajin, një pjesë prej të cilave ishin blerë nga autoritetet e Durrësit. Gjithashtu, tashmë në portin shqiptar kishte edhe një kantier detar ku ndërtoheshin anijet. Kjo kishte ndikuar në shtimin e numrit të anijeve. Në vitin 1707, në Durrës numëroheshin tetë anije.³⁴ Ato kishin fituar akses për sa i

³⁰ ASV, CSM, 1. S, b. 661, 23 gusht 1710.

³¹ *Po aty*, 21 shkurt 1709.

³² Guido Candiani, “Sanità e controllo mercantile alle Bocche di Cattaro: il Lazzaretto di Castelnovo, 1700-1797”, në *Mediterranea – ricerche storiche* – v. XVII, nr. 48 (april 2020), 39.

³³ ASV, CSM, 1. S, b. 661, 30 qershor 1707. “...e continuando farano perder l'uso del navigar a quei delle Boche”.

³⁴ Stavri Naçi, “Rreth tregtisë së Sanxhakut të Shkodrës me Republikën e Venedikut gjatë shekullit të XVIII”, në *Buletini i Shkencave Shoqërore të Universitetit të*

përket lundrimit drejt Venecies. Pretendimi i tyre se transporti i mallrave nga portet e Shqipërisë duhej të bëhej nga anijet shqiptare në vend të atyre perashtine, sipas konsullit venecian të Durrësit, e kishte komplikuar edhe më tepër situatën. Pikërisht në atë moment, anijet e Durrësit kishin nisur të kryenin transportin detar ndërmjet Durrësit dhe Herceg Novit e Raguzës. Kjo ishte një dëshmi që portet shqiptare nisën të merrnin një fizionomi kombëtare.

Tregtia pësoi një rënie në dyvjeçarin 1709-1710. Një ndër arsytet që ndikoi negativisht për këtë në vitin 1709, qe shmangia e mallrave që tregtoheshin drejt Venecies, shtimi i numrit të anijeve të huaja dhe mbyllja e tregtisë dhe e konsullatës veneciane të Durrësit në janar 1709, sepse, sipas njoftimeve, mund të niste Lufta Veneto-Turke e Moresë.³⁵ Një tregues tjetër negativ për mbarëvajtjen e tregtisë ishte edhe pagesa me vonesë e taksës doganore nga ana e tregtarëve në Venecia, gjë që nuk ndodhte më parë, si rrjedhojë dhe ardhja me vonesë e asaj pjese që i përkiste konsullit venecian si të ardhura konsullore.³⁶ Ja si shprehet ai:

“vërehen vonesa të gjata për derdhjen e tyre në Venecia, në një kohë që më parë *cottimo* paguhej nga tregtarët në port pa shtyrje afati”.³⁷

Deri më 15 janar 1709 ishin nisur dy anije nga Durrësi drejt Herceg Novit.³⁸ Madje, anija e dytë raguzane ishte nisur nga një misionar françeskan, kapelani i konsullatës, Paulo da Soriano sipas udhëzimeve të zëvendëskonsullit venecian, i cili kishte hartuar policat e ngarkesave.³⁹

Ajo që rëndoi më shumë situatën ishte ligji i ndalimit të tregtisë së drithërave nga Stambolli në përgjithësi me Venecien dhe i transportit të tyre nga anijet ulqinake dhe perashtine.⁴⁰ Në fakt, që në vitin 1702, Venecia kishte vendosur që zonat e Shqipërisë të pasura me drithëra nëpërmjet porteve të Durrësit, Vlorës, Bashtovës etj., të furnizonin me

Tiranës, 1 (Tiranë: 1963), 19; ASV, CSM, 1. S, b. 661, 30 qershor 1707. “...i Durazini incominciano ancor loro à fabricar bastimenti havendone sin hora al n° di otto”.

³⁵ ASV, CSM, 1° S, b. 661, 15 janar 1709.

³⁶ *Po aty*, 8 prill 1709.

³⁷ ASV, CSM, 1° S, b. 661, 8 prill 1709 «osservando il lungo ritardo della riscossione de medesimi in Venezia; quando prima alla scala stessa dà mercanti era pagato il *cottimo* senza dilatione alcuna.»

³⁸ ASV, CSM, 1. S, b. 661, 15 janar 1709.

³⁹ *Po aty*.

⁴⁰ *Po aty*, 11 shkurt 1709. Letra e fratit Paulo dhe e Pjetër Engjëllit, nënkonsull venecian i Shkodrës, drejtuar konsullit venecian Roza.

grurë Kotorrin venecian dhe hinterlandin e tij, që ishte në kufi me sanxhakun e Shkodrës.⁴¹ Kjo ishte një goditje e madhe për të dyja palët, por sidomos për anijet e Ulqinit, sepse nga tregtia kryesisht e drithërave ishte zhvilluar lundrimi dhe ishte rritur numri i anijeve të flotës ulqinake që i njihnin portet e Adriatikut, duke e kaluar numrin e anijeve të Perashtit për faktin se ishin blerë nga ulqinakët dhe tashmë konkurronin anijet veneciane.⁴²

Në fillim të vitit 1709, krerët e tregut kishin sjellë opinionin e tregtarëve të Durrësit, të cilët ishin të mendimit që anijeve ulqinake t'u lihej transporti i drithit drejt Dalmacisë dhe Istrias:⁴³

“Disa tregtarë të përmendur [të Durrësit] pohojnë se do t’ia dilnin po t’ua lejonin gjithashtu shkarkimin e drithërave në Dalmaci dhe Istria, që të silleshin nga ulqinakët në qytetet e këtyre Provincave.”⁴⁴

Pikërisht, tregtia e drithërave i kishte nxitur anijet ulqinake që të frekuentonin portet e tjera veneciane, duke e shpërndarë fluksin e mallrave që kishte si destinacion Venecien. Disa prej tregtarëve nuk ishin dakord me dekretin e Portës që ua ndalonte tregtinë e drithit anijeve ulqinake, sepse kjo do të sillte si pasojë edhe mungesën e mallrave të tjera shtesë që ata transportonin, si: vaji, katrami dhe djathi “*accessorio del loro principal Trafico*”. Madje, dekreti i detyronte edhe autoritetet veneciane për mbikëqyrjen e detit (Krerët e Detit) që të kontrollonin zbatimin e tij. Megjithatë, furnizimi me drithëra kishte rëndësi për Venecien, prandaj ata ishin të detyruar të kontrollonin kryesisht rrugën detare drejt zonës së grumbullimit të drithit në Raguzë dhe në vend që t’i ndalonin anijet ulqinake me drithëra, që i shkëmbenin ato në det me mallra të anijeve të tjera, u ishte dhënë urdhër që t’i drejtonin ato në Venecia.⁴⁵ Një fakt tjetër ishte se a do të lejohej shkëmbimi i drithërave

⁴¹ Riccardo Predelli, *I libri commemoriali della Repubblica di Venezia*, Regesti, vol. 8, XXX (Cambridge: Cambridge University Press, 2012), dok. nr. 124, viti 1702, 110.

⁴² ASV, CSM, 1. S, b. 661, 21 shkurt 1709. Raport i konsullit venecian Roza për tregtinë e Shqipërisë me Venecien.

⁴³ Po aty, CSM, 2. S, b. 61, 3 shkurt 1709.

⁴⁴ Po aty, CSM, 2. S, b. 61, 3 shkurt 1709. “*Alcuni de Mercanti predetti reputano che potesse riuscir Conferente il permeter bensi lo Scarico de formenti nella Dalmazia et Istria, che fossero da Dulcignoti condoti nelle Citta di dette Provincie*”.

⁴⁵ *Dispacci del capitano del Golfo Alvise Foscari 1708-1711*, ed. Fausto Sartori (Venezia: Malcontenta, 2006), 52, 55.

ndërmjet anijeve perashtine dhe atyre ulqinake dhe nëse jo kjo do të ishte në dëm të tregtisë?! Për këtë autoritetet veneciane ishin të vetëdijshme, megjithëse nuk e donin një gjë të tillë, sepse këto masa do t'i detyronin anijet ulqinake që të tregtonin me portet e tjera të Adriatikut. Kjo ndodhi me anijen e kapitenit Mehmet Bekini, të cilit i ishte ndaluar transporti i mallrave në Venecia dhe kishte ndërmarrë një ngarkesë me drithëra dhe duhan drejt Ankonës.⁴⁶ Gjithashtu, përveç banderolës së shteteve të huaja, anijet kishin nisur të mbanin edhe banderolën osmane.

Megjithatë, ndonjë anije perashtine që transportonte drithëra u ishte afruar brigjeve shqiptare, gjë që mund të sillte kontradikta të reja.⁴⁷ Ato mund të përballeshin me milicët turq që ishin ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të dekretit për drithërat, si dhe me autoritetin e kadiut dhe të doganierëve, të cilët ishin detyruar tashmë që të qëndronin në Durrës.⁴⁸ Madje, nga letërkëmbimi i ambasadorit francez në Stamboll me konsullin francez të Durrësit Compté, Stambolli do të dërgonte 9 anije sulltanore në Durrës për të marrë masa ndaj anijeve perashtine që mund ta shkelnin dekretin, që shkonin deri në djegien e tyre.

Për sa i përket ripërtëritjes së flotës dalmato-kotorrare dhe kufizimit të asaj ulqinake, konsulli venecian i Durrësit u propozoi si zgjidhje Pesë të Urtëve, si të vetmen mënyrë për t'i bërë ballë konkurrencës dhe dekretit penalizues osman për shkak të krizës së drithërave, lënien e rrugëtimit të parë të drithërave në duart e anijeve ulqinake dhe durrsake, të cilat mund ta kryenin transportin e tyre në një port të lirë (*porto franco*) si ai i Kotorrit kundrejt shtimit të tarifës me gjysmë dukati starën e drithit ose si të ishte më mirë, për këto anije që bënin pjesë në kategorinë e anijeve të huaja osmane. Kjo do të sillte disa avantazhe. *Së pari*, çmimet e drithërave shqiptare do të ishin më të mira në Grykën e Kotorrit sesa në Shqipëri, të cilat do të bliheshin nga anijet kotorrare, dhe më pas mund t'i transportonin drejt Dalmacisë dhe Venecies. *Së dyti*, do të minimizohej rreziku i sulmeve korsare, sidomos i anijeve berbere veriafrikane, të cilat do të shkurajoheshin për hyrjen në Adriatik. Sigurisht, anijet shqiptare do ta kishin më të lehtë sigurimin e drithërave për t'i dërguar drejt Kotorrit.

⁴⁶ ASV, CSM, 2. S, b. 61, 10 maj 1710.

⁴⁷ Po aty, CSM, 1. S, b. 661, 21 shkurt 1709.

⁴⁸ Po aty, 19 prill 1709.

Në prill 1710, Porta e liberalizoi me anë të një dekreti tregtinë e drithërave për venecianët, por ua lejoi atë vetëm anijeve perashtine me portet dalmate dhe ua ndaloi anijeve ulqinake, ndërkohë që edhe Venecia e mbylli lazaretin e Kastelovos dhe të Splitit dhe e ktheu atë në një destinacion për karvanët siç ishte në fillim, për të shkurajuar transportin me anije ulqinake.⁴⁹ Përgjigjja e ulqinakëve ishte kthimi i tyre nga transportues në tregtarë. Në gusht 1710, disa anije ulqinake u ishin afruar brigjeve të Durrësit për ngarkesa me drithëra dhe që të mos i linin perashtinët që t'i ngarkonin ato, me bindjen se ata e kishin detyruar Senatin venecian të nxirrte një dekret të tillë.⁵⁰ Në këtë rast, konsulli venecian duhej të shuante çdo kontradiktë e cila mund të lindte ndërmjet dy komuniteteve dhe që e dëmtonte tregtinë. Madje, gjatë një takimi që ai pati me kapitenin ulqinak Mustafa, i cili ishte dërguar nga autoritetet e Ulqinit dhe donte të dinte lidhur me shkakun e moslejimit nga pala veneciane të transportit të drithërave, ai i tha se nuk e dinte arsyen. Sidoqoftë, ai e ftoi kapitenin që t'i bindte autoritetet e Ulqinit që të mos lejonin që të bezdiseshin anijet në Adriatik dhe të mos bashkoheshin me korsarët veriafrikanë, sepse përndryshe do të bëheshin edhe ata bashkëfajtorë.⁵¹

Në dokumentet konsullore veneciane të Durrësit nuk shënohen anijet që merreshin me tregtinë e drithërave, vajit etj. Por nga viti 1713, Pesë të Urtët i kërkuan Pietro Rozës për shkak të pranisë së një anijeje tregtare nga Qefalonia, që të regjistronte anijet që kalonin në portin e Durrësit, prandaj ai jep edhe informacion për ngarkesat me drithë.⁵² Shtatori i atij viti, – shkruan ai, – ishte muaji më angazhues për konsullatën, sepse vinin anije zakonisht nga Dalmacia dhe Kotorri për t'i transportuar ato.⁵³ Madje, në fund të vitit 1713 dhe ditët e para të vitit 1714, nëntë anije të ngarkuara me grurë, farë liri dhe vaj u nisën drejt Venecies.⁵⁴ Megjithatë, në janar 1714 për shkak të prodhimit të paktë dhe

⁴⁹ Candiani, "Sanità", 39; Naçi, "Rreth tregtisë së Sanxhakut të Shkodrës", 19; ASV, CSM, 2. S, b. 61, 26 prill 1710.

⁵⁰ *Po aty*, CSM, 1. S, b. 661, 23 gusht 1710.

⁵¹ *Po aty*, 23 shtator 1710.

⁵² *Po aty*, 3 qershor 1713.

⁵³ *Po aty*, 10 shtator 1713.

⁵⁴ *Po aty*, 2 janar 1714.

mungesës së drithërave ‘*scarsezza della raccolta*’ në Ballkan, u ndalua përsëri tregtia e tyre ‘*à prohibire l’extrazione del grano*’.⁵⁵

Pikërisht në vitin 1709, edhe kompania e londrinave holandeze e drejtuar nga Pulimeno-Neranzi do ta kishte shtrirë tregtinë e saj të pëlhurave dhe të veshjeve prej mëndafshi në Sicili në këmbim të lëndëve të para, nëse nuk do të ishte përhapur fenomeni i korsarisë për shkak të luftës për Fronin e Spanjës.⁵⁶

Për sa i përket tregtisë së lëkurëve, një sasi e madhe lëkurësh kalonte nga Durrësi në Ankonë pikërisht nëpërmjet konsullatave franko-holandeze, ndërsa për Venecien meqenëse eksporti i lëkurëve nëpërmjet Dalmacisë ishte i paktë, i importonte ato nga Durrësi dhe i përmbushte nevojat e saj me lëkurët që arrinin nga Durrësi në Ankonë.⁵⁷

Stanjacioni i tregtisë në vitin 1709 i kishte detyruar disa tregtarë që të kishin shkëmbime tregtare me Raguzën për faktin se kapitenët e anijeve refuzonin të ngarkonin disa mallra dhe kishin dyfishuar tarifat e qiramarrjes së anijeve.⁵⁸

Më 30 korrik 1709, mallrat ishin pakësuar për shkak të largimit të tregtarëve dhe konsulli Roza u propozoi Pesë të Urtëve mbylljen e rrugës tregtare.⁵⁹ Megjithëse tregtia në portin e Durrësit vazhdoi edhe gjatë vitit 1710, ajo ishte shkatërruar dhe shpresat për një ripërtëritje ishin të pakta “*ne vi è apparenza, che il negotio ritorni ad incaminarsi*”.⁶⁰ Drastike ishte edhe rënia e numrit të anijeve që niseshin nga Durrësi. Ato ishin reduktuar nga 10-12 anije që niseshin më parë me ngarkesa prej 1 000 pakosh në dy anije me nga 700-800 pako.⁶¹ Kjo do të ndikonte gjithashtu në të ardhurat konsullore. Lidhur me këtë çështje, konsulli venecian pohoi se ato nuk ishin të larta si në të kaluarën dhe se nevojitej një vlerësim i saktë nga krerët e tregut, të cilët i kishin informuar autoritetet veneciane se këto të ardhura do të arrinin në 2 000 dukate për 1 500 dengjet me lesh që ishin ngarkuar nga të dyja anijet “*Perchè è passato il tempo, che questa Scala rendeva quelle somme*”.⁶² Sidoqoftë, ishte

⁵⁵ *Po aty*, 12 janar 1714.

⁵⁶ *Po aty*, 21 shkurt 1709.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ Candiani, “Sanità”, 38.

⁵⁹ ASV, CSM, 1. S., b. 661, 30 korrik 1709.

⁶⁰ *Po aty*, 10 gusht 1710.

⁶¹ *Po aty*, 6 gusht 1709.

⁶² *Po aty*, 6 tetor 1710.

llogaritur se për të dyja portet e Durrësit dhe të Bunës, ato mund të arrinin në 1 500 dukate.⁶³

Sipas tabelës në vijim, në vitin 1710 pati një rritje të tregtisë së leshit me 7,8% në krahasim me vitin 1709, ndërsa tregtia e lëkurëve u pesëfishua, ndërkohë që tregtia e dyllit pësoi një rënie me 26,4%. Për këtë duhet të ketë ndikuar në mënyrë të veçantë shpallja e tarifave të reja doganore të mallrave të eksportit të Shqipërisë në vitin 1710.⁶⁴ Sigurisht, kjo ishte diktuar nga situata e vështirë në të cilën gjendej tregtia në muajt e parë të vitit, çka i shtyu krerët e tregut që të kërkonin heqjen e taksës doganore veneciane prej 2% të Cottimos.⁶⁵ Në fakt, të ardhurat doganore ishin të ulëta.

Tabela 2 për të tria produktet kryesore të tregtisë së portit të Durrësit në dyvjeçarin 1709-1710⁶⁶

Viti	1709		1710	
Malli	Sasia e leshit dhe e dyllit në libra dhe e lëkurëve në copë	Dukate	Sasia e leshit dhe e dyllit në libra dhe e lëkurëve në copë	Dukate
Leshi	468.667	1.051,18	508.651	1.145,11
Saftjan dhe lëkurë dashi	9.163	126,4	38.329 <u>3.490</u> 41.819 <u>392</u> <u>42.211</u> 45.436	597,24
Dylli	28.826	2.879,15	213.049	2.569,8
Taksa në dukate për të tria produktet	4.048,27		4.311,43	

Reforma doganore i uli çmimet e qiramarrjes së anijeve për mallrat kryesore, si p.sh.: leshi që më parë transportohej me 12 dukate çdo 1 000

⁶³ Po aty, CSM, 2. S., b. 61, 14 prill 1710.

⁶⁴ Po aty, CSM, 2° S., b. 48, tarifat e mallrave të miratuara nga Senati më 26 prill 1710 dhe të shpallura më 21 korrik 1710.

⁶⁵ Po aty, CSM, 2° S., b. 61, 14 prill 1710.

⁶⁶ Po aty, CSM, 2° S, b. 48, 10 janar 1714; Gligor Stanojević, "Statistički podaci o izvozu iz Albanije u Veneciju pocetkom XVIII vijeka", *Mesovita Gradja*, Miscellanea vol. 14 (Beograd: Prosveta, 1985), 14-15.

libra, tashmë zbriti në 9 dukate, ndërsa për lëkurët nga 14 dukate për 1 000 copë paguanin 11 dukate, gjë që e lehtësoi tregtinë.⁶⁷

Në vitin 1710 pati një zgjerim edhe tregtia franko-holandeze e duhanit. Dragomani i nderit i konsullatës franceze në Selanik dhe tregtari voskopojar Konstantin Paiko, ndërmori tregtinë e duhanit në ortaki me Joan Neranzin e Nicola Pulimenon.⁶⁸ Ata e tregtonin atë drejt Ankonës duke u bërë konkurrencë sipërmarrësve venecianë të duhanit, që e siguronin atë në Shqipëri.⁶⁹

Në vitin 1711, detyrat e konsullit u fokusuan në ndalimin e shmangies së mallrave nga drejtimi i tyre në Republikën e Venecies si në vitin 1710 dhe pakësimit të numrit të anijeve të huaja në portin e Durrësit «*perchè non si disperdino le merci dalla Piazza di Venezia come seguì l'anno decorso, e non si introduchino a maggior numero di bastimenti esteri in questa scala*».⁷⁰ Vështirësitë për anijet perashtine rridhnin nga anijet e konsullatave të tjera dhe qiramarrja e anijeve ulqinake.

Pati edhe shkaqe të tjera të jashtme që lidheshin me situatën në Perandorinë Osmane. Gjatë Luftës Ruso-Turke në vitin 1711, Beilerbeu i Rumelisë zbriti edhe në Shqipëri për rekrutimin e sejmenëve dhe të spahinjve dhe mbledhjen e taksave. Por, në disa zona nga mosbindja e sejmenëve nuk kishte qenë i mundur rekrutimi, prandaj bejlerbeu ishte zhvendosur në Selanik. Nga Vlora e Kanina e deri në Janinë njerëzit ishin ngritur kundër taksave dhe rekrutimeve dhe gjithashtu kishte pasur luftime me beilerbeun.⁷¹

Si rezultat i reformës doganore, tregtia pati një rritje në dyvjeçarin 1711-1712. Po t'i referohemi tabelës së mëposhtme, tregtia e leshit në vitin 1712 u përgjysmua në krahasim me vitin 1711, ashtu si dhe tregtia e lëkurëve, ndërsa tregtia e dyllit u rrit me 17,3%. Megjithatë, taksa doganore në total për vitin 1712 ishte më e lartë se ajo e vitit 1711.

⁶⁷ Po aty, CSM, 1. S, b. 661, 28 prill 1707; po aty, CSM, 2. S., b. 48, 4 korrik 1710.

⁶⁸ Jorgos N. Svoronos, *Le commerce de Salonique* (Paris: Presses Universitaire de France, 1956), 17, 200-202.

⁶⁹ ASV, CSM, 1. S, b. 661, 21 shkurt 1709.

⁷⁰ Po aty, 19 janar 1711.

⁷¹ Po aty, 30 prill 1711.

Tabela 3 për të tria produktet kryesore të tregtisë së portit të Durrësit në dyvjeçarit 1711-1712.⁷²

Viti	1711		1712	
Malli	Sasia e leshit dhe e dyllit në libra dhe e lëkurëve në copë	Dukate	Sasia e leshit dhe e dyllit në libra dhe e lëkurëve në copë	Dukate
Leshi	788.963	1.714,13	396.353	879
Lëkurë	65.583	911,60	35.003	421,71
Dylli	499.345	6.041,3	603.890	7.286,18
Taksa në dukate për të tria produktet	7.996,97		8.586,89	

Efekti i saj u ndie edhe në vitin 1713 dhe më pas pësoi rënie. Në vitin 1714, tregtia e leshit ra me rreth 6 herë në krahasim me vitin 1713 dhe tregtia e dyllit ra 1.5 herë ose me rreth 64,5%, ndërsa ajo e lëkurëve u rrit me 15,8%. Rënia e tregtisë së leshit, sipas konsullit venecian, lidhet me konkurrencën e tregtarëve të huaj «*a causa della concorrenza dei mercanti stranieri*», kryesisht francezë që kishin ngarkuar një pjesë të leshit dhe sasinë e tij të paktë në treg.⁷³ Si rezultat, koha e pritjes së anijeve veneciane në port ishte zgjatur.⁷⁴ Në këtë periudhë, francezët po investonin pará dhe kapitale në tregti «*portando per negozio parte de contanti*» për blerjen e produkteve të vendit, si vaji dhe gruri, duke shkaktuar rritjen e çmimeve në treg përkatësisht me 22 aspra për okën e vajit dhe 24 aspra për grurin, ndërkohë që kriza e drithërave në vitin 1714 kishte mbërthyer Rumelinë.⁷⁵ Këto pará vinin nga tregtia e veshjeve dhe e londrinave franceze të importit, të cilave ua kishin ulur çmimet në 180-200 dukate për metër «*a d. 200, e 180 il braccio*», duke penguar në këtë mënyrë shitjen e veshjeve veneciane «*queste fano restare la vendita d'e panni Veneziani*» dhe atyre që arrinin nga Ankona.

⁷² Po aty, CSM, 2° S, b. 48, 10 janar 1714; Stanojević, “Statistički”, 15-17.

⁷³ ASV, CSM, 1° S, b. 662, 27 korrik 1714 dhe 28 korrik 1714.

⁷⁴ Po aty, 28 korrik 1714.

⁷⁵ Po aty, 27 korrik 1714.

Tabela 4 për të tria produktet kryesore të tregtisë së portit të Durrësit në dyvjeçarin 1713-1714.⁷⁶

Viti	1713		1714	
Malli	Sasia e leshit dhe e dyllit në libra dhe e lëkurëve në copë	Dukate	Sasia e leshit dhe e dyllit në libra dhe e lëkurëve në copë	Dukate
Leshi	603.664	1352,18	100.887	224,15
Lëkurë	19.886	427,67	23.639	135
Dylli	457.246	5530,9	295,091	3569,21
Taksa në dukate për të tria produktet	7.309,94		3.928,36	

Po t'i referohemi taksës doganore në tabelat e mësipërme, vihet re se tregtia pati një rritje në dyvjeçarin 1711-1712 dhe një rënie të lehtë në vitin 1713, për t'u përgjysmuar më pas në vitin 1714 që shënoi fillimin e luftës së Moresë. Në fakt, mungojnë të dhënat për periudhën 1714-1718, por me mbarimin e luftës dhe rivendosjen e paqes me marrëveshjen e Pasarovicit (1718), rihapet edhe tregtia.⁷⁷

Në janar 1713, tregtarët e Shkodrës nisën të frekuentonin portin e Durrësit. Në anijen *San Niccolò e Madonna de Carmini* shumica e mallrave u përkisnin tregtarëve shkodranë.⁷⁸ Megjithëse anijes iu krijua një e çarë nga stuhia dhe u ndal në portin e Tivarit për ta riparuar atë përkohësisht, ajo arriti në Kotorr ku iu desh të qëndronte në *Porto Rose* dhe më pas me vështirësi e dërgoi mallin në Herceg Novi.

Në prill 1713, konsulli Roza ishte thirrur në Venecia nga Proveditorët e Armatimeve (*Provveditor all'Armar*) dhe brenda 3-4 muajve ai do të nisej që të takonte me këtë rast edhe Pesë të Urtët dhe do t'ia linte drejtimin zëvendësit të tij, Giovanni Cumano.⁷⁹ Por në shtator, ai u detyrua ta shtynte nisjen për në pranverën e vitit 1714, sepse në vend që të mbaronte si zakonisht me të gjitha ngarkesat e anijeve, i duhej të priste anije të tjera.⁸⁰ Gjithashtu, një arsye tjetër ishte ardhja e anijeve

⁷⁶ *Po aty*, CSM, 2° S, b. 48, 10 janar 1714; Stanojević, "Statistički", 17-18.

⁷⁷ Papahagi, "Les Roumains", 47.

⁷⁸ ASV, CSM, 1. S., b. 662, 19 janar 1713.

⁷⁹ *Po aty*, 18 prill 1713.

⁸⁰ *Po aty*, 10 shtator 1713.

korsare veriafrikane në dimër, për të cilat ai duhej të informonte bailiun. Kështu, konsulli venecian Roza u largua më 4 korrik 1714 dhe u zëvendësua nga zëvendëskonsulli Giovanni Cumano.⁸¹ Me sa duket, Pesë të Urtët po shpallnin zgjedhjen e konsullit të ri. Kjo shfaqet në një letër të dërguar nga Kurbin, ku argjipeshkvi katolik i Durrësit shprehte mbështetjen e tij për konsullin Pietro Roza.⁸²

Në këtë periudhë, Venecia po siguronte rezervat e nevojshme të drithit. Këtë e dëshmon fakti i pjesëmarrjes së Venecies në tregtinë e drithit me 7 anije, nga 18 shtatori 1713 e deri në fillim të vitit 1714, dy prej të cilave edhe me ngarkesa vaji.⁸³ Pikërisht, nga mesi i janarit 1714 pati mungesë të drithit në të gjithë Rumelinë dhe kjo solli si rezultat ndalimin e tregtisë së drithërave.⁸⁴ Kjo ndodhte edhe gjatë përgatitjeve për fushata ushtarake, kur gruri grumbullohej nga ushtria në magazinat e shtetit.⁸⁵

Anijet franceze dhe gjenoveze ishin të pranishme në Vlorë në shek. XVII.⁸⁶ Në çerekun e parë të shek. XVIII, ato arrinin tashmë edhe në Durrës, gjë që nxiste edhe më tepër konkurrencën me anijet perashtine për sa u përket ngarkesave me lesh, vaj dhe grurë.⁸⁷

Nga fundi i vitit 1714, venecianët vazhdonin me grumbullimin e drithit. Përveç anijeve që frekuentonin portin e Durrësit për drithëra, venecianët angazhuan edhe anijet që po ktheheshin pa ngarkesa nga Lindja.⁸⁸

Gjithashtu, konsulli venecian duhej të merrej edhe me çështje të tjera që u përkisnin shtetasve venecianë, si në rastin e 7 marinarëve dezertorë të një anijeje që po mbushte ujë në Vlorë, të cilët u çarmatosën nga banorët dhe iu dorëzuan doganierit, i cili më pas i drejtoi te konsulli Roza.⁸⁹ Pasi i bindi që t'i riktheheshin marinës, i dërgoi me një anije të shoqëruar nga nënkancelari i konsullatës te proveditori i jashtëzakonshëm

⁸¹ *Po aty*, 11 korrik 1714.

⁸² *Po aty*, 30 korrik 1714.

⁸³ *Po aty*, 2 janar 1713.

⁸⁴ *Po aty*, 12 janar 1714.

⁸⁵ Pëllumb Xhufi, *Arbërit e Jonit. Vlorë, Delvina e Janina në shek. XV-XVII*, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike (Tiranë: Onufri, 2016), 543.

⁸⁶ *Po aty*, 547.

⁸⁷ ASV, CSM, 1. S., b. 662, 13 shtator 1714.

⁸⁸ *Po aty*, 11 nëntor 1714.

⁸⁹ *Po aty*, 9 tetor 1713.

i Kotorrit, të cilit i shkruante që t'i falte ata.⁹⁰ Edhe më 1720, disa dezertorë venecianë të trupave të përtejdetit (*Truppe Oltremarine*) me seli në Korfuz, arritën me një anije ulqinake në Durrës.⁹¹

Pikërisht në dhjetor 1714, anijet ulqinake nisën të frekuentonin portin me pëlqimin e venecianëve. Dy anije ulqinake që erdhën për të ngarkuar duhan dhe një anije që kishte ardhur në Durrës në nëntor për të ngarkuar leshin e tregtarëve shkodranë, ishin gati për t'u nisur në Venecia.⁹² Ndërkohë që kishte shpërthyer lufta e Moresë, më 7 dhjetor 1714, një javë më pas lajmi nuk kishte ardhur akoma në Durrës, por dihej se veziri ishte gati për sulm.⁹³

Preteksti për nisjen e saj ishte se Venecia nuk kishte respektuar Traktatin e Karlovicit dhe nuk kishte dorëzuar ikanakët nga Mali i Zi në Kotorr dhe se gjoja kishte ndihmuar piratët maltezë.⁹⁴ Megjithëse, tregtia me Venecien u ndal gjatë luftës së Moresë (1714-1718), ajo e zhvilloi atë nëpërmjet konsullatave angleze, holandeze dhe gjenoveze që u hapën nga tregtarët Joan Neranzi dhe Gjergj Vreto.⁹⁵ Në tregtinë me Venecien ishin përfshirë gjithashtu në këtë periudhë edhe anijet franceze. Në një letër, shpjegohet se anija franceze e kapitenit Stéphan Sicard që transportonte mëndafsh me anë të tregtarit Leonard Capitanachi, ishte sulmuar nga një anije ulqinake dhe ishte zhdëmtuar ndoshta pjesërisht nga siguruesit venecianë.⁹⁶ Për këtë çështje, ambasadori francez në Stamboll shkruante se nevojiteshin 90 çanta me pará, shumë e barabartë me 45 000 zekinë.

Në shtator 1713 vdiq konsulli francez i Durrësit, Balthasar Comte, i cili u zëvendësua në shkurt 1714 nga konsulli i ri Joseph Isnard.⁹⁷ Mungesa e konsullit francez e shtyu konsullin venecian në tetor të po atij viti që të mendonte se konsullata franceze e Durrësit nuk ishte në ditët më të mira.⁹⁸

⁹⁰ *Po aty*.

⁹¹ *Po aty*, 26 maj 1720.

⁹² *Po aty*, 14 dhjetor 1714.

⁹³ *Po aty*.

⁹⁴ Nikola Samardžić, "The Peace of Passarowitz 1718: An Introduction", *The peace of Passarowitz*, ed. Charles W. Ingrao, Nikola Samardžić, Jovan Pešalj, West Lafayette (Indiana: Purdue University Press, 2011), 13.

⁹⁵ Valeriu Papahagi, *Aromăni Moscopoleni Și Comerțul Venețian in sec. al XVII-lea și al XVIII-lea*. (București: 1935), dok. XLIX, 9 shtator 1715, 194.

⁹⁶ ASV, CSM, 1. S., b. 662, 19 shkurt 1719.

⁹⁷ *Po aty*, 23 shkurt 1714.

⁹⁸ *Po aty*, 9 tetor 1713.

Në vitin 1717, Isnard pas një konflikti me kapitenin Louis Marcel iu desh të mbështetej te tregtarët e portit të Durrësit dhe kryesisht ata voskopojarë, si Gjergj Vreto, Mihail Simo dhe vëllai i tij, që do të dëshmonin në favor të Isnard-it në mënyrë që ai t'ia dërgonte deklaratën ambasadorit francez në Stamboll.⁹⁹ Megjithatë, konsulli francez i Durrësit u hoq për shkak të humbjeve që i shkaktoi tregtisë.¹⁰⁰ Në vend të tij, në dokumentet e vitit 1719 shfaqet konsulli i ri francez Carlo Ventura.

Si përfundim, reformat doganore të vitit 1705 dhe 1710, ndikuan në rritjen e tregtisë në vitet 1707-1708 dhe 1711-1713. Gjatë luftës së Moresë për t'i lehtësuar marrëdhëniet tregtare Venecia i hoqi taksat doganore, por ato u rivendosën në prag të rihapjes së konsullatës veneciane dhe tregtisë me Shqipërinë në janar 1719.¹⁰¹

Burime dhe bibliografi:

Arkiva:

Archivio dello Stato di Venezia (më tej: ASV)

Cinque Savi alla Mercanzia (CSM) 1. S, b. 661 (1699-1711)

- CSM, 1. S, b. 662 (1712-1738)
- CSM, 1. S., b. 61, (1709 – 1722)
- CSM, 2. S, b. 48, (1700 – 1712)

Literaturë historiografike:

Candiani, Guido. “Sanità e controllo mercantile alle Bocche di Cattaro: il Lazzeretto di Castelnovo, 1700-1797”. *Mediterranea – ricerche storiche* – v. XVII, nr. 48 (prill 2020): 29-58.

Costantini, Giovanni. “Commercio e Marina”. Në *Storia di Venezia, L'Ultima fase della Serenissima*, ed. Paolo del Negro e Paolo Preto, 555-612, vol. VIII. Roma: Giovanni Treccani, 1998.

Costantini, Vera. “Commerci e economie nell'Adriatico d'età moderna”, *Balcani occidentali, Adriatico e Venezia fra XIII e XVIII secolo / Der Westliche Balkan, der Adria-raum und Venedig (13-18. Jahrhundert). Schriften der Balkan Kommission*, 50, ed. Oliver Jens Schmitt,

⁹⁹ Papahagi, “Les Roumains de l'Albanie”, 55-56.

¹⁰⁰ Anne Mezin, *Les consuls de France au siècle des Lumières (1715-1792)* (Paris: Ministère des Affaires étrangères, Direction des archives et de la documentation, 1997), 26.

¹⁰¹ ASV, CSM, 1. S., b. 61, 15 janar 1719.

- Gherardo Ortalli. Venezia: Istituto Veneto di Scienze, Lettere ed Arti / Wien: Österreichische Akademie der Wissenschaften Philosophisch-historische Klasse, 2009.
- Dispacci del capitano del Golfo Alvise Foscari 1708-1711, ed. Fausto Sartori. Venezia: Malcontenta, 2006.
- Hoti, Ulpian. "An overview of trade aspects between Albania and Western Countries". *European Academic Research*, vol. III, Issue 2 (maj 2015): 2590-2599.
- Mezin, Anne. *Les consuls de France au siècle des Lumières (1715-1792)*. Paris: Ministère des Affaires étrangères, Direction des archives et de la documentation, 1997.
- Papahagi, Valeriu. "Les Roumains de l'Albanie et le commerce vénitien aux XVIIe et XVIIIe siècles", *Mélanges de l'École roumaine en France*. Paris: 1931: 29-124.
- Papahagi, Valeriu. *Aromani Moscopoleni, Şi Comerţul Veneţian in sec. al XVII-lea si al XVIII-lea*. Bucureşti: 1935.
- Samardžić, Nicola. "The Peace of Passarowitz, 1718: An Introduction". *The peace of Passarowitz*, ed. Charles W. Ingrao, Nikola Samardžić, Jovan Pešalj. West Lafayette, Indiana, Purdue University Press, 2011: 9-38.
- Signori, Umberto. "Reti consolari veneziane nell'Impero ottomano del Seicento". Në *Isole e frontiere nel Mediterraneo moderno e contemporaneo*, ed. Arturo Gallia, Lavinia Pinzarrone, Giannantonio Scaglione. Studi e ricerche. Palermo: Infieri, 2017: 19-35.
- Stanojević, Gligor. "Statistički podaci o izvozu iz Albanije u Veneciju početkom XVIII vijeka". *Mesovita Gradja, Miscellanea*, vol. 14. Beograd, Prosveta, 1985: 7-20.
- Svoronos, Jorgos N. *Le commerce de Salonique*. Paris: Presses Universitaire de France, 1956.
- Shkodra, Zija. "Hyryje". Në *Dokumente mbi Shqipërinë në shekullin XVIII: Letra të konsujve venedikas të Durrësit (1696-1707)*. Përktheu dhe përgatiti për botim Zija Shkodra. Tiranë: Akademia e Shkencave, 1975.
- Khufi, Pëllumb. *Árbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shek. XV-XVII*. Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike. Tiranë: Onufri, 2016.
- D'Alberton Vitale, Rossana. "La scala di Durazzo negli anni del console Rosa (1705-1733)". Në *Studi veneziani*, vol. XXXIV. Pisa, Roma: Istituti editoriali e poligrafici internazionali, 1997: 225-245.

ALVIN SARAÇI

Institute of History/ Academy of Sciences of Albania

saracialvin@hotmail.com

*S u m m a r y***THE TRADE RELATIONS BETWEEN DURRËS AND VENICE
IN THE YEARS 1707-1714**

The trade relations between the port of Durrës and Venice during the period 1707-1714 are based on the correspondence of the Venetian consul of Durrës with the Trade Venetian Authority of *Cinque Savi alla Mercanzia*. The consular reports cast light on the difficulties that trade came across and the causes that affected it, while the Venetian custom house statistics furnish us the quantity of goods in pounds or lbs and the customs tax in ducats giving us a view of the economic and trade framework of the three main wares: wool, leather and wax. Among the causes are: the competition with the other consulates, the rise of the number of foreign ships, the decrease of the freights, the flight of the merchants, the closing of the consulate in 1709 and the contrasts before the Venetian Morean War of Morea, the law of the prohibition of the grain trade for the Venetians and the ships of Ulqin and Perast in 1709 and 1714 etc. Among the measures the Venetian authorities took, though their temporary effect, were the two customs reforms of 1705 and 1710 that livened up trade.

HAXHI ADEMI

Instituti i Historisë "Ali Hadri", Prishtinë

ademihaxhi@hotmail.com

<https://doi.org/10.61773/yytrjh34>

**PUSHTIMI I SHQIPËRISË NGA ITALIA DHE REFLEKTIMI
TE SHQIPTARËT NË KOSOVË
1939-1941**

Abstrakt:

Artikulli synon të japë një vështrim të përgjithshëm rreth pushtimit të Shqipërisë nga Italia në vitin 1939 dhe ndikimit të këtij pushtimi te shqiptarët në Kosovë. Pas pushtimit, Italia ndërmori masa strategjike për realizimin e objektivave të saj politike dhe ushtarakë.

Studimi thekson rëndësinë e Marrëveshjes së Mynihut të vitit 1938, e cila riktheu shpresat për ribashkimin e Kosovës dhe të Çamërisë, duke forcuar aspiratat shqiptare për të korrigjuar padrejtësitë historike të vendosura ndaj tyre në Konferencën e Ambasadorëve në Londër gjatë viteve 1912-1913.

Pushtimi italian intensifikoi reagimet e liderëve shqiptarë në Jugosllavi kundër shpërnguljes dhe rriti shpresën për bashkim me Shqipërinë. Për shqiptarët e Kosovës, pushtimi italian ishte "drita në fund të tunelit". Propaganda italiane mbështeti idenë e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Gjendja e krijuar nga pushtimi italian nxiti shpresat për realizimin e aspiratave kombëtare, duke intensifikuar reagimet kundër politikave jugosllave të spastrimit etnik. Bashkimi kombëtar dhe përballja me politikën e Beogradit u bënë çështje kryesore për shqiptarët në Kosovë.

Fjalë kyçe:

Pushtimi italian, Shqipëri, Kosovë, përbërja etnike, Lufta e Dytë Botërore, rrethanat ndërkombëtare, aspirata shqiptare, politika serbe, bashkim kombëtar.

Hyrje

Kosova¹ dhe krahinat lindore shqiptare të aneksuara nga Jugosllavia deri në vitin 1912 përbënin shumicën absolute të popullsisë, ndërsa elementi sllav (serb, malazez, bullgar, maqedonas) ishte një pakicë e parëndësishme, e infiltruar gjatë kohës së Perandorisë Osmane. Diplomati dhe studiuesi shqiptar, Hamit Kokalari, në librin e tij “Kosova – djepi i shqiptarizmit”, përshkruan përbërjen etnike të këtyre krahinave shqiptare dhe thekson se “elementët serbe e malazeze” në Kosovë “nuk përfaqësonin veçse 5% të popullsisë së përgjithshme”. Sipas tij, në veri të “distrikteve të Shkupit, Kumanovës, Tetovës, Gostivarit dhe Kërçovës”, as para e as pas vitit 1912, nuk figuronte asnjë element “bullgaro-maqedonas”.² Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (dhjetor 1912 – korrik 1913), u vendosën ndarjet territoriale që përfshinin Kosovën dhe viset e tjera shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi. Procesi i dëbimit të popullsisë shqiptare nga Kosova dhe trevat verilindore, përkatësisht Maqedonia e Veriut e sotme, filloi me shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike, rënien e Perandorisë Osmane dhe pushtimin e tokave shqiptare nga aleanca ortodokse ballkanike, përkatësisht ajo serbo-malazezo-bullgaro-greke.³ Dokumentet e zbuluara kohët e fundit tregojnë se brenda vitit 1912-1913, ushtritë pushtuese të lartpërmendura, sidomos ajo serbe, dëbuan me dhunë mbi 120 000 shqiptarë të besimit islam. Shumica e tyre u vendosën në Stamboll, Anadoll dhe në vise të tjera të Turqisë.⁴

¹ Me këtë term gjeografik u jemi referuar kufijve të sotëm politikë të Kosovës, që përfshin një sipërfaqe prej 10 877 km². *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II (H-M), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare (Tiranë: Kristalina-KH, 2008), 1293-1323.

² Hamit Kokalari, *Kosova – djepi i shqiptarizmit*, Lidhja Kosovare në mërgim (New York: Flushing N. Y., 1962), 86.

³ Rexhep Qosja, *Çështja shqiptarëve* (Prishtinë: Toena: 1998), 111-113.

⁴ Hakif Bajrami, “Konventa jugosllave-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve”, në *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, Hakif Bajrami (red.), Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova (Prishtinë: 1992), 177; *Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë (1922-1941)* (përmbledhje dokumentesh), përzgjedhja dhe redaktimi Qerim Lita, Instituti i Historisë “Ali Hadri” (Prishtinë: 2019), 5.

Si rezultat, Luftërat Ballkanike (1912-1913) jo vetëm që larguan Perandorinë Osmane nga Ballkani, por shkaktuan edhe zhvendosjen masive të një popullsie të madhe të besimit mysliman. Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913) lanë gjysmën e popullsisë dhe të trevave shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë së pavarur.⁵ Vetëm nën sundimin e Serbisë dhe të Malit të Zi mbetën të paktën 900 000 shqiptarë në një territor prej 22 000 km².⁶ Shqiptarët që mbetën nën regjimin serb dhe malazez u përballën me dhunë fizike dhe presion psikologjik, shkatërrimin e vendbanimeve dhe grabitjen e ushqimeve dhe të bagëtisë. Përveç vrasjeve, pushteti serbo-malazez zbatoi konvertimin e dhunshëm të shqiptarëve katolikë dhe myslimanë në ortodoksi sllave.⁷ Ky konvertim kishte për qëllim shkombëtarizimin dhe asimilimin e asaj pjese të popullsisë që do të pranonte ndërrimin e fesë, ndërsa për ata që refuzonin, synimi ishte zhvendosja. Kështu, pushteti synonte spastrimin etnik dhe krijimin e një Kosove të pastër sllave dhe ortodokse.⁸ Konsullata e Përgjithshme e Serbisë në Selanik i kishte raportuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Beograd se gjatë 17 muajve të fundit të periudhës nëntor 1912 – mars 1914, rreth 240 000 myslimanë ishin zhvendosur nga viset e sapoçliruar në Turqi përmes portit të Selanikut. Ky proces përfshi u jo vetëm pjesët greke të Maqedonisë, por edhe territore të tjera të kontrolluara nga Serbia dhe Mali i Zi. Raporti nënvizon se një numër i konsiderueshëm i këtyre të shpërngulurve ishin përballur me kushte të rënda dhe nuk kishin mundur të përshtateshin me administratën e re. Arsytet e kësaj shpërnguljeje janë të shumta. Pamundësia për t'u përshtatur me sundimin e ri serbo-malazez dhe fanatizmi fetar janë faktorët kryesorë që nxitën këtë fenomen. Pushteti

⁵ Arkivi i Institutit të Historisë – Tiranë (më tej: *AIHT*), Fondi: *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.P.A.A.*) (Arkivi Mbretëror dhe Shtetëror, Vjenë), Vj. 23-10-1080, nr. 4269. Relacion tepër konfidencial i kontit Berchtold në Vjenë, dërguar konsullit austro-hungarez në Vlorë Lejhanec, Vjenë, 9 shtator 1913.

⁶ Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Bon -Tiranë: Iliria, 1992), 9.

⁷ *HHSt.A.P.A.A.* në *AIHT*, Vj. 24-40-4037, nr. 29. Raport i zëvendëskonsullit austro-hungarez në Prizren, Kohlrus, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Prizren, 8 shkurt 1914.

⁸ Richard C. Hall, *The Balkan Wars 1912-1913: Prelude to the First World War* (London, New York: Routledge, 2000), 4-5; Oliver Jens Schmitt, *Ballkani në shekullin XX* (Tiranë: Artini, 2021), 78-79.

grek, gjithashtu, kishte kontribuar në këtë situatë duke e bërë të pamundur ekzistencën e myslimanëve në këto vise, duke u konfiskuar pronat dhe duke ua dhënë ato kolonëve grekë. Në total, shpërngulja është realizuar përmes 395 anijeve dhe nuk përfshinte fëmijët nën moshën 6 vjeç. Pjesa më e madhe e këtyre 240 000 njerëzve ishte vendosur në Stamboll, Anadoll dhe në vise të tjera të Turqisë. Ky informacion tregon për një operacion të madh dhe të organizuar për zhvendosjen e myslimanëve nga Ballkani drejt Turqisë.⁹

Pas përfundimit të luftës Serbia, duke qenë pjesë e bllokut fitues të Antantës, e shfrytëzoi mirë këtë moment historik. Qëllimi i hershëm i monarkëve serbë për një shtet të përbashkët të sllavëve të Jugut ku do të dominonin serbët, u realizua me formimin e Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene (MSKS), më 1 dhjetor 1918.¹⁰ Me themelimin e kësaj mbretërie, rifilloi politika antishqiptare, e cila synonte nënshtrimin e shqiptarëve dhe ndryshimin e strukturës etnike për të integruar këto troje në mbretëri.¹¹ Pas një pushtimi fillestar në tetor të vitit 1912, Kosova u ripushtua nga forcat serbe midis 16 dhe 26 tetorit 1918, duke u bërë pjesë e Mbretërisë SKS. Pas Luftës së Parë Botërore, Kosova u përfshi me dhunë në Mbretërinë Serbo-Kroato-Sllovene në vitin 1918, e cila më vonë, në tetor të vitit 1929, u transformua në Mbretërinë e Jugosllavisë. Gjatë kësaj periudhe, rrethanat politike dhe socio-ekonomike në Kosovë ishin tejet të vështira, për shkak të politikave shtypëse të regjimit të Beogradit.¹² Me miratimin e kushtetutës së re, Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene ndryshoi emrin në Mbretëria e Jugosllavisë. Në vitin 1929, ajo u riorganizua administrativisht në njësi të quajtura banovina. Territori i

⁹ *Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914*, Књига 7, Свеска 1, Одељење историјских наука, Београд, 1980 (*Dokumenti o spoljnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914*, Knjiga 7, Sveska 1, Odeljenje istorijskih nauka (Beograd: 1980)), 617-618.

¹⁰ Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene u themelua më 1 dhjetor 1918 në Beograd, ku në Pallatin Mbretëror, Princi trashëgimtar Aleksandri shpalli solemnisht bashkimin e mbretërisë së serbëve, kroatëve dhe sllovenëve në një mbretëri të bashkuar. Shih Georges Castellan, *Historia e Ballkanit* (Prishtinë: NGBGSH Gutenberg, 1997), 442.

¹¹ Hakif Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb (1844-1995)* (Prishtinë: QIK, 1995), 96.

¹² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (KMKK), Dosja (më tej: D.) 28/3, Nr. 161, II/1991, Viti (më tej: V.) 1921, fl. 1. Mbi krimet serbe në tokat shqiptare, 12 shkurt 1921.

Kosovës u nda në tri banovina: 1. Banovina e Vardarit, ku përfshiheshin qarku i Gjilanit, Ferizajt (Nerodimes), Graçanicës, Kamenicës, Podgorës, Gorës dhe Malit të Sharrit; 2. Banovina e Zetës, që përfshinte qarkun e Gjakovës, Pejës, Mitrovicës, Drenicës, Istogut dhe Podrimës; dhe 3. Banovina e Moravës, që përfshinte qarkun e Vushtrrisë dhe Llapit.¹³ Përveç ndarjes së territoreve shqiptare në disa banovina, kjo masë synonte të dobësonte popullsinë shqiptare dhe të pengonte bashkërendimin e tyre në organizimin e kryengritjeve apo aktiviteteve të tjera kundër pushtetit të Beogradit.

Kjo politikë antishqiptare vazhdoi deri në prill të vitit 1941, kur Mbretëria Jugosllave, përfshirë Kosovën, u pushtua nga Fuqitë e Boshtit.¹⁴ Gjatë periudhës 1918-1941, shqiptarët e Kosovës u trajtuan si qytetarë të dorës së dytë. Ndaj tyre, Mbretëria Jugosllave përdori forma të ndryshme shtypjeje.¹⁵ Hapësirat shqiptare në këtë mbretëri u shndërruan në koloni serbe, ku u vendosën mbi 60 mijë kolonë serbë dhe malazezë.¹⁶ Përveç këtij kolonizimi, shqiptarët u detyruan të shpërnguleshin dhe numri i të shpërngulurve nga Kosova varionte nga 100 mijë deri në 150 mijë shqiptarë, të cilët u vendosën kryesisht në Turqi dhe në Shqipëri. Në tërësi, nga trojet shqiptare në Mbretërinë e Jugosllavisë gjatë periudhës së përmendur janë shpërngulur 240 mijë shqiptarë,¹⁷ por ky numër mund të jetë edhe më i madh, pasi statistikatat nuk janë reale në paraqitjen e numrit

¹³ Liman Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1878-1941*, Instituti i Historisë (Prishtinë: 2004), 86.

¹⁴ Haxhi Ademi, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945)*, Instituti i Historisë “Ali Hadri” (Prishtinë: 2021), 83-84.

¹⁵ *Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme*, Fondi MPJ (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V.) 1960, Dosja (më tej: D.) 530/2. B VII -2, fl. 8-10. Relacion: “Gjendja dhe probleme të popullsisë shqiptare në Jugosllavi”.

¹⁶ *Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit* (më tej: AIDSSH), Fondi (më tej: F.) 7, Viti (më tej: V.) 1946, Dosja (më tej: D.) 128, fl. 57-58. Raport mbi Kosovën; Millan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*, Institut za istoriju Kosova (Priština: 1981), 223; Ramiz Abdyli, “Vështrim mbi papunësinë në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)”, në *Vjetari*, nr. XVII-XIX, Arkivi i Kosovës (Prishtinë: 1984), 232; Jusuf Osmani, *Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941, Dokumente: Kolonizimi*, vëll. I (Prishtinë: pa botues, 2016), 99-100; Ademi, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore*, 454.

¹⁷ Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*, Instituti i Historisë (Prishtinë: 1981), 177

total të të shpërngulurve.¹⁸ Pozita e shqiptarëve në prag të Luftës së Dytë Botërore ishte jashtëzakonisht e vështirë, për shkak të mungesës së zhvillimit ekonomik në Kosovë dhe në trevat shqiptare brenda Mbretërisë së Jugosllavisë. Jo vetëm që nuk u bë asnjë investim në këto vise, por pushteti jugosllav punoi sistematikisht për shpërnguljen e popullsisë shqiptare dhe zëvendësimin e saj me popullsi sllave.¹⁹ Gjatë periudhës ndërmjet Dy Luftërave Botërore, autoritetet e Beogradit zbatuan Reformën Agrare me synim shpronësimin dhe largimin e shqiptarëve, duke ua dhënë tokat e tyre kolonëve sllavë. Reforma Agrare dhe kolonizimi ishin dy mjete kryesore të përdorura për të arritur objektivin e Beogradit: ndryshimin e strukturës etnike në disfavor të shqiptarëve, të cilët përbënin shumicën dërrmuese në Kosovë. Kolonizimi kishte gjithashtu si qëllim parandalimin e emigrimit të popullsisë serbe dhe malazeze drejt Amerikës, duke u ofruar atyre toka të shqiptarëve. Zbatimi i Reformës Agrare dhe kolonizimi kaluan nëpër tri faza: e para nga viti 1912 deri më 1920, e dyta nga viti 1920 deri më 1934, dhe e treta nga viti 1934 deri më 1941. Gjatë këtyre fazave, politika e Beogradit intensifikoi përpjekjet për realizimin e Reformës Agrare dhe kolonizimin, duke synuar ndryshimin e strukturës etnike në favor të popullsisë sllave në trevat shqiptare.²⁰

Shpërngulja u bë në mënyra dhe forma të ndryshme, kryesisht përmes dhunës, por këtu vlen të përmendet edhe marrëveshja e vitit 1938 e njohur si Konventa jugosllavo-turke, e cila parashihte shpërnguljen e shqiptarëve në Republikën e Turqisë.²¹ Duhet theksuar se për shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova ishin hartuar me dhjetëra programe politike, gjersa për këtë çështje kishte përgatitur një program edhe akademiku serb Vasa Cubrilovic, i cili në referatin e mbajtur më 7 mars 1937 në Klubin e Kulturës Serbe, shpjegonte mënyrat më “efikase” me të cilat Mbretëria Jugosllave duhej t’i shpërngulte shqiptarët nga

¹⁸ Osmani, *Kolonizimi, Reforma Agrare*, I, 94.

¹⁹ Noel Malcom, *Kosova një histori e shkurtër* (Prishtinë: Koha, 2011), 358.

²⁰ Osmani, *Kolonizimi, Reforma Agrare*, I, 58.

²¹ *Arhiv Jugoslavije, Beograd* (më tej: AJ), F. Dvor (Oborri Mbretëror). Shkresë e ambasadës mbretërore dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme – Sektorit politik, Beograd, 19 nëntor 1935; *Historija Diplomatiје*, vol. III, redaktor Vladimir Petrović Potemkin (Zagreb: Matica Hrvatska, 1951), 505-507; Hakif Bajrami, “Konventa Jugosllave-Turke e vitit 1938 për shqiptarët”, në *Gjurmime albanologjike*, Seria e shkencave historike, nr. XII/1982 (Prishtinë: 1983), 245-246.

Kosova.²² Gjatë viteve '30 të shek. XX, shqiptarët e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare përjetuan një periudhë jashtëzakonisht të vështirë. Pushteti i Beogradit ushtroi një fushatë të gjerë dhune dhe terrori kundër tyre. Qëllimi kryesor i kësaj fushate ishte shpërngulja e shqiptarëve nga vendet e tyre të origjinës. Shpërngulja u realizua përmes masave të ndryshme represive, përfshirë përdorimin e forcës, presionin ekonomik dhe politik, si dhe propagandën. Një numër i madh i shqiptarëve u detyruan të lënë shtëpitë dhe tokat e tyre, duke u vendosur kryesisht në Turqi dhe në Shqipëri. Këto veprime patën pasoja të rënda për popullsinë shqiptare, duke përfshirë humbjen e pronave, ndryshimet demografike dhe vështirësitë ekonomike dhe sociale në vendet pritëse.²³ Edhe në prag të Luftës së Dytë Botërore, rrethanat e përgjithshme politike, ekonomike, administrative, arsimore e kulturore për shqiptarët, ishin tejte të vështira.²⁴

Shqiptarët e Kosovës, jo vetëm që nuk gëzonin asnjë të drejtë kombëtare e qytetare, por nga pushteti jugosllav trajtoheshin mjaft keq. Të gjitha qeveritë e Mbretërisë së Jugosllavisë, që nga ripushtimi i Kosovës më 1918 e deri në fillim të Luftës së Dytë Botërore, ndoqën një diskurs politik që ishte në kundërshtim me interesat kombëtarë të shqiptarëve.

Megjithatë, shqiptarët në një masë të vogël u bënë pjesë e institucioneve shtetërore, ngaqë donin të përfaqësonin interesat e tyre kombëtarë, sado që mundësitë ishin fare minimale. Në fundin e viteve '30 ata i gjejmë, ndonëse jo në masën e duhur, të kyçur në jetën politike duke vepruar në parti të ndryshme si në Partinë Demokratike, Partinë Radikale etj. Arsyet e integritit në partitë politike serbe i gjejmë te mungesa e partive shqiptare, sepse Xhemijeti që ishte partia e vetme që mbronte interesat e tyre në Mbretërinë e Jugosllavisë, kishte kohë që ishte shuar nga pushteti i Beogradit.²⁵

²² Vaso Çubrilloviq, *Shpërngulja e shqiptarëve* (SHBA: botuar në: "Zëri i Kosovës", organ i lëvizjes për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi, 1982), 5.

²³ AMPJ, V. 1960, D. 530/2. B/VII -2-, fl. 8-10. Relacion: "Gjendja dhe probleme të popullsisë shqiptare në Jugosllavi". Për më tepër, shih: Ali Hadri, "Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918- 1941)", në *Studime historike*, nr. 2 (1988): 78-95.

²⁴ AIDSSH, F. 7, V. 1946, D. 128, fl. 57-58. Raport mbi Kosovën.

²⁵ Afrim Krasniqi, *Partitë politike në Shqipëri (1920-2006)*, Instituti i Studimeve Politike (Tiranë: Eurorilindja, 2006), 79.

Liderët e skenës politike shqiptare të Kosovës u përfshinë në jetën politike, me qëllim që të përfaqësonin interesat e popullit shqiptar në Mbretërinë e Jugosllavisë. Ata u munduan në mënyra të ndryshme që të përfaqësonin interesat e shqiptarëve në institucionet më të larta shtetërore në Beograd. Parlamenti ishte arena ku më së shumti, deputetët shqiptarë përfaqësuan interesat e tyre kombëtarë dhe jo rrallë reagues kundër politikës diskriminuese që pushteti jugosllav ndiqte ndaj shqiptarëve.²⁶

Pa marrë parasysh pozitën e disfavorshme të shqiptarëve në kuadër të Mbretërisë së Jugosllavisë dhe përkundër faktit se shteti i tyre amë ishte pushtuar nga Italia, prandaj edhe nuk mund të prisnin mbështetje, megjithatë ata edhe gjatë vitit 1939 zhvilluan në forma të ndryshme aktivitete politike. Personalitetet më të njohura që zhvilluan aktivitete të ndryshme ishin: Ferhat Draga, Asim Luzha, Shaban Mustafa, Sherif Voca, Bajazit Boletini, Sulejman Kryeziu, Iljaz Agushi,²⁷ Bajram Ajvazi, Asim Jakova, Mustafa Dërguti, Ilijaz Prishtina, Sejdi Hoxha, Sadik Zeneli, Asim Efendi Luzha (deputet i Drenicës) etj.²⁸ Ndërsa, nga gjysma e dytë e vitit 1939, në Kosovë, në formë ilegale ishte ringjallur organizata “Bashkimi” (Xhemijeti). Nga të dhënat e kohës kuptojmë se Ferhat Draga kishte mbajtur një tubim themelues në Banjë të Vranjës. Në këtë mbledhje kishin marrë pjesë edhe Ilijaz Agushi, Qerim Zena, Jusuf Imeri, Sherif Voca, Adem Mormullaku, Jahja Daci, Sadik Kurti dhe Asim Luzha. Të gjithë kryetarët shqiptarë përpiqeshin që kjo lëvizje të maskohej me përkrahjen e Bashkimit Radikal Jugosllav (JRZ),* por në të vërtetë të punohej në frymën e grupit të shqiptarëve. Përkundër përpjekjeve të personaliteteve të sipërsëhënuara për të përfaqësuar

²⁶ Hakif Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*, Instituti i Historisë, Prishtinë: 1981, 267-268; Idriz Halabaku, *Lëvizjet Nacionalçlirimtare në zonën okupuese bullgare të Kosovës (1941-1944)* (Punim i magistraturës), Universiteti i Prishtinës (Prishtinë: 1977), 39.

²⁷ Iljaz Agushi pas pushtimit të Kosovës dhe bashkimit me Shqipërinë mbajti pozita të larta, ishte nënkryeministër dhe ministër i Punëve Botërore. “Emërimi i qeverisë së re Libohova”, *Tomori*, nr. 114, Tiranë, 13 maj 1943, 1; Iljaz Agushi vritet më 27 tetor 1943. *AIHT*, F. A-V-9, “Kronologjia e ngjarjeve në Shqipëri, 1925-1946”, fl. 30.

²⁸ Ademi, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore*, 26.

* Fjala shtet dhe mbret zëvendësoheshin me JRZ (Jugosovenska Radikalna Zajednica – Bashkësia Jugosllave Radikale) dhe me Stojadinoviç, sepse partia e tij ishte shtetkrijuese dhe se ata duhej të konsideroheshin të shenjtë. Më gjerësisht shih në: Bajrami, *Rrethanat shoqërore*, 267.

interesat e shqiptarëve nëpërmjet përfshirjes së tyre në institucionet shtetërore (Parlamentin Jugosllav etj.), megjithatë, gjendja e tyre nuk ndryshoi ngaqë burgosjet, persekutimet, vrasjet²⁹ ishin bërë tanimë dukuri të zakonshme ndaj shqiptarëve që përfshiheshin në kuadër të Jugosllavisë. Pra, gjendja e popullsisë shqiptare në prag të Luftës së Dytë Botërore vijoi të ishte tepër e rëndë.

Madje, me qëllim që të paralizojë jeta politike e partive, me urdhëresë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, gjatë muajit maj të vitit 1940 ishte ndaluar çdo tubim publik, si edhe veprimtaria propagandistike në përgjithësi. Politikanët duhej të mbanin qëndrim neutral dhe se populli nuk duhej të manifestonte kurrfarë shqetësimi lidhur me situatën ndërkombëtare. Andaj me të drejtë, mund të themi, se jeta politike që nga themelimi i Mbretërisë SKS e deri në prill të vitit 1941, ishte tejte e rëndë, në veçanti për shqiptarët, të cilët nuk pushuan së punuari për të përfaqësuar të drejtat e tyre etnike e qytetare.³⁰

Reflektimi i rrethanave ndërkombëtare te shqiptarët në prag të Luftës së Dytë Botërore

Marrëveshja e Mynihut, e mbajtur më 29 shtator 1938, është një ngjarje e rëndësishme në historinë e Luftës së Dytë Botërore e cila ndriçoi strategjitë dhe aspiratat e Adolf Hitlerit për zgjerimin territorial të Gjermanisë. Hitleri kishte nisur planin e tij për zgjerimin e Gjermanisë me aneksimin e Austrisë më 12 mars 1938. Ky ishte një hap i rëndësishëm që e sfidonte Traktatin e Versajës, i cili kishte vendosur ndalimin e bashkimit të Austrisë me Gjermaninë pas Luftës së Parë Botërore. Hitleri përdori konceptin e vetëvendosjes si justifikim për

²⁹ Vrasjet politike në Kosovë filluan që nga viti 1920 me helmimin e Ilija Krasojoviqit në Prizren, vrasjen e Ahmet Mulla Sylës nga Shtimja, vrasjen e Nazim Gafurrit (1923), Zef Lush Markut (1928-1929), Ramë Bllacës (1879-1938/39). Të dhënat janë të ndryshme për sa i përket vitit të vrasjes së Ramë Bllacës: 27 gushti i vitit 1938 dhe viti 1939). Por dihet mirëfilli arsyeja e vrasjes së tij nga ana e pushtetit të Beogradit: u shpreh hapur në Beograd kundër shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi. Me t'u kthyer nga Beogradi u vra në Bllacë nga Osman Qerimi. Sipas të dhënave të historiografisë shqiptare, vrasja e deputetit ishte atentat i kurdisur nga qeveria në Beograd me qëllim që të përhapej frika te shqiptarët. Shih: Adem Derguti, Rexhep Shahu, *Bllaca* (monografi), (Kukës: Dy Drina, 2013), 21-43.

³⁰ Ademi, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore*, 28.

veprimet e tij, duke argumentuar se austriakët donin të bashkoheshin me Gjermaninë.³¹

Shqiptarët në Kosovë dhe në Çamëri, që ishin ndarë midis Serbisë (pjesë e Jugosllavisë) dhe Greqisë, shpresonin se parimi i vetëvendosjes që kishte bërë jehonë në Europë mund të aplikohet për ta dhe të ndihmonte në rivendosjen e territoreve të humbura. Veprimet e Hitlerit për të bashkuar rajonet me popullsi gjermane në Çekosllovakia përmes forcës, krijuan një precedent që shqiptarët besonin se mund të përdorej për të mbështetur kërkesat e tyre për ripërkufizimin e kufijve dhe për të rikuperuar territoret e humbura. Në kontekstin e paqësimit të europianëve ndaj kërkesave të Hitlerit, shqiptarët shpresonin se ndërkombëtarët do të tregonin të njëjtën tolerancë ndaj kërkesave të tyre për të korrigjuar padrejtësitë që kishin ndodhur pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane dhe pas ndarjeve territoriale që u bënë pas Luftës së Parë Botërore.³²

Për Hitlerin që ishte në invazion, bashkimi i Austrisë me Gjermaninë nuk mjaftoi, kështu që kërkoi përfshirjen e të gjitha shteteve, në të cilat jetonin një numër i popullsisë gjermane. Prandaj, pas Austrisë u pushtua Çekosllovakia që kishte 15 milionë banorë, prej të cilëve vetëm një e treta ishin çekë. Nga popullsia (minoritetet) që jetonin në Çekosllovakia, 3.5 milionë prej tyre ishin gjermanë, të cilët jetonin në krahinën e Sudeteve që ishte pranë kufirit me Gjermaninë, dhe sipas Hitlerit duhej të përfshiheshin në kuadër të Gjermanisë.³³

Me ambiciet dhe kërkesat e Hitlerit u pajtua edhe Kryeministri anglez, Neville Chamberlain (Nevil Çemberlein), pas një takimi të zhvilluar më 15 shtator 1938, ku Hitleri i foli për keqtrajtimin e gjermanëve në këtë zonë. Çemberlein pranoi që Çekosllovakia të copëtohej dhe të gjitha krahinat e saj me popullsi mbi 50% gjermane t'i bashkëngjiteshin Gjermanisë. Detajet rreth kësaj ndarjeje do të bëheshin në takimin tjetër të radhës, pas dy ditëve, në Bad Godesberg, në Lanin e Rinit. Çemberlein në këtë periudhë kohore "bindi" qeverinë çeke ta pranonte propozimin e tij.³⁴ Në takimin e Bad Godesberg-ut, që u

³¹ Henry Kissinger, *Diplomacia* (Tiranë: Laert, 1999), 311; Daut Bislimi, *Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945*, Instituti Albanologjik (Prishtinë: 1997), 37.

³² Ademi, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore*, 92.

³³ Kissinger, *Diplomacia*, 311; Bislimi, *Formacionet politiko-ushtarake*, 37.

³⁴ AMPJ, V. 1939, D. 44, fl. 98. Telegram i ambasadorit shqiptar në Londër mbi fjalimin e kryeministrit anglez rreth pushtimit të Çekosllovakisë, Londër, 17 mars 1939.

zhvillua më 24 shtator, Hitleri i rriti kërkesat, duke bërë të qartë se ai nuk pranonte të humbiste kohë me procedurat e plebishitit e demarkacionit krahinë më krahinë, por kërkonte që procesi të fillonte më 26 shtator, pra katër ditë më pas e jo të përfundonte më vonë se për 48 orë. Çemberlein nuk arrinte të kuptonte, se si mund t'i bëhej një poshtërim kaq i madh Çekosllovakisë, ndërsa Kryeministri francez Daniel, reagoi akoma më me vendosmëri: “Për disa ditë lufta është e pashmangshme”.

Në këto rrethana, Britania e Madhe, tashmë kishte pranuar ndarjen e Çekosllovakisë së bashku me të drejtën e vetëvendosjes për gjermanët e Sudeteve. Ajo së bashku me Francën po i afroreshin vendimit për të hyrë në luftë, jo për të mbështetur një aleat, por për shkak se brenda një kohe tepër të shkurtër do të sulmoheshin nga Gjermania, e cila shprehte hapur ambiciet e saj për pushtimin e sa më shumë shteteve.³⁵ Në rrethanat e tensionit të vazhdueshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, diplomacia italiane doli me një ide për zgjidhjen e kësaj krize. Kështu, Benito Mussolini – Duçe (Benito Musolini) i “nxori nga situata të gjithë” duke bërë propozimin për një konferencë, e cila ishte parashikuar midis ministrave të Jashtëm të Italisë dhe Gjermanisë, por që tashmë duhet të zgjerohet edhe me pjesëmarrjen e kryetarëve të qeverive të Francës (Édouard Daladier, sq. Daladie), Britanisë së Madhe (Çemberlein), Gjermanisë (Hitleri) dhe Italisë (Musolini). Të katër udhëheqësit u takuan më 29 shtator 1938 në Mynih (München), takim i cili nuk zgjati shumë. Kryeministri francez dhe ai anglez bënë përpjekje të vazhdueshme për ta kthyer propozimin e parë që Çekosllovakia të copëtohej dhe të gjitha krahinat e saj me popullsi mbi 50% gjermane do t'u bashkëngjiteshin Gjermanisë. Musolini nxori një dokument që përmbante propozimin e Hitlerit të bërë në Bad Godesberg. Në anën tjetër, Hitleri përshkroi çështjen në formën e një ultimatumit. Si përfundim, mund të themi se, ftesa nga Musolini për një takim në Mynih ishte vetëm që të pranohej paqësisht programi i Hitlerit të programuar në Bad Godesberg, përpara se të fillonte lufta për ta imponuar atë.³⁶ Ky takim shërbeu si një anomali e veçantë: ndëshkimi për dorëzim para shantazhit të cilin e pranuan udhëheqësit anglez dhe francez në emër të paqes. Megjithatë, synimet e

* Në librin e Kissinger-it del në pah një gabim ortografik, duke ngatërruar Godesberg me fjalën Golesberg. Bad Godesberg është lagje e qytetit të Bonit me 73 172 banorë (2014). www.godesberg.de

³⁵ Kissinger, *Diplomacia*, 311-313.

³⁶ *Po aty*, 313-314.

Hitlerit nuk përfunduan me ndarjen e Çekosllovakisë,³⁷ por vazhduan me pushtimin e plotë të saj, vetëm gjashtë muaj pas Mynihut, pra në mars të vitit 1939.³⁸ Sukset e tij e inkurajuan edhe Italinë, respektivisht udhëheqësin e saj Musolinin, i cili për pak muaj pushtoi Shqipërinë.³⁹ Me pushtimin e plotë të Çekosllovakisë nga Gjermania, u shkelën parimet bazë të Versajës. Por, me anë të këtij veprimi, Hitleri kërkonte dominim në Europë dhe jo vetëvendosje apo barazi mes shteteve dhe kombeve.

Marrëveshja e Mynihut ngjalli shpresa në mesin e shqiptarëve për rikthimin e krahinave të humbura të Kosovës nga Mbretëria e Jugosllavisë dhe të Çamërisë nga Greqia. Prandaj, në SHBA, emigrantët e Çamërisë i dërguan një letër katër nënshkruesve të paktit të Mynihut, duke kërkuar prej tyre të korrigjonin vendimet e Konferencës së Ambasadorëve, më 1913.⁴⁰

Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste më 7 prill 1939

Në prag të Luftës së Parë Botërore, në tetor të vitit 1914, Italia ndërmoi një veprim sulmues ndaj Shqipërisë, duke pushtuar ishullin e Sazanit dhe qytetin e Vlorës. Kjo ndodhi në kohën e largimit të Princit Wilhelm von Wied nga vendi. Edhe pa qenë pjesëmarrëse në luftë, Italia arriti të merrte kontrollin mbi këto territore shqiptare. Traktati sekret i Londrës, i firmosur më 26 prill 1915, detyroi Aleatët të njihnin sovranitetin e Italisë mbi këto territore të pushtuara, duke konsoliduar pozicionin italian në Shqipëri.⁴¹

³⁷ Pjesa çeke u bë protektorat gjerman, ndërsa Sllovakia teknikisht u caktua shtet i pavarur, por nën varësinë e Gjermanisë. Më gjerësisht shih: Kissinger, *Diplomacia*, 314-316.

³⁸ R. Gerald Hughes, "The Ghosts of Appeasement: Britain and the Legacy of the Munich Agreement," *Journal of Contemporary History* (Sage Publications, Ltd., 2013), 48: 4, 688-716, 691.

³⁹ Eric Hobsbawm, *Epoka e ekstremeve* (Tiranë: Çabej, 1994), 128.

⁴⁰ Adolf Hitler, *Testamenti Politik (4 shkurt-29 prill 1945)*, (Tiranë: Helga's Secrets, 2012), 45; Owen Pearson, *Albania and King Zog, Independence, Republic and Monarchy* (Londër: The Center for Albanian Studies, 2004), 410.

⁴¹ Bernd J. Fischer, *Shqipëria gjatë Luftës (1939-1945)* (Tiranë: Çabej, 2000), 30; AIHT, F. A-VIII-305, Referati (elaborati) i dr. Ivo Andriqit mbi Shqipërinë, viti 1939 (përktheu Hasan Çipuri), botuar në revistën "Časopis za Suvremenu Povijest, Broj 2(24) godine IX. (Zagreb, 1977) (revista për historinë moderne, Pakti i Londrës dhe Shqipëria), 9; "Italia dhe Shqipëria", *Gazeta e Korçës*, Nr. 34, 13 tetor 1920, 1; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Periudha e Pavarësisë (28 nëntor 1912 – 7 prill

Italia kishte një interes të vazhdueshëm në Shqipëri që nga shpallja e Pavarësisë së saj, por ky interes u thellua pas Luftës së Vlorës në vitin 1920. Ndryshe nga vendet e tjera fqinje të Shqipërisë, si Greqia dhe Jugosllavia, të cilat kishin interesa kryesisht territorialë, Italia synonte të zgjeronte ndikimin e saj politik dhe ekonomik. Hapja e Bankës Kombëtare të Shqipërisë në vitin 1925 nën kontrollin italian⁴² dhe nënshkrimi i dy pakteve të rëndësishme në vitet 1926 dhe 1927, janë shembuj të përpjekjeve të Italisë për të forcuar pozitën e saj në Shqipëri.⁴³

Në arenën ndërkombëtare viti 1938 konsiderohej si viti i çështjeve minoritare dhe të të drejtave të tyre (Mbledhja e Mynihut). Ahmet Zogu e shfrytëzoi interesimin italian për të gjallëruar irredentizmin te shqiptarët dhe la hapësirë për rigjallërimin⁴⁴ e Komitetit të Kosovës në Shqipëri, pa llogaritur aktivizimin në këtë drejtim të nëpunësve të tij të besuar, me origjinë nga Kosova (Sali Vuçiternën, Bedri Pejanin, nipin e Isa Boletinit, Tafil Boletinin, Ali Riza Kosovën, Hysni Pejën, Mehmet Delinë).⁴⁵ Më

1939), redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2007), 78-80; Më gjerësisht për pretendimet greke ndaj Shqipërisë, shih: AMPJ, V. 1945, D. 128/1, fl. 34; Sonila Boçi, *Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritetit (1939-1949)*, Qendra e Studimeve Albanologjike / Instituti i Historisë (Tiranë: Kristalina-KH, 2012), 54.

⁴² Živko Avramovski, “Okupimi i Shqipërisë nga Italia dhe qëndrimi i qeverisë jugosllave”, në *Përparimi*, nr. 1-2 (1964), 25.

⁴³ AMPJ, V. 1939, D. 32, fl. 174. Marrëveshjet midis Shqipërisë dhe shteteve të tjera deri më 7 prill 1939, Tiranë, 19 dhjetor 1945; Bajram Xhafa, “Kushtet historike të ngritjes së Mbretërisë Shqiptare”, në *Monarkia Shqiptare (1928-1939)*, QSA / Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2011), 40; Pranvera Teli- Dibra, “Kriza e marrëdhënieve shqiptaro-italiane në optikën diplomatike angleze (1931-1934)”, në *Monarkia Shqiptare*, 146.

⁴⁴ Në vitet '30 të shek. XX, Komiteti i Kosovës në Tiranë vepronte aktivisht, në bashkëpunim me figurat e tjera drejtuese publike të lëvizjes kosovare dhe me rrymat e quajtura “Irredentistët kosovarë prozogistë”. Përfaqësuesit prozogistë nga Kosova ishin shumë aktivë pranë Mbretit Zog dhe përpiqeshin që ta nxisnin atë që t'i mbronte shqiptarët në kuadër të Jugosllavisë dhe dëshironin që, shqiptarët të cilët jetonin në Kosovë dhe në Maqedoni ta ruanin gjuhën e tyre, të ishin të vetëdijshëm për kombësinë e tyre, të siguronin ekzistencën kombëtare dhe në ndonjë ndryshim historik eventual të haseshin si shqiptarë të vetëdijshëm. *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. III (1925-1939), drejtues dhe redaktor shkencor Beqir Meta, grup autorësh, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2020), 606.

⁴⁵ Verli, “Interesimi i shtetit shqiptar”, 221-222.

vonë, Komiteti i Kosovës⁴⁶ të cilin e drejtonte Bedri Pejani, u shtri edhe në Kosovë.⁴⁷

Më 7 prill 1939, Italia fashiste ndërmori pushtimin e Shqipërisë, një veprim që ishte rezultat i një interesi të gjatë dhe të përkushtuar për vendin.⁴⁸ Nën udhëheqjen e Benito Musolinit, Italia zhvilloi marrëdhënie të ngushta diplomatike dhe ekonomike me Shqipërinë, duke forcuar ndikimin e saj përmes marrëveshjeve të ndryshme. Huat e dhëna dhe marrëveshjet ekonomiko-financiare dëshmojnë për intensifikimin e përpjekjeve të Italisë për të dominuar në Shqipëri, duke e shndërruar atë në një protektorat të vetin. Në vitet 1937-1938, ministri i Jashtëm i Italisë, konti Galeazzo Ciano, hartoi dhe zbatoi planin për pushtimin e Shqipërisë. Përpjekjet e tij për të nënshtruar vendin u intensifikuan me miratimin e planit të tij nga Musolini, në janar të vitit 1939.⁴⁹ Më 5 prill, kundërpërgjigjja shqiptare për traktatin e propozuar nga Italia nuk arriti të shmangete pushtimin. Italia kishte mbledhur 20 mijë trupa në Bari dhe Brindisi, të gatshme për të sulmuar në rast refuzimi nga pala shqiptare.⁵⁰ Pushtimi i Shqipërisë nga Italia më 7 prill 1939 shënoi fundin e ekzistencës së shtetit të pavarur shqiptar. Kjo ngjarje ishte pjesë e planeve strategjike të Fuqive të Boshtit për vendosjen e regjimit fashist

⁴⁶ Synimi i Komitetit ishte riaktivizimi i çetave kaçake dhe bashkimi i Kosovës me Shqipërinë. Në periudhën korrik-shtator kryetar ishte Ismet Bej Kryeziu, i cili gëzonte besimin e Zogut. Më pas u emërua Sali Vuçiterna, i cili qëndroi në këtë pozitë deri në verën e vitit 1939. Pas tij u emërua Bedri Pejani. Që të tre këta luajtën një rol të rëndësishëm, ndërsa anëtarë të tjerë ishin Sali Mani (Bajraktari) nga Gashi, Xhaferr Spahia nga Tropoja, Mehmet Aliu nga Vlana – prefekturë e Kosovës, Baftjar Kollovazi nga Borja e Lumës, Murat Koloshi nga Maqellara e Dibrës. Të gjithë këta kishin çetat e tyre të gatshme për çdo aksion. Qendra e Komitetit në Kosovë ishte Gjakova, e drejtuar nga ndërmarrja “Rizvanolli”. Ferhat Draga, aktivizoi në këtë drejtim Xhafer Devën, Shaban Mustafanë, Mustaf Aliun, të gjithë nga Mitrovica, Iliaz Agushin nga Prishtina, Hafiz Abdullahun nga Prizreni. *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. III, 607.

⁴⁷ AQSH, F. 149, V. 1941, D. I-1170, fl. 109. Mbi situatën e krijuar, Mitrovicë, 1 korrik 1941. Për Komitetin e Kosovës, Bedri Pejani.

⁴⁸ Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe tokat e lirueme 1939-1946* (Tiranë: Botimet Jozef, 2018), 58.

⁴⁹ Shyqyri Ballvora, “Qëndresa e popullit shqiptar dhe kriza e regjimit fashist të pushtimit (prill 1941 – dhjetor 1941)”, në *Studime historike*, nr. 1, V. XXI (V) (1968): 178.

⁵⁰ AMPJ, V. 1939, D. 44, fl. 102. “Italianët a do të zbarkojnë në Shqipëri”, Gjenevë, 4 prill 1939.

në rajonin e Ballkanit dhe të Mesdheut. Në këtë kohë të vështirë, shqiptarët u ndien të pambrojtur nga vendet demokratike, duke mbetur të vetëm përballë agresionit italian.⁵¹ Një ndër ngjarjet historike që jo rrallë bëhet objekt studimi është data 7 prill 1939, kur Italia pushtoi ushtarakisht Shqipërinë.⁵² Nga kjo ditë, Shqipëria pushoi së qeni si një shtet i pavarur në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare.⁵³ Pushtimi i saj ishte pjesë e planeve strategjike të Fuqive të Boshtit për vendosjen e regjimit fashist në rajonin e Ballkanit dhe të Mesdheut, zonë me rëndësi strategjike.⁵⁴ Pra, me pushtimin e Shqipërisë nga Italia, shënohet fundi i ekzistencës së shtetit të pavarur shqiptar. Megjithatë, a duhet analizuar qëndrimi i tyre kundrejt pushtimit italian? Ditët e para të prillit të vitit 1939 ishin plot tension për Mbretin e Shqipërisë, Zogun, i cili kishte presion nga diplomacia dhe politika italiane, e cila i sforcoi veprimet e saj për ta pranuar projekttraktatin e propozuar nga ana e tyre. Trysnia u shtua edhe ndaj qytetarëve dhe në veçanti ndaj shtresave intelektuale dhe rinisë shkollore e universitare. Kështu, nxënësit e shkollave, studentë, intelektualë e patriotë dolën rrugëve e shesheve në protesta e në demonstrata. Më 5 e 6 prill, ata demonstruan para institucioneve më të rëndësishme të shtetit, si para Pallatit Mbretëror, selisë së qeverisë, legatave franceze e amerikane etj. Qytetarët të revoltuar nga presioni italian, kërkonin armë dhe shpreheshin të gatshëm për të luftuar.⁵⁵ Por, Mbreti Zog dhe kabineti i qeverisë i drejtuar nga Koço Kota nuk mund t'u dilnin në ndihmë demonstruesve, ngaqë ndodheshin në një gjendje të rëndë. Në fakt, demonstratat në Tiranë, por edhe në qytetet më të mëdha të vendit objektivisht nuk ishin drejtuar kundër tyre. Ato ishin reagim

⁵¹ AIHT, F. A-VIII-297, Xhelku Maksutoviç, "Rezistenca evropiane në vitet e Luftës së Dytë Botërore (1938-1945)", vëll. I (përktheu Sh. Hobdari), (*Rezistența Europeană în anii celui de-al doilea război mondial 1938-1945*, vol. I, Bucurest: 1973), fl. 5; Bajram Xhafa, *Qëndresa e 7 prillit 1939, vepër e shtetit kombëtar shqiptar*, (Shkodër: Camaj-Pipa, 2007), 12; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj (1939-1990), redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (Tiranë: Toena, 2008), 23.

⁵² Xhafa, *Qëndresa e 7 prillit 1939*, 12.

⁵³ AIHT, F. A-VIII-297, Xhelku Maksutoviç, "Rezistenca Evropiane në vitet e Luftës së Dytë Botërore", fl. 5.

⁵⁴ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, f. 23.

⁵⁵ Gurakuqi, *Shqipëria dhe Tokat e Lirue*, 56-57.

kombëtar që erdhi si mbështetje në momentet më të rënda për qenësinë e shtetit dhe të kombit.⁵⁶

Në përfundim, pushtimi italian i Shqipërisë më 7 prill 1939 shënoi jo vetëm fundin e pavarësisë shtetërore, por gjithashtu tregoi gatishmërinë e shqiptarëve për t'u përballur me agresionin e huaj, duke u organizuar në protesta dhe demonstrata masive nëpër qytete, si një shprehje e fortë e ndjenjës kombëtare dhe përpjekjeve për të mbrojtur qenësinë e shtetit dhe dinjitetin e kombit.

Ndikimi i pushtimit italian i Shqipërisë te shqiptarët në Kosovë, 1939-1941

Pushtimi i Shqipërisë pati ndikim edhe te shqiptarët në Jugosllavi. Në njërën anë, liderët politikë filluan të reagonin më intensivisht kundër shpërnguljes së shqiptarëve. Pas pushtimit italian të Shqipërisë, shqiptarët në Kosovë panë një shpresë për realizimin e aspiratave të tyre për bashkim me Shqipërinë. Për ta, kjo ishte "drita në fund të tunelit", pasi gjendja e tyre politike, ekonomike dhe sociale në Kosovë ishte shumë e vështirë. Italia, e nxitur nga ambiciet për zgjerim, e pa pushtimin dhe aneksimin e Shqipërisë si një hallkë të rëndësishme në zinxhirin e projekteve të saj ekspansioniste në Ballkan. Në verën e vitit 1939, ndikuar nga invadimi gjerman në Europë, Italia filloi të hartonte plane për zgjerim të mëtejshëm duke përfshirë jo vetëm Shqipërinë, por edhe Jugosllavinë dhe trevat shqiptare të kontrolluara prej saj. Duke qenë në dijeni të pozitës së rëndë të shqiptarëve nën sundimin jugosllav dhe dëshirës së tyre për bashkim kombëtar, Italia e shfrytëzoi këtë situatë për të promovuar nacionalizmin shqiptar dhe për të zhvilluar një strategji konkrete. Sipas ministrit të Jashtëm italian, Galeazzo Ciano, kjo strategji përfshinte tri faza kryesore: (1) propagandën kulturore dhe fetare për të theksuar identitetin kombëtar shqiptar; (2) përmirësimin e kushteve sociale dhe mirëqenies publike; dhe (3) krijimin e një organizate klandestine ushtarake të gatshme për të ndërhyrë në momentin kur do të shpërthente kriza jugosllave.⁵⁷

Cilat ishin politikat kryesore që pushteti i Beogradit përdori për të ndryshuar raportet etnike në Kosovë? Pushteti i Beogradit, përmes

⁵⁶ Paskal Milo, *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore I* (Tiranë: Toena, 2014), 32-33.

⁵⁷ *The Ciano Diaries (1939-1943)*, edited by Hugh Gibson (UK: Simon Publications, 2001), 93-112.

politikave institucionale, synonte të ndryshonte raportet etnike në Kosovë duke dëbuar popullsinë shqiptare nga trojet e tyre. Këto politika përfshinin shpërngulje të detyruar, diskriminim ekonomik dhe represion kulturor, të cilat rëndonin më tej situatën e shqiptarëve në rajon. Për më tepër, shqiptarët po përballeshin me një sistem arsimor që përpiqej të asimilonte popullsinë shqiptare duke promovuar kulturën dhe gjuhën serbe.⁵⁸

Në këtë klimë të tensionuar, pushtimi italian i Shqipërisë u perceptua si një mundësi për të sfiduar *status quo*-në dhe për të kërkuar një ribashkim të territoreve shqiptare. Lëvizjet patriotike dhe nacionaliste shqiptare filluan të intensifikoheshin, duke kërkuar mbështetje ndërkombëtare për çështjen e tyre. Shqiptarët në Kosovë dhe më gjerë shpresonin se Italia, si një fuqi e madhe europiane, do të ndihmonte në realizimin e aspiratave të tyre kombëtare.⁵⁹

Megjithatë, realiteti politik dhe strategjik i kohës ishte kompleks, dhe interesat e Fuqive të Mëdha shpesh binin ndesh me aspiratat e popujve të vegjël. Pavarësisht shpresave të shqiptarëve, pushtimi italian i Shqipërisë nuk solli menjëherë ndryshimet e dëshiruara në Kosovë dhe në territoret e tjera shqiptare nën sundimin jugosllav.

Jugosllavët kishin frikë se italianët mund të realizonin aspiratat e tyre, dhe ky shqetësim mund të ilustruhet duke shqyrtuar një plan sekret të Shtabit të Përgjithshëm në Beograd. Ky plan dërguar ministrit të Luftës dhe të marinës jugosllave, si edhe ministrit të Punëve të Jashtme dhe atij të Punëve Brendshme të Mbretërisë Jugosllave, përmban detaje që tregojnë këtë frikë, duke përfshirë ndër të tjera:

“Tashmë ka një numër të konsiderueshëm të shqiptarëve të cilët deklarojnë: ‘le të vijë edhe dreqi i mallkuar, do të jetë më mirë se kështu [...]. Shqiptarët janë të pakënaqur me gjendjen që kanë në shtetin tonë. Ky është një fakt të cilit nuk mund t’i ikim. Ata kërkojnë dalje nga kjo situatë, janë të gatshëm që t’i besojnë çdokujt dhe të bien pre e secilës propagandë. Mu për këtë, besohet se edhe propaganda italiane mund të mbështetet nga një numër i madh i tyre. Tashmë edhe i ka bërë për vete. Nëse merret parasysh sistemi i punës i propagandës italiane dhe posedimi i mjeteve. Ndoshta është e mjaftueshme vetëm premtimi se toka e marrë do

⁵⁸ Ademi, *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore*, 92.

⁵⁹ Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, Instituti i Historisë (Prishtinë: 2012), 30.

t'u kthehet, që të gjithë shqiptarët tanë t'i bëjë italofilë. Gjendja e këtillë mund të paralizohet në dy mënyra: ose sa më parë t'i shpërngulim nga territori ynë, ose në anën tjetër t'i kënaqim me kërkesat e tyre në pikëpamje materiale dhe kulturore. Kuptohet se kjo e fundit me siguri se ata do t'i kënaqte vetëm përkohësisht, që në kohë sa më të afërt, ndoshta për ne më e pafavorshme, përsëri të kërkojnë bashkimin me Shqipërinë”.⁶⁰

Si ndikoi gjendja e re politike në Shqipëri dhe si e favorizoi pushteti jugosllav shpërnguljen e shqiptarëve nga Kosova? Sa i përket gjendjes së re politike në Shqipëri pas pushtimit italian dhe në lidhje me aktivitetin e disa krerëve shqiptarë nga Kosova, të shpërngulur në Shqipëri në mes të Dy Luftërave Botërore, kuptohet edhe nga një shkresë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, dërguar Shtabit të Përgjithshëm në Beograd, në të cilën thuhet: “Pushteti ynë shtetëror e ka favorizuar shpërnguljen e shqiptarëve, që të mundësohet popullimi i elementit tonë nacional në viset e rrezikuara përreth kufirit shqiptar. Të gjithë të shpërngulurit nga territori ynë, nga Kosova apo nga Serbia Jugore, njihen në Shqipëri me një emër të përgjithshëm: kosovarë”. Më tej thuhej: “Me ardhjen e italianëve dhe përmbysjen e shtetit shqiptar, u parashtrua çështja se, mos vallë irredentizmi shqiptar do të vazhdojë në formë më të përfurcuar apo do të dobësohet. Menjëherë pas ardhjes së Italisë, disa kosovarë u përpoqën të interesohen për çështjen e tyre. Ismet bej Kryeziu, axha i Gani bej Kryeziut nga Gjakova, e ngriti çështjen e irredentizmit shqiptar para kontit Xhani [duhet të jetë konti Ciano – H. A.], kur ky ishte në Tiranë dhe në legatën italiane bëri pranimin e shqiptarëve me ndikim. Ndaj iluzioneve të Ismet beut, konti Xhani nuk dha asnjë përgjigje. Gjithashtu kosovari i njohur, Avni Gjilani, gjatë qëndrimit të delegacionit shqiptar në Romë, e ka pyetur Musolinin, se çka do të ndodhë me Kosovën. Por, edhe me këtë rast nuk është marrë asnjë përgjigje”.⁶¹ Duke pasur parasysh faktin se Italia në Shqipëri gradualisht po e merrte tërë pushtetin në duart e veta (ushtinë, xhandarmërinë, policinë, trupat kufitare dhe doganat) shqiptarët, edhe nëse dëshironin, nuk

⁶⁰ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve*, 401-402. Plani sekret i Shtabit të Përgjithshëm – Beograd, dërguar ministrit të UM, MPJ, MP të Mbretërisë Jugosllave, lidhur me përshpejtimin e shpërnguljes së shqiptarëve, Beograd, viti 1939.

⁶¹ *Po aty*, 403-404. Shkresë e MPJ të Jugosllavisë, për Shtabin e Përgjithshëm – Beograd, në të cilën përshkruhet aktiviteti i disa krerëve shqiptarë nga Kosova, Beograd, 1939.

do të mund të zhvillonin kurrfarë aksioni irredentist kundër jugosllavëve pa pëlqimin e tyre.

“Sipas gjendjes së tanishme dhe sipas disponimit të tanishëm, nuk ka gjasa për veprim në këtë drejtim”.⁶²

Pas pushtimit të Shqipërisë, një pjesë e përfaqësuesve politikë e rritën tej mase intensitetin e aktiviteteve politike, sepse tanimë e shihnin si mundësi ndaljen e shpërnguljes së popullsisë shqiptare nga Jugosllavia. Në dokumentet diplomatike jugosllave për këtë çështje, ndër të tjera, thuhet:

“Shqiptarët janë shumë të brengosur për shkak të konventës për shpërnguljen në Turqi. Udhëheqësit e tyre, në krye me Ferhat bej Dragën, u sugjerojnë që në asnjë mënyrë të mos i lëshojnë vatrat e tyre, sepse pushteti nuk ka rrugë dhe metodë që me forcë t’i shpërngulë [...]”.⁶³

Karvanit të kundërshtimit të shpërnguljes së popullsisë shqiptare iu bashkuan shumë personalitete si Tahir Zajmi, që ishte një ndër udhëheqësit e “Komitetit të Kosovës” dhe një ndër udhëheqësit e policisë fashiste në Shqipëri, i cili kishte arritur të vendoste lidhje me Beqir Malën, ish-nëpunësin e komunës së Gjakovës. Sipas instruksioneve të Zajmit, Maloku kishte zhvilluar me sukses propagandë në mesin e popullatës shqiptare për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Këtë propagandë e kishte zhvilluar gojarisht, duke kontaktuar me popullsinë shqiptare në tregjet javore në Gjakovë dhe Pejë. Maloku ishte përjashtuar nga detyra zyrtare në komunën e Gjakovës, si i papërshtatshëm në pikëpamje nacionale.⁶⁴

Sipas një shkrese të datës 5 gusht 1939, një grup i deputetëve shqiptarë të Parlamentit Jugosllav, i përbërë nga Asim Murteza Luzha, përfaqësues i Drenicës, Adem Marmullaku nga Burimi dhe Zenel Ibraimi nga Kaçaniku kishin vizituar Gjakovën. Ata u takuan me Sulejman Kryeziun, kryetar i komunës dhe Ramiz Rizën, anëtar i Drejtorisë

⁶² Esilda Luku, *Diplomacia evropiane ndaj Shqipërisë, ndërmjet dy Konferencave të Paqes (1919-1946)*, Instituti Albanologjik (Prishtinë: 2015), 262.

⁶³ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve*, 405-406. Raport i Shtabit të Përgjithshëm – Beograd, për Ministrinë e Luftës dhe për marinën jugosllave, lidhur me aktivitetin në Kosovë nga ana e Ferhat Dragës, Beograd, qershor 1939.

⁶⁴ *Po aty*, 407. Shkrese e Shtabit të Përgjithshëm – Dhoma e Dytë Operative, dërguar komandantit të Armatës III -Shkup, lidhur me aktivitetin politik të Tahir Zajmit dhe Beqir Malokut, Beograd, maj 1939.

Komunale në Gjakovë. *“Qëllimi i ardhjes së tyre është ngritja e vetëdijes nacionale te popullata myslimane dhe grumbullimi i të dhënave rreth veprimtarisë së qeveritarëve agrarë në Metohi”*.⁶⁵ Pra, grupi i deputetëve të cilët vizituan Gjakovën kishte deklaruar se ata do të vepronin te pushtetarët në Jugosllavi që të gjithë shqiptarët të merrnin shpërblim në parë për tokën e konfiskuar, dhe se në këtë drejtim vetëm sa kishin marrë premtime nga faktorët relevantë.

Politika e Beogradit zyrtar kishte raportuar mbi çdo fjalim dhe diskutim të përfaqësuesve politikë shqiptarë të ish-Mbretërisë Jugosllave. Kështu, sipas një shkrese të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Mbretërisë Jugosllave, lidhur me aktivitetin e Ferhat Bej Dragës në Kosovë, ndër të tjera thuhej:

“Në fillim të muajit shtator të këtij viti, Ferhat bej Draga, ka mbajtur mbledhje në Kosovë me parinë shqiptare dhe me këtë rast, veç tjerash, ka deklaruar se Shqipëria do t’i bashkojë të gjitha trojet deri në Nish”.⁶⁶

Sipas raportit të Shtabit të Përgjithshëm, për ministrin e Luftës dhe të marinës jugosllave, ministrin e Punëve të Jashtme, ministrin e Punëve të Brendshme, komandantin e Armatës III dhe komandantin e trupave kufitare, lidhur me aktivitetin politik të parisë shqiptare në Kosovë “Më 4 gusht të këtij viti, në Prizren, kanë qëndruar deputetët* e popullit: përveç rrethit të Prizrenit, ata, po ashtu vizituan edhe numrin më të madh të rretheve në Kosovë”.⁶⁷ Nga diskutimet dhe fjalimet e mbajtura pas pushtimit të Shqipërisë, liderët e skenës politike shqiptare synonin të ndalonin në radhë të parë shpërnguljen e popullsisë shqiptare për në Turqi. Sipas politikës zyrtare të Beogradit, thuhej se në masë të madhe kishte filluar të përhapej propaganda për të ardhmen e popullit shqiptar dhe kjo zhvillohej në veçanti nëpërmjet përfaqësuesve fetarë:

⁶⁵ *Po aty*, 408-410. Njoftim nga MPBJ-ja lidhur me qëndrimin e deputetëve shqiptarë në Prizren, Beograd, gusht 1939.

⁶⁶ *Po aty*, 410. Raport i Shtabit të Përgjithshëm – Beograd, për Ministrinë e Luftës dhe për marinën jugosllave, lidhur me aktivitetin e Ferhat Bej Dragës në Kosovë, Beograd, qershor 1939.

* Kadri Saliu nga Gostivari, Ilaz Agushi nga Nerodimja, Asim Murteza Luzha nga Drenica, Mustafa Dërguti nga Podrimja dhe Zenel Bej Strazimiri nga rrethi i Kaçanikut.

⁶⁷ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve*, 409. Raport i Shtabit të Përgjithshëm – Beograd, mbi aktivitetin e përfaqësuesve politikë shqiptarë.

“Para një kohe në Manastir ka qëndruar kryetari i Ulema Mexhlsit në Shkup, Sherif Osmani, për një kontroll të imamëve dhe me këtë rast ka agjituar në mesin e popullatës shqiptare, që të mos shpërngulen për në Turqi”.⁶⁸

Pas vitit 1939, Shërbimi Ushtarak Informativ (SIM), me qendër në Shkodër, Elbasan dhe Kukës, synonte të depëronte edhe në Kosovë. Madje, nuk munguan as plane dhe deklarata të hapura dhe konkrete gjatë vizitës së politikanëve italianë në Shqipëri. Ndonëse më herët flitej vetëm për propagandë, nga 7 prilli 1939, kjo ide e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë filloi të jetësohej. Kështu, konti Çiano, më 21 prill 1939, kishte theksuar se politika italiane do të merrej në mënyrë aktive me çështjen e Kosovës, pasi aty do të krijohej problemi me irredentizmin. Në këtë kontekst, politika italiane e integritetit të Kosovës kishte për qëllim të përforconte lidhjet etnike dhe kulturore midis shqiptarëve të Kosovës dhe atyre të Shqipërisë. Një tjetër aspekt i rëndësishëm ishte përdorimi i propagandës për të fituar mbështetjen e popullatës shqiptare. Propaganda italiane promovonte idenë e një bashkimi kombëtar, duke përdorur simbolet kombëtare dhe kulturën e përbashkët shqiptare si mjete për të arritur qëllimet e saj.⁶⁹ Çiano u njoftua nga Tahir Shtylla për problemet e shqiptarëve në Mbretërinë e Jugosllavisë. Shtylla, ndër të tjera, argumentonte se, shqiptarët e Shqipërisë që ishin pjesë përbërëse e Mbretërisë Italiane kërkonin me ngulm bashkimin me trojet shqiptare në Mbretërinë e Jugosllavisë, për shkak se bashkëkombësit e tyre ishin të shtypur [...].⁷⁰

Sipas informacioneve të marra nga burime në Beograd, edhe në pjesët e tjera të hapësirës shqiptare, si në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi, u përhapën informacione të ndryshme dhe spekulime në lidhje me të ardhmen e statusit të shqiptarëve në kuadër të Mbretërisë Jugosllave. Këto informacione përfshinin diskutime rreth mundësive për ndryshime administrative dhe të drejta më të gjera për shqiptarët:

“Në banovinën e Zetës, e posaçërisht në rrethet: Pejë, Gjakovë, Sjenicë, Beranë dhe Ulqin, bëhet një propagandë e gjallë nëpërmjet simpatizuesve italianë, e më së shumti nga katolikët shqiptarë dhe klerikët e tyre. Të gjithë këta paralajmërojnë ardhjen e shpejtë të

⁶⁸ Po aty, 413. Nga vizita e kryetarit të Ulema Mexhlsit të Shkupit dhe konsullit të Turqisë në Manastir.

⁶⁹ Ali Hadri, *Lëvizja Nacional-Çlirimtare në Kosovë (1941-1945)*, Prishtinë: “Rilindja”, 1971, 99.

⁷⁰ TV, ABC-Story, “Shqipëria e Madhe që e krijuan fashistët”, pjesa 1, minuta 4-5.

Italisë në këto vise dhe propagandojnë rreth nevojës së kryengritjes kundër pushtetit tonë për shkak të marrjes së padrejtë të pronës. Krejt këtë pronë, thonë, menjëherë do t'ua kthejë Italia posa të vijë dhe ta pushtojë Kosovën”.⁷¹

Shqiptarët hezituan që t'u bashkoheshin stërvitjeve të armatës ushtarake jugosllave. Sipas një analize të komandantit të Armatës III-Shkup, dërguar Shtabit të Përgjithshëm në Beograd, në lidhje me reagimin e popullsisë shqiptare në Kosovë, me rastin e ftesës së fundit për të bërë stërvitje ushtarake në mesin e shqiptarëve u dëgjuan edhe këto komente:

“Përse na thërrasin, që të luftojmë për ta, ndërsa në shtëpi i kemi lënë fëmijët e uritur”. “Kur neve na e morën tokën, le të na lënë nëpër shtëpitë tona, që në një mënyrë tjetër ta fitojmë bukën për fëmijët tanë”.

Shqiptarët shprehën mosbesim dhe frikë lidhur me qëllimet e këtyre stërvitjeve, duke menduar se ata mund të kishin qëllime të fshehta për të kontrolluar dhe për të nënshtruar më tej popullsinë shqiptare. Disa të tjerë vunë në dyshim nevojën për pjesëmarrje, duke argumentuar se shqiptarët kishin qenë gjithmonë të diskriminuar dhe të nënvlerësuar brenda ushtrisë jugosllave, dhe se kjo stërvitje nuk do të sillte asgjë të re për ta. Gjithashtu, pati shqetësime rreth trajtimit dhe kushteve gjatë stërvitjeve, me disa që kujtuan eksperiencat negative të mëparshme të shqiptarëve në ushtri. Ky hezitim dhe skepticizëm tregon për një hendek të thellë midis popullsisë shqiptare dhe autoriteteve jugosllave, duke reflektuar tensionet dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme që kishin karakterizuar marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Përkundër këtyre pakënaqësive, në prill të vitit 1939, kur u lëshua thirrja për stërvitje për shkak të ngjarjeve në Shqipëri, shqiptarët pranuan që të mobilizoheshin. Por, nëse do të bëhej mobilizimi i përgjithshëm, thirrjes nuk do t'i përgjigjeshin një numër i madh i shqiptarëve. Kjo për faktin se shqiptarët për shkak të propagandës së urrejtjes, marrjes së tokës, ishin bindur se më mirë do të ishin nën sundimin e italianëve, vetëm t'u

⁷¹ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve*, 413. Informatë e Shtabit të Përgjithshëm – Beograd, dërguar ministrit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, lidhur me propagandën e klerikëve katolikë dhe myslimanë shqiptarë.

ktheheshin tokat e marra, sesa të jetonin ende nën ato rrethana.⁷² Të mirinformuar nga gjendja e krijuar, Partia Fashiste e Shqipërisë, e formuar në qershor të vitit 1939 në Tiranë, synonte përhapjen e idesë së krijimit të bashkimit të shqiptarëve në një shtet të vetëm.⁷³

Shqiptarët e Shqipërisë dhe shqiptarët në Mbretërinë e Jugosllavisë, e shihnin me tone të ndryshme sundimin italian. Kjo është e kuptueshme, sepse shqiptarët në Shqipëri e kishin humbur lirinë, ndërsa shqiptarët në Mbretërinë e Jugosllavisë e kishin të humbur lirinë dhe tashmë një pjesë e tyre kishte humbur edhe tokat, të cilat shpresonin se do t'u ktheheshin me ndihmën e italianëve. Në dokumentet diplomatike jugosllave, ndër të tjera, thuhet:

“Shqiptarët tanë, nëse do të vinte puna, në kushte të njëjta, të bënin përzgjedhjen ndërmjet nesh dhe italianëve, me siguri se me kënaqësi do të ngelnin nën ne. Mirëpo, kur është në pyetje toka, shkolla, shtypi, për të cilët ata, në rast se këto vise do të bashkoheshin me Shqipërinë, që gjithsesi shpresojnë, atëherë ata me një kënaqësi shumë më të madhe do të pajtoheshin të jetonin nën qeverisjen italiane”.⁷⁴

Një kthesë e këtillë në të besuarit në mesin e shtresave të gjera të popullatës shqiptare në Jugosllavi, kishte ardhur për shkak të propagandës italiane për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Italianët e shihnin irredentizmin shqiptar në Jugosllavi, si “dritë në fund të tunelit”. Ata, menjëherë pas pushtimit të Shqipërisë, filluan instalimin e aparatit të tyre propagandistik, ku siç e kemi theksuar më lart janë botuar disa dhjetëra libra e qindra artikuj në të cilët tregohej lidhshmëria ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë.⁷⁵

Ky material qarkullonte edhe nëpër Kosovë. Në harkun kohor 1939-1941 nga Italia dhe nga qeveria shqiptare që ishte nën ndikimin e Italisë, u organizuan veprime të ndryshme, madje planifikohej edhe një kryengritje. Por siç dihet, kjo nuk u bë. Kosova u pushtua në kuadër të

⁷² Po aty, 415. Analizë e Korparmatës III-Shkup, dërguar Shtabit të Përgjithshëm në Beograd, 19 shtator 1939.

⁷³ Bajram Shatri, *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX*, I (Prishtinë: Libri Shkollor, 2006), 46.

⁷⁴ Lita, *Shpërngulja e shqiptarëve*, 415. Analizë e Korparmatës III-Shkup, dërguar Shtabit të Përgjithshëm në Beograd, 19 shtator 1939.

⁷⁵ Ali Hadri, “Sistemi i pushtimit fashist në Kosovë (1941-1944)”, në *Kosova*, nr. 7 (1979), 687.

pushtimit të Jugosllavisë.⁷⁶ Kjo periudhë e errët e historisë është dëshmi e sakrificave dhe e vuajtjeve të mëdha të shqiptarëve nën sundimin e një regjimi represiv. Megjithatë, këmbëngulja dhe rezistenca e tyre janë dëshmi e fuqisë dhe e qëndresës së tyre përballë padrejtësive historike.

Si ndryshoi situata për shqiptarët në Kosovë pas pushtimit nazifashist? Me pushtimin e Jugosllavisë nga forcat nazifashiste, gjendja për shqiptarët ndryshoi ndjeshëm, duke sjellë një riorganizim politik dhe territorial që përkohësisht i bashkoi trojet shqiptare nën administrimin italian dhe gjerman. Gjermania kishte interes strategjik në Jugosllavi, duke synuar një dalje në detin Adriatik për të fuqizuar pozicionin e saj detar në Mesdhe. Shtetet e Bllokut nazifashist (Gjermania, Italia, Hungaria dhe Bullgaria) kishin përgatitur pushtimin e Jugosllavisë, duke ndjekur qëllime nacionale dhe territoriale të qarta.⁷⁷ Në pranverën e vitit 1941, situata në Ballkan u bë gjithnjë e më e tensionuar. Hitleri kishte dy opsione ndaj Jugosllavisë: ta detyronte të bëhej aleate ose ta pushtonte. Përpjekja e parë u konkretizua me nënshkrimin e Traktatit Trepalësh më 25 mars 1941, nga Kryeministri jugosllav Dragisa Cvetkovic. Megjithatë, një ditë më vonë, qeveria jugosllave u përmbys nga një grusht shteti popullor i udhëhequr nga gjenerali Dushan Simoviq, duke shkaktuar largimin e Princit Pavle dhe shpalljen e Mbretit Petar II madhor. Kur Hitleri mësoi për këto zhvillime, ai vendosi për një ofensivë ndëshkuese. Më 27 mars 1941, ai deklaroi se Jugosllavia do të pushtohej dhe ushtria e saj do të shkatërrohej.⁷⁸ Po atë ditë, Hitleri i shkroi një letër Musolinit dhe urdhëroi që të njoftohej për fillimin e sulmit gjerman më 2 ose 3 prill, duke kërkuar nga italianët që të sulmonin Shkupin. Ndërkohë, në Jugosllavi filluan protesta antigjermane,⁷⁹ por forcat gjermane tashmë ishin pozicionuar në Bullgari, me qëllim që të bllokonin lidhjen veri-jug në Maqedoni dhe izolimin e ushtrisë jugosllave dhe asaj greke.⁸⁰ Më 6

⁷⁶ Izber Hoti, *Forcat e armatosura në Kosovë gjatës Luftës së Dytë Botërore*, Instituti i Historisë (Prishtinë: 1998), 23-34.

⁷⁷ AIHT, F. A-VIII-297, Xhelku Maksutoviç, “Rezistenca Evropiane në vitet e Luftës së Dytë Botërore”, fl. 19.

⁷⁸ Osman Zeka, *Bashkëpunimi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës me Lëvizjet Nacionalçlirimtare në territoret fqinje (1941-1945)* (tezë e doktoratës), Universiteti i Prishtinës & Fakulteti Filozofik (Prishtinë: 1988), 254.

⁷⁹ “Trubullimet në Jugosllavi”, *Tomori*, Tiranë, 1 prill 1941.

⁸⁰ *Kriegstagebuch des Oberkommandos der Wehrmacht (Wehrmachtführungsstab)*, Band I: 1. August 1940 - 31. Dezember 1941, Zusammenestellt und erläutert von Hans-Adolf Jöcopsen (Frankfurt: Bernard & Graefe Verlag für Wehrwesen, 1965).

prill 1941, Armata XII gjermane, së bashku me trupat italiane dhe hungareze, filloi sulmin ndaj Jugosllavisë dhe Greqisë, duke përdorur Shqipërinë si bazë. Bullgaria dhe Rumania, të cilat tashmë ishin pjesë e Bllokut, u përdorën si korridore për kalimin e trupave naziste. Pushtimi i Jugosllavisë nga trupat e Fuqive të Boshtit (gjermane dhe italiane) filloi më 6 prill 1941 dhe shpejt përfshi u edhe Kosovën. Edhe pse pati rezistencë, forcat pushtuese depërtuan shpejt, duke ndryshuar rrethanat për shqiptarët. Gjatë luftës, pjesa jugore dhe lindore e Kosovës u goditën rëndë nga forcat gjermane, të cilat sulmuan në dy drejtime: Bujanovc-Shkup-Kaçanik-Ferizaj dhe Bujanovc-Gjilan.⁸¹ Më 7 prill, forcat gjermane thyen mbrojtjen vendëse dhe hynë në Shkup, duke bombarduar Ferizajn dhe duke shkaktuar viktima civile.⁸² Ndërsa përpjekjet për të ndaluar depërtimin gjerman në Grykën e Kaçanikut dështuan, Divizioni i Kosovës u mobilizua, por shumë qytete mbetën pa forca ushtarake të rregullta.⁸³ Komanda jugosllave urdhëroi tërheqjen e divizionit, por më pas u tërhoq nga ky vendim. Më 9 prill, forcat gjermane hynë në Ferizaj pa hasur në rezistencë dhe vazhduan në drejtim të Prishtinës. Më 10 prill, Prishtina ra në duart e pushtuesve.⁸⁴ Ndërsa, më 13 prill trupat ushtarake italiane kaluan lumin Drin dhe më 14 prill hynë edhe në Prizren.⁸⁵ Përfundimisht, mund të themi se pushtimi italian i Shqipërisë reflektoi një situatë ndryshe për shqiptarët në Kosovë, krahasuar me ata në Shqipëri. Pas pushtimit të Jugosllavisë, përfshirë Kosovën, nga forcat nazifashiste, gjendja për shqiptarët në rajon pësoi një ndryshim të thellë dhe të rëndësishëm. Kjo situatë solli një riorganizim politik dhe territorial, duke bashkuar përkohësisht disa prej trojeve shqiptare nën administrimin italian, gjerman dhe bullgar. Shqiptarët në Jugosllavi shiheshin nga pushtuesit me qëllime të ndryshme. Italianët dhe gjermanët e konsideronin popullatën shqiptare si një mjet për realizimin e ambicieve të tyre ekspansioniste, ndryshe nga politikat jugosllave, të cilat

⁸¹ Fehmi Rexhepi, "Sistemi i pushtimit në Gjilan e rrethinë", në *Kosova*, nr. 7 (1979), 364.

⁸² Fadil Hoxha, "Formimi i njësie ushtarake dhe aksioni i armatosur në Kosovë e Metohi më 1941", në *Përparimi*, nr. 708 (1961), 454.

⁸³ *Zbornik Dokumentata i Podataka o Narodnooslobodilačko matu naroda Jugoslavije* (më tej: *ZDPN*). Tom XIII, Knjiga 1, Dokumenti Kraljevine Italije 1941, 1969, 44.

⁸⁴ Izber Hoti, "Sistemi pushtues në Prishtinë dhe në rrethinë 1941-1944", në *Kosova*, nr. 7 (1979), 346.

⁸⁵ Zeka, *Bashkëpunimi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare*, 253.

synonin të ndryshonin strukturën etnike në Kosovë. Këto politika përfshinin dëbimin e popullsisë shqiptare dhe kolonizimin e Kosovës me elementë sllavë. Megjithatë, pas intervenimit të Fuqive të Boshtit, ky diskurs ndryshoi dhe shqiptarët në Kosovë u përballën me realitete të reja.

Përfundime

Në këtë studim kemi paraqitur fillimisht një historik të shkurtër mbi Kosovën dhe krahinat lindore shqiptare të aneksuara nga Jugosllavia deri në vitin 1912, duke theksuar përbërjen etnike dhe numrin e popullsisë shqiptare që përbënte shumicën absolute. Burimet historike tregojnë qartë se “elementët serbë dhe malazezë” në Kosovë përfaqësonin vetëm 5% të popullsisë së përgjithshme. Po ashtu, Kokalari ka theksuar se në veri të “distrikteve të Shkupit, Kumanovës, Tetovës, Gostivarit dhe Kërçovës”, as para dhe as pas vitit 1912, nuk figuronte asnjë element “bullgaro-maqedonas”.

Më pas kemi ofruar të dhëna për reflektimin e rrethanave ndërkombëtare të shqiptarët në prag të Luftës së Dytë Botërore, duke treguar rëndësinë e Marrëveshjes së Mynihut. Kjo marrëveshje ngjalli shpresat e shqiptarëve për rikthimin e krahinave të humbura të Kosovës dhe Çamërisë. Ajo ndriçoi strategjitë dhe aspiratat e Adolf Hitlerit për zgjerimin territorial të Gjermanisë dhe ngjalli shpresa në mesin e shqiptarëve për të korrigjuar vendimet e padrejta të Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913.

Gjithashtu, kemi analizuar ndikimin e pushtimit italian të Shqipërisë mbi shqiptarët në Kosovë. Pushtimi i Shqipërisë nga Italia fashiste pati ndikim edhe te shqiptarët në Jugosllavi, duke i shtyrë liderët politikë të reagonin më intensivisht kundër shpërnguljes së shqiptarëve. Për shqiptarët në Kosovë, pushtimi italian ishte "drita në fund të tunelit", duke shpresuar për realizimin e aspiratave të tyre për bashkim me Shqipërinë në një kohë kur gjendja e tyre politike, ekonomike dhe sociale ishte shumë e vështirë. Po ashtu, kemi ofruar të dhëna për angazhimin e liderëve politikë në Kosovë për të mos u shpërngulur, ngaqë politika zyrtare serbe synonte ndryshimin e strukturës etnike në Kosovë.

Burime dhe bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (ASHAK)

Arkivi i Institutit të Historisë, Tiranë (AIH)

Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Fondet MPJ (AMPJ)

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)

Arhiv Jugoslavije – Beograd (AJ)

Botime dokumentare:

Документи о спољној политици Краљевине Србије 1903-1914, Књига 7, Свеска 1, Одељење историјских наука, Београд, 1980 (*Dokumenti o spoljnoj politici Kraljevine Srbije 1903-1914*, Knjiga 7, Sveska 1, Odeljenje istorijskih nauka. Beograd: 1980).

Osmani, Jusuf. *Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941, Dokumente: Kolonizimi*, vëll. I. Prishtinë: pa botues, 2016.

Shpërngulja e shqiptarëve në Republikën e Turqisë (1922-1941) (Përmbledhje dokumentesh). Përzgjedhja dhe redaktimi Qerim Lita. Instituti i Historisë “Ali Hadri”. Prishtinë: 2019.

Literaturë historiografike:

Abdyli, Ramiz. “Vështrim mbi papunësinë në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)”. Në *Vjetari*, nr. XVII-XIX. Arkivi i Kosovës. Prishtinë: 1984.

Ademi, Haxhi. *Kosova gjatë Luftës së Dytë Botërore (1941-1945)*. Instituti i Historisë “Ali Hadri”. Prishtinë: 2021.

Avramovski, Živko. “Okupimi i Shqipërisë nga Italia dhe qëndrimi i qeverisë jugosllave”. Në *Përparimi*, nr. 1-2 (1964).

Bajrami, Hakif. “Konventa jugosllave-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve”. Në *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, Hakif Bajrami (red.), Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova. Prishtinë: 1992.

Bajrami, Hakif. “Konventa jugosllave-turke e vitit 1938 për shpërnguljen e shqiptarëve”. Në *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, Hakif Bajrami (red.). Shoqata për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga Kosova. Prishtinë: 1992.

- Ballvora, Shyqyri. “Qëndresa e popullit shqiptar dhe kriza e regjimit fashist të pushtimit (prill 1941 – dhjetor 1941)”. Në *Studime historike*, nr. 1, V.XXI (1968).
- Bislimi, Daut *Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945*. Instituti Albanologjik. Prishtinë: 1997.
- Boçi, Sonila. *Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritetit (1939-1949)*. Qendra e Studimeve Albanologjike / Instituti i Historisë. Tiranë: Kristalina-KH, 2012.
- Casellana, Georges. *Historia e Ballkanit*. Prishtinë: NGBGSH “Gutenberg”, 1997.
- Derguti, Adem. & Shahu, Rexhep. *Bllaca* (Monografi). Kukës: Dy Drina, 2013.
- Dushku, Ledia. “Debatet shqiptaro-grek dhe Lidhja e Kombeve (1920-1922)”. Në *Studime historike*, nr. 3-4 (2006): 69-86.
- Fischer, Bernd J. *Shqipëria gjatë Luftës (1939-1945)*. Tiranë: Çabej, 2000.
- Fjalor *Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II (H-M). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Enciklopedisë Shqiptare. Tiranë: Kristalina-KH, 2008.
- Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria dhe tokat e lirueme 1939-1946*. Tiranë: Botimet Jozef, 2018.
- Hadri, Ali. “Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941)”. Në *Studime historike*, nr. 2 (1988): 79-98.
- Hadri, Ali. “Sistemi i pushtimit fashist në Kosovë (1941-1944)”. Në *Kosova*, nr. 7 (1979).
- Halabaku, Idriz. *Lëvizjet Nacionalçlirimtare në zonën okupuese bullgare të Kosovës (1941-1944)* (Punim i magjistraturës). Universiteti i Prishtinës. Prishtinë: 1977.
- Hall, C. Richard. *The Balkan Wars 1912-1913: Prelude to the First World War*. London, New York: Routledge, 2000.
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III (Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 – 7 prill 1939). Redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: Toena, 2007.
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj (1939-1990). Redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Tiranë: Toena, 2008.
- Historija Diplomatiје*, vol. II. Redaktor Vladimir Petrović Potemkin. Zagreb: Matica Hrvatska, 1951.
- Hitler, Adolf. *Testamenti Politik (4 shkurt – 29 prill 1945)*. Tiranë: Helga’s Secrets, 2012.
- Hobsbawm, Eric. *Epoka e ekstremeve*. Tiranë: Çabej, 1994.

- Hoti, Izber. "Sistemi pushtues në Prishtinë dhe në rrethinë 1941-1944". Në *Kosova*, nr. 7 (1979).
- Hoti, Izber. *Forcat e armatosura në Kosovë gjatës Luftës së Dytë Botërore*. Instituti i Historisë. Prishtinë: 1998.
- Hoxha, Fadil. "Formimi i njësisë ushtarake dhe aksioni i armatosur në Kosovë e Metohi më 1941". Në *Përparimi*, nr. 708 (1961).
- Hughes, R. Gerald. "The Ghosts of Appeasement: Britain and the Legacy of the Munich Agreement". Në *Journal of Contemporary History* (Sage Publications, Ltd., 2013).
- Kissinger, Henry. *Diplomacia*. Tiranë: Laert, 1999.
- Kokalari, Hamit. *Kosova – djepi i shqiptarizmit*, Lidhja Kosovare në Mërgim. New York: Flushing N.Y., 1962.
- Krasniqi, Afrim. *Partitë politike në Shqipëri (1920-2006)*. Instituti i Studimeve Politike. Tiranë: Eurorilindja", 2006.
- Luku, Esilda. *Diplomacia Evropiane ndaj Shqipërisë, ndërmjet dy konferencave të paqes (1919-1946)*. Instituti Albanologjik. Prishtinë: 2015.
- Malcolm, Noel. *Kosova – Një histori e shkurtër*. Tiranë: Koha Ditore & Shtëpia e Librit, 2001.
- Obradović, Millan. *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)*. Institut za istoriju Kosova. Priština: 1981.
- Pearson, Owen. *Albania and King Zog, Indipendence, Republic and Monachy*. London: The Center for Albanian Studies, 2004.
- Qosja, Rexhep. *Çështja shqiptarëve (historia dhe politika)*. Prishtinë: Toena: 1998.
- Rexhepi, Fehmi. "Sistemi i pushtimit në Gjiilan e rrethinë". Në *Kosova*, nr. 7 (1979).
- Schmitt Jens, Oliver. *Ballkani në shekullin XX*. Tiranë: Botime Artini, 2021.
- Syla, Sabit. *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*. Instituti i Historisë. Prishtinë: 2012.
- Shatri, Bajram. *Arsimi fillor në Kosovë në shekullin XX, I*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2006.
- Teli-Dibra, Pranvera. "Kriza e marrëdhënieve shqiptaro-italiane në optikën diplomatike angleze (1931-1934)". Në *Monarkia Shqiptare (1928-1939)*. QSA / Instituti i Historisë. Tiranë: Toena, 2011.
- Verli, Marenglen. *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Bon-Tiranë: Iliria, 1992.
- Xhafa, Bajram. *Qëndresa e 7 prillit 1939, vepër e shtetit kombëtar shqiptar*. Shkodër: Camaj- Pipa, 2007.

Xhafa, Bajram. "Kushtet historike të ngritjes së Mbretërisë Shqiptare". Në *Monarkia Shqiptare (1928-1939)*. QSA / Instituti i Historisë. Tiranë: Toena, 2011.

Zeka, Osman. *Bashkëpunimi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës me Lëvizjet Nacionalçlirimtare në territoret fqinje (1941-1945)* (tezë e doktoratës). Universiteti i Prishtinës & Fakulteti Filozofik. Prishtinë: 1988.

Gazeta e revista:

Gazeta e Korçës, Korçë, 1920

Tomori, Tiranë, 1941

Site:

TV, ABC-Story, *Shqipëria e Madhe që e krijuan fashistët*, pjesa 1, minuta 4-5.

HAXHI ADEMI

Institut of History "Ali Hadri", Prishtina
ademihaxhi@hotmail.com

S u m m a r y

THE ITALIAN OCCUPATION OF ALBANIA AND ITS IMPACT
ON THE ALBANIANS OF KOSOVA

The article examines the Italian occupation of Albania and its impact on the Albanians in Kosovo. After the occupation, Italy implemented strategic measures to achieve its political, economic, and military objectives. Numerous books and articles addressed the relationships between Italy and Albania, emphasizing the issue of national unification, a key problem for Albanians since the division at the Conference of Ambassadors in London (1912-1913).

The study highlights the significance of the Munich Agreement of 1938, which raised hopes for the return of the lost regions of Kosovo and Chameria, strengthening aspirations to rectify historical injustices. This agreement symbolized a turning point in international politics and directly influenced the increase in the sense of Albanian national identity.

The Italian occupation intensified the reactions of Albanian political leaders in Yugoslavia against the displacement of Albanians and increased the hope for unification with Albania. For the Albanians of Kosovo the Italian

occupation was "the light at the end of the tunnel" during a difficult political, economic, and social period. This period was characterized by extraordinary pressures to change the ethnic structure of the region, where official Serbian policy aimed at ethnic cleansing and assimilation of Albanians.

The study emphasizes the efforts of Kosovo's political leaders to prevent the displacement of Albanians and the alteration of the ethnic structure in the region. Italian propaganda supported the idea of the unification of Kosovo with Albania, aiming to prevent the abandonment of homes by Albanians and strengthen national cohesion. The policies of assimilation and displacement, supported by propaganda and strategic actions, aimed to weaken the Albanian ethnic identity and increase Italian influence in the region.

The new situation created by the Italian occupation spurred hopes for the realization of national aspirations, intensifying reactions against Yugoslav policies of ethnic cleansing and the displacement of Albanians. National unification and confrontation with Belgrade's policies became primary issues for the Albanians in Kosovo, closely linking them to developments in Albania following the Italian occupation. This period represents a significant moment in the history of the Albanians in Kosovo marking their efforts for survival and preservation of national identity in the front of the challenges of aggressive assimilation and displacement policies.

ROMEO GURAKUQI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë
romeo_gurakuqi@hotmail.com; romeo.gurakuqi@asa.edu.al
<https://doi.org/10.61773/3vy7eg82>

**DËSHMI ZYRTARE BRITANIKE MBI TRAGJEDINË E
POPULLSISË SHQIPTARE NË EPIRIN E JUGUT NË VITET
1944-1945**

Abstrakt:

Artikulli synon të trajtojë ngjarjet e fundit të Luftës së Dytë Botërore në Çamëri (Kaonia e Jugut dhe Thesprotia), veçanërisht pas tërheqjes së ushtrisë gjermane nga Epiri i Jugut, krahinë e cila iu dha Greqisë sipas kufijve të vitit 1913 dhe 1921. Në periudhën 1941-1944, kjo zonë përjetoi paqëndrueshmëri politike dhe ushtarake të shkaktuar nga Lufta Italo-Greke dhe kontrollet e ndryshueshme ushtarake të diktuar nga faktorë madhorë vendimmarrës, në Romë, Berlin dhe Athinë. Autori, duke përdorur burime arkivore britanike, paraqet për herë të parë ngjarjet në Çamëri nga mesi i vitit 1944 deri në verën e 1945-s. Kjo është historia e një spastrimi etnik dhe fetar, i cili filloi në vitin 1913, u përkeqësua në vitet 1914-1915, përjetoi një valë të tretë pas Luftës së Parë Botërore dhe arriti kulmin gjatë muajve të fundit të Luftës së Dytë Botërore. Autori pohon se vrasjet, përndjekjet dhe shpërnguljet u nxitën nga lufta civile në Greqi, indiferenca britanike ndaj asaj që po ndodhte në Çamëri, frika e Enver Hoxhës për pushtetin e tij dhe sjellja e paparashikueshme e forcave greke. Në këtë periudhë, kufiri jugor i Shqipërisë u bë një linjë ndarjeje mes interesave perëndimorë dhe lindorë, duke ndarë popullin shqiptar dhe duke përkeqësuar situatën e respektimit të të drejtave të njeriut në të dyja anët e kufirit. Popullsia shqiptare myslimane u shpërngul nga Greqia Veriore, ndërsa ajo e krishterë përjetoi një denacionalizim të heshtur, duke humbur traditat e tyre të vjetra nacionale në Epir, në peshën e një greqizimi të hapur dhe të ashpër.

Fjalë kyçe:

Shqipëria e Jugut, Epir, Çamëri, Thesproti, Lufta e Dytë Botërore, Lufta e Ftohtë, Foreign Office, British Military Mission in Albania.

Hyrje në trajtimin e problemit

Në Luftën e Dytë Botërore, marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, dy vendeve fqinje, me sovranitet shtetëror të shkatërruar për shkak të pushtimit të Shqipërisë më 1939 nga Italia fashiste dhe të Greqisë më 1941 nga Gjermania dhe Italia në aksion të përbashkët, janë kushtëzuar nga faktorë të trashëguar nga e kaluara, nga pasojat e Luftës Italo-Greke, nga sjelljet e grupimeve të ndryshme politike, nacionaliste dhe komuniste në secilin vend, karshi problematikave të lindura nga lufta, nga shkatërrimi dhe nga përçarja që lanë pas pushtuesit në të dyja vendet.

Mbi marrëdhëniet shqiptaro-greke ndikonte: problemi i vjetër i kufirit, të cilin qarqet shoviniste greke gjenin rastin ta rikontestonin sa herë shihnin që rendi gjeopolitik tronditej ose zhbalancohej; problemi i popullsisë shqiptare që banonte në Greqi, në Epirin e Jugut, subjekt i një shtypjeje sistematike nga ana e të gjitha regjimeve politike të një Greqie, që përcolli mes dy luftërave sistematikisht diktaturat dhe demokracitë për një periudhë 30-vjeçare; problemi i agresionit të Italisë nga toka shqiptare dhe çështja e gjendjes së luftës të shpallur reciprokisht, edhe nga qeveria kukull e Shqipërisë nën Italinë, edhe nga vetë Greqia; për kohën pas 29 nëntorit 1944, kemi edhe problemin e njohjes së regjimit të Enver Hoxhës që u vendos në Shqipëri, regjim që ishte në një marrëdhënie të ngushtë me forcat e EAM-it (*Fronti Nacionalçlirimtar Grek*), kundërshtare të EDES-it (*Lidhja Kombëtare Republikane Greke*) dhe regjimit të instaluar nga britanikët në muajin tetor të vitit 1944 në Athinë.

Çështja e kufirit greko-shqiptar ka qenë e lidhur me çështjen e përkatësisë etnike të krahinës së njohur nga grekët si “Epir” dhe nga shqiptarët si Shqipëria e Jugut. Kjo linjë kufitare u bazua mbi Protokollin e Firences të 17 dhjetorit 1913 dhe kaloi mes për mes Shqipërisë së Jugut / Epirit. Linja e Firences në fakt nuk kënaqi plotësisht shqiptarët (në jug të kësaj linje shtrihej Epiri i Jugut, i banuar në mënyrë kompakte, së paku në Çamëri, Kostur dhe Konicë, nga popullsi shqiptare e besimit mysliman dhe të krishterë ortodoks), pavarësisht se u mundësoi formimin e shtetit. Por, nga ana tjetër, linja e përcaktuar nga vendimet ndërkombëtare para dhe pas Luftës së Parë Botërore, nuk la të pakënaqur as Greqinë, që identifikonte të gjithë popullsinë ortodokse në trojet shqiptaro-epirote,

arbitrarisht, si të etnicitetit grek.¹ Më 1914 në jug të Principatës së pavarur dhe asnjansë Shqiptare shpërthyen trazira të importuara politikisht dhe ushtarakisht nga Athina dhe më pas u krijua me imponim i ashtuquajtur i Epiri i Veriut autonom. Pas fillimit të Luftës së Parë Botërore, trupat greke pushtuan edhe zyrtarisht krahinën. Greqia shpalli aneksimin dhe në Parlamentin e Athinës u sajua në vitin 1915 edhe një përfaqësi e deputetëve të vetëquajtur epirotë.² Para evakuimit të Epirit të Veriut nga ana e trupave ushtarake greke, numri i banorëve në Shqipërinë zyrtare të Jugut ka qenë 300 000 frymë (180 000 myslimanë shqiptarë dhe 120 000 ortodoksë shqiptarë ose grekë). Humbjet që ka pësuar elementi shqiptar mysliman nga njëra anë prej masakrave të bëra prej bandave greke, dhe nga ana tjetër prej sëmundjeve të lisë, dizenterisë, malaries dhe urisë, rezultojnë të jenë nga 60 000 deri në 70 000 frymë.³ Megjithatë, Italia ndërhyri në anën shqiptare, dërgoi trupa dhe në vitin 1917 shpalli një Shqipëri të pavarur nën protektoratin italian,⁴ por përgjithësisht në Shqipërinë e Jugut, italianët ndoqën një politikë të ekuilibruar në raport me ndjeshmëritë greke dhe shqiptare, duke mbrojtur para së gjithash interesat italianë në këto anë.⁵ Në Konferencën e Paqes në Paris, si Greqia dhe Shqipëria e pretenduan Epirin e Veriut dhe Epirin e Jugut, paralelisht (Shqipëria natyrale e Jugut). Grekët pretendonin se në Epirin e Veriut jetonin 150 000 «grekë» në pikëpamje të ndërgjegjes nacionale. Pala shqiptare në këmbim pretendonte se ishin 40 000 shqiptarë myslimanë dhe 14 000 shqiptarë të krishterë në jug të Linjës së Firences, d.m.th. në krahinën e Thesprotisë në Epirin e Jugut. Në vitin 1920, Shqipëria hyri në

¹ Rasti i raporteve shqiptaro-greke para Luftës së Parë Botërore është trajtuar nga ana ime gjerësisht në dy monografi: Romeo Gurakuqi, *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë* (Tiranë: UET Press, 2011); dhe Romeo Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914* (Tiranë: UET Press, 2012), 530-555.

² *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: AIH), Fondi i Arkivit të Vjenës – *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSt.A.P.A.A.*), Vj. 25-5-530. Raport i zëvendëskonsullit perandorak dhe mbretëror austro-hungarez në Janinë, 22 qershor 1915.

³ *Po aty*, Vj. 25-56. Spostime etnografike në Epir, Vlorë, më 17 shkurt 1915 (korrespondon me: *HHStAPAA* në AIH, N-217, D. 90/3, fl. 6-7).

⁴ Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore (1 nëntor 1918 – 9 nëntor 1921), Statusi, kufijtë dhe rindërtimi shtetëror* (Tiranë: UET Press, 2013), 10-11.

⁵ Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Kristalina-KH, 2013), 209-238.

Lidhjen e Kombeve dhe e paraqiti çështjen e caktimit dhe të njohjes së kufirit para këtij organizmi ndërkombëtar të kombeve të lira. Me vendimin e 9 dhjetorit 1921 të Konferencës së Ambasadorëve, u ripërcaktuan kufijtë shtetërorë të shtetit shqiptar dhe një Komision i Hetimit të Lidhjes së Kombeve u dërgua për të shqyrtuar zonat në diskutim.⁶ Komisioni pati arritur në përfundimin se ndjenjat nacionaliste greke ishin më të fuqishme në jug të kufirit, d.m.th. në Greqi, mes panepirotasve, sesa në popullsinë e vetë Epirit të Veriut. Prandaj Komisioni i Hetimit të Lidhjes së Kombeve, në tërësi, aprovoi Linjën e Firences (atë të 17 dhjetorit 1913), si një kufi të arsyeshëm që mund të ndërtohej për këtë hapësirë, ku raca, gjuha, besimi ishin përzier në mënyrë të pashkatërrueshme.⁷

Në vitin 1921, pas raportit të Komisionit të Hetimit të Lidhjes së Kombeve, Konferenca e Ambasadorëve njoftoi se kishte konfirmuar kufirin shqiptaro-grek të vitit 1913, përfshirë Linjën e Firences. Për disa kohë Greqia nuk dëshiroi ta njihte këtë kufi, por në vitin 1922 e bëri në fakt këtë gjë, me disa rezervime që lidheshin me numrin e fshatrave ende nën diskutim në ish-kazanë e Korçës. Pas dërgimit të një komisioni tjetër të përkufizimit të kufirit, Greqia më në fund, megjithëse duke ngurrar, pranoi vendimin mbi kufirin, në vitin 1924. Ekonomikisht kjo hapësirë ishte pjesa më prodhimtare e shtetit shqiptar. Kjo krahinë nuk mund të thuhet se ishte ekonomikisht thelbësore për Greqinë. Kufiri prekte përgjatë linjat natyrale të komunikimit. Pretendimet greke për rishikimin e kufirit, që prej vitit 1924 e këndej, kanë qenë më së shumti të bazuara mbi arsye strategjike. Grekët u përpoqën të argumentonin se kufiri i vitit 1924 ishte i pamundur për të mbrojtur Greqinë nga ndonjë agresor dhe se kufiri strategjik për Greqinë, shtrihej ndërmjet linjës së maleve në jug të Vlorës.⁸ Pra, kemi të bëjmë me një pretendim absurd të Greqisë për ta shtyrë kufirin edhe më tutje në veri të Linjës së Firences, duke harruar se në jug të kësaj linje, ndodhej një popullsi kompakte e autoktone shqiptare

⁶ Gurakuqi, *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore*, 215- 257.

⁷ *The National Archives*, London (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371. 8531, C 7811, Raport i Komisionit Hetimor mbi punën e tij nga 19 dhjetori deri më 1 shkurt 1923, hetimi në Shqipërinë e Jugut, 2 maj 1923.

⁸ *Po aty*, WO.202.960, Albania, Appendix "A" to G-2 (P.B.), Allied Force Headquarters [Shtabi i Forcave Aleate] (më tej: AFHQ) *Balkan Political Review*, Issue No.1^o, for week ending 8 November 1944, Albania. Notë e shkurtër mbi minoritetin grek në Shqipëri dhe çështjen e kufirit greko-shqiptar.

dhe në jug të Linjës së Firences, po ashtu jetonin mbi 50 000 shqiptarë etnikë nën një tryzni të ndërlikuar për shkak të diversitetit religjioz në bashkësinë vendëse. Gjithsesi, çështja e kufirit tokësor mes Shqipërisë dhe Greqisë u konsiderua një çështje e mbyllur, ditën kur në Quai d'Orsay, më 30 korrik 1926, u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të aktit final prej ambasadorëve të të gjitha vendeve garantuese të Traktatit të Paqes dhe prej ministrave të Jashtëm të të tria vendeve të interesuara, Greqisë, Jugosllavisë dhe Shqipërisë.⁹

Popullsia e Epirit të Jugut në Luftën e Dytë Botërore

Për sa i përket numrit të shqiptarëve në prefekturën e Thesprotisë para luftës, i jemi referuar indirekt *Greek White Book*, "*Italy's Aggression against Greece*", botuar në Athinë në vitin 1940. Dokumenti 111 në këtë libër citon Agjencinë Italiane të Lajmeve "Stefani", e cila shprehej se në Çamërinë e aneksuar në vitin 1913 banonin 80 000 shqiptarë dhe vetëm 10 000 ishin të kombësisë greke. Mirëpo, në dekadën e dytë dhe të tretë të shek. XX, një pjesë e popullsisë shqiptare të Epirit të Jugut, u detyrua të emigronte, ose të shkëmbehej me popullsinë greke të Azisë së Vogël. Për shkak të kësaj lëvizjeje, situata në vitet 1940 ishte e ndryshme në pikëpamje të numrit të popullsisë shqiptare banuese në krahinë: në muajin gusht të vitit 1940 gjendeshin në Çamëri ende rreth 50 000 shqiptarë, të cilët përbënin shumicën e popullsisë. Po në të njëjtin libër, gjejmë dokumentin 112, që i referohet Agjencisë së Athinës, e cila jep një pamje krejt tjetër. Aty shkruhet se, prej totalit të 65 074 banorëve të këtij distrikti, 18 109 ishin të nacionalitetit shqiptar. Ata gëzonin benefitet e një administrimi paternalist dhe jetonin në harmoni të plotë me pjesën tjetër të bashkëqytetarëve të tyre.¹⁰ Mendoj që shifra e parë është e situatës së popullsisë shqiptare e dekadës së dytë të shek. XX, përpara proceseve të valës së parë të largimit të sforcuar të çamëve drejt Shqipërisë dhe drejt emigracioneve të tjera në Turqi. Ndërkohë që shifra greke besoj se ishte e zvogëluar në minimumin e vet dhe mohonte tërësisht ekzistencën e popullsisë ortodokse shqiptare të Çamërisë, e cila nuk llogaritej. Popullsia shqiptare ortodokse, sipas nesh, ishte numëruar

⁹ Po aty, FO. 371. 11203, C9240/27/90, Përcaktimi i kufirit shqiptar, Komisioni i Kufirit Shqiptar, 1922-1925, raport mbi realizimin e punës.

¹⁰ Po aty, FO. 371.48094, R 7709/544/90, no. 244, 89/18/45, Leeper për Anthony Eden-in, Athinë, 23 prill 1945.

nga ky regjistrim si popullsi greke. Sjelljet shtypëse të pashallarëve shqiptarë në shërbim të Perandorisë Osmane në fund të shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX, kishin bërë punën e vet dhe kishin ndikuar në një afrimitet më të madh të ortodoksëve shqiptarë në Epirin e Jugut me Kishën Ortodokse Greke dhe me shtetin helen, si mbrojtës të tyre, në fund të fundit. Kjo shpjegon heshtjen e saj dhe pranimin afatgjatë të realitetit të ri gjeopolitik në këto anë.

Rrjedhojat e Luftës Italo-Greke për Epirin e Jugut

Me shpërthimin e Luftës Italo-Greke 1940-1941, shqiptarët në të dyja anët e kufirit, në Epirin e Veriut dhe Epirin e Jugut, kanë qenë viktimat e para të këtij konflikti, që nuk ishte në thelb një përplasje për interesat e tyre. Shpërthimi i luftës prishi gjithë ekuilibrat e brishtë, të ngrirë në njëfarësoj prej dy dekadash. Më pas, popullsia shqiptare e Epirit të Jugut, ka pësuar dhe shoqëruar, paralelisht me popullsinë greke, dramën shtetërore greke, atë të dezintegrimit të strukturës së Mbretërisë së Greqisë, të përçarjes së brendshme politike, të pushtimit gjerman të pjesës më të madhe të territorit shtetëror, pushtimit italian të Epirit në tërësi dhe ishujve jonianë, ballafaqimit të brendshëm politik e civil që vijoi gjatë në këtë vend. Shqiptarët e Çamërisë arritën të mbijetojnë në një situatë me vështirësi të papara, në vitet që pasuan: është fjala për vitet 1941-1944. Ata u mjaftuan t'u kërkonin autoriteteve italiane deri në verën e vitit 1943, dhe atyre gjermane pas kësaj kohe deri në evakuimin e tetorit 1944, njohjen e të drejtave që iu mohuan në periudhën e viteve 1913-1941, dhënien e furnizimeve ushqimore për popullatën e mjeruar dhe ndonjë kërkesë sigurie dhe mbrojtjeje.¹¹

Thënë ndryshe, gjatë gjithë periudhës së luftës, çështja e Epirit të Jugut dhe brenda saj “çështja çame”, u mbajt e ngrirë. Rajoni u drejtua fillimisht deri në kapitullimin e Italisë, nga ushtarakët italianë, që siguronin administrimin e çështjeve civile dhe mbrojtjen e bashkësisë shqiptare në bashkërendim me të Plotfuqishmin italian në Athinë, Ghigi. Ndikimi i Mëkëmbësisë së Tiranës në çështjen çame, pas ngjarjeve të dhunshme ndëretnike në krahinë, erdhi duke u ridimensionuar në mënyrë

¹¹ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) Mëkëmbësia e Përgjithshme, Viti (më tej: V.) 1941, Dosja (më tej: D.) 699, fl. 37-38. Letër e Nuri Dinos për Françesko Jakomonin.

të qartë dhe të vendosur. Në fakt, procesi i greqizimit të popullsisë kishte ndikuar në ndryshimin e pamjes etnike të territoreve të Epirit të Jugut. Duke bërë një inspektim në rajon, diplomati italian Carlo Umiltá do të deklaronte se nga Kosturi shqiptar nuk kishte mbetur as hija. Grevena (Grebeneja) ishte bërë arumune; Meçova ishte mikse, arumune dhe greke, Janina, Arta dhe Preveza ishin greke. Në të gjitha këto lokalitete, popullsitë mbizotëruese ishin të vendosura për të mos u përfshirë në shtetin shqiptar. Umiltá arrinte kështu në përfundimin se ideja për t'i aneksuar këto vende në Shqipëri ishte absurde, sepse i gjithë populli do të hidhej më pas në kryengritje. Ky inspektim dhe këto konkluzione të Umiltá-s, bënë që në fund të vitit 1941, autoritetet italiane të ndryshonin qëndrim, të linin mënjane përfundimisht idenë e sistemimit të Epirit të Jugut në Shqipëri, të mos flisnin më për Çamërinë dhe Roma i aprovoi plotësisht përfundimet e arritura nga ai.¹² Kjo vendimmarrje në heshtje shpjegon arsyen pse një volum shkencor mbi Çamërinë i Institutit të Studimeve Shqiptare nuk u botua në vitin 1942 dhe në muajin janar 1943 si përfundim u la mënjane, për "*arsye të oportunitetit politik*".¹³ Sipas nesh, zgjidhja do të kishte qenë, një veçim i territorit me shumicë shqiptare në Epirin e Jugut deri në rrjedhën e lumit Kallamas, nga pjesa tjetër. Mirëpo një diferencim i tillë nuk ndodhi, madje as nuk u ideua si propozim dhe zgjidhje e arsyeshme e situatës politike dhe etnike.

Ndërkohë, pas dezintegrimit të shtetit grek në prill të vitit 1941, mjedisi politik i Greqisë u copëtua në grupime politike e ushtarake me interesa dhe prirje nga më të ndryshme. Në rrethanat e pushtimit filloi aktivitetin edhe lëvizja e rezistencës, e cila ka qenë e përbërë nga këto grupe: forcat e EAM/ELAS-it të drejtuara nga Stefanos Sarafis, që përfaqësonin forcat e majta; EDES e drejtuar nga Napoleon Zervas, që përmbledhte venizellistë dhe republikanë; grupimi i tretë kanë qenë monarkistët, të cilët kishin pol kryesor drejtimi, qeverinë në emigracion. Gjermanët, nga ana e tyre, kishin krijuar forcat ushtarake të qeverisë greke progjermane. Forcat e EDES-it, të drejtuara nga Napoleon Zerva, operonin kryesisht në Epir dhe kur Italia po kapitullonte në verën e vitit 1943, në Epir erdhën gjermanët dhe Zervas bëri marrëveshje mossulmimi

¹² Davide Rodogno, *Il Nuovo Ordine Mediterraneo, Le politiche di occupazione dell'Italia fascista in Europa (1940-1943)*, (Torino: Bollati Boringhieri, 2014), 137, 139, 140, 141.

¹³ Alberto Basciani, *L'impero dei Balcani, L'occupazione italiana dell'Albania (1939-1943)* (Roma: Viella, 2022), 172.

me ta.¹⁴ Për sa i përket qëndrimit ndaj çamëve, EDES, me një orientim ideologjik nacionalist dhe antikomunist, hodhi poshtë në mënyrë kategorike politikën e kujdesshme ndaj popullsisë çame që ndiqte EAM/ELAS. Napoleon Zervas, udhëheqësi i EDES-it, nuk tregoi asnjë dëshirë për të bashkëpunuar me popullsinë çame në luftën kundër okupatorit, pavarësisht përpjekjeve dhe presionit që bënë oficerët britanikë të ndërlihdjes, për të nxitur një politikë të tillë.¹⁵ Pas marrjes së kontrollit të Epirit nga ana e ushtrisë gjermane në verën e vitit 1943, situata në Çamëri u bë katastrofike, për shkak të shkatërrimit të fshatrave dhe akteve të hakmarrjeve reciproke, për vuajtjet e pësuar nga popullsia vendëse e këtyre anëve në kohën e diktaturës ushtarake të Metaxas-it.

Kur armatat sovjetike hynë në Europën Lindore, më 1944, mungesa e një plani të Treshes së Madhe Aleate për gadishullin e Ballkanit, u bë e dukshme dhe problematike. Me qëllim që të parandalonin një përplasje midis forcave britanike dhe atyre sovjetike, Winston Churchill (Uinston Çërçill) dhe Stalini ranë dakord të ndanin përgjegjësitë mbi gadishullin e Ballkanit, kur u takuan për të famshmen “Marrëveshje të Përqindjeve”, të tetorit të vitit 1944. Mbi bazën e notave informale të shkëmbyera në mes këtyre dy liderëve, Greqia do të mbetej nën sferën e ndikimit britanik, Rumania dhe Bullgaria në atë sovjetike, ndërsa Jugosllavia dhe Shqipëria (e harruar fillimisht) mbetën në fashon e përgjysmuar të influencave të superfuqive aleate.¹⁶ Churchill kishte parasysh që këto marrëveshje do të “fluturonin” me mbarimin e luftës, por u provua se ky pakt informal ishte i vështirë të harrohej në Moskë. Mbi bazën e përcaktimeve të marrëveshjes, pas lufte Stalini mori vendime të rëndësishme. Kështu, ai e detyroi EAM-in të merrte pjesë në një kabinet qeveritar të unitetit kombëtar, të kryesuar nga një kryeministër probritanik, si Jorgos

¹⁴ Shih edhe: Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar*, 134.

¹⁵ Eleftheria K. Manta, “The Çams of Albania and the Greek State (1923-1945)”, në *Journal of Muslim Minority Affairs*, 29:4 (15 December 2009), 531.

¹⁶ *Churchill Archive online* (www.churchillarchive.com): David Woolner, *The birth of the Anglo-American ‘Special Relationship’*, Roosevelt Institute, 2002; Winston, S. Churchill, *The Second World War*, Vol.6, Triumph and Tragedy (Boston: Houghton Mifflin, 1976), 227; Po ashtu shih: Wilson Center, Digital Archive, International History Declassified, <http://digitalarchive.wilsoncenter.org/document/123187>, “Record of Meeting at the Kremlin, Moscow on 10 October 1944, at 7 p.m.,” October 10, 1944, History and Public Policy Program Digital Archive, Public Record Office.

Po ashtu: TNA, PREM, 3-41, procesverbali personal i kryeministrit, 11.10. 1944, Seria No. M (tal) 5/4.

Papandreu. Vendi në fakt ishte në çoroditje totale. Greqia nuk u vendos kështu nën sundimin komunist falë Marrëveshjes së Përqindjeve të Stalinit dhe Churchill-it. Rusët mbetën jashtë Greqisë dhe trupat britanike u vendosën në Greqi, me aprovimin e Presidentit Roosevelt (Rusvelt) dhe mareshalit Stalin.¹⁷

Lufta civile dhe pasojat në Epirin e Jugut

Siç edhe dihet, me largimin e gjermanëve, në Greqi filloi periudha e përballjeve të brendshme mes EAM-it dhe EDES-it. *Kështu, nga muaji tetor 1944 deri në muajin shkurt 1945, EAM, që ishte në fakt zotërues i vendit, do t'u kundërvihej trupave britanike, të cilat kërkonin rivendosjen e pushtetit mbretëror.* Komunistët bënë dy gabime kryesore taktike, që ndikuan negativisht në kauzën e tyre: 1. ata humbën shumë kohë dhe energji duke ndjekur sukseset e përditshme nëpërmjet sulmeve ndaj pozicioneve pararojë të stacioneve policore në kryeqytet dhe në qendrat e tjera të rezistencës; dhe 2. ata zhvendosën forca të konsiderueshme të ELAS-it kundër forcave të Zervas-it në Epir. Dhe kjo lëvizje kishte pak kuptim, ndërkohë që sukcesi i ELAS-it në Athinë do të thoshte shkatërrim i Zervas-it në Epir.¹⁸ Në Krishtlindjet e vitit 1944, Churchill dhe Antony Eden u nisën në Athinë për t'u përpjekur të gjenin një zgjidhje politike për krizën në Greqi. Misioni i tyre dështoi të ndalonte luftimet, por, kur kryeministri britanik u kthye në Londër, ia doli të zgjidhte një vështirësi politike, duke bindur Mbretin George të mos kthehej në Greqi gjatë asaj kohe; në mungesë të tij, kryepeshkopi Demaskions duhej të sillej si regjent. Damaskions vendosi një gjeneral republikan veteran, Nikolaos Plastiras, për të zëvendësuar Papandreun si kryeministër, dhe disa ditë më vonë, natën e 4-5 janarit 1945, forcat e ELAS-it dolën qetësisht jashtë Athinës. Një armëpushim u nënshkrua më 11 janar 1945. Një muaj më vonë, më 12 shkurt u nënshkrua *Marrëveshja e Varkizës*. Pas këtij akti pajtimi, edhe Zervas, më 15 shkurt 1945, shpërndau guerilasit e tij andartë të mbetur në Ishullin e Korfuzit. Me parashikimin e demobilizimit të ELAS-it dhe krijimin e ushtrisë së re, Varkiza parashitroi mundësinë edhe

¹⁷ D. George Kousoulas, "The Greek Communists Tried Three Times and Failed", në *The Anatomy of Communist Takeovers*, edited by Thomas T. Hammond & Robert Farrell (New Haven and London: Yale University Press, 1976), 296-297.

¹⁸ Po aty, 299.

të invadimit të Shqipërisë dhe për rrjedhojë ngriti një problem serioz rreziku për regjimin e ri të sapoinstaluar të Enver Hoxhës.¹⁹

.....

Sa më sipër ishte situata greke në kompleksitetin e vet, por një rëndësi të posaçme merr gjendja e popullsisë shqiptare në Epirin e Jugut. Përshkrimi i gjatë i mësipërm madje synon të qartësojë pikërisht pozicionin e popullsisë shqiptare brenda kësaj trazire dhe lufte të brendshme politike dhe civile. Që nga vera e vitit 1944 së paku, popullsia shqiptare e Çamërisë u vendos nën goditje. Dy janë tipat e goditjeve: spastrimi i popullsisë shqiptare myslimane të Çamërisë, frikësimi i sforcuar ndaj popullsisë shqiptare ortodokse atje, spastrimi nga trojet dhe pronat e tyre stërgjyshore. Dy lloj spastrimesh kanë ndodhur ndaj çamëve myslimanë: fillimisht Zerva deri në dhjetorin e vitit 1944; më pas forcat qeveritare të ushtrisë së rregullt të komanduar nga Plastiras dhe të mbështetura nga mbetjet e EDES-it të Zervas-it. Jo më pak armiqësore ndaj Çamërisë kanë qenë edhe forcat e majta të ELAS-it, gjegjësisht lëvizja partizane greke. Duhet të saktësojmë, se ndaj shqiptarëve të Çamërisë të gjitha këto forca, kundërshtarë për vdekje mes tyre në planin e brendshëm, në planin e qëndrimit ndaj shqiptarëve në tokat e tyre në Greqi ato kanë qenë unitare. Bashkërisht, ato kanë qenë kundër njohjes së të drejtave sovrane të pakicës kompakte të çamëve, që në fakt në atë territor ku banonin ishin shumicë.

Çfarë rezulton nga dokumentet britanike në lidhje me keqtrajtimin, dhunën dhe mizoritë e forcave të ndryshme greke ndaj popullsisë shqiptare në verën e vitit 1944 deri në muajt e parë të vitit 1945?

Në fund të muajit maj 1944, trupat e Napoleon Zervas-it mësynë drejt Pargës, pushtuan Paramithinë, më datë 27 qershor të vitit 1944. Kjo lëvizje vendosi nën kërcënim minoritetin shqiptar nga perëndimi në Margarit, në veri, deri në det, dhe në rrugën Janinë-Igumenicë. Situata u acarua edhe më tej nga interferenca e trupave gjermane që përdornin çamët. Kështu, një togë gjermane kundërsulmoi, duke përfshirë në repartet e veta edhe pjesëtarë të minoritetit çam. Kundërsulmi u zmbraps

¹⁹ Haris Vlavianos, *Greece, 1941-49: From Resistance to Civil War, (The Strategy of the Greek Communist Party)* (New York: Palgrave Macmillan, 1992), 74.

nga forcat e Zervas-it, duke sjellë si pasojë të drejtpërdrejtë, fillimin e një persekutimi në shkallë të gjerë ndaj minoritetit shqiptar. Shumë kryefamiljarë u tërhoqën me njerëzit e tyre në veri të lumit Kalvakiotikos.²⁰

Zyra përfaqësuese e ministrit rezident britanik në Bari jep këtë shpjegim mbi pretekstin e fillimit të gjenocidit ndaj popullsisë shqiptare të krahinës çame: pas evakuimit përfundimtar të Greqisë prej gjermanëve, trupat e Zervas-it morën në zotërim këtë pjesë të Çamërisë, që banohej nga popullsia shqiptare atje dhe u strehuan në shtëpitë që u përkisnin në pronësi shqiptarëve. Siç duket, në një lokalitet të vetëm, 40 ushtarë të Zervas-it pas kësaj hyrjeje të paftuar dhe jomiqësore në shtëpitë e shqiptarëve, u zhdukën dhe më vonë u gjetën të vrarë. Ky incident që ka ndodhur në muajin qershor të vitit 1944, shërbeu si pretekst që nxiti raprezaljet prej forcave të Zervas-it, të cilat nga kjo kohë filluan nxjerrjen jashtë të të gjithë popullsisë shqiptare të Çamërisë drejt Shqipërisë, proces që vazhdoi gjatë dhe i përfshiu të gjithë, pa dallim, si gratë ashtu edhe fëmijët.²¹

Ka edhe një rrethanë strategjike që ka ndikuar në fillimin e këtij represioni: në muajin gusht 1944, Napoleon Zervës i lindi nevoja për të forcuar linjën mbrojtëse në bregdet, për të siguruar furnizime për forcat e tij paramilitare. Kjo nevojë strategjike i erdhi për mbarë Zervës, pasi me këtë rast ai filloi të pastronte zona të tjera, përfshirë edhe fshatrat shqiptare në krahinën e Filatit. Kjo ofensivë shkaktoi një evakuim të mëtejshëm të minoritetit shqiptar. Një numër i konsiderueshëm banorësh shqiptarë filluan të kalonin kufirin për në Shqipëri, për t'i shpëtuar goditjes shfarosëse. Së fundi, gjatë tërheqjes gjermane dhe me urdhër të gjeneralit britanik Scobie, Zerva i zhvendosi trupat e tij më në Veri, në afërsi të kufirit shtetëror me Shqipërinë, për të prerë tërheqjen gjermane nga Korfuzi. Me këtë rast, ai kreu një rrugë dhe dy punë: përzuri edhe minoritetin shqiptar drejt Shqipërisë. Kjo lëvizje provokoi rëndë qeverinë shqiptare progjermane, e cila ndërmori një fushatë në gusht dhe në shtator në radio dhe në gazetë. Sipas deklaratave zyrtare të qeverisë së Tiranës,

²⁰ TNA, HS 5/75. Marrëdhëniet mes grupeve shqiptare dhe greke në vitet 1943-1944, Ballit Kombëtar dhe EDES-it.

²¹ Po aty, FO. 371.48094, R2294/544/90. Nënkoloneli Deakin, z. Brooad, Bari, 23, janar 1945.

forcat greke të Zervas-it në verën e vitit 1944 kishin vrrarë rreth 250 shqiptarë dhe kishin persekutuar më se 20 mijë të tjerë.²²

Kështu pra, në verën e vitit 1944 konflikti filloi me gjakderdhje të madhe. Sipas rendit kronologjik, masakra e parë e madhe ka ndodhur në muajin qershor 1944 në Paramithi. Nga fillimi i muajit qershor 1944, EDES vendosi si objektiv marrjen nën kontroll të Paramithisë dhe hapësirës së saj të gjerë, ku Shtabi i Përgjithshëm i Lindjes së Mesme i forcave Aleate kishte vendosur të krijonte një urë për të lehtësuar furnizimin me armatim të forcave të rezistencës. Çlirimi dhe sigurimi i kësaj hapësire bregdetare u konsiderua si një nevojë e dorës së parë ndaj dhe Zervas, që kishte juridiksionin e kontrollit ushtarak të kësaj krahine, filloi ekzekutimin e kësaj detyre. Në fund të muajit qershor të vitit 1944, forcat gjermane e lëshuan Paramithinë, ku mbeti vetëm një garnizon i vogël, së bashku me pak njësi paraushtarake të popullsisë vendëse çame, që do ta mbronin këtë qytet. Në mëngjesin e datës 27 qershor të vitit 1944, forcat e EDES-it hynë në Paramithi. Në drekë, forcat e EDES-it masakruan jo vetëm mbrojtësit e qytetit dhe parinë çame, por pa dallim edhe fëmijët dhe gratë e popullsisë vendëse myslimane. Viktimat kanë qenë me qindra dhe kush arriti të ikte, u drejtua në bregun perëndimor të lumit Kalamas. Pjesa tjetër u grumbullua në kampe përqendrimi, të shoqëruar nga rojet e EDES-it dhe u transferua në vende të tjera drejt kufirit me Shqipërinë.²³ Në masakrën e 27 qershorit 1944 në Paramithi u vranë, u therën dhe vdiqën nga të rrahurat më se 600 gra, burra e fëmijë. Barbarizma u kryen edhe në Karbunarë, Dragon, Kardhiq, Margëlliç, Pargë, Filat, Spatar, Koske etj.²⁴ Vetëm pas masakrës së Paramithisë, më 10 korrik 1944, u bë organizimi i Komandës së Çamërisë nga Nuri Dino, Moulla Emin, Vehib Hodo me drejtimet operacionale mbrojtëse, që tregohen më poshtë në punim. Masakrat e para i detyruan rreth 20 000 shqiptarë të Çamërisë (të krahinës së Paramithisë dhe të Pargës), që në muajin gusht 1944 të mblidhen në Filat. Aq ishte acaruar situata, sa autoritetet greke nën gjermanët, me pranimin edhe të Neubacher-it, të dërguarit të posaçëm gjerman për Juglindjen, kishin projektuar që në këtë kohë një ndërrim të tyre me popullsinë ortodokse greke të krahinës së

²² *Po aty*, HS 5/75. Marrëdhëniet mes grupeve shqiptare dhe greke në vitet 1943-1944, Ballit Kombëtar dhe EDES-it.

²³ Manta, "The Çams of Albania and the Greek State", 532.

²⁴ Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar*, 126.

Gjirokastrës dhe të Konispolit.²⁵ Në ditët e para të muajit gusht të vitit 1944, EDES vazhdoi operacionet e veta në Çamëri. Luftëtarët e EDES-it kapërcyen çdo rezistencë të popullsisë vendëse dhe njëkohësisht vijuan operacionet e deportimit të popullsisë shqiptare drejt territorit të Shqipërisë. Ata bënë një kërdi të madhe mbi krerët e Çamërisë, popullsinë civile, duke kaluar nën thikë 250 burra, parinë dhe klerin mysliman. Qyteti i Paramithisë u dogj sërish, popullsia u vra dhe u masakrua, ndërsa 12 fshatra përreth pësuan të njëjtin fat.²⁶ Më 28 gusht 1944, në Pargë, bandat e Zervës vranë 49 burra dhe 8 gra.²⁷ Kjo ployë e re u krye nga çetat nacionaliste greke të Zervës ndaj popullsisë fatkeqe të Çamërisë, si vepra e fundit e një vargu salvimesh që shovinistët, në mënyrë të koordinuar si struktura të identifikuara, civile, ushtarake dhe religjioze kishin ndërmarrë për më shumë se gjysmë shekulli në Epirin e Jugut ndaj popullit shqiptar. Më 21 shtator të vitit 1944, forcat gjermane, që deri atëherë nuk kishin arritur të ndalnin masakrat, filluan të evakuoeshin nga Epiri. Misioni Ushtarak Britanik urdhëroi EDES-in të parandalonte, që forcat gjermane të imbarkoeshin për në Ishullin e Korfuzit. Divizioni i 10-të i EDES-it urdhëroi njësitë e veta të ndërmerrnin një sulm të përgjithshëm kundër forcave gjermane dhe brenda pak ditëve i gjithë rajoni i Thesprotisë u çlirua. Në mbrojtje të popullsisë shqiptare të Filatit kishin mbetur vetëm njësitë e armatosura të Çamërisë, por rezistenca e tyre ndaj depërtimit të forcave nacionaliste greke u kapërcye shumë shpejt. Ajo që pasoi ishte një masakër tjetër e madhe, që ndodhi në tetor të vitit 1944 në Filat. Për pesë ditë qyteti ishte në kaos, shkatërrim dhe vrasje pa dallim. Udhëheqësit shqiptarë të Filatit, Masar dhe Nuri Dino u larguan më përpara për në territorin e Shqipërisë, së bashku me forcat gjermane, duke e lënë popullsinë pa udhëheqësi. Dhjetëra gra dhe fëmijë u mbyllën në ndërtesën e shkollës së Filatit dhe vetëm pas ndërhyrjes së oficerëve aleatë, ata u liruan dhe shpëtuan pas ditësh të tëra kërcënimi nga terroristët andartë. Brenda pak ditëve, e gjithë popullsia shqiptare e zonave fshatare të Çamërisë u deportua dhe aty nuk mbeti më këmbë shqiptari jo i

²⁵ *Përmbledhje dokumentesh nga Fondi i Komandës Gjermane, 1940-1944*, Buletini Arkivor Ushtarak (Tiranë: 2017), dok. nr. 244. Përfaqësia gjermane në Beograd, Brude Junker dërguar Përfaqësisë në Tiranë, telegram i shifruar, nr. 230, Beograd, 21 gusht 1944.

²⁶ “Çetat nacionaliste Greke dhunojnë tanësinë shqiptare dhe mobilizojnë popullsinë përdhunisht”, në gazetën *Bashkimi i Kombit*, e mërkurë, 6.09.1944.

²⁷ Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar*, 127.

krishterë.²⁸ Vetëm dy masakra, ajo e Paramithisë dhe ajo e Filatit, lanë pas 2 000 kufoma, gra, fëmijë, pleq dhe burra të çarmatosur, të masakruar shtazërisht nga banditët fashistë të Greqisë së Luftës së Dytë Botërore. Gjatë periudhës korrik – nëntor 1944, mendohet se i gjithë minoriteti shqiptar mysliman në Greqi kaloi një herë për në Shqipëri. Shifra që përflitej ishte rreth 18 mijë banorë të shpërngulur.²⁹ Vetëm në qytetin e Filatit, pas katër ditësh pushkatimesh afër spitalit dhe te përroi i Shejlës, sipas dëshmimeve të të mbijetuarve, u ekzekutuan 259 veta.³⁰ Studiuesja greke Eleftheria K. Manta e vendos këtë numër në mes 22 000 dhe 25 000 banorë të deportuar.³¹

Nga Komiteti Antifashist i Çamërisë, si për ta hedhur poshtë alibinë e Zervas-it dhe qeverisë së Plastiras, për bashkëpunim në bllok komunitar me pushtuesin, vjen një informacion i detajuar që mban datën 17 tetor 1944. Është një letër e gjatë në të cilën jepen detaje mbi masakrat, grabitjet e plaçkitjet, të cilat ushtria e Zervas-it kishte bërë ndaj popullsisë së Çamërisë. Përveç kësaj, aty kemi po ashtu një protestë dhe një numër kërkesash të bëra nga ky organizëm. Dokumenti bën fjalë për krime çnjerëzore dhe plaçkitje të kryera nga bandat e organizuara të EDES-it, nën komandën e gjeneralit Zervas në Çamëri. Në fshatrat e Paramithisë, Gardhitis, Dhrahumi, Karbumari, Velia, Filati, Galbaqi dhe Spatari u masakruan 338 persona, përfshirë burra dhe gra. Raporti jep edhe shifrat e dëmeve ekonomike të plaçkitura: 1 621 000 rrënjë gruri, 4 949 000 rrënjë misri, 2 217 500 rrënjë tërshërë e elbi, 361500 okë me djathë delesh, 1307 kokë gjë e gjallë, 5 140 koshere bletësh, 607 kuaj; 26750 okë lesh; 18 599 okë duhan, 26 800 okë oriz, 37 000 okë bajame, 32 000 pemë ullinjsh dhe dëme pronash të llogaritura në 84 700 franga. Këto veprime dhe akte konsiderohen nga Komiteti Antifashist i Çamërisë si veprime karakteristike barbare fashiste, të cilat e kishin hedhur popullsinë shqiptare të Çamërisë, në vuajtje dhe mjerim që nuk kishin një paralele në histori. Ky komitet, për këtë arsye, i dërgoi qeverisë së Unitetit Kombëtar të Greqisë, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Ajrore Aleate të Mesdheut, qeverive të Fuqive të Mëdha, Anglisë, Rusisë dhe Amerikës, Komitetit Qendror të EAM-it, Guvernatorit të Epirit, Komitetit Panepirot të EAM-

²⁸ Manta, "The Çams of Albania and the Greek State", 533.

²⁹ TNA, HS 5/75. Marrëdhëniet mes grupeve shqiptare dhe greke në vitet 1943-1944, Ballit Kombëtar dhe EDES-it.

³⁰ Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar*, 127.

³¹ Manta, "The Çams of Albania and the Greek State", 533.

it, Komitetit Krahinor të EAM-it në Filat të Çamërisë një notë proteste. Ajo notë u dërgua në emër të popullsisë antifashiste të minoritetit shqiptar të Çamërisë, që ishte shqyer në pjesë dhe ishte shkatërruar prej kriminelëve të bandave të EDES-it dhe ishte detyruar të kalonte në territorin e Shqipërisë, duke vuajtur nga uria dhe sëmundjet. Komiteti protestonte për barbarizmat e pashembullta dhe krimet e kryera nga EDES mbi popullsinë e pafajshme që kishte mbetur në Çamëri. Bëhej fjalë për më shumë se 300 gra dhe fëmijë të masakruar; vejusha dhe vajza të reja të dhunuara, dhe në rrethanat e tyre të pambrojtura, ata vazhdonin të mbeteshin viktimat të akteve të turpshme të barbarëve të bandave të EDES-it. Të njëjtat banda kishin djegur dhe shkatërruar më shumë se 2 500 deri 3 000 shtëpi, së bashku me furnizimet ushqimore dhe çdo gjë brenda. E keqja tjetër qëndronte se të gjitha këto krime kryheshin prej organizatës së EDES-it, e cila operonte nën emërtimin nacionalçlirimtar, në të njëjtën kohë kur nazizmi ishte mundur, kolaboracionizmi i pretenduar nuk kishte më asnjë vlerë dhe goditja e tyre ishte thjesht një pastrim i pastër etnik. Protesta bën të qartë se shqiptarët e Çamërisë, nuk e mbanin veten përgjegjës për krimet nga të cilat vuajtën grekët dhe shqiptarët e Çamërisë. Ato krime ishin bërë, sipas përfaqësuesve të kësaj organizate të majtë shqiptare në Çamëri, nga klika fashiste e familjes Dino dhe bejlerëve krahinorë (autoritetet greke do të akuzonin posaçërisht Nuri Dinon, Xhemil Dinon, Masar Dinon dhe Vehib Huton). Në fakt, shqiptarët e Çamërisë nuk iu nënshtruan planeve të EDES-it, ndaj dhe ata e pësuan në këtë formë. Komiteti bëri të qartë dhe mori përsipër të njoftonte se, pakica shqiptare në Çamëri e konsideronte veten pjesë integrale të popullit grek, me të cilin ata bashkoheshin për interesa të njëjtë. Gjaku i derdhur në betejën e përbashkët për lirinë e Greqisë e bënte lidhjen e vëllazërisë mes tyre edhe më të fortë, shpreheshin hartuesit. Për këtë, ata jepnin si shembull 500 shqiptarë të Çamërisë të rreshtuar në radhët e ELAS-it, fakt që shërbente kështu si provë se edhe shqiptarët e kësaj ane morën pjesë aktive në luftën për çlirim dhe klasifikimi në bllok si kolaboracionistë ishte një përkufizim i gabuar, i padrejtë. Kërkesat kryesore që pasonin kishin të bënin me kthimin e menjëhershëm të popullsisë së Çamërisë në tokat e veta, sigurimin e instalimit dhe dhënien e mundësisë për të jetuar, dërgimin e një përfaqësuesi të qeverisë në Çamëri për të filluar hetimin dhe sjelljen para drejtësisë të kriminelëve fajtorë, dërgimin e shpejtë të ushqimeve, furnizimeve mjekësore dhe gjëra të tjera të nevojshme për nevojat e popullsisë; largimin e menjëhershëm të

ushtarëve të EDES-it nga krahina e Çamërisë, me objektiv shpëtimin e nderit, jetës dhe pasurisë së popullsisë; barazi të plotë të të drejtave, bazuar në Kartën e Atlantikut dhe pjesëmarrjen e popullsisë çame në luftën e popullit grek kundër agresorëve të huaj; lëshimin e menjëhershëm të 300 grave dhe fëmijëve që ishin të destinuar të dërgoheshin në kampet e përqendrimit në Filat dhe Paramithi. Protesta përfundon me thirrjen “Çamëria e Lirë”.³²

Pyetja që bëhet është kjo: Vërtet familja Dino ka marrë pjesë në masakra, siç pretendojnë grekët dhe këta anëtarë shqiptarë të komitetit antifashist, apo kemi të bëjmë me një frazeologji të majtë, të zbutur e të përunjur ndaj autoriteteve greke, për t’u bërë e pranueshme për Aleatët, në kontekstin e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe pozicionit krejtësisht të brishtë të Çamërisë? Kjo mbetet për t’u verifikuar. Po një dokument i firmosur nga nacionalistët shqiptarë të Çamërisë, të lë të kuptosh se në rastin e rezistencës së parisë së Çamërisë, kemi të bëjmë me një organizim vetëmbrojtjeje, të realizuar në muajin qershor 1944 nga familja Dino dhe pasuesit e tyre nacionalistë, në rrethanat e tërheqjes së gjermanëve, kur perspektiva e një operacioni spastrues, karakteristik shovinist grek, ishte në përgatitje e sipër. Pra, sipas arsytimit tonë, bëhej fjalë për masa mbrojtëse dhe jo për organizime pronaziste. Në vitin 1943, pushtuesit gjermanë përdorën agjentë mes minoritetit shqiptar në Greqi për të provokuar incidente pas incidentesh në këtë vend. Në verën e vitit 1944, një grup prej këtyre agjentëve, nën komandën e Ismail Haki-t, të armatosur prej gjermanëve, ndërmori një sulm kundër një bande të forcave të Zervas-it në zonën e Janinës. Pas kësaj pasoi raprezalja e ndërmarrë nga Zervas mbi fshatrat shqiptare në rajonin e Filatit. Menjëherë pas ngjarjes kemi deklaratën e Enver Hoxhës të datës 4 tetor 1944, në të cilin ai shpallte se synonte të ndiqte forcat e Zervas-it, përgjegjëse për masakrat ndaj fshatrave shqiptare në territorin grek. Enver Hoxha, siç duket, ishte i ndikuar edhe prej arritjes pranë Shtabit të tij edhe të një Misioni të EAM-it.³³ Në të vërtetë, ai nuk bëri asgjë të tillë dhe kërcënimi i lëshuar nga ai ishte një flluskë propagandistike. Shumë burime tregojnë të njëjtën gjë, se pas largimit të trupave gjermane nga Epiri i Jugut, forcat e EDES-it për hakmarrje kishin masakruar deri në

³² TNA, FO. 371.48094, R 544/544/90, Copy of Broadcast 18.12.1944. Detaje të masakrave dhe plaçkitjeve që ushtria e Zervës ka bërë mbi popullsinë e Çamërisë.

³³ *Po aty*, FO. 371.43564. Phillip Broad për Harold Macmillan-in, Bari, 28 tetor 1944, nr. 177.

800 shqiptarë në vjeshtën e vitit 1944.³⁴ Kemi të bëjmë me burime të ndryshme, shifra të ndryshme njerëzish të vrarë në masakra, por ajo që duhet të jetë e vërtetë është ekzistenca e kësaj goditjeje asgjësuese ndaj shqiptarëve të Kaonisë së Jugut dhe të Thesprotisë në kohën e Luftës Italo-Greke. Pas qershorit 1944, duhet të kenë ndodhur goditje të limituara asgjësuese ndaj forcave të EDES-it nga forcat e mbledhura nga familja Dino, me synim ndaljen e andartëve në përpjekje për t'u instaluar në krahinë. Por, përplasjet mes forcave ushtarake të palëve dhe goditja e padallimtë ndaj popullsisë civile shqiptare myslimane në këto anë, janë dy zhvillime krejt të pakrahasueshme, raste disproporcionale sjelljeje që klasifikohen jo njëllor në të drejtën ndërkombëtare.

Dhuna e filluar nga vera e vitit 1944 nxiti procesin e largimit masiv të popullsisë shqiptare të Çamërisë, të mbetur ende pa u goditur, kryesisht drejt Shqipërisë. Vala e largimit vazhdoi pa ndërprerje deri në dhjetor të vitit 1944. Goditja e andartëve ka qenë, jo ndaj forcave kolaboracioniste, siç arsyetohet rëndom politikisht edhe sot, por ndaj një popullsie të tërë etnikisht dhe fetarisht të përcaktuar dhe tërësisht e paarmatosur. Madje, goditja është kryer nga forcat greke që kishin pasur edhe pakte me gjermanët, që më vonë u bënë me Aleatët, kundër një popullsie tashmë plotësisht pa mbrojtje dhe të etiketuar nga pikëpamja fetare si myslimane, dhe nga pikëpamja politike, padrejtësisht në bllok, si kolaboracioniste.

Në fillim të muajit dhjetor 1944 afërsisht rreth 4 000 refugjatë nga minoriteti shqiptar i Greqisë së Veriut, gjendeshin ende në zonën në jug të Gjirokastrës, pjesa tjetër, më e madhja, kishte lëvizur drejt veriut në kërkim të ushqimit dhe strehimit.³⁵

Në dhjetor të vitit 1944, pas marrëveshjes së Frontit Nacionalçlirimtar (FNÇ) me EAM-in, pati një ndërprerje të fluksit të emigrimit drejt Shqipërisë dhe rikthim të një pjese të të emigruarve nga Shqipëria drejt Greqisë. Mirëpo ky fenomen ishte i përkohshëm, pjesor, sepse sërish në vitin 1945, pas masakrës së marsit të vitit 1945, procesi migrator nga Çamëria drejt Shqipërisë rifilloi, tashmë me një rrugë pa kthim. Nga shqiptarët e zonës së Filatit në veriperëndim të Greqisë, raportohej se 18 000 banorë u detyruan sërish të iknin në Shqipërinë e Jugut, gjatë sulmeve të muajve të parë të vitit 1945, të ndërmarrë nga

³⁴ *Po aty*, HS 5/70, Force 399/ SF/ 880/G29/B8. Raport i kapitenit Harlou, 13 dhjetor 1944.

³⁵ *Po aty*, WO.202.960, Albania, to G-2 (P.B.), AFHQ Balkan Political Review, Issue No.19, for week ending 9 January -1945.

guerilasit e Zervas-it dhe ushtria e Plastiras-it. Shumë prej këtyre refugjatëve u vendosën në një kamp në Sarandë dhe FNÇ-ja filloi një përpjekje për të lëvizur disa prej refugjatëve drejt Veriut të vendit. Armiqësia mes minoritetit shqiptar në Epirin e Jugut dhe guerillasve të Zervas-it, kishte ekzistuar për disa kohë dhe ishte inkurajuar prej gjermanëve. Ndërkohë që situata në Epirin e Veriut ishte krejtësisht e ndryshme. As Balli Kombëtar dhe as FNÇ-ja nuk kishin persekutuar asnjë anëtar nga minoriteti grek në Shqipëri, megjithëse FNÇ-ja kishte ndërmarrë ndonjë raprezalje ndaj familjeve të veçanta greke për kundërshtim të urdhrave të saj. Marrëdhëniet ndërmjet FNÇ-së dhe EAM/ELAS-it mbetën në sipërfaqe miqësore, dhe në këtë kohë që Zervas bënte raprezaljet ndaj shqiptarëve në Greqi, pranë Shtabit të Përgjithshëm të FNÇ-së ishte i pranishëm Misioni i EAM-it. Duhet të kujtojmë se FNÇ-ja në këtë kohë dyshonte, se EAM, njëlloj si qeveria greke, kishte të njëjtat projekte mbi Shqipërinë e Jugut.³⁶ Dhe ky dyshim në fakt mbi EAM-in ishte plotësisht i vërtetë: ndaj çështjes shqiptare në Greqi dhe problemeve që lidheshin me minoritetet dhe linjat kufitare, partitë politike greke, pavarësisht krahut politik, kanë pasur pak ose aspak diferenca.³⁷

Në fund të muajit janar të vitit 1945, Enver Hoxha pretendonte se gjatë pesë muajve të krizës në Epirin e Jugut, rreth 18 000 banorë çamë kishin kaluar kufirin drejt Shqipërisë. Shefi i Seksionit Vendor për Shqipërinë i *Force* 399, majori Watrous arriti të takonte një pjesë prej emigrantëve dhe të konfirmonte shumë nga ato çfarë ishin shkruar e raportuar më parë mbi minoritetin shqiptar në Greqi dhe sjelljen e autoriteteve qeveritare greke. Arsyeja kryesore e këtij largimi masiv që refugjatët i dhanë majorit Watrous, ishte frika e raprezaljeve të bandave të Napoleon Zervas-it. Ata pranuan hapur se kur Zervas ishte duke vuajtur në duart e gjermanëve, një numër prej njerëzve të tyre, pra banorëve çamë, shfrytëzuan rastin dhe vranë pasuesit terroristë të Zervas-it. Në rrugën nga Vlora në Llogora, majori britanik dhe njerëzit që e shoqëronin, kaluan pranë rreth 1 000 çamëve dhe më vonë pranë disa barakave të vjetra italiane në Vlorë ata takuan edhe disa qindra të tjerë, të cilët ishin ushqyer dhe strehuar prej përfaqësuesve lokalë të këshillave

³⁶ *Po aty*, WO.202.960, Albania, Appendix "A" to G-2 (P.B.), AFHQ Balkan Political Review, Issue No.17, for week ending 27 December 1944.

³⁷ Shih për këtë: Sonila Boçi, *Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritetit 1939-1949*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Kristalina, 2012), 131-143.

nacionalçlirimtarë. Përfaqësuesi krahinor, dr. Rexhep Sulejmani, i raportoi majorit britanik se shumë prej çamëve ishin dërguar në Veri dhe disa kishin arritur në rrethinat e Tiranës. Sistemime ishin bërë për çamët, duke i shoqëruar në zonat e vendit mes Lushnjës dhe Fierit, në Myzeqe, ku kishte toka të punueshme bujqësore. Dr. Sulejmani deklaroi se, arsyeja që çamët kishin lënë Greqinë ishte se ata ishin keqtrajtuar dhe në disa raste qenë masakruar prej forcave të Napoleon Zervas-it.³⁸

Në qoftë se masakrat ndaj çamëve deri në muajin dhjetor 1944 – janar 1945 ishin bërë nga forcat e Zervas-it, pas vendosjes së autoritetit qeveritar të gjeneralit Plastiras, ato vijuan tashmë nga ushtria e rregullt e Greqisë. Mes evidencave të regjistruara është masakra e ndodhur në Filat, më 13 mars 1945, kur 70 burra u ekzekutuan dhe gratë e tyre u dhunuan. Pas masakrës së Filatit, me mijëra refugjatë të tjerë morën rrugën për në Shqipëri.³⁹ Sipas versionit të raportuar nga refugjatët e mbërritur në Shqipëri, ngjarja është zhvilluar në këto rrethana: më datë 6 mars 1945, lejtënant Cristo Kaca zbarkoi nga Korfuzi në pjesën kontinentale dhe ky zbarkim i tij ishte parë nga barinjtë e zonës. Ndër banditët e tjerë drejtues, barinjtë dhe dëshmitarët konstatuan edhe majorin Ilio Kaca, i cili erdhi nga Palo Fshati, si edhe kolonelin Zotto. Ata kishin deklaruar se i përkisnin Organizatës së Plastiras dhe kishin qenë të veshur me uniforma ushtarake greke, me kurorë në kapelat e tyre. Atyre më pas iu bashkuan gangsterë të armatosur nga Korfuzi dhe nga popullsia lokale greke, afërsisht rreth 50 deri 100 njerëz të armatosur. Mes kriminelëve të përfshirë në masakër rezulton të ketë qenë Zoes Pantazis, banor i Parapotamo-s të Thesprotisë dhe Christo Katsio, banor i Palaicchori-t të Filatit. Kanë qenë pikërisht këto personazhe të errëta të botës së krimiit ordiner dhe politik, që kanë kryer masakrën e datës 12 dhe 13 mars 1945 në Filat, e cila shënoi nxjerrjen përfundimtare edhe të 5 000 shqiptarëve të fundit të rikthyer pas marrëveshjes së dhjetorit 1944 mes FNÇ-së dhe EAM-it.⁴⁰

³⁸ TNA, FO 371.48079, R 3134/46/90. Hetim i përgjithshëm i gjendjes në Shqipëri. Raport nga major Watrous, drejtues i Seksionit të Forcave Vendore të Shqipërisë 399, 5 shkurt 1945.

³⁹ *Po aty*, FO 371.48094, R 5665/544/90. Broad nga zyra e ministrit rezident në Mesdheun Qendror për Foreign Office, Caserta, 26 mars 1945.

⁴⁰ *Po aty*, FO 371.48094, R 8564/544/90. Turi i Shqipërisë së Jugut 2-6 prill, brigadier Hodgson.

Raport i gjeneral brigadierit Hodgson, drejtues i British Military Mission në Shqipëri

Për të hetuar rreth ngjarjeve në Thesproti, Foreign Office (FO) kërkoi që gjeneral brigadieri Hodgson, i cili në atë periudhë vepronte në Shqipëri, të dërgonte një oficer britanik në Jugun e Shqipërisë.⁴¹ Në fakt, paralelisht me këtë kërkesë, në fund të muajit mars të vitit 1945, një detashment i trupave britanike që ndodheshin në Greqi arriti në Filat për të hetuar në detaje mbi ngjarjet. Mirëpo, qeveria greke kishte marrë masat dhe kishte udhëzuar Guvernatorin e Përgjithshëm të Epirit për t'iu raportuar ushtarakëve britanikë, se njësitë e Gardës Kombëtare Greke nuk sulmonin çamët dhe se ata kishin marrë veprime të përshtatshme vetëm kundër atyre që ishin përgjegjës për incidentet. Por, toka çame në atë kohë ishte e boshatisur nga popullsia vendëse. Asnjë dëshmi e vërtetë mbi atë çfarë kishte ndodhur në ato anë, nuk mund të merrej në një territor të spastruar etnikisht nga banorët autoktonë, dëshmitarë të ngjarjeve. Në fakt, vetëm në harkun kohor midis tetorit 1944 deri në janar 1945, llogariteshin nga 12 000 deri në 14 000 shqiptarët e zhvendosur nga pjesa veriperëndimore e Epirit nën etiketimin e pavërtetë, si luftëtarë guerilas, që gjoja kishin bashkëpunuar me gjermanët. Mirëpo, në këtë numër përfshiheshin kryesisht gra e fëmijë. Për çfarë kolaboracionizmi bëhej fjalë? Në fakt, bëhej fjalë qartazi për një raprezalje të paramenduar dhe të nxitur, për nevoja të spastrimit etnik dhe zënies së territoreve. Kujtojmë që nga Marrëveshja e Varkizës, një numër trupash të EDES-it, të mbetur nga dezintegrimi, ishin rikthyer sërish nga Korfuzi në Epir dhe kishin vazhduar ta godisnin popullsinë e Çamërisë.⁴² Më 4 prill 1945, gjeneral brigadieri Hodgson vendosi të shkonte vetë për të bërë hetimin. Ai u nis nga Tirana së bashku me kolonel Palmer-in.⁴³ Vizita është zhvilluar në Greqi, nga data 4 prill deri më 10 prill të vitit 1945, gjatë së cilës ai ka pasur takime me majorin Hutchinson, *BMM Epirus Higher Military Command* dhe majorin grek Sarandis, oficer i Komandës më të lartë greke në Epir dhe me lejtënant kolonelin Hunt G1 të korpusit 3 britanik. Synimi

⁴¹ *Po aty*, FO 371.48094, R 5665/544/90. Nga Foreign Office për zyrën e ministrit rezident të Mesdheut Qendror në Caserta, 27 mars 1945.

⁴² *Po aty*, FO 371.48094, R 5958/544/90. Leeper për Foreign Office, Athinë, 30 mars 1945.

⁴³ *Po aty*, FO 371.48094, R 6202/544/90. Telegram nga Macmillan për Foreign Office, Caserta, 4 prill 1945.

i vizitës ka qenë për të marrë nga autoritetet britanike në Epir rezultatet e hetimeve të tyre në lidhje me masakrat ndaj shqiptarëve në Filat, gjatë muajit mars 1945, si dhe për të diskutuar rreth çështjeve të përgjithshme të kufirit greko-shqiptar. Së pari, major Sarandis pranoi se masakrat e muajit mars 1945 kishin ndodhur, por ai fajin ua la disa elementëve të ardhur nga Korfuzi. Për sa i përket numrit të të vrarëve, Sarandis pranoi një shifër afërsisht midis 60 deri në 70 shqiptarë. Ai, gjithashtu, tregoi edhe për aksionet pararendëse të ndërmarra nga grekët kundër minoritetit shqiptar. Duke pohuar se aksionet, posaçërisht ai i marsit të vitit 1945, ishin ndërmarrë të gjitha me urdhër të gjeneralit Zervas dhe autoriteteve të tjera, Serandis deklaroi se kjo ngjarje ishte shpagim ndaj shqiptarëve për bashkëpunimin e tyre me italianët dhe gjermanët kundër grekëve. Major Sarandis raportoi se gjeneral Zervas zotëronte dokumente në Athinë të lidhura me krimet e kryera, si nga pakica shqiptare, ashtu edhe nga andartët e tij. Komentet e Palmer-it rreth këtyre deklaratave janë si më poshtë: është e mundshme që pakica shqiptarë të ketë bashkëpunuar me italianët gjatë luftës së tyre me Greqinë dhe ky bashkëpunim të ketë ardhur nga dëshira për ta parë Çamërinë të përfshirë në një Shqipëri me kufij më të gjerë dhe nga mundësia që u ofrohej shqiptarëve për të shpëtim ndaj grekëve borxhet e vjetra të tyre. Gjithsesi, Palmer që shoqëronte Hodgson-in, mendonte se nuk ishte e mundur të arrihej në një përfundim se kush ka qenë fillimisht përgjegjës për nisjen e serisë së ballafaqimeve. Zonat ku minoriteti shqiptar jetoi deri në muajin dhjetor të vitit 1944, ishin: Filati, Paramithia, Margëlliçi, Igumenica, në fakt zonat më të pasura të Epirit. Palmer konstatoi se përherë ka pasur një ndjenjë urrejtjeje dhe smire prej anës së grekëve të kësaj zone kundër popullsisë shqiptare të Çamërisë, për shkak të pasurisë, bukurisë dhe begatisë së trojeve të tyre. Numri i popullsisë shqiptare i pretenduar nga shqiptarët për këtë zonë në vitin 1919, ishte rreth 54 000. Por shifra që Palmer mendonte se ishte më e sakta, është afërsisht mes 20 000 dhe 25 000. Siç duket, ai këtu nuk arrinte të dallonte popullsinë ortodokse shqiptare të Epirit, si të nacionalitetit shqiptar, popullsi që i shpëtoi në fakt masakrave, por që me kalimin e kohës do të vendosej nën presionin frikësues të mosdeklarimit për asnjë arsye të identitetit shqiptar të krishterë epirot. Palmer konstatonte se, gjatë pushtimit gjerman, sipas përllogaritjes së *Force 399*, numri i shqiptarëve që bashkëpunuan me ata ishte afërsisht mes 2 000 deri 3 000, ndërkohë që nga 400 deri 700 shqiptarë të Çamërisë kishin qenë të rreshtuar në radhët e ELAS-it, forcave nacionalçlirimtare

antifashiste. Kjo e fundit, do të duhej të ishte arsyeja pse përpjekjet e tyre ishin drejtuar më shumë kundër EDES-it, sesa kundër gjermanëve. Pasuesit grekë të EDES-it në krahinë kishin pësuar në fakt dëme, si nga ana e forcave shqiptare që ishin rreshtuar me gjermanët, ashtu edhe prej çetave shqiptare të ELAS-it. Sapo gjermanët u tërhoqën nga disa zona të pjesës veriore të Greqisë, duke lënë çamët prapa me disa udhëheqës, mbështetësit e EDES-it filluan të hakmerreshin. Ballafaqimet midis shqiptarëve dhe mbështetësve të EDES-it, u zhvilluan përgjatë gjithë verës së vitit 1944, me provokime nga të dyja palët, një situatë që në mënyrë të padyshimtë ishte nxitur dhe inkurajuar prej gjermanëve. Largimi i refugjatëve çamë drejt Shqipërisë, që kishte filluar gjatë verës së vitit 1944, u rrit në çerekun e fundit të vitit 1944. Në fund të vitit 1944 e gjithë pakica shqiptare myslimane në Greqi, me shumë pak përjashtime, kishte kaluar kufirin. Disa masa ishin marrë prej FNÇ-së në muajin janar 1945 për të inkurajuar çamët për t'u kthyer në Greqi, për shkak të një marrëveshjeje të arritur nga FNÇ-ja me EAM-in. EAM kishte marrë në këtë kohë kontrollin e Greqisë Veriperëndimore. Llogaritet që numri i çamëve të rikthyer në Greqi në këtë periudhë ka qenë ndërmjet 3 000 dhe 5 000. Ndërkohë, sulmet e datave 12 dhe 13 mars 1945 kishin ardhur për shkak të ndjenjave ekstreme antishqiptare të grekëve në këtë zonë, më shumë sesa si rezultat i ndonjë provokimi prej anës së vetë shqiptarëve. Pikërisht për shkak të këtij sulmi të fundit, edhe ata pak shqiptarë të kthyer në dhjetor të vitit 1944, u detyruan të largoheshin sërish drejt Shqipërisë dhe në fund të marsit dhe në fillim të prillit 1945 nuk kishte më këmbë shqiptari mysliman në Epirin e Jugut. Në rrethanat kur ende nuk ishte vendosur një kontroll i fortë qeveritar në zonën veriperëndimore të Greqisë, nuk ekzistonte asnjë shans për çamët të riktheheshin sërish në Çamëri.⁴⁴

Ekzistenca e një regjimi ushtarak shtypës në Shqipëri, që nuk kishte moral për të mbrojtur shqiptarët që persekutoheshin, ua lehtësoi punën qarqeve ushtarake greke për mbylljen e rrugëve të kthimit të garantuar të të përndjekurve në shtëpitë e veta në Thesproti.

Pas mbledhjes së të dhënave, gjeneral brigadieri Hodgson që drejtonte ekspeditën, bëri këto komente mbi raportin kryesor: ai mendonte se sapo të vendoseshin disa shkallë kontrolli në zonë, duhej të kryhej një

⁴⁴ *Po aty*, FO 371.48094, R 8331/544/90. Raport nga nënkoloneli C.A.S, Palmer mbi vizitën në Greqinë e Veriut, 9-14 prill 1945.

investigim i plotë mbi ngjarjet e marsit 1945 në Çamëri. Hodgson frikësohej se derisa Hoxha të merrte siguri që çamët mund të ktheheshin në tokat dhe pronat e tyre, ai do të ndërmernte kundërmasa ndaj minoritetit grek në Shqipëri. Ky dyshim mund të ishte i logjikshëm në pikëpamje të arsytimit të thjeshtë në rrethanat ballkanike, por diktatori i ri i Shqipërisë nuk kishte dhënë asnjë shenjë, as nuk kishte bërë ndonjë kërcënim për akte të tilla hakmarrëse. Në radhë të parë kjo dilte jashtë interesit të Hoxhës, i cili nuk donte të rriste armiqtësinë ndaj regjimit të tij të pakonsoliduar. Por kjo mundësi hipotetike e parashikuar nga Hodgson ishte edhe jashtë kuadrit të atmosferës së krijuar në Shqipëri për shtetasit shqiptarë me prejardhje greke, që kishin gëzuar të drejta të plota në Shqipëri, madje më shumë sesa popullsitë e tjera të krishtera në veri të këtij vendi, të vendosura nën represionin e regjimit komunist. Qëndrimi i pandjeshëm i Enver Hoxhës ndaj çështjes së Çamërisë, nga ana tjetër, ishte i lidhur edhe me pasiguritë e diktatorit të ri për pushtetin e vet ende të pakonsoliduar. Gjithsesi, Hodgson propozoi krijimin e një delegacioni të çamëve në Shqipëri, delegacion që do ta paraqiste çështjen e tyre pranë çdo komisioni hetimi, që do të mund të krijohej në të ardhmen (nuk u krijua kurrë në fakt). Propozimi tjetër kishte të bënte me qeverinë greke, e cila sapo të vendosej në kontroll të territorit, duhej të jepte siguri se çamët do të mirëpriteshin për t'u rikthyer në vendin e tyre. Hodgson sqaronte se, sapo të përmirësoheshin marrëdhëniet dhe sa më shpejt të vendosej kontrolli dhe siguria e territorit, aq më pak shanse për incidente të ngjashme do të kishte. I fundit fare ndër propozimet, ishte ai për shkëmbimin e popullsisë, si një alternativë zgjidhjeje. Nuk ekzistonte më në Greqi një minoritet shqiptar mysliman. Sipas propozimit të Hodgson-it, një numër grekësh nga Shqipëria mund të dërgoheshin në Greqi për të zënë fshatrat e boshatisura prej shqiptarëve, duke ua dhënë pronat dhe pasuritë e tyre në Shqipëri në shkëmbim popullsisë së ardhur prej krahinës çame.⁴⁵ Por kjo nuk përbënte një opsion në kodet shqiptare ndërkomunitare në shtet, përveç vështirësive të tjera që krijoheshin dhe pabarazisë së pasurisë që vendosej në shkëmbim. Ishte një model i cili kishte funksionuar përherë mes Greqisë dhe Turqisë, në kurritz të shqiptarëve, por një qasje e tillë e zgjidhjes së konflikteve nuk mund të funksiononte në Shqipëri, për shkak të një tradite të mosprekjes së jetës së

⁴⁵ *Po aty*, FO 371.48094, R 8331/544/90. Misioni Ushtarak Britanik në Shqipëri, D.K.P Hodgson, brigadier komandues i Misionit Ushtarak Britanik në Shqipëri, 18 prill 1945.

fqinjit dhe për faktin që minoriteti grek i Shqipërisë, intelektualët e tij kishin qenë përherë të integruar me dinjitet dhe barazi në jetën zyrtare të Tiranës.⁴⁶

*Indiferenca e diplomatëve britanikë ndaj çështjes
së persekutimit të popullsisë shqiptare myslimane
në Epirin e Jugut*

Në FO, Leeper* i analizoi të dyja raportet e përgatitura gjegjësisht nga Palmer dhe Hodgson. Ai konstatoi se nuk kishte virtualisht më asnjë çam në anën tjetër të kufirit grek dhe meqenëse ata tashmë ishin në Shqipëri, nuk kishte më mundësi për incidente. Duke qenë se për të bërë një hetim të plotë duhej të kalonin edhe shumë muaj, ai propozoi që do të ishte në interesin e përgjithshëm të Britanisë që çështja të lihej e fjetur.⁴⁷ Si gjithnjë, Leeper ishte në një pozicion të plotë favorizues ndaj Greqisë dhe si përherë shumë pak i ndjeshëm ndaj shqiptarëve, pavarësisht se në këtë rast bëhej fjalë edhe për gjenocid dhe për shpërngulje me forcë të popullatës civile. Ndërkohë që Leeper ishte kundër dhënies së garancive për qeverinë shqiptare dhe kundër mundësisë që qeveria britanike të kujdesej që shqiptarët e Çamërisë të lejoheshin për t'u kthyer në Greqi, A. D. Smith, një tjetër zyrtar i lartë i FO-së, mendonte se ky problem do të duhej të ishte objekt shqyrtimi i drejtpërdrejtë ndërmjet qeverisë greke dhe asaj shqiptare.⁴⁸ Britanikët llogarisin që nga rreth 35 000 shqiptarë të Çamërisë të besimit islam [saktësim imi – R. G.] sa ishte popullsia para Luftës së Dytë Botërore, në territorin e shtetit shqiptar kishin arritur të hynin 18 000, pjesa tjetër llogaritej që nuk kishte arritur t'i mbijetonte luftës dhe gjenocidit të EDES-it dhe forcave ushtarake të qeverisë së gjeneralit Plastiras.⁴⁹ Pas gjenocidit ndaj popullsisë së Çamërisë, në

⁴⁶ Shih më hollësisht për këtë: Boçi, *Minoritetet në Shqipëri* 146-166; Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar*, 143-151, 188-194.

* **Sir Reginald Leeper** ishte diplomat britanik i karrierës. Në fillim të Luftës së Dytë Botërore ai u bë drejtor i Departamentit të Inteligjencës Politike dhe nga viti 1943-1946 ambasador britanik pranë qeverisë greke në emigracion. Ai ka luajtur një rol kyç në zhvillimet politike greke në fund të luftës dhe në vitet e luftës civile, duke qenë një mbështetës i forcave monarkiste.

⁴⁷ TNA, FO 371.48094, R 8331/544/90. Shënime të datës 10 maj 1945 nga Leeper.

⁴⁸ Po aty, FO 371.48094, R 8331/544/90. Shënime të datës 23 maj 1945 nga A.D. Smith.

⁴⁹ Po aty, FO 371.48094, R 7709/544/90. Notë mbi bisedën me nënkolonelin Palmer, Misioni Ushtarak Britanik në Shqipëri, 13 prill 1945, nënshkruar nga D.W.S. Hunter.

qytetin e Filatit arritën të mbijetonin vetëm 15 familje çame dhe 5 të tjera ia dolën të zhvendoseshin për në Korfuz. Pjesa tjetër e popullsisë nga Thesprotia, gjegjësisht lugina e Paramithisë, qyteti i Margëlliçit, Filati dhe praktikisht nga e gjithë zona e njohur në greqisht si e Fanarit, shqiptarët myslimanë, ose u shfarosën nga popullsia greke e këtyre anëve me ndihmën e ushtrisë, ose kërkuan strehim në Shqipëri.⁵⁰

Autoritetet greke, respektivisht Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë greke, urdhëroi një të ashtuquajtur investigim, përmes të cilit u mundua të justifikonte aksionin e spastrimit etnik. Përfundimi i arritur nga ky investigim i njëanshëm i ushtrisë është se akuzat shqiptare për gjenocid ndaj çamëve, ishin të pabazuara. Përmes ambasadës mbretërore të Greqisë në Londër, në FO janë paraqitur dy dokumente justifikuese të përgjigjes së ashpër greke: 1. një e ashtuquajtur qarkore e Komandës së Çamërisë që jep drejtimet e operacioneve, që mban datën 10 korrik 1944 dhe është e firmosur nga Moulla Emin, Nuri Dino dhe Vehib Huto;⁵¹ 2. një raport nga

⁵⁰ Po aty, FO 371.48094, R 7709/544/90. Minoriteti shqiptar në Thesproti, P.M.M. Payne, 18.04.1945.

⁵¹ Po aty, FO 371.48094, R 20573/544/90. *Circular, Tsamouria Command, Direction of Operation. Further to the previous orders, we lay stress on the following points which must be carried out as precisely as possible: 1. The Tsamouria front facing Zervas forces is divided into four sectors a) Arpista- Margariti; b) Margariti –Kortessi; c) Kortessi-Nikolitsi; d) Nikolitsi-Panaghia. 2. In the rear, the secondary centers are arranged as follows: Arpista-Vole-Vrachona and Gropa tou Koutsi with center at Arvenitsa; Tsouri-Liaourati-Margariti-Vrastova-Smokovina-Mourtos-Masrek with center at Marsek; Glombotsari-Sarati-Zounosati-Selitsa-Vresta and Grechochori with center (seat) at Grechochori; Dornitsa-Semeritsa-Kokonia ... Bedelenia-Vratila-Vorfania-Soulessi and Kastrou with center at Vorfania. 3. In each Centre of the rear there shall be an Administration which will be concerned with the following tasks: a. to send continuous reinforcements of the front; b) to see that the needs of the troops at the front are duly satisfied; c. to render the necessary assistance to displaced emigrated families. 4 The chief of each command will wield all power and any armed person found in the rear must obey him blindly, otherwise he will be arrested, disarmed and sent to the court-martial which has absolute jurisdiction and can impose on him the death sentence. 5 The chiefs of the Commands (Comitadji) are personally responsible for any failure to carry out the above points. 6 In this sacred struggle of Tsamouria personal friendships as well as every family bond must be set aside and everyone must unreservedly pledge himself to the service of the fatherland, our honor and the salvation of Tsamouria. 7 The execution of every order will bring about the complete success of our purpose, whilst, on the contrary, non-execution will bring disaster. We have resolved to succeed at all cost, TSAMOURIA, 10 July, 1944, the command of the Centre of Grechochori, 1 Moulla Emin 2 Nouri 3 Veib Honto, signed Nouri Dino.*

Komisioni i Hetimit, i drejtuar nga lejtënant kolonel Vassili Papayannis, komandant i Batalionit 164 të Gardës Kombëtare të Greqisë, realizuar më datë 14 korrik 1945, që nxjerr të pafajshëm autorët e akuzuar të masakrës së 12-13 marsit 1945 në Filat, Zoes Pantazis dhe Christo Katsios.⁵² Ky është versioni i cili, që nga ajo kohë e deri më sot, vazhdon t'i përmbahet pa ndërprerje shteti grek dhe të gjitha qeveritë e këtij vendi, pavarësisht kahut politik. Këto institucione të vendit fqinj me Shqipërinë, nuk paraqitën asnjëherë reflektim të arsyeshëm dhe distancim nga ndëshkuesit hakmarrës ndaj nënshtetasve të Greqisë të nacionalitetit shqiptar, fëmijëve, grave, pleqve dhe familjeve të pambrojtura që s'kishin të bënin me kolaboracionizmin e pretenduar të pak individëve të parësisë së Çamërisë, që edhe ai është i nevojshëm të lexohet i pashkëputur nga historia pararendëse e trajtimit të shqiptarëve mes dy luftërave dhe njëlloj me leximet e vlerësimet që kryejnë shtetet serioze të perëndimizueme për rastet e ngjashme të bashkëpunimit të elitave të minoriteteve të shtypura.

Raporti i Woodhouse-it

Kaluan disa muaj nga zhvendosja përfundimtare e popullsisë shqiptare nga Kaonia e Jugut dhe Thesprotia dhe më 16 tetor 1945, koloneli britanik Woodhouse përgatiti një raport shënues të shkurtër mbi çamët, përmbajtja e të cilit, sipas gjykimit tonë, është njollosëse edhe për Misionin Aleat në Greqi të drejtuar nga koloneli i lartpërmendur. Woodhouse pranon dhe justifikon njëkohësisht, se Zerva, i inkurajuar prej Misionit Aleat të drejtuar nga ai vetë, i nxori jashtë çamët prej shtëpive të

⁵² *Po aty*, FO 371.48094, R 20573/544/90, f. 142. Vasili Papayannis ka intervistuar në lidhje me ngjarjet, të cilat ai i vendos nga data 12 deri më 18 mars 1945, që shënojnë disa prej krimeve më të rënda kundër elementëve myslimanë të Thesprotisë, në rajonin e Filatit, ku 60 deri në 70 persona janë ekzekutuar dhe janë kryer akte sistematike të plaçkitjeve, përdhunimeve dhe veprave të tjera penale. Qëllimi i hetimit ishte, që të shqyrtonte, nëse këto vepra ishin kryer ose jo nga bandat e drejtuara nga Zoes Pantazis dhe Christo Katsios. Për këtë janë pyetur dëshmitarët: Hadza Latif, banor i Tricoforio – Filat, Vassili Stroungari banor i Filatit, Eleftherio Venetis – Filat, Petro Stroungami – Filat, Petro Elia – Filat, Nicholas Goulas – Filat, Spyridon Zafiris – Filat, Christo Athanassiou – Filat, Timoleon Vasdaki – Filat, Gregory Kotsos – Filat, dhe pas shqyrtimit të dëshmive të të akuzuarve drejtpërdrejt, Zoes Pantazis banor i Parapotamo të Thesprotisë, Christo Katsio banor i Palaiochori (Filat). Raporti është një përpjekje për të klasifikuar në bllok popullsinë shqiptare myslimane, si përgjegjëse për bashkëpunimin me fashistët dhe një orvatje për të shfajësuar dy të akuzuarit nga pjesëmarrja në masakrën e ndodhur në periudhën nga data 12 deri më 18 mars 1945.

tyre më 1944, me qëllim që të lehtësonte operacionet kundër armikut. Ai pranon se dëbimi nga Greqia ishte kryer në mënyrë të përgjakshme për shkak të shpirtit të hakmarrjes, i cili ishte ushqyer, sipas Woodhouse-it, prej brutaliteteve të kryera prej çamëve në bashkëpunim me italianët. Sipas tij, vepra e Zervës u plotësua përmes masakrimit të pafalshëm të çamëve të Filatit në mars 1945, kryer prej mbetjeve të forcave të shpërndara të tij, të komanduara nga një oficer i thirrur Zotos, i cili më vonë, pas masakrës, shërbeu si oficer në Shtabin e Përgjithshëm të Komandës së Lartë të Epirit, në Janinë, të cilin Woodhouse e kishte takuar personalisht në muajin korrik 1945. Pra, siç shihet, masakruesit kishin pasur edhe bekimin e shpërblimin e autoriteteve më të larta politike e ushtarake greke, si dhe heshtjen apo edhe lejimin e misionit ushtarak aleat në atë krahinë. Masakra ndikoi që në muajin korrik 1945, zonat e Filatit dhe të Paramithisë të ishin gati 100% të religjionit ortodoks, të unifikoheshin arbitrarisht si greke, pasi metodat e përdorura nga Zerva qenë shumë të ashpra dhe oficerët e tij kishin dalë jashtë kontrollit. Ata arritën ta zhvendosnin tërë popullsinë dhe ta pastronin tokën greke nga një minoritet i padëshirueshëm për helenët.⁵³

Rëndësi të posaçme për saktësinë e analizës merr Memorandumi i anëtarëve të Presidiumit të Kongresit çam (Taho Sejko, Kasëm Demi, Mamo Habib, Vehab Demi etj.), të cilët, të mbledhur më 23 shtator 1945 në Vlorë të Shqipërisë, ia drejtuan Kryesisë së Konferencës së Ministrave të Jashtëm të Aleatëve në Londër.⁵⁴ Nga ky dokument ne mësojmë versionin shqiptar për dy tragjeditë e para, atë të Paramithisë dhe atë të Filatit, gjegjësisht të ndodhura në muajin qershor 1944 dhe tetor 1944, të cilat lanë pas 2 000 kufoma, gra, fëmijë, pleq dhe burra të paarmatosur, të masakruar shtazërisht nga banditët fashistë të Greqisë së fundit të Luftës së Dytë Botërore. Këto masakra ishin vetëm dy nga qindra ngjarje tragjike të ndodhura në tre vitet e përgjakshme të Luftës së Dytë Botërore në Epirin e Jugut që shkaktuan emigrimin e gjithë popullatës së Çamërisë, që lanë atje vetëm viktimat dhe pasuritë e tyre. Presidiumi i kongresit, bazuar në parimet e luftës kundër agresorëve fashistë dhe në Kartën e Atlantikut, konstatonte se e tërë përgjegjësia e këtyre masakrave dhe e çnderimeve binte mbi organizatën EDES, që përkrahej nga qeveria e Athinës së asaj

⁵³ Po aty, FO 371.48094, R 18138/544/90. Notë mbi çamët, C.M. Woodhouse, 16 tetor 1945.

⁵⁴ Po aty, FO 371.48094, R 17516/544/90. Memorandum drejtuar Presidencës së Konferencës së Ministrave të Jashtëm Aleatë, 6 tetor 1945.

kohe. Prandaj anëtarët e këtij kongresi i kërkonin Konferencës së Ministrave të Jashtëm të vendeve aleate: 1. dënimin e kriminelëve shovinistë grekë, të cilët shkaktuan vdekjen e një pjese të madhe të popullit minoritar shqiptar në Greqi; 2. kthimin e popullit çam në vatrat e tyre; 3. sigurimin e të drejtave të barabarta me gjithë pjesën tjetër të popullit grek, ashtu siç ato të drejta i gëzonte minoriteti grek në Shqipëri. Memorandumi vendos në dukje edhe kontekstin historik, politik dhe ushtarak kur ndodhën masakrat. Aty përcaktohet se masakrat barbare, grabitjet dhe çnderimet shtazarake kishin ndodhur ndërkohë që luftëtarët e minoritetit shqiptar në Greqi ishin të inkuadruar me forcat e rezistencës të Greqisë dhe po luftonin ashpërsisht kundër okupatorit gjerman. Pikërisht në atë kohë forcat shoviniste të Zervas-it, të komanduara personalisht prej tij, kishin hyrë pabesisht nëpër qytetet dhe fshatrat e Çamërisë duke përsëritur barbarizmat e vitit 1912.⁵⁵

Si e kanë argumentuar autoritetet greke qëndrimin e tyre?

Ekzistojnë një numër dokumentesh, por të një rëndësie të veçantë në bllokimin e kthimit të çamëve në Greqi janë së paku dy prej tyre të hartuara në Londër, nga ambasada e Greqisë atje. Letra e datës 4 dhjetor 1945, e shoqëruar me së paku dy dokumente të pretenduara, paraqet si provë të bashkëpunimit urdhrin e “Drejtimeve të Operacioneve” të përdorur nga “Komanda e Çamërisë”, të paraqitur më lart në këtë punim, që është i datës 10 korrik 1944, ndërkohë që në të vërtetë, masakrat greke kishin filluar së paku një muaj më parë, në qershor të vitit 1944. Urdhrat e “Drejtimeve të Operacioneve” të “Komandës së Çamërisë”, sipas ambasadës greke, ishin gjetur në trupin e Vehib Hutos, komandantit çam të vrarë në përplasjen e armatosur që ndodhi në Makryhora, më datë 4 gusht 1944, mes gjermanëve që bashkëpunonin me çamët myslimanë dhe forcave të gjeneralit Zervas. Më tej, në letrën e ambasadës thuhet se Nuri Dino, i cili kishte nënshkruar urdhrin, kishte qenë një vegël e Italisë fashiste dhe një armik i betuar i Greqisë. Familja e tij kishte qenë me mjaft ndikim mes popullsisë shqiptare myslimane të Thesprotisë. Përgjatë gjithë periudhës së luftës, ai akuzohej se kishte qenë në shërbim të Fuqive të Boshtit. Shumë shpejt pas shpalljes së bashkimit italo-shqiptar në maj të vitit 1939, Nuri Dino u caktua nga sekretari italian i Partisë Fashiste në

⁵⁵ Po aty.

Tiranë. Kur Italia sulmoi Greqinë, ai pretendohet se komandoi një batalion të Çamërisë që bashkëpunoi me italianët, invadoi territorin grek dhe kreu, sipas tyre, krime nga më të neveritshme dhe të ndyra kundër popullsisë greke të Thesprotisë. Pas pushtimit të Greqisë, ai u vendos në Athinë, ku së bashku me kushëririn e tij Xhemil Dino, mbeti në kontakt shumë të ngushtë me italianët. Ndërkohë, për mbështetjen e akuzës së bashkëpunimit të Xhemil Dinos, ambasada greke përdorte dëshminë e Jakomonit gjatë gjyqit që iu bë në vitin 1945 në Romë, se Xhemil Dino kishte qenë agjenti i tij në Athinë, i cili e kishte mbështetur atë me të gjithë llojet e informacionit rreth Çamërisë. Gjithashtu, Nuri Dino, së bashku me kushëririn e tij Masar Dino, akuzoheshin nga autoritetet greke, se me kërkesën e italianëve kishin organizuar banda të armatosura të çamëve myslimanë, të cilët plaçkitën Epirin përgjatë gjithë kohës së pushtimit. Pas kapitullimit të Italisë, Nuri Dino dhe çetat nën komandën e tij, u vunë në shërbim të gjermanëve dhe morën pjesë në operacionet kundër “patriotëve” grekë të gjeneralit Zervas, i cili sipas autoriteteve greke kishte luftuar pushtuesit,⁵⁶ por që ne na rezulton në të gjitha manualët se ka qenë në marrëveshje armëpushimi me gjermanët në Epir, nga muaji shtator 1943.

Letra e dytë me akuza e ambasadës greke në Londër i përket datës 11 dhjetor 1945. Akuzat bazohen në fillësë mbi deponimet e Jakomonit në gjyqin që po i zhvillohej në Romë, vërtetësinë e të cilave nuk kemi pasur mundësinë ta provojmë me dokumentet autentike të drejtësisë italiane.⁵⁷ Më pas, ajo letër merret me aktivitetin kryesor të çamëve, në të mirë të vendeve të Boshtit, menjëherë pas pushtimit të Greqisë prej Gjermanisë dhe Italisë, nga muaji prill 1941. Sërish në këtë komunikim përdoret urdhri i Nuri Dinos, i datës 10 korrik 1944, një muaj pas fillimit

⁵⁶ *Po aty*, FO 371.48094, R 20573/544/90. J. Romanos nga ambasada e Mbretërisë së Greqisë në Londër për Laskey-n në Foreign Office, Londër 4 dhjetor 1945, f. 138-139.

⁵⁷ *Po aty*, FO 371.48094, R 21040/544/90. Memorandum në lidhje me takimin e myslimanëve të Çamërisë mbajtur në Vlorë më 23 shtator, ambasada e Mbretërisë së Greqisë në Londër, 11 dhjetor 1945. Dëshmia e Jacomoni-t, sipas këtij memorandumi: “*My own personal recollection and the impression of all those who happened to be there during those days (of the assault on Greece), as well as the evidence furnished by photographs taken on the spot, all tend to show that not only was there no corruption by bribery, but also that the population of Tsamouria was full of enthusiasm during the advance of our troops. In March, 1940, Nouri Dino, e Tcham and Chieftain of Tsamouria, was authorized by Ciano to send arms to Greece. Nouri applied to me and I prevented the importation of arms into Greece*”.

të sulmeve ndaj popullsisë çame dhe pas masakrës së Paramithisë prej trupave të Zervas-it. Më tej, letra e ambasadës greke pretendon se në Athinë ekzistonte një listë me emra të autorëve çamë dhe të krimeve të kryera nga ata përgjatë gjithë periudhës së pushtimit kundër popullsisë së krishterë të Thesprotisë. Pretendohet për qindra banorë të krishterë të vrarë, fshatra të krishtera të plaçkitura dhe të bastisura. Letra e arsyeton largimin e çamëve drejt Shqipërisë, jo si rezultat i hakmarrjes së grekëve, por i frikës së tyre nga ndëshkimi për krimet e kryera më përpara, gjë që bie në kundërshtim me të vërtetën.⁵⁸

Në fakt, nuk mund të përjashtohen rastet e një revanshi dhe të krimeve të kryera nga personazhe të caktuara të botës minoritare shqiptare në Epirin e Jugut. Kemi të bëjmë me një indikator të një spiraleje dhune të filluar shumë herët, me pushtimin dhe masakrimin fillimisht të popullsisë shqiptare në Epir që nga vitet 1912-1913 dhe që vijoi me mohimin sistematik të të drejtave të tyre nën shtetin helen të periudhës mes Dy Luftërave Botërore. Ndërkohë, akuzat për pastrim të forcave të gjeneralit Zervas prej çamëve dhe bashkëpunimi i tyre me Gestapon, është një prej falsiteteve më të pabazuara që autoritetet zyrtare të Athinës ua ekspozonin (për fat të keq ua ekspozojnë me një errësim arkaik edhe sot zyrtarisht publikut) qeverisë britanike dhe vendeve të tjera fituese në luftë. Para largimit të gjermanëve nga Greqia, monarkistët dhe fashistët grekë, së bashku me Gestapon, kishin qenë në bashkëpunim të ngushtë mes tyre dhe masakrat e para ndaj çamëve janë bërë me bekimin e pushtuesve.⁵⁹ Bashkëpunimi tipik ose bashkëpunimi për mbijetesë, ose akomodimi me pushtuesit që u jepte të drejta të mohuara më përpara, i disa individëve nga Çamëria, nuk mund të shërbente në asnjë rast si alibi për shfarosjen dhe shpërnguljen e një popullsie të tërë nga trojet e tyre stërgjyshore, manipulimin e të dhënave, dhënien e një versioni antihistorik të përkundërt me vlerat europiane për 70 vjet me radhë pas ngjarjeve, nga ana e organeve shtetërore dhe përfaqësuese të Greqisë.

FO i United Kingdom (UK), përmes *Research Department* ka ndërtuar dhe përshtatur të freskuar, të vërtetën e vet mbi kufirin etnik greko-shqiptar. Ndër të tjera, në raportet e përmirësuara, shpjegohet

⁵⁸ *Po aty*, FO 371.48094, R 21040/544/90. Memorandum në lidhje me takimin e myslimanëve të Çamërisë mbajtur në Vlorë më 23 shtator, ambasada e Mbretërisë së Greqisë në Londër, 11 dhjetor 1945.

⁵⁹ *Po aty*, FO 371.48094, R 21489/544/90. Persekutimi grek i minoritetit shqiptar në Çamëri, nga Moska për Foreign Office, 26 dhjetor 1945.

historia e gjatë e kësaj vijëndarjeje dhe situata e popullsisë në të dyja anët e kufirit shqiptaro-grek në Epir kryesisht, ku, jo vetëm shtetet hasen, por edhe blloqet etnike gjegjëse ndërthuren dhe ortodoksia përkon dhe përbashkon në të dyja anët, nacionalitetet e veçanta, shqiptare dhe greke. Për sa i përket Epirit, ky departament përcakton se nën sundimin otoman, përpara se Greqia të bëhej një mbretëri e pavarur me një kufi që mbronte vetëm grekët etnikë, popullsia e gjithë krahinës së Epirit e ka konceptuar vetveten të ndarë në myslimanë dhe të krishterë, më shumë sesa në shqiptarë dhe grekë. Atëherë, sikurse edhe sot, shkruhet ndër të tjera në analizë, shumë shqiptarë ishin myslimanë, por ekzistonte edhe një minoritet shqiptar i të krishterëve ortodoksë, nën autoritetin kishtar të Patrikanës Ekumenike të Kostandinopojës. Kështu, në qoftë se një person i përkiste besimit mysliman në këtë krahinë, ekzistonte një supozim i besueshëm që ai ishte i nacionalitetit shqiptar, por në qoftë se ai ishte i krishterë, kjo nuk do të thoshte se ai domosdoshmërisht ishte grek. Madje, as gjuha nuk ishte/është një guidë e besueshme në këtë përcaktim. Kjo sepse nën sundimin otoman, të krishterët ortodoksë ishin njohur zakonisht si grekë, pasi gjuha greke ishte gjuha zyrtare e kishës ortodokse. Greqishtja u përdor zakonisht si gjuhë zyrtare edhe prej qeveritarëve turq, për tregti dhe për arsimim, në jug të lumit Kalamas. Gjuha shqipe nuk lejohej të përdorej, madje as prej banorëve të pastër etnikisht shqiptarë. Në vitin 1919, në jug të Linjës së Firences, pala shqiptare pretendonte se jetonin 40 000 shqiptarë myslimanë dhe 14 000 shqiptarë ortodoksë, vetëm në krahinën e Çamërisë. Kjo shifër, nga britanikët konsiderohej shumë e lartë. Në fakt, para Luftës së Dytë Botërore, shumë pak dihej rreth situatës reale, ndjenjave të popullsisë shqiptare në Çamëri. Kjo ishte situata në disa linja e gjendjes së popullsisë deri në vitin 1941, e marrë në linjën e hulumtimit të studiuesve të FO-së. Pyetjet që ne shtrojmë pas këtyre të dhënave janë: Çfarë të drejtash gëzonin shqiptarët në kuadrin e lirive të garantuara të minoriteteve, nën aktet ndërkombëtare dhe nën kuadrin e brendshëm konstitucional, në shtetin grek deri më 1941? Cili ishte numri i shkollave në gjuhën shqipe në prefekturën e Thesprotisë, nga viti 1913 deri në vitin 1941? Cilat ishin të drejtat e minoritetit të krishterë shqiptar në këtë krahinë? A ka pasur politika migratore nga ana e shtetit grek për zhvendosjen e shqiptarëve myslimanë drejt Turqisë, në periudhën mes Dy Luftërave Botërore? Dhe pyetja më kryesore: Një popull i shtypur pa asnjë të drejtë, për një hark kohor nga viti 1913-1941, a pritet të jetë një popull miqësor dhe një qytetar besnik i atij shteti, i cili e

ka shtypur për 30 vjet me radhë egërsisht? Unë besoj, me siguri në vetvete, që jo. Pushtimi italian në fakt i hapi paradoksalisht dritën e lirisë që nuk ekzistonte, për arsyet e veta, një populli të shtypur, të paarsimuar nën pengim emancipues, anipse nën sigla fashiste që popullsia nuk i kuptonte aspak. Frymëmarrja e lirë e popullsisë çame, pas dezintegrimit shtetëror të Greqisë në vitin 1941, mund të ishte një kurth për një jetë të qëndrueshme ndryshe, por faji në asnjë rast nuk mund t'u mbetej viktimave të dhunës, civilëve pa rol vendimmarrës, por orkestruesve të dhunës së para vitit 1941 dhe pas vitit 1941, që sidomos në këtë periudhë të dytë ishin të shumëngjyrshëm. Përzierja e përgjegjësisve nuk e ndihmon aspak kuptimin e së vërtetës dhe drejtësinë e një shteti demokratik.

Autoritetet greke, jo vetëm nuk dënuan vrasësit dhe deportuesit e EDES-it, por pas shpalljes së legjislacionit për procedurat penale kundër të gjithë bashkëpunëtorëve dhe kriminelëve të luftës, Gjykata Speciale e Bashkëpunëtorëve, në Janinë, në vitin 1945, dënoi në masë 1 930 nënshtetas grekë të nacionalitetit shqiptar, shumë prej tyre me dënim me vdekje, ndërsa në vitin 1946 edhe 179 të tjerë.⁶⁰ Çështja çame më 1945, kishte arritur në një pikë kritike: të vrarë, të nxjerrë jashtë nga shtëpitë dhe vatrat stërgjyshore, të zhdukur, të shpronësuar dhe pa perspektivë kthimi pjesa e mbetur, për 77 vjet me radhë deri më sot, kur po shkruajmë këto radhë. Kjo krijoi bazën e një kundërshtie, që në fakt nuk e kishte fillësën në vitet e Luftës së Dytë Botërore, por shumë më përpara, në agimin e krijimit të shtetit të copëtuar shqiptar më 1913-1914 dhe fillimit të procesit të nxjerrjes së sforcuar jashtë, të popullsisë kompakte shqiptare në atë krahinë shqiptare, që i mbeti shtetit grek nga ndarja e kufijve në Ballkan pas Luftërave Ballkanike. Refugjatët nga Çamëria në Shqipëri që në fillimin e mbërritjes së tyre në Shqipërinë e Vjetër, kanë shprehur dëshirën e tyre ndaj autoriteteve britanike për t'u kthyer në Greqi, në vatrat, shtëpitë dhe pronat e tyre. Ata kërkuan që ky kthim të ndodhte sa më shpejt që të ishte i mundshëm, por vetëm me kushtin që Aleatët të garantonin sigurinë e tyre, pasi ata nuk i besonin më Plastiras-it, i cili, njëlloj si Zervas, i goditi pabesisht për së dyti. Qeveria komuniste shqiptare, e izoluar nga bota, e frikësuar nga qëndrueshmëria e vet e brendshme dhe e jashtme, do ta mbante të ngrirë problemin çam dhe nuk do të interesohej fare, as për kthimin e tyre në vatrat shekullore dhe as për shkollimin e popullsisë ortodokse shqiptare të Çamërisë, për të drejtat e tyre minoritare, të barabarta

⁶⁰ Manta, "The Çams of Albania and the Greek State", 533.

me ato që gëzonte minoriteti grek në Shqipëri, që asnjëherë nuk pësoi persekutimin që pësuan shqiptarët e tjerë, nga komunistët shqiptarë nën diktaturë. Lufta e Ftohtë ngriu dhe e kaloi gati në harresë këtë çështje, ndërkohë që qeveritë e tranzicionit të rrëmuishëm parademokratik të pas vitit 1991 në Shqipëri, nuk arritën ta artikulonin asnjëherë qartë këtë problem mjaft të mprehtë të marrëdhënieve me shtetin fqinj. Çamëria dhe çamët u sakrifikuan dhe po sakrifikohen ende, për hir të ruajtjes të ca interesave më të mëdha, ndërkohë që interesi ndaj çështjes së tyre është i njëjlojtë dhe prioritar për nga rëndësia e ndërtimit të urave të vërteta dhe të sigjerta të aleancës strategjike. Dy vende europiane, si Shqipëria ashtu edhe Greqia, duhet të gjejnë forcën sot për ta parë të vërtetën me sy dhe për të korrigjuar gabimet e së kaluarës.

Është pra, edhe historia e një padrejtësie të heshtur në historinë bashkëkohore, që ndryshoi panoramën religjioze, nacionale dhe pronësore në Epirin e Jugut për 80 vjet, duke pranuar se periudha e pas Luftës së Ftohtë nuk ka sjellë ndryshime thelbësore të parametrave të lirisë për palën më të interesuar, subjekt i mohimit të të drejtave, pasardhësit e popullsisë së zhvendosur përdhunisht. Mohimi dhe heshtja e të drejtave civile dhe kulturore për një kohë kaq të gjatë u lehtësua nga ekzistenca e një shteti shqiptar të mbyllur diktatorial, që mohonte çdo të drejtë të brendshme qytetare në shtetin amë dhe për rrjedhojë me një autoritet të rrënuar në arenën ndërkombëtare, ku fjalë nuk i kishte gratë. Nga ana tjetër, drama e popullsisë shqiptare myslimane në Epirin e Jugut u pasua nga një dramë tjetër po aq e padrejtë, që është denacionalizimi gradual dhe i heshtur i popullsisë shqiptare të krishterë në po të njëjtën anë, që jeton, por humbet mjaft nga tradita origjinale epirote dhe arbnore e Çamërisë.

Burime dhe bibliografi:

Arkiva:

Arkivi i Institutit të Historisë (AIH)

- Fondi i Arkivit të Vjenës – *Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien (HHSt.A.PA.A.)*

The National Archives, London (TNA)

Churchill Archive online (www.churchillarchive.com): David Woolner, The birth of the Anglo-American 'Special Relationship', Roosevelt Institute, 2002

Wilson Center, Digital Archive, International History Declassified,
<http://digitalarchive.wilsoncenter.org/document/123187>, “Record of
 Meeting at the Kremlin, Moscow on 10 October 1944, at 7 p.m.,”
 October 10, 1944, History and Public Policy Program Digital Archive,
 Public Record Office.

Botime dokumentare:

Përmbledhje dokumentesh nga Fondi i Komandës Gjermane, 1940-1944.
 Buletini Arkivor Ushtarak. Tiranë: 2017.

Literaturë historiografike:

Basciani, Alberto. *L'impero dei Balcani, L'occupazione italiana dell'Albania (1939-1943)*. Roma: Viella, 2022.

Meta, Beqir. *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri (1912-1924)*.
 Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë:
 Kristalina-KH, 2013.

“Çetat nacionaliste Greke dhunojnë tanësinë shqiptare dhe mobilizojnë
 popullsinë përdhunisht”. Në gazetën *Bashkimi i Kombit*, e mërkurë,
 6.09.1944.

Kousoulas, D. George. “The Greek Communists Tried Three Times and Failed”.
 Në *The Anatomy of Communist Takeovers*. Edited by Thomas T.
 Hammond & Robert Farrell. New Haven and London: Yale University
 Press, 1976.

Rodogno, Davide. *Il Nuovo Ordine Mediterraneo, Le politiche di occupazione
 dell'Italia fascista in Europa (1940-1943)*. Torino: Bollati
 Boringhieri, 2003.

Manta, Eleftheria K. “The Çams of Albania and the Greek State (1923-1945)”.
 Në *Journal of Muslim Minority Affairs*, 29:4 (15 December 2009).

Vlavianos, Haris. *Greece, 1941-49: From Resistance to Civil War (The Strategy
 of the Greek Communist Party)*. New York: Palgrave Macmillan,
 1992.

Gurakuqi, Romeo. *Principata e Shqipërisë dhe Mbretëria e Greqisë*. Tiranë:
 UET Press, 2011.

Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria 1911-1914*. Tiranë: UET Press, 2012.

Gurakuqi, Romeo. *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas Luftës së Parë Botërore
 (1 nëntor 1918 – 9 nëntor 1921)*. *Statusi, kufijtë dhe rindërtimi
 shtetëror*. Tiranë: UET Press, 2013.

Boçi, Sonila. *Minoritetet në Shqipëri midis identitetit dhe integritetit 1939-1949*.
 Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë:
 Kristalina, 2012.

Churchill, Winston S. *The Second World War*, Vol.6 Triumph and Tragedy. Boston: Houghton Mifflin, 1976.

ROMEO GURAKUQI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

romeo_gurakuqi@hotmail.com

romeo.gurakuqi@asa.edu.al

S u m m a r y

OFFICIAL BRITISH TESTIMONY ON THE TRAGEDY OF THE ALBANIAN POPULATION
IN THE SOUTHERN EPIR DURING 1944-1945

This paper aims to explore the final events of World War II in Chameria, Southern Epirus, with a focus on the withdrawal of German forces and the ethnic cleansing that occurred during this period, as detailed primarily through British sources. The region, which became part of Greece after the border delineations of 1913 and 1921, experienced intense political and military instability from 1941 to 1944 due to the Italo-Greek War and changing military controls. The paper also reviews the history of the Albanian-Greek border, highlighting the natural boundaries of Southern Epirus, or "Natural Albania of the South."

The author, through pioneering archival research, uncovers the events in Chameria from mid-1944 to 1945, revealing the first detailed account of an ethnic cleansing motivated by religious differences. This cleansing, which began with the division of the region in 1913, intensified through several waves over the years and reached its tragic conclusion during the final year of WWII. The author argues that the displacement, persecution, and mass killings of Muslim Albanians were influenced by the chaotic Greek Civil War, British inaction, and complex regional dynamics.

The study further highlights how the Cold War entrenched a division between Albania and Greece, symbolized by the Iron Curtain, which separated the two countries' populations. Muslim Albanians were forcibly displaced, and their rights have been denied for decades, while the remaining Christian Albanians faced a gradual loss of identity. This historical injustice, often overlooked, reshaped the religious, national, and cultural landscape of Southern Epirus and continues to impact the region today.

...vijon nga numri i kaluar 2023/2

GJON BORIÇI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

gjon.borici@asa.edu.al

<https://doi.org/10.61773/2wf3ay44>

NJË VËSHTRIM NË TERMA POLITIKO-EKONOMIKË NDËRMJET SHQIPËRISË DHE JUGOSLLAVISË NË PERIUDHËN 1945-1949 (Pjesa e tretë, prill – shtator 1948)

Abstrakt:

Pjesa e tretë e artikullit studimor mbi çështjet ekonomiko-politike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, përqendrohet më së shumti tek elementët e krizës në marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Për shumë kohë është folur e shkruar se shkaku i vërtetë i acarimit shqiptaro-jugosllav është ai ideologjik, por mendoj se ishte thellësisht ekonomik pas acarimit sovjeto-jugosllav për të njëjtat arsye. Rrënjët e kësaj krize filluan me acarimin Tito-Stalin që në fund të vitit 1947, duke u thelluar gjithnjë e më shumë në tre muajt e parë të vitit 1948. Presidenti i Jugosllavisë, Tito, nuk dëshironte më që Bashkimi Sovjetik të kishte një pozitë të privilegjuar ekonomike dhe rrjedhimisht politike në vendin e tij duke rritur në kulm përplasjet ndërmjet dy vendeve. Duke qenë se lideri sovjetik Stalin nuk dëshironte të shihej në sytë e botës si një kapitalist i fshehtë dhe për të ruajtur staturën e tij prej marksist-leninisti puritan, e akuzoi hapur në emër të Informbyrosë Titon dhe Partinë Komuniste Jugosllave (PKJ) si thelbësisht antimarksiste dhe antisocialiste duke i etiketuar si tradhtarë. Duke marrë shkas nga fjalët e rënda të Stalinit ndaj Titos dhe Jugosllavisë dhe duke qenë i ndërgjegjshëm për situatën e rëndë të varësisë ekonomike që kishte Shqipëria ndaj Jugosllavisë, edhe Enver Hoxha nuk hezitoi për asnjë moment që të rreshtohet pa asnjë mëdyshje në krah të Bashkimit Sovjetik, duke iu bashkuar "korit" të vendeve komuniste që e etiketuan si tradhtarë PKJ-në. Edhe kjo pjesë e studimit është mbështetur në dokumente të shumta arkivore, ku jo pak prej tyre prezantohen për herë të parë, si dhe në literaturën bashkëkohore ndërkombëtare. Metodologjia e përdorur në këtë artikull është analitike-krahasuese për të hedhur dritë në njërën prej

periudhave më thelbësore të fillimit të konsolidimit të regjimit komunist në Shqipëri.

Fjalë kyçe:

Shqipëri, Jugosllavi, Stalin, acarim, ekonomi, borxhe.

Hyrje

Në fillim të vitit 1948, koncepti i ndërtimit të socializmit nga një vend i vetëm do të sillte në qendër të vëmendjes rolin që duhej të kishte shteti në këtë proces kur tashmë bota ishte ndarë në dy blloqe kundërshtarë me modele të ndryshme politike dhe mbi të gjitha ekonomike.¹ Jugosllavia e mareshalit Tito, doli pararojë në përpjekjen për të zgjidhur këtë dilemë dhe për të treguar edhe një lloj pavarësie ekonomike dhe rrjedhimisht ideologjike ndaj Bashkimit Sovjetik (BS). Deri në fund të vitit 1947, vendi lider i komunizmit botëror ishte i pasfidueshëm brenda kampit që kishte krijuar vetë dhe me një prestigj në rritje në arenën ndërkombëtare. Në këtë dilemë të rrugës së ndërtimit të socializmit prej Jugosllavisë dhe forcës politike – Partisë Komuniste Jugosllave që e drejtonte atë kishte edhe një problem tjetër; atë të kombësive të ndryshme që përbënin Federatën Jugosllave. Nëse acarimi me BS-në dilte jashtë kontrollit të PKJ-së, pa dyshim do të kishte turbullira të forta brenda kombësive të ndryshme në Jugosllavi, çka mund të thoshte edhe shpërbërje e saj (Jugosllavisë). Për shumë vjet, acarimi jugosllavo-sovjetik i vitit 1948 është quajtur ideologjik dhe në fjalët e Eduard Kardelit "ishin zhvilluar dy pikëpamje ndërmjet nesh dhe rusëve për sa i përkiste çështjes së zhvillimit të socializmit; ose socializmi do të zhvillohej nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet popujve të barabartë ose nëpërmjet ekspansionit të BS-së siç do të dëshironin rusët".²

Nën dritën e hulumtimeve të reja arkivore dhe të studimit më të kujdesshëm të literaturës shkencore bashkëkohore ndërkombëtare, teza se acarimi Tito-Stalin i vitit 1948 ishte vetëm mbi baza ideologjike, për mendimin tim, nuk qëndron. Ideologjia u përdor për të fshehur arsyet e

¹ Hilde Katrine Haug, *Creating a Socialist Yugoslavia; Tito, communist leadership and the national question* (New York: I.B. Tauris, 2012), 125.

² Po aty.

vërteta të acarimit mes dy vendeve, respektivisht ndërmjet dy udhëheqësve, fakt që u pranua edhe nga Koçi Xoxe në njërën nga mbledhjet e Byrosë Politike për të cilën kam folur gjerësisht më poshtë. Nëpërmjet argumenteve thellësisht të mbështetura në burime primare arkivore dhe të literaturës më të fundit bashkëkohore shkencore ndërkombëtare, do të argumentoj tezën time në këtë pjesë të tretë të artikullit studimor mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave se, ishin pikërisht mosmarrëveshjet ekonomike ndërmjet Jugosllavisë dhe BS-së që çuan në acarimin ndërmjet tyre dhe se do të ishte pikërisht ky acarim që do të shpëtonte Shqipërinë nga tutela e varësisë ekonomike dhe rrjedhimisht politike prej shtetit fqinj verior. Pjesa e tretë e këtij artikulli shkencor është totalisht e mbështetur në burime autentike arkivore shqiptare dhe në literaturën më të fundit ndërkombëtare për të vërtetuar, sipas mendimit tim të mbështetur në këto burime, se ishin arsyet më së shumti ekonomike që çuan fillimisht në çarjen e marrëdhënieve Tito-Stalin, por që u mbajtën të fshehta për atë kohë duke i veshur acarimit Jugosllavi-BS një petk ideologjik. Megjithatë, duke mos pasur akses në burimet arkivore në Moskë dhe Beograd, diskutimin lidhur me këtë çështje të ndjeshme në një nga periudhat më të vështira të Luftës së Ftohtë e lë të hapur për diskutime të mëtejshme, nëse ndonjë nga kolegët apo lexuesit e interesuar paraqet prova të reja të ndryshme nga ato që kam gjetur unë deri në kohën e shkrimit të këtij artikulli.

Acarimi Tito-Stalin dhe dilema e Shqipërisë në marrëdhëniet me Jugosllavinë

Që në fillim të vitit 1946, Tito dhe besnikët e tij kishin arritur në përfundimin se ishin të pakënaqur për mënyrën se si po shkonin punët në ekonominë jugosllave.³ Pas një vizite të suksesshme që kishin kryer në Poloni dhe në Çekoslovaki, më 27 mars 1946, Tito filloi të japë direktivat e para lidhur me ndryshimet e menaxhimit të ekonomisë në Jugosllavi. Ai i quajti planet e mëparshme ekonomike "të pavlera" duke u përplasur në këtë mënyrë me hartuesin kryesor të politikave ekonomike jugosllave, Andrija Hebrang, i cili, nga ana e tij, çdo plan ekonomik e

³ Vladimir Unkovski-Korica, *The economic struggle for power in Tito's Yugoslavia: From World War II to Non-Alignment* (London: I.B. Tauris, 2016), 44.

kishte mbështetur te sovjetikët.⁴ Ndryshimet ekonomike që zunë fill pikërisht në këtë kohë, u konsideruan radikale dhe pa dyshim do të kishin një çmim për t'u paguar.

Në vitin 1947, Jugosllavia filloi të ndërmernte një sërë hapash të pavarur në politikën e jashtme, ku më i dukshmi ishte dërgimi i armëve komunistëve grekë në luftën civile që po zhvillohej në Greqi.⁵ Dërgimi i armëve komunistëve grekë prej Titos, alarmoi Stalinin i cili nga ana e tij kërkoi një kontroll më të rreptë mbi Jugosllavinë.⁶ Jugosllavët, sipas Stalinit, po fitonin ndikim pasi edhe plani i tyre i vitit 1947 për të themeluar një konfederatë me Shqipërinë dhe Bullgarinë u bë publik nga lideri bullgar Dimitrov (Georgi Dimitrov) në fillim të vitit 1948.⁷ Për të kontrolluar totalisht Titon, ashtu siç kishte bërë me çdo udhëheqës tjetër në Europën Qendrore dhe Lindore, Stalini u përpoq t'i impononte liderit jugosllav nënshkrimin e një traktati mbi tregtinë i cili ishte totalisht në favor të BS-së.⁸ Sigurisht, Tito e kundërshtoi prerë propozimin e Stalinit për firmosjen e një traktati të tillë tregtar dhe pas këtij refuzimi, menjëherë ky i fundit e akuzoi liderin jugosllav për deviacionizëm dhe me një letër të hapur të datës 27 mars 1948, Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik akuzoi Jugosllavinë për armiqësi ndaj BS-së dhe fajtoje në tradhtinë ndaj rrugës së pastër marksiste-leniniste, por nuk guxoi të thoshte se ishte pikërisht refuzimi tregtar nga ana e Jugosllavisë shkaku i kësaj "tradhtie". Megjithatë, edhe pse i vuri kundër të gjithë Informbyronë, Stalini i keqllogariti mundësitë e tij ndaj Jugosllavisë. Ai besonte se stalinistët fanatikë anëtarë të PKJ-së do ta rrëzonin Titon, por ndodhi krejt e kundërta, ata u lidhën më shumë rreth liderit të tyre.⁹ Keqllogaritja më e keqe ishte dështimi i Stalinit për të parandaluar që Jugosllavia t'i kthente sytë për mbijetesë nga Perëndimi.¹⁰ Duke qenë se nuk ia doli dot ta nënshtrohte, në fund të vitit 1948, lideri sovjetik

⁴ *Po aty*, 45.

⁵ Ana Lalaj, "Shqipëria në vitet '40 – fqinjësi e vështirë", në konferencën shkencore *Shqipëria në kuadrin e sfidave globale të sigurisë*, 29 prill 2011, Tiranë: UFO University Press, 2011, 2-3; shih edhe Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë (1956-1978)*, bot. II (Tiranë: GEER, 2022), 24.

⁶ Unkovski-Korica, *The economic struggle*, 57.

⁷ *Po aty*, 58.

⁸ Ian D. Armour, *A history of Eastern Europe 1918 to the present; Modernisation, Ideology and Nationality* (London: Bloomsbury Academic, 2021), 209.

⁹ *Po aty*, 210.

¹⁰ *Po aty*.

urdhëroi një bllokadë të plotë tregtare të të gjithë Kampit Socialist ndaj Jugosllavisë, e cila rezultoi në një humbje të menjëhershme prej 2 miliardë dinarësh për vendin ballkanik.¹¹

Si do të reagonte Shqipëria ndaj kësaj çarjeje të rëndë mes Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik? Mbledhja e Byrosë Politike e Partisë Komuniste Shqiptare (PKSH) e 14 marsit 1948, do të rezultonte përfundimtare lidhur me të ardhmen e Shqipërisë. Megjithatë, dukej sikur gjërat po shtyheshin pambarim për të mbyllur çështjen e bashkimit.* Më 12 prill 1948, në mbledhjen e Byrosë Politike u vendos që t'i dërgohej një letër ministrit sovjetik të Punëve të Jashtme Vjaçesllav Molotov, ku i kërkohej që të mos largoheshin këshilltarët sovjetikë nga Shqipëria.¹² Edhe në këtë mbledhje, zëri kryesor ishte Koçi Xoxe veçanërisht kur po diskutohej që t'i kërkohej përfaqësuesit jugosllav Savo Zllatiç se si e kishte menduar Jugosllavia përfshirjen e Shqipërisë në planin federativ dhe si do të ishte mënyra e organizimit të këtyre marrëdhënieve.¹³

Ndërkohë që Shqipëria po bëhej gati t'i falej Jugosllavisë, ndodh e papritura. Në mbledhjen e radhës të Byrosë Politike më datë 20 prill 1948, anëtar i Komitetit Qendror (KQ) të PKSH-së, Kristo Themelko [Shulja], njoftoi se ishte lajmëruar nga Beqir Balluku se Jugosllavia kishte dhënë urdhër që brenda tri ditëve të gjithë oficerët dhe instruktorët jugosllavë të largoheshin nga Shqipëria.¹⁴ E gjithë Byroja Politike

¹¹ Unkovski-Korica, *The economic struggle*, 72-73. "Brenda disa ditësh nga rezoluta e Kominform-it, Bashkimi Sovjetik dhe vendet e Europës Lindore ndërprenë traktatet tregtare me Jugosllavinë dhe u vendos në total një bllokadë ekonomike në fund të vitit 1948. Mosdërgimi i materialeve, planeve dhe paisjeve nga Çekosllovakia, Hungaria, Polonia dhe Hungaria i kushtoi Jugosllavisë 2 miliardë dinarë, vlerë e cila reduktoi në maksimum dërgimin dhe shkëmbimin e mallrave ndërmjet Jugosllavisë dhe BS për vitin 1949".

* Shih më gjerësisht pjesën e dytë të studimit në "Studime historike", 2/2023.

¹² *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 14/Organet Udhëheqëse (më tej: OU), Viti (më tej: V.) 1948, Dosja (më tej: D.) 74, fleta (më tej: fl.) 1-2. Procesverbal në dorëshkrim i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, mbi përgatitjen e një letre dërguar Molotovit për mostërheqjen e specialistëve sovjetikë nga Shqipëria, 12 prill 1948.

¹³ *Po aty*, fl. 3-4. "Raport i Koçi Xoxes mbi bisedën që ishte kryer me Savo Zllatiçin në lidhje me format e organizimit të marrëdhënieve të jugosllavëve me Shqipërinë dhe se si e kishin menduar ata [jugosllavët] ta përfshinin Shqipërinë në planet federale jugosllave".

¹⁴ AQSH, F. 14/OU, V. 1948, D. 78, fl. 1. Procesverbal në dorëshkrim i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, mbi njoftimin që i ka bërë Beqir Ballukut gjenerali

shtangu. Menjëherë pas fjalës së Shules, Enver Hoxha kërkoi që Byroja Politike të hartonte një letër e cila do t'i dërgohej me urgjencë Titos.¹⁵ Si për të justifikuar lëvizjen e jugosllavëve, përsëri Shule mori fjalën dhe ua hodhi fajin vonesave që po i bënte Shqipëria formës së bashkimit me Jugosllavinë duke thënë se "ne e kemi lënë këtë çështje zvarrë".¹⁶ Nga ana tjetër, Enver Hoxha mori një qëndrim krej ndryshe nga ai i mbledhjes së mëparshme duke u shprehur se:

"Unë nuk jam i këtij mendimi. Këto janë çështje të rëndësishme dhe nuk mbarohen shpejt".¹⁷

Themelko i kujtoi Hoxhës se kur kishte qenë në Moskë, Stalini vetë i kishte thënë se duhej që Shqipëria të bashkëpunonte me Jugosllavinë dhe se çdo ndihmë e ardhur nga BS-ja do të vinte nëpërmjet Jugosllavisë.¹⁸ Në fakt, kjo pjesë e këtij procesverballi me dorëshkrim ka disa kontradikta të fjalës së Shules. Pak më poshtë ai shprehet se "ne po i pyesim sovjetikët për çdo gjë" dhe se "nuk duhet të kemi marrëdhënie me një platformë me jugosllavët".¹⁹ Kontradikta këtu në fjalën e Shules është e dukshme. Ishte apo nuk ishte ai i gatshëm të nxiste bashkimin në një njësi federale me Jugosllavinë? Kjo pjesë e këtij procesverballi mbetet enigmë dhe po kaq mbetet edhe mospërfshirja në debat në këtë mbledhje e Koçi Xoxes.

Dënimi i "tradhtisë" jugosllave dhe "pastërtia" e PKSH-së

Pas Plenumit të përfundimit të zgjedhjeve lokale të 15-22 shkurtit 1948 dhe Plenumit VIII, dukej se fati i Shqipërisë nën Jugosllavinë ishte vulosur. Në fakt, nuk do të ndodhte kështu. Më 23 prill 1948, Byroja Politike mbledhet në mënyrë urgjente me urdhër të Enver Hoxhës pasi ky i fundit ishte njoftuar nga ambasadori sovjetik në Tiranë Çuvakin se, BS-ja do të tërhiqte brenda dy-tri ditëve të gjithë personelin e instruktorëve nga Shqipëria, për shkak të marrëdhënieve të Shqipërisë me

Kupreshanin për tërheqjen nga Shqipëria të të gjithë oficerëve dhe instruktorëve të qeverisë jugosllave brenda tri ditëve, 20 prill 1948.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty.

Jugosllavinë.²⁰ Nga ky vendim i qeverisë sovjetike më i alarmuari pa dyshim ishte Hoxha vetë. Ai njoftoi Byronë se e kishte telefonuar Çuvakinin në orën 3:30 të mëngjesit, me lutjen parashtruar qeverisë sovjetike që ta rishikonte këtë vendim dhe ky i fundit i kishte thënë se do t'ia komunikonte menjëherë Molotovit kërkesën e qeverisë shqiptare.²¹ Në këtë mbledhje foli vetëm Enver Hoxha dhe askush tjetër. Ishte një mbledhje urgjente, procesverbali i së cilës është mbajtur në formën e dorëshkrimit pa u daktilografuar, ku shihet qartë alarmimi i Hoxhës lidhur me vendimin e qeverisë sovjetike. E kuptonte mirë se çdo të thoshte për pushtetin e tij një acarim me BS-në. Çfarë kishte ndodhur që BS-ja kishte marrë këtë vendim ndaj Shqipërisë?

Dy ditë pas mbledhjes së datës 23 prill 1948, më 25 prill Byroja Politike e KQ të PKSH-së me urdhër direkt të Enver Hoxhës, zhvilloi një tjetër mbledhje urgjente lidhur me dy letrat që Tito i kishte dërguar udhëheqjes shqiptare.²² Në dosjen përkatëse që kam hulumtuar, nuk jepet përmbajtja e letrave që Tito i kishte dërguar udhëheqjes në Tiranë, edhe pse në dokument theksohet fakti se të dyja letrat janë lexuar me zë [pa specifikuar nga kush], por bëhet fjalë për gjeneralin Kupreshanin (Milan Kuprešanin), emrin e të cilit e nxori "pa dashje" në mbledhjen e sqaruar më poshtë Kristo Themelko në këtë mbledhje të Byrosë Politike. Ishte një nga herët e rralla, kur Enver Hoxha i kërkoi Byrosë mendim të hapur për këto letra dhe se çfarë përgjigje duhej t'i kthente udhëheqja e PKSH-së Titos.²³

Sipas Gogo Nushit, i pranishëm në këtë mbledhje, një pjesë e udhëheqjes shqiptare akuzohej për mosbesim ndaj Jugosllavisë dhe se kjo gjë nuk ishte e vërtetë sipas tij.²⁴ Vetë Enver Hoxha bie dakord me

²⁰ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1948, D. 80, fl. 1. Procesverbal në dorëshkrim i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, mbi njoftimin që i kishte bërë Enver Hoxhës ministri fuqiplotë i BRSS-së në Tiranë, Çuvakin për tërheqjen e instruktorëve sovjetikë brenda dy-tri ditëve nga Shqipëria, 23 prill 1948.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*, F. 14/OU, V. 1948, D. 82, fl. 38. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike, 25 prill 1948.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*. Pjesë nga fjala e Gogo Nushit: "Një gjë del kuartë si përmbledhje e atyre gjërave, ai e thotë shqip se në një pjesë të udhëheqjes t'onë ka mosbesim. Ne e kemi parë është apo nuk është një gjë e tillë dhe themi se nuk ka një gjë të tillë, kemi pasur dyshime pas letrës së P.K.B. por para kësaj letrë nuk kemi hasur asnjë mosbesim tek Jugosllavët, nuk ka pasë asnjë gjë të tillë".

mendimin e Nushit dhe, mbi të gjitha, shtoi se ishte i vetëdijshëm për sakrificat që kishte bërë Jugosllavia për të ndihmuar Shqipërinë.²⁵ Sipas Tuk Jakovës, i gjithë thelbi i problemit qëndronte te Federata dhe sipas tij kjo gjë nuk mund të merrej e shkëputur nga vendet e tjera të Kampit Socialist.²⁶ Edhe vetë Jakova nuk e mohoi faktin që të ekzistonte një federatë e përbashkët shqiptaro-jugosllave dhe pengesa e vetme sipas tij ishte politike, megjithatë duheshin gjetur forma për të shkuar drejt saj²⁷ dhe nuk guxoi të përmendte arsyen e vërtetë të mosrealizimit të saj e cila ishte fillimisht ekonomike, siç e kam shpjeguar në pjesën e parë dhe të dytë të këtij studimi.* Pandi Kristo, i cili vetëm disa muaj më vonë do të akuzohej si projugosllav me Koçi Xoxen, u shpreh në këtë mbledhje se lidhshipi shqiptar kishte bërë mirë që kishte marrë mendimin e BS-së në lidhje me Federatën.²⁸ Tuk Jakova pas një pauze të shkurtër, nxori si konkluzion të vetin se PKJ-ja kishte dashur ta përdorte Shqipërinë si vegël për të pretenduar bashkimin me dëshirën e Shqipërisë.²⁹

Enver Hoxha nuk mund të mohonte atë se çfarë kishte vendosur një muaj më parë, kur kishte dhënë aprovimin për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Duke iu drejtuar Jakovës i thotë:

"Ti i di gjërat se si u zhvilluan. Faktet janë kështu e tani na thuhet se paska dyshim tek neve?"³⁰

Në të gjitha diskutimet e kësaj mbledhjeje ishte shumë e qartë se gjithkush po mendohej të justifikojë lidhur me situatën që ishte shkaktuar ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Ishte e dukshme se Koçi Xoxes po i rrëshqiste situata nga duart, pasi kishte qenë një nga përkrahësit më të flaktë të politikës projugosllave të Shqipërisë dhe njeriu që kishte shprehur dakordësinë e plotë për vendosjen e divizionit ushtarak jugosllav në Korçë. Në këtë mbledhje, ai u përpoq ta mbronte qëndrimin e tij, por bëri një gabim tepër të madh duke deklaruar se

²⁵ *Po aty.*

²⁶ *Po aty.*

²⁷ *Po aty.*

* Shih më gjerësisht pjesën e parë dhe të dytë të këtij studimi të botuar në "Studime historike", 1/2023 dhe 2/2023.

²⁸ *Po aty.*

²⁹ *Po aty*, fl. 39. Pjesë nga fjala e Tuk Jakovës: "Unë kam nxjerrë këtë konkluzion, këtu del se K.C. i P.K.J. desh të na përdori neve si vegël që neve e duam bashkimin e do Shqipëria dhe të na përdori si votë".

³⁰ *Po aty.*

Bashkimi Sovjetik mund ta sakrifikonte Shqipërinë dhe se ushtria shqiptare nuk rezistonte dot.³¹ Në mbështetje të Xoxes doli Themelko, i cili u përpoq të tregohej më "i zgjuar" se parafolësi duke u përpjekur të dukej si strateg gjeopolitik. Ai theksoi se nëse BS-ja sakrifikonte Shqipërinë, atëherë do t'i duhej të bënte lëshime në Iran e madje shkoi aq larg sa foli për t'i kërkuar llogari BS-së, edhe pse ky i fundit sipas tij ishte përgjegjës për fatin e popujve.³²

I gjithë thelbi i çështjes së kësaj mbledhjeje qëndronte te krijimi i Federatës. Vetë Enver Hoxha rimori fjalën duke deklaruar se kur ishte takuar me Savo Zllatiçin* për këtë çështje, ai i kishte thënë se nëse vinte vetë Tito në Shqipëri dhe bihej dakord, Shqipëria mund të merrte edhe Kosovën.³³ Kristo Themelko, i cili ishte po aq sa Xoxe projugosllav, në vijim deklaroi se gjatë takimeve që kishte pasur me gjeneralin Kupreshanin ky i fundit i kishte thënë se Jugosllavia nuk duhej të perceptohej si një vend që kërkonte të zaptonte Shqipërinë.³⁴

Enver Hoxha, duke ndier se krahu projugosllav në Shqipëri do të merrte tatëpjetën pas përplasjeve mes Jugosllavisë dhe BS-së që në fakt ishin "thembra e Akilit", çështje të cilat do t'i sqaroj më poshtë, e pyeti drejtpërdrejt Themelkon:

"Ç'mendon ti për letrat e Marshallit [Tito]?"³⁵

I pyetur drejtpërdrejt, Themelko nuk kishte se si të mohonte se kishte qenë pro politikës sipas propozimeve të gjeneralit jugosllav Kupreshanin dhe Zllatiçit, por u justifikua se këto propozime i mendonte se kishin ardhur nga "lart".³⁶ Edhe Enver Hoxha kishte qenë dakord, siç e kam paraqitur në pjesën e dytë të këtij studimi botuar në "Studime historike" 2/2023, por kësaj radhe ai u mundua të ndante dëshirën e paraqitur nga Savo Zllatiçi dhe Kupreshanin nga vendimmarrja e KQ të

³¹ *Po aty*. Pjesë nga fjala e Koçi Xoxes: "Me çështjen e Divizionit janë të lidhura edhe ato që u thanë se Bashkimi Sovjetik e sakrifikon Shqipërinë e se ushtria jonë nuk reziston".

³² *Po aty*, fl. 39-40.

* Shih pjesën e dytë të këtij studimi në "Studime historike", 2/2023.

³³ *Po aty*. "Kur erdhi Savo te neve i thashë pse na bëhen tërthorazi këto propozime, ai tha se mundet të vijë edhe Titoja dhe mund t'u japim edhe Kosovën".

³⁴ *Po aty*, fl. 41. "Kupreshanin më ka thënë dy tri herë se mos mendoni që ne jemi një vend që kërkon të zaptojë Shqipërinë".

³⁵ *Po aty*, fl. 42.

³⁶ *Po aty*.

PKJ-së.³⁷ Themelko nuk mund t'i dilte kundër Enver Hoxhës dhe gjeti përsëri vend të justifikojë duke deklaruar se vetëm pasi e kishte "këshilluar" Komandanti, atëherë ai kishte hezituuar në çdo propozim të paraqitur nga jugosllavët.³⁸

Me një naivitet të denjë për një fillestar politik, Xhoxhi Blushi në fjalën e tij e vuri gishtin aty ku i dhimbte më shumë Enver Hoxhës: te çështja Nako Spiru. Blushi u shpreh se ishte i shqetësuar sepse ishte dënuar nga partia puna armiqësore e Spirut dhe tashmë na dilte se gabim nuk e kishte pasur ai, por partia.³⁹ Po partia kush ishte? Ishte Enver Hoxha. Blushi nuk mund të thoshte se kryetari dhe kryeministri e kishin pasur gabim dhe me atë çfarë deklaroi e përgjithësoi gabimin. Koçi Xoxe, nga ana e tij, duke kuptuar situatën u përpoq të dukej si më pak projugosllav duke i quajtur manovrat e gjeneralit Kupreshanin të poshtra.⁴⁰ Po ashtu, ai sulmoi Jugosllavinë lidhur me marrëdhëniet e kësaj të fundit me BS-në, duke vënë në dukje atë që të tjerët nuk kishin guxuar se "*këputja e marrëdhënieve tregtare mes tyre kishte sjellë problemin politik*".⁴¹

Më qartë se kaq nuk kishte ku të shkonte. Xoxe me këtë fjali kishte goditur "thembrën e Akilit" dhe jo vetëm që dekonspiroi të vërtetën, por i dha fund dilemës mbi arsyen e vërtetë të acarimit Tito-Stalin. Ekonomia kishte qenë thelbi i acarimit të marrëdhënieve BS-Jugosllavi. Në diskutimet pasuese, Byroja Politike vendosi që t'u jepte të drejtë letrave që KQ i PKBS-së i kishte dërguar PKJ-së, ku e akuzonte për antisovjetizëm. Pyetjes së Enver Hoxhës se a kishte antisovjetizëm në qëndrimet jugosllave, Gogo Nushi i përgjigjet prerë se ishte dakord me letrat që kishte dërguar KQ i PKBS-së dhe se Shqipëria edhe pse kishte bërë çfarë i kishte thënë Jugosllavia në lidhje me partinë, legalizimin, kongresin etj., i kishte ndrequr gabimet e veta në frymën prosovjetike.⁴²

³⁷ Po aty. Pjesë nga fjala e Enver Hoxhës: "Ne thoshim si thoshte Savo vetë, që 'këto çështje janë të K.C. dhe këto të tjerat janë të miat'".

³⁸ Po aty.

³⁹ Po aty. Pjesë nga fjala e Xhoxhi Blushit: "Tash na del si e papritur përgjigjja duke ditur se ne e dënuam punën e Nako Spirut, vijën e tija dhe tash na del se nuk jemi ne në rregull, na del se ndryshe veprojme në praktikë dhe ndryshe deklarojmë, kjo nuk më duket e drejtë".

⁴⁰ Po aty, fl. 44.

⁴¹ Po aty.

⁴² Po aty, fl. 46.

Më lart e kam theksuar si qëndronte çështja e acarimit sovjeto-jugosllav. Natyrisht në dokumentet shqiptare që kam hulumtuar përveç citimit të Xoxes, nuk tregohet në asnjë rresht arsyeja e vërtetë e "tradhtisë" jugosllave, arsye të cilën Xoxe e përmendi vetëm një herë dhe ndoshta ishte penduar që e kishte përmendur. Thelbi i acarimit të marrëdhënieve mes dy vendeve aq më tepër aleatë, janë pa dyshim çështjet ekonomike. BS-ja dhe Jugosllavia nuk bënëin përjashtim edhe në këtë rast. Jugosllavia për vitet 1947-1948 nuk mund të thuhet se kishte një pavarësi financiare nga BS-ja, por vendosi të vepronte sikur të ishte e pavarur. Hapat e saj në lidhje me krijimin e Federatës ballkanike me Shqipërinë dhe Bullgarinë, edhe pse fillimisht ishin përkrahur nga Stalini, më vonë u konsideruan prej këtij të fundit si fillim i pavarësisë jugosllave dhe, nga periudha janar-mars 1948, marrëdhëniet u karakterizuan nga acarime të forta politike ndërmjet dy vendeve.⁴³ Në mbledhjen e famshme të Byrosë Politike të PKBS-së të shkurtit 1948, Stalini aprovoi Federatën, por kundërshtoi dërgimin e trupave jugosllave në Shqipëri me arsyetimin se kërcënohej prestigji ndërkombëtar i BS-së.⁴⁴ Aprovimi i Stalinit për Federatën me Bullgarinë, por pa përmendur Shqipërinë, nga jugosllavët në mbledhjen e Byrosë të 1 marsit 1948, u cilësua si kontroll i tërthortë sovjetik, ndaj ata [jugosllavët] hodhën poshtë ndihmën sovjetike për industrinë e lehtë dhe vendosën të shtojnë investimet në industrinë e rëndë, veçanërisht atë ushtarake.⁴⁵ Kjo ishte e tepërt për Stalinin. Ai refuzoi bisedimet mes dy vendeve për çështjet tregtare, por Tito nuk denjoi të përfillte këtë masë të liderit sovjetik.⁴⁶ Madje, ai [Tito] shkoi edhe më larg duke filluar me kërkesë të tij bisedime tregtare me amerikanët mbi bazën e tregtisë së arit, duke u kërkuar atyre ndihmë financiare dhe asistencë teknike.⁴⁷

Ky veprim ishte përtej çdo limiti për Stalinin. Ai vendosi të tërhiqte të gjithë personelin ushtarak dhe civil nga Jugosllavia në fund të shkurtit 1948.⁴⁸ Nga data 20 mars 1948 kur Tito me kujdes i shkroi Molotovit, pati shkëmbime të ashpra në letra mes dy vendeve, të cilat arritën kulmin më 28 qershor lidhur me çarjen e pariparueshme ku Stalini nëpërmjet

⁴³ Unkovski-Korica, *The economic struggle*, 58.

⁴⁴ *Po aty*.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 58-59.

⁴⁶ *Po aty*, fl. 59.

⁴⁷ *Po aty*.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 60.

Informbyrosë e cilësoi Titon si antimarksist "tradhtar" dhe që kishte punuar në frymën kundër socializmit.⁴⁹

Ndërkaq, Byroja Politike e PKSH-së vijonte të debatonte ideologjikisht lidhur me natyrën e marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe "tradhtisë" së saj ndaj socializmit. Për Gogo Nushin, problemi më i madh ishte se PKSH-ja nuk ishte legalizuar ende, nuk kishte bërë kongresin dhe se në problematikat e punëve të brendshme (Sigurimit) ishte ndier fort ndikimi i jugosllavëve.⁵⁰ Në të njëjtën frymë me Nushin diskutoi edhe Tuk Jakova, duke i quajtur të drejta të gjitha ato që kishte shkruar partia bolshevike e BS-së.⁵¹ Nesti Kerenxhi në frymën e një militanti ordiner në fjalën e tij, deklaroi se letra e PKBS-së ishte e drejtë edhe për faktin se partia bolshevike kishte shumë më tepër eksperiencë pasi i kishte kaluar të gjitha etapat dhe për këtë arsye kishte të drejtë!⁵² Si për t'i vënë kapak punës me Jugosllavinë, Enver Hoxha në fund të mbledhjes deklaroi se letra e partisë bolshevike ishte një armë me rëndësi, mbi të gjitha në radhë të parë për zhvillimin e drejtë të kritikës marksiste-leniniste.⁵³ Po sipas tij, letra e PKBS-së ndaj PKJ-së do të mbetej në histori për kritikën e drejtë që i bëhej KQ të PKJ-së dhe të një sërë udhëheqësve që kishin devijuar nga vija marksiste-leniniste, dhe se Byroja Politike e PKSH-së ishte krejtësisht dakord me akuzat dhe vërejtjet që i ishin bërë Jugosllavisë nga BS-ja.⁵⁴ Me pak fjalë, tashmë, sipas Hoxhës, kishte ardhur momenti që PKSH-ja të bënte kthesën e madhe dhe të rishikonte çdo politikë projugosllave që kishte ndjekur dhe se akuza që i ishte bërë se kishte krijuar një front antijugosllav, në fakt, sipas tij, kishte qenë kurth pasi pa dashje kishin marrë pjesë në një front antisovjetik.⁵⁵ Hoxha u betua në mbledhje se do të luftonte çdo formë antisovjetizimi, dhe se këtë e tutje ai dhe e gjithë Byroja do të ishin të patundur në qëndrimet prosovjetike.⁵⁶

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ AQSH, F. 14/OU, V. 1948, D. 82, fl. 46. Vijim i procesverbalit të mbledhjes së Byrosë Politike, 25 prill 1948.

⁵¹ *Po aty*.

⁵² *Po aty*, fl. 53.

⁵³ *Po aty*, fl. 58.

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ *Po aty*, fl. 59.

⁵⁶ *Po aty*, fl. 60. "Për çështjen e antisovjetizmit, ne kemi qenë të patundur dhe në luftë kundër atyre që kanë qenë antisovjetikë të cilët ne i luftojmë dhe do t'i luftojmë me të gjitha forcat".

Për t'i treguar Bashkimit Sovjetik se sa vasal i bindur do të ishte, Hoxha urdhëroi që të përpilohej një letër drejtuar PKBS-së, ku të dilte qartë roli negativ i Jugosllavisë dhe rreziku që i vinte komunizmit nga vija politike e PKJ-së.⁵⁷ Koçi Xoxe e përkrahu "me vrap" këtë ide të Hoxhës duke deklaruar se PKSH-ja duhej të bënte një kritikë të shëndoshë në interesin e përgjithshëm të partisë dhe, si për të mbrojtur veten, deklaroi se letra nuk duhej të ishte e qëllimshme.⁵⁸ Gjithashtu, Xoxe propozoi që në formulimin e letrës që do t'i dërgohej PKBS-së, të viheshin në dukje lidhjet dhe gjendja ekonomike e Shqipërisë.⁵⁹

Në fakt, problemet ekonomike në fillim të vitit 1948 për Shqipërinë po ndiheshin jo pak, madje që në fillim të vitit 1948. Në një raport të datës 15 janar 1948 për qytetin e Beratit, komiteti i partisë njoftonte KQ-në se ndërmarrjet qendrore nuk kishin furnizuar në mënyrë të rregullt popullatën.⁶⁰ Po ashtu, një tjetër problem që njoftohej nga qyteti i Beratit ishte edhe çështja e kuadrit të partisë, niveli i të cilit linte shumë për të dëshiruar.⁶¹ Për sa i përkiste situatës politike, të bëjnë përshtypje raportet e shumta të dërguara nga komitetet e partisë nëpër rrethe ku dënohej "tradhtia" e Titos ndaj kauzës së komunizmit.⁶² Problemet ekonomike që po haste vendi nga të gjitha rrethet justifikoheshin me situatën e nderë ndërkombëtare që po kalonte globi, e veçanërisht me situatën aktuale në Jugosllavi.⁶³ Gjendja "e nderë" që ekzistonte në Jugosllavi kishte

⁵⁷ *Po aty*, fl. 61.

⁵⁸ *Po aty*.

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ AQSH, F. 14/Strukturat (më tej: Str), V. 1948, D. 4. fl. 2. Raporte dyjavore të ardhura nga rrethet për KQ-në, lidhur me situatën politike dhe ekonomike në Shqipëri.

⁶¹ *Po aty*, fl. 24.

⁶² AQSH, F. 14/Str., V. 1948, D. 10, fl. 104. Raport nga Shkodra i datës 31 korrik 1948.

⁶³ *Po aty*, fl. 113. Pjesë nga raporti i Komitetit të Partisë të rrethit Shkodër, 1 shtator 1948: "Ngjarjet e fundit që kanë ndodhë në arenën ndërkombëtare siç asht ashpërsimi i luftës politike dhe ashpërsimi i kontradiktave të Kampit të madh Demokratik Anti-Imperialist dhe atij imperialist, siç asht lufta që po zhvillohet në Greqi, Kinë, Palestinë etj., e sidomos që nga deklarimi i gjendjes së krijuar në Jugosllavi, kanë ba që edhe në rrethin tonë të ndigjohet njëfarë acarimi i gjendjes politike, ngase këtu ka shumë elementë të goditun nga ana e Pushtetit tonë, për shkak të aktivitetit të tyre reaksionar dhe të pjesëmarrjes së tyre në lëvizjet e Hasan Isufit, Llesh Marashit e të Jup Kazazit me Postribën kundër qytetit të Shkodrës".

ndikuar, sipas raporteve, jashtëzakonisht shumë në daljen sërish në pah të elementëve reaksionarë dhe të klerit katolik në qytetin e Shkodrës.⁶⁴

Ishte e dukshme se pas acarimit dhe prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, Shqipërisë do t'i shtoheshin edhe më shumë hallet ekonomike. Për këtë arsye ishin dhënë direktiva të qarta, veçanërisht për të konfiskuar sa më shumë monedha ari nga qytetarët shqiptarë kudo që i fshihnin. Në një raport për Policinë Popullore të datës 30 prill 1948, njoftohej KQ i PKSH-së se ishin konfiskuar për tremujorin e parë të këtij viti në të gjitha rrethet e vendit 20 mijë napolona ar.⁶⁵ "Tradhtia" jugosllave u "diskutua" gjerësisht në aktivet e PKSH-së nëpër rrethe nën drejtimin e mbikëqyrjen e plotë të të dërguarve më kryesorë të KQ-së dhe të gjithë pjesëmarrësit pa diskutim aprovuan rezolucionin e PKBS-së. Ata shprehën mbështetjen e plotë për Enver Hoxhën dhe dënuan klikën projugosllave të Koçi Xoxes.⁶⁶ Megjithatë, ishte e pamundur të mos bëhej një "autokritikë" me një nivel të mjerueshëm ideologjik e politik gjatë mbledhjeve të forumeve të partisë nëpër rrethe, ku justifikimet ishin sa për sy e faqe dhe ku shfajësohej totalisht udhëheqja e PKSH-së.⁶⁷ Komunikata e PKSH-së u lexua në çdo aktiv në rrethe dhe u aprovua në të gjitha mbledhjet.⁶⁸

⁶⁴ AQSH, F. 14/Str., V. 1948, D. 12, fl. 131. Raport i muajit gusht 1948 për rrethin e Shkodrës.

⁶⁵ Po aty, F. 14/Str., V. 1948, D. 56, fl. 18. Raporte mbi punën e Policisë Popullore dërguar KQ-së në Tiranë.

⁶⁶ Më gjerësisht shih AQSH, F. 14/Str., V. 1948, D. 70 dhe AQSH, F. 14/Str., V. 1948, D. 70/1.

⁶⁷ AQSH, F. 14/Str., V. 1948, D. 70 fl. 93. "Partia tonë solidarizohet menjëherë me P.K. të (BS), me Inform Byronë, me udhëheqësin e madh Stalinin. Partia jonë ka patur suksese, punon për ngritjen e socializmit në bazë të teorisë marksiste-leniniste. Në këtë rrugë Partia jonë krijoi lidhje të ngushta me P.K. Jugosllave e popullin, konditat e vendit tonë dhe lufta na lidhi, kjo ishte e natyrshme. Nga këto lidhje Partia jonë, A. P. u indinjua kundër poshtërsive të tyre. Duke parë qëndrimin e Partisë Komuniste Jugosllave kundrejt nesh, kjo është e madhe. Komiteti Central i joni së shpejti do të nxjerri një rezolucion të kuartë mbi këto dhe mbi gabimet tona. Do të përcaktojë mirë ç'rol të poshtër kanë lojtur Udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave kundër neve. Kohët e fundit K.Q. i P. K. Shqiptare nxori rezolucionin e Nako Spirut. Në rast se do të kuptohen drejt qëllimet e Partisë Komuniste Jugosllave ne do të zbulojmë shumë gjëra. Ata me qëndrimin e tyre kanë mundur të na futin në disa pozita, na kanë bërë të bëjmë gabime në vijnë marksiste e organizative. Ata kanë dash të shtinin në dorë të gjithë Partinë, vendin tonë. Këto gjëra do dalin kuartë. Një gjë është e kuartë se Partia e jonë është e shëndoshë, përpjekjet tona kanë qenë heroike sidomos kohët e fundit".

⁶⁸ Po aty, fl. 139-140.

Situata në marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë po precipitonte me shpejtësi. Byroja Politike e PKSH-së duhej patjetër të merrte masa energjike për të treguar përpara BS-së se e dënonte vijën jugosllave. Për këtë arsye, pas dërgimit të letrës së dytë nga BS-ja kundër Jugosllavisë, në datat 13-14 maj 1948, Byroja Politike zhvilloi një tjetër mbledhje maratonë ku mori në shqyrtim letrën e PKBS-së.⁶⁹ Nuk do të kishte dyshim se nga të tërë pjesëmarrësit në atë mbledhje madje edhe më projugosllavët, si Pandi Kristo, Kristo Themelko e mbi të gjithë Koçi Xoxe, nuk do të kurseheshin duke thënë se sa gabim po vepronte PKJ-ja dhe në fjalët e Xhoxhi Blushit sa i dëmshëm kishte qenë ndikimi i saj te PKSH-ja.⁷⁰ Pandi Kristo për sa i përket letrës më datë 7 mars 1948, dërguar nga BS-ja kundër Jugosllavisë, kërkoi që të studiohej thellësisht pasi kishte një rëndësi të madhe veçanërisht "për neve".⁷¹ Koçi Xoxe shkoi edhe më tej, duke e quajtur letrën e PKBS-së të një rëndësie historike.⁷² Tito, sipas Xoxes, duhej patjetër të bënte kthesë e nuk duhej ta shihte Jugosllavinë si një brilant të shkëputur nga socializmi.⁷³ Vetë Enver Hoxha i dëgjoji me durim folësit dhe në fjalën e tij, të cilën sipas dokumentit që kam hulumtuar e ka ndrequr disa herë, e cilësoi PKSH-në të fortë pasi e kishte duruar shumë padrejtësinë jugosllave, siç e kishte duruar Bashkimi Sovjetik.⁷⁴ Enver Hoxha e quajti qëndrimin jugosllav antimarksist dhe antisovjetik dhe cilësoi që kjo frazë e tij të përfshihej edhe në notën që do t'i dërgohej ambasadorit sovjetik në Tiranë.⁷⁵

Jugosllavia nuk mund të mbetej pa përgjigje nga udhëheqja shqiptare lidhur me qëndrimet e saj të fundit. Më datë 20 maj 1948, në mbledhjen e radhës të Byrosë Politike u vendos që t'u jepej përgjigje letrave që kishte dërguar Tito, e që sipas lidërshiptit shqiptar ishin akuza të rënda ndaj vendit.⁷⁶ Tuk Jakova mori fjalën i pari në këtë mbledhje dhe qëndrimi i tij, lidhur me përgjigjen që duhej t'i kthente Byroja Politike e

⁶⁹ AQSH, F. 14/OU, V. 1948, D. 87, fl. 1. Mbledhje e Byrosë Politike e KQ të PKSH-së, 13-14 maj 1948.

⁷⁰ *Po aty*, fl. 44.

⁷¹ *Po aty*, fl. 46.

⁷² *Po aty*, fl. 47.

⁷³ *Po aty*, fl. 48.

⁷⁴ *Po aty*, fl. 50. Pjesë nga fjala e Enver Hoxhës: "Në qoftë se ka që nuk i ka humbur nervat është Partia jonë, Partia jonë ka duruar me durim të gomarit. Atë që tha Pandi për Partinë Bolshevike se ka duruar, është po ashtu edhe për neve".

⁷⁵ *Po aty*, fl. 52.

⁷⁶ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1948, D. 89, fl. 1. Mbledhje e Byrosë Politike, 20 maj 1948.

PKSH-së Jugosllavisë, duhej të ishte i fortë dhe i mbështetur.⁷⁷ Vetë Enver Hoxha në fjalën e tij ishte pak konfuz për sa i përkiste formës, pasi siç diskutoi edhe vetë, çështjet ishin delikate dhe duheshin shtruar drejt.⁷⁸ Ishte i kuptueshëm problemi i Hoxhës. Ai kishte qenë ndjekës i verbër i kësaj politike, që kishte bërë të mundur lidhjen e plotë deri në vasalitet të Shqipërisë ndaj Jugosllavisë. Ai ishte faktori vendimtar për vendin e tij, siç e kam paraqitur në pjesën e dytë në artikullin e mëparshëm, i bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë. Tashmë, atdheu i socializmit kishte goditur aleatin e tij më të ngushtë. Dilema e tij ishte e madhe. Po nëse BS-ja ndryshonte qëndrim përsëri ndaj Jugosllavisë, sikur të mos kishte ndodhur asgjë? Megjithatë, një përgjigje ndaj letrave të Jugosllavisë edhe për t'i treguar besnikëri BS-së duhej bërë. Më datë 22 maj 1948, në një tjetër mbledhje të Byrosë Politike u aprovua letra që do t'i dërgohej udhëheqjes së PKJ-së.⁷⁹ Në këtë dokument që kam hulumtuar nuk është paraqitur letra që i është dërguar PKJ-së.

Prishja me jugosllavët kërkonte patjetër të gjendeshin "fajtorët" dhe të justifikoheshin plotësisht Enver Hoxha dhe enturazhi i tij. Fillimi i goditjes së elementit më të dukshëm projugosllav do të fillonte nga ai vetë pas ardhjes së letrës së tretë të BS-së kundër Jugosllavisë. Tanimë ai nuk kishte dyshime se acarimi sovjeta-jugosllav nuk ishte i ndreqshëm, të paktën sa të ishte Stalini gjallë. Më datë 25 maj 1948, Hoxha thirri mbledhjen e radhës të Byrosë Politike për të studiuar letrën e tretë të PKBS-së kundër PKJ-së.⁸⁰ Në këtë mbledhje, Hoxha e tha prerë se tani e tutje çdo qëndrim që do të mbahej ndaj Jugosllavisë duhej të diktohej nga partia bolshevike.⁸¹ Hoxha, pasi dëgjoi edhe diskutimet e "treshes" më projugosllave pas tij, Kristo-Xoxe-Themelko, mori përsëri fjalën duke filluar në këtë mënyrë procesin e rrënimit total të kësaj "tresheje". Sipas Hoxhës, diskutimet e tre personave të lartpërmendur ishin të lëkundura, nuk kishin nxjerrë mësimet e duhura nga letrat e BS-së dhe duhej t'i

⁷⁷ *Po aty*, fl. 1-2.

⁷⁸ *Po aty*, fl. 10.

⁷⁹ AQSH, F. 14/OU, V. 1948, D. 90, fl. 1. Provesverbal në dorëshkrim i mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSH-së, ku u lexua dhe u aprovua letra që do t'i dërgohej KQ të PKJ-së, 22 maj 1948.

⁸⁰ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1948, D. 93, fl. 1. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike, 25 maj 1948.

⁸¹ *Po aty*, fl. 25.

"studionin" më me themel.⁸² Dhe, po në të njëjtin diskutim, Hoxha filloi procesin e rehabilitimit të Mehmet Shehut duke deklaruar:

"Unë i thashë Pandit se Mehmet Shehu nuk ka gabuar dhe Pandi vuri duart në kokë dhe tha [për veten] se nuk ka gabuar; se Mehmet Shehu ka gabuar se është egoist, arrogant, që nuk është komunist i mirë dhe që pajtohesh fare lehtë me Nako Spirun dhe ne e kemi akuzuar për punën e tij në shtatmadhori në lidhje me Jugosllavinë".⁸³

Vënia e duarve në kokë nga ana e Pandi Kristos do të thoshte shumë. Tashmë gjërat do t'i përmbyseshin me shpejtësi atij, Koçi Xoxes dhe Kristo Themelkos. Megjithatë, ende nuk kishte ardhur koha që këta tre persona të goditeshin hapur nga Enver Hoxha dhe ai vetë të dilte si shpëtimtari i situatës. Goditja ndaj çdo elementi projugosllav, sipas tij, duhej bërë me kujdes që ai dhe vetëm ai të dilte i panjollësuar.

Nuk do të ishte në fakt aq e thjeshtë për Hoxhën të shpëtonte nga marrëdhënia e ngushtë që kishte ideuar vetë me Jugosllavinë. Për kushtet e Shqipërisë, Jugosllavia kishte hedhur jo pak pará. Më 3 qershor 1948, Byroja Politike mblihet përsëri për të diskutuar letrën që kishte ardhur nga KQ i PKJ-së në përgjigje të letrës dërguar nga PKSH-ja, më datë 23 mars 1948.⁸⁴ Letra dërguar nga KQ i PKJ-së u konsiderua nga Byroja Politike pa asnjë bazë, por u vendos që të dërgohej një delegacion nga Komiteti Qendror për të shkuar në Jugosllavi për të diskutuar disa çështje.⁸⁵ Dhe çështjet që duhej të diskutoheshin, siç e pranoi vetë Byroja, ishin ato me karakter ekonomik.⁸⁶ Këto çështje kërkonin zgjidhje të prerë, por Shqipëria ishte tepër e dobët ekonomikisht dhe rrjedhimisht përpara Jugosllavisë e çarmatosur. E vetmja mënyrë për të mbijetuar duke iu falur tërësisht BS-së, ishte që të fillonte menjëherë identifikimi i elementëve si antisovjetikë në Byro dhe në shoqëri.

⁸² *Po aty*, fl. 30-32. Pjesë nga fjala e Enver Hoxhës: "Unë i thashë Pandit t'i lexonte letrat e Partisë Bolshevike shumë herë".

⁸³ *Po aty*, fl. 31.

⁸⁴ *Po aty*, F. 14/OU, V. 1948, D. 97, fl. 1. Procesverbal i mbledhjes së Byrosë Politike, 3 qershor 1948.

⁸⁵ *Po aty*.

⁸⁶ *Po aty*.

Denoncimi i të gjitha traktateve dhe marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nga qeveria e RPSH-së

Më 6 prill 1948 u zhvillua një mbledhje e rëndësishme në Durrës në prani të delegates të KQ-së (nuk thuhet në dokument emri) për këtë takim, ku u sulmuan tepër ashpër "tradhtarët" Sadik Premtja, Anastas Lulo dhe "tradhtari" më i rrezikshëm nga të gjithë, Nako Spiru.⁸⁷ Nga e dërguara e KQ-së, Nako Spiru u etiketua si tradhtar që donte të shtrembëronte vijën e Partisë, ta dëmtonte atë dhe ishte mik i ngushtë i tradhtarit tjetër Sejfulla Malëshova.⁸⁸ Gjithashtu, Nako Spiru u akuzua se dëshironte të prishte konventën ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe se e kishte konsideruar si shitje të Shqipërisë te Tito.⁸⁹ Miqësia e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë ishte e paprekshme pasi ishte ky vend i cili, sipas rezolutës së Plenumit VIII, po e ndihmonte në të gjitha drejtimit shtetin tonë.⁹⁰ Në këtë mbledhje u akuzua shkarazi edhe Mehmet Shehu si i afërt me Nako Spirun dhe u shtrua pyetja se përse vijonte të mbante detyra me rëndësi.⁹¹ Madje, në mbledhjen maratonë të celulës [që filloi nga ora 12:00 deri në orën 23:00, e cila u shty për të nesërmen më 7 prill për të përfunduar në orën 22:00 të datës 8 prill], Mehmet Shehut iu vu në dukje egërsia e tij në trajtimin e kundërshtarëve dhe ekzekutimi i 60 personave të lidhur me Ballin me urdhër të tij.⁹² Nako Spiru dhe të tjerët u sulmuan edhe në mbledhjen e celulës së

⁸⁷ *Po aty*, F. 14/Str., V. 1948, D. 383, fl. 1. Procesverbal i organizatës bazë të rrethit të Durrësit me rastin e punimit të rezolucionit të Plenumit VIII të PKSH-së.

⁸⁸ *Po aty*.

⁸⁹ *Po aty*, fl. 2.

⁹⁰ *Po aty*. "Neve kemi miq të sinqertë që na ndihmojnë. Kemi Jugosllavinë e Marshallit Tito, Bashkimin Sovjetik dhe Bullgarinë e Dimitrovit".

⁹¹ *Po aty*, fl. 3. Pjesë nga pyetja e Vasil Vrahoritit: "Pse Mehmet Shehu i cili paska marrë pjesë në tradhtinë e Nako Spirut qëndron akoma në një detyrë të madhe?"

⁹² *Po aty*, fl. 18. "Krahas me këtë lidhje dhe çështjen e Mehmet Shehut. Partia nuk lejonte që të bëheshin masakrime por këtë e dënonte; ndërsa Mehmeti e ka bërë. Kur dëgjohej emri i tij, kundërshtarët vendosnin të mos dorëzoheshin vetë, duke thënë se komunistat u nxirrnin sytë. Japim shembullin në vitin 1944, kur ka luftue në rrethet e Lushnjës ka kapë 60 njerëz të hedhur me Ballin dhe i ka pushkatuar. Ky veprim nuk ishte i drejtë dhe u godit nga Partia. Mehmeti ka bërë që nga shpirti i tij egoist të luftonte kaq shumë për të dalë në krye të Ushtrisë".

seksionit të Punëve të Brendshme në mbledhjen e jashtëzakonshme, që u mbajt në datën 6 prill 1948.⁹³

Kjo mbledhje do të rezultonte e dështuar. Marrëdhëniet me Jugosllavinë ishin shumë pranë përfundimit të hidhur. Në një notë verbale të datës 20 prill 1948, të dërguar nga Enver Hoxha për Titon, i kërkohej këtij të fundit që të përshpejtoheshin punët për largimin e të gjithë instruktorëve dhe delegatëve ushtarakë jugosllavë nga Shqipëria.⁹⁴ Ky ishte vetëm fillimi i acarimit shqiptaro-jugosllav. Dy muaj më vonë, më 29 qershor 1948, Enver Hoxha në cilësinë e kryeministrit do të urdhëronte që në çdo institucion shtetëror duke filluar nga Kuvendi Popullor dhe duke përfunduar te zyra më e fundit e Komitetit të Partisë në rrethe, të hiqej menjëherë portreti i Titos dhe të mbahej vetëm portreti i tij dhe i Stalinit.⁹⁵ Qesharak është fakti se Hoxha për portretin e tij i drejtohet vetes në vetën e tretë me shprehjen "Komandantit tonë".⁹⁶ Gjithashtu, më datë 9 tetor 1948, MPJ e Shqipërisë mori njoftim nga ambasada shqiptare në Beograd lidhur me listat e sakta të familjeve kosovare që ishin konsideruar "të papërshtatshme", në mënyrë që të riatdhesoheshin në Jugosllavi.⁹⁷ Qëndrimi i pjesëtarëve të këtyre familjeve konsiderohej armiqësor, ndaj duheshin larguar.⁹⁸ Nga ana e saj, edhe Jugosllavia kishte marrë masat përkatëse. Sipas një njoftimi në dhjetor të vitit 1948 të ambasadës në Beograd, mësuesit shqiptarë që jetonin në Kosovë e Metohi dhe Maqedoni pengoheshin nga autoritetet jugosllave të hynin në kontakt me ambasadën shqiptare.⁹⁹

⁹³ *Po aty*, fl. 29.

⁹⁴ *Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (Fondet MPJ) (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V.) 1948, Dosja (më tej: D.) 162, fl. 4. Notë nga ministri i Punëve të Jashtme i RPSH-së Enver Hoxha për mareshalin Tito, 20 prill 1948.

⁹⁵ AMPJ, V. 948, D. 163, fl. 1. Urdhër i Enver Hoxhës për heqjen e portretit të Titos nga zyrat shtetërore.

⁹⁶ *Po aty*. "Në çdo rast mbledhje, mitingje, parakalime, manifestime etj., do të jetë vetëm fotografia e shokut Komandant dhe e shokut Stalin. Në zyrat Shtetnore do të mbahet vetëm fotografia e Komandantit tonë dhe e shokut Stalin. Kryeministri Enver Hoxha, firma, vula".

⁹⁷ *Po aty*, V. 1948, D. 215, fl. 3. Njoftim nga ambasada e RPSH-së në Beograd për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Tiranë, 9 tetor 1948.

⁹⁸ *Po aty*, fl. 5.

⁹⁹ *Po aty*, fl. 28. Njoftim i ambasadës së RPSH-së në Jugosllavi për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 24 dhjetor 1948.

Duke qenë se marrëveshjet me Jugosllavinë kishin qenë guri i themelit të çdo politike të hartuar nga qeveria shqiptare, duke filluar nga akordi i datës 25 shkurt 1945 mbi shkëmbimet reciproke tregtare,¹⁰⁰ tashmë pas letrave të dërguara nga BS-ja dhe pas mbledhjeve maratonë të cilat i kemi diskutuar më lart, duhej bërë një ndryshim i fortë 180 gradë. Më 30 qershor 1948, qeveria e RPSH-së nën drejtimin e Enver Hoxhës i cili në mbledhje nuk lejoi askënd të fliste, i bëri me dije anëtarët e qeverisë se do të denoncoheshin të gjitha traktatet politike dhe ekonomike të nënshkuara ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë.¹⁰¹ Enver Hoxha në fjalën e tij denoncoi çdo marrëveshje me qeverinë jugosllave, pasi me një qeveri të tillë nuk mund të bashkëpunohej më.¹⁰² Kishte edhe një problem tjetër në marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë. Përveç anës financiare vendi kishte nevojë urgjente për t'u rindërtuar. Përgjigjen e kësaj dileme në po të njëjtën mbledhje e dha vetë kryeministri. Ai shpjegoi se për rindërtimin e Shqipërisë tani e tutje do të ndihmonin vendet e tjera të demokracive popullore dhe, në radhë të parë, Bashkimi Sovjetik.¹⁰³

Në fakt, sipas njoftimeve nga MPJ e Shqipërisë, që në muajin maj 1948, marrëdhëniet me Jugosllavinë kishin qenë të ftohta.¹⁰⁴ Diplomatatë shqiptarë në Beograd, sipas këtyre njoftimeve, nuk e kishin më "derën e hapur" në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shpeshherë nuk arrinin të

¹⁰⁰ *Po aty*, V. 1948, D. 167/1, fl.1/3. "Marrëdhëniet tregtare të viteve 1946-1947 ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë".

¹⁰¹ *Po aty*, F. 490/Këshilli i Ministrave (më tej: KM), V. 1948, D. 322, fl. 4-5. Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të Ministrave mbi informimin e qeverisë për rezolucionin e Byrosë Informative për gjendjen në PK Jugosllave dhe mbi denoncimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë, 30 qershor 1948; shih edhe *po aty*, V. 1948, D. 167, fl. 30-33. Mbi marrëveshjet ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

¹⁰² *Po aty*, fl. 4. Pjesë nga fjala e Enver Hoxhës: "A do t'i vazhdojmë këto marrëdhënie? Këto marrëdhënie me një qeveri të tillë s'mund t'i vazhdojmë, se janë në rrugë të gabuar antishqiptare. Këto marrëveshje duhet t'i denoncojmë. Arsyet tona janë të mëdha që këto marrëdhënie të quhen nul. Të forcojmë traktatin e miqësisë të ndihmës reciproke për marrëdhënie të ardhshme me popujt e Jugosllavisë, të cilët do të kenë një udhëheqje me të vërtetë të shëndoshë. Pra, unë propozoj që të denoncohen të gjitha marrëdhëniet e protokollet që kemi me Jugosllavinë dhe njëkohësisht të gjithë jugosllavët që janë në zyrat tona shtetërore të largohen brenda 48 orëve nga vendi ynë".

¹⁰³ *Po aty*.

¹⁰⁴ *Po aty*, V. 1948, D. 156, fl. 1. Mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave.

takonin asnjë diplomat jugosllav.¹⁰⁵ Gjithashtu, edhe informacionet lidhur me familjet shqiptare në Kosovë e Metohi ishin gjithnjë e më të pakta.¹⁰⁶ Po ashtu, nga të gjitha ambasadat e Shqipërisë në vendet e Kampit Socialist, deri në fundin e vjeshtës së vitit 1948, raportet që vinin në Tiranë ishin të shumta lidhur me qëndrimin *en block* të demokracive popullore kundër Jugosllavisë dhe ky fakt ishte një lehtësim i madh për Enver Hoxhën.¹⁰⁷ Kështu, raportet e ambasadës shqiptare në Pragë dërgonin informacione në Tiranë për gjendjen ekonomike në Jugosllavi, sipas së cilës ajo konsiderohej si "mjaf e keqe".¹⁰⁸ Është në fakt, mjaf i çuditshëm ky informacion pasi, siç e pasqyron vetë dokumenti, një vit më parë gjendja ekonomike e Jugosllavisë ishte "e lulëzuar".¹⁰⁹

Prishja e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve, do të shoqërohej edhe me një përhapje të gjerë të materialit propagandistik në vend dhe më datë 30 qershor 1948, gazeta "Bashkimi" botoi të plotë Komunikatën e mbledhjes së Byrosë Informative kundër "tradhtisë" së Jugosllavisë.¹¹⁰ Më 16 korrik 1948 nga Kukësi erdhi njoftimi në KQ, në Tiranë, se ishin përhapur fjalë propagandistike mbi dislokimin e forcave të shumta ushtarake jugosllave në kufirin midis dy vendeve.¹¹¹ Gjithashtu, më datë 31 korrik, në qytetin e Kukësit forcat e Sigurimit kishin gjetur broshura propagandistike në mbrojtje të vijës së PKJ-së duke hedhur poshtë vendimin e Informbyrosë.¹¹² Në një parullë tjetër në muajin shtator 1948, Enver Hoxha quhej gënjeshtar dhe i bëhej thirrje popullit shqiptar të mos i besonte, pasi regjimi i tij ishte një regjim terrori dhe shtypjeje.¹¹³

¹⁰⁵ *Po aty*.

¹⁰⁶ *Po aty*, fl. 2, 26.

¹⁰⁷ *Po aty*, fl. 58-70.

¹⁰⁸ *Po aty*, fl. 76.

¹⁰⁹ *Po aty*.

¹¹⁰ *Po aty*, V. 1948, D. 216, fl. 156. Komunikatë mbi mbledhjen e Byrosë Informative të partive komuniste dhe punëtore, gazeta "Bashkimi", nr. 1093, 30 qershor 1948.

¹¹¹ AQSH, F. 14/Str., V. 1948, D. 271, fl. 1. Korrespondencë e komiteteve të partisë të rretheve me Komitetin Qendror të PKSH-së, në lidhje me materialin propagandistik të revizionistëve jugosllavë shpërndarë në Shqipëri nga elementët armiq në Shqipëri në shërbim të UDB-së.

¹¹² *Po aty*, fl. 5.

¹¹³ *Po aty*, fl. 14. "Mos i dëgjoni gënjeshttrat e Enverit me shokët e tij që populli pati gjitha shpresat ke ay dhe pritte premtimet e dhana, por ma në fund nuk ia dha popullit atë që i kishte premtue gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare në të cilën ju po e shifni dhe ju vet se premtimet e lirisë së popullit tonë shqiptar janë dhanë terrore, burgime të pafajshmëve, mbytje në dru si ka ndodhë këto ditët e fundit në rrethin Koplik e ndër

Përfundime

Për të mbyllur këtë pjesë të tretë të këtij studimi, për gjetjen e materialeve që kam cituar besnikërisht nga arkivat shqiptarë dhe nga literatura ndërkombëtare, ishte shumë e vështirë. Në këtë artikull u ndesha me një skepticizëm të lartë nga ana e recensentëve, të cilët kundërshtojnë argumentet e mia lidhur me arsyen e prishjes së marrëdhënieve Jugosllavi-BS fillimisht dhe më pas ato Shqipëri-Jugosllavi. Edhe pse nuk paraqitën asnjë argument apo provë shkencore të re për të hedhur poshtë argumentet e mia, sepse vijonin t'i qëndronin tezës së vjetër – shkakut ideologjik të prishjes së marrëdhënieve, përsëri i falënderoj që gjetën kohë për të lexuar dhe për të dhënë mendime për këtë pjesë të tretë të studimit tim, që në fakt ishin edhe një shtysë për mua për të përforcuar tezën time me disa shtesa. Duke qenë se studimi ka edhe një pjesë të katërt që është e fundit, aty do të tregohet edhe më gjerësisht arsyeja për të cilën kam shkruar më lart e prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, që është kryekëput ekonomike. Provat financiare që iu paraqitën Byrosë Politike në vitin 1949, nga një komision i posaçëm i përbërë nga figura të larta të pushtetit komunist (emrat dhe paraqitjen e këtyre provave do t'i pasqyroj në artikullin e radhës në “Studime historike”), u morën si shembull edhe në vitin 1984 një vit para vdekjes së Enver Hoxhës, kur udhëheqja komuniste shqiptare [Byroja Politike] donte të dinte nivelin e marrëdhënieve ekonomike me Jugosllavinë dhe si mund të manovronin lidhur me borxhin ende të pashlyer në atë kohë ndaj fqinjit verior.

Burime dhe bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror i Shtetit i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Fondet:

F. 14/Organet Udhëheqëse (OU): 1948.

F. 14/Strukturat (Str.): 1948.

F. 490/Këshilli i Ministrave (KM): 1948.

vende të tjera... Ju bajmë thirrje që të vini çeta-çeta dhe të bashkoheni me vllaznit tuej që ju presin në Jugosllavi dhe për së shpejti do të ktheni në tokën e lirë shqiptare me një demokraci popullore (Shqiptarët që kërkojnë Liri)".

Arkivi i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë (AMPJ): 1948.

Literaturë historiografike:

Haug, Hilde Katrine. *Creating a Socialist Yugoslavia; Tito, communist leadership and the national question*. New York: I.B. Tauris, 2012.

Unkovski-Korica, Vladimir. *The economic struggle for power in Tito's Yugoslavia; from World War II to Non-Alignment*. London: I.B. Tauris, 2016.

Lalaj, Ana. "Shqipëria në vitet '40 – fqinjësi e vështirë, në konferencën shkencore "Shqipëria në kuadrin e sfidave globale të sigurisë". Tiranë: UFO University Press, 29 prill 2011.

Armour, Ian D. *A history of Eastern Europe 1918 to the present; Modernisation, Ideology and Nationality*. London: Bloomsbury Academic, 2021.

Boriçi, Gjon. *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1978*, bot. II. Tiranë: GEER, 2022.

...continues from the previous issue 2023/2

GJON BORIÇI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
gjon.borici@asa.edu.al

S u m m a r y

A VIEW IN POLITICAL-ECONOMIC TERMS BETWEEN ALBANIA AND YUGOSLAVIA
IN THE PERIOD 1945-1949
(Part three, April -September 1948)

The third part of this paper deals with the sharp problems in the first line between Yugoslavia and the Soviet Union as a consequence of ideological rifts that in true were economic between Tito and Stalin. The Yugoslav leader rejected Stalin's proposal to sign a trade agreement which was totally in favor of the Soviet Union. Through this agreement Staling aimed to better control Yugoslavia economically and consequently politically. Tito's decline to sign Stalin's trade agreement led to uncompromised political clash between the two

leaders, and Stalin expelled Yugoslavia from COMINFORM. In this tense situation between the two important countries of the socialist camp, Albania was in a very difficult position. The Albanian Politbureau was in the last stages of concluding the union within a confederation with Yugoslavia, and now was facing the uncompromised rift between the Soviet Union and "sister" Yugoslavia. For the communist Albanian leader Enver Hoxha, was no dilemma but to accuse Yugoslavia for treason and to totally rely on the Soviet Union by taking the stand "ordered" by Stalin to denounce all the agreements and cooperation with Yugoslavia.

ERJON PAPAGJONI

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

epapagjoni@gmail.com

<https://doi.org/10.61773/2dc9h441>

**“GODITJA” NË LETËRSI, ARTE DHE KULTURË
NË VITIN 1973****Abstrakt:**

Aksioni politik i PPSH-së dhe i Enver Hoxhës në fillim të viteve '70, që kulmoi me Plenumin IV të KQ të PPSH-së në qershor 1973, u identifikua si luftë kundër shfaqjeve të liberalizmit dhe “ndikimeve të huaja” në letërsi, arte dhe kulturë. Në fakt, ky plenum ishte “hapje rruge” për tryshinën dhe raprezaljen që do të pasonte ndaj artistëve, shkrimtarëve, krijuesve, të cilët u kritikuan, u demaskuan, u poshtëruan publikisht, disa prej tyre edhe u internuan dhe u burgosën. Aksioni që u ndërmor ishte një ogur i zi i politikës shtypëse, frikësuese, përçarëse që u ndoq ndaj krijuesve; një frenim i prirjeve liberale dhe risive në fushën e kulturës dhe të arteve, duke ndaluar çdo mendim, veprim e prirje, të cilat sillnin në arenën e ideve dhe sjelljeve të shoqërisë dëshirën për ndryshim. Për këtë arsye zanafillat e një mendësie, pëlqimi dhe qëndrimi më tolerant ndaj kulturës dhe artit bashkëkohor, tok me frymën e “gëzimit të jetës”, shijet, afeksionet ndaj Perëndimit, u goditën fort dhe u konsideruan një rrezik ndaj pushtetit të PPSH-së.

Fjalë kyçe:

Letërsi, arte, diktaturë, censurë, liberalizëm.

Një pikë-nyje e kthesës së politikës korrente të PPSH-së dhe Enver Hoxhës, e cila solli pasoja të rënda në jetën politike shoqërore të vendit, ishte Plenumi IV i Komitetit Qendror të PPSH-së, mbajtur më 26 dhe 27 qershor 1973. Ky plenum u njoh gjerazi si tryshia dhe raprezalja që iu bë disa mundësive të pakta të zhvillimit të letërsisë dhe arteve në një frymë disi më të liberalizuar. Vendimet e këtij plenumi u pasuan nga ndërmarrja

e një fushate të gjerë spastrimesh dhe krijimi i një klime linçimi në të gjitha veprimtaritë partiake e shtetërore siç qenë Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë dhe e Energetikës, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, e cila arriti kulmin me likuidimin e Mehmet Shehut, kryeministrit radikal të kohës. Dështimet në ekonomi, varfërimi gjithnjë e më i madh, krijimi i një regjimi të rreptë kontrolli e frike, ndikimi nga modeli jetësor i demokracive të vendeve të Europës Perëndimore me zgjerimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, pakënaqësia në rritje, qenë arsyt kryesore përse Enver Hoxha (ndoshta i shtyrë edhe nga paranojat pas infarktit që i ndodhi në verën e vitit 1972), për të garantuar ardhmërinë klanore të pushtetit inicioi goditjen e paprecedent në fushën delikate të letërsisë dhe të arteve, e cila u konkretizua në vendimet famëkeqe të Plenumit IV të PPSH-së. Hoxha e argumentoi këtë goditje si rrezik të “depërtimit të ideologjisë së huaj në fusha të ndryshme të jetës së vendit dhe në ndërgjegjen e njerëzve tanë”, duke shfrytëzuar “vatrat dhe gjurmët e ideologjive të vjetra... veçanërisht konceptet dhe shprehitë individuale mikroborgjeze... Thelbi i këtij agresioni ideologjik dhe synimi kryesor i armikut të klasës në kushtet e sotme për degjenerimin e rendit socialist, të politikës së brendshme e të jashtme të partisë e të shtetit tonë, është nxitja e liberalizmit në të gjithë frontin”.¹

Klima dhe atmosfera e krijuar në rrethet letrare-artistike dhe ato kulturore e shoqërore në përgjithësi, mori formën e një ankthi dhe frike të mbushur me dyshime, përçarje, shpifje, akuza e kundërakuza. Në parathënien e vëllimit II “Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (dokumente arkivore), 1969-1973”, me autorë Beqir Meta, Afrim Krasniqi, Hasan Bello, me të drejtë përcaktohet se “i gjithë mekanizmi i komunikimit dhe i veprimit pasqyron një sistem frike e ndëshkimi horizontal e vertikal, ku askush jashtë rrethit të ngushtë të udhëheqësit nuk është i mbrojtur dhe imun. Në këtë sistem nuk ka vend për debat, argumente dhe as mendim profesional. Vetë teza se në çështjet e artit dhe të kulturës ka zëra se vendimmarrjet duhen marrë nga

¹ Enver Hoxha, “Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre” (Raport i mbajtur nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH-së, shoku Enver Hoxha), në *PPSH, Dokumenta kryesore*, vëll. VI (1971-1975), (Tiranë: 8 Nëntori, 1978), 351.

profesionistët dhe jo nga partia, konsiderohet tezë e rrezikshme dhe armike”.²

Shkaku pse PPSH-ja ndërmoi këtë veprim ndëshkues ndaj shkrimtarëve dhe artistëve, ndaj njerëzve të medias dhe inteligjencies krijuese në përgjithësi, sipas një raporti të Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar sekretarit të Komitetit Qendror, Ramiz Alia, në fillim të vitit 1973,³ lidhej me idetë, mendimet dhe qëndrimet e ndryshme që ishin shfaqur në meset sociale kundër politikave izalocioniste të PPSH-së, kundër ngushtimit në maksimum të komunikimit me jashtë dhe horizontit pritës, që vinte nga jeta, arti dhe kultura botërore. PPSH-ja i transferoi dhe i komentoi këto probleme, mendime e qëndrime të njerëzve si “punë armiqtësore” të elementëve armiq, që ishin kundër revolucionarizimit të kulturës dhe artit, dhe jo si një reagim qytetar e intelektual i kohës për liri e të drejta. Sipas këtij raporti, dy prej këtyre reagimeve ia vlenin si më tipikët. I pari: “Rinia tek neve mbahet nën tutelë, prandaj e detyrojnë të bëjnë gjëra të papëlqyera, ndërsa në vendet e tjera të rinjtë bëjnë çfarë të duan, prandaj nuk ndodh asgjë”.⁴ Reagimi i dytë ishte politikisht më kundërvënës ndaj regjimit: “Ne shqiptarët jemi të çuditshëm, fryhemi menjëherë. Për një çikë që lëshuam flokët mbi qafë, shih se çfarë bëhet. Puna që bëjnë këta është që të bëjnë revolucion në Afrikë dhe jo të edukojnë rininë në Evropë. Qëllimi i romaneve nuk është për të bërë vetëm edukimin klasor revolucionar, por për edukimin estetik të rinisë. Por, përderisa problemet artistike merren nga shija e një personi, nuk mund të bëhet gjë e saktë. Ne jemi ekstremistë të mëdhenj dhe kemi frikë se mos përsëritet historia e viteve 1965 që ka qenë kulmi i triumfit të anti-arsyes”.⁵

Në një tjetër informacion të kësaj ministrie dërguar po Ramiz Alisë, paraqitet zhgënjimi dhe dëshpërimi i njerëzve ndaj politikës së PPSH-së.

² *Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (Dokumente historike)*, vëll. II (1969-1973), përgatitën për botim Beqir Meta, Afrim Krasniqi, Hasan Bello, Instituti i Historisë dhe Fondacioni Konrad Adenauer (Tiranë: Emal, 2019), 5.

³ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.), 14/ Arkivi i Partisë (AP)-Strukturë (Str.), Viti (më tej: V.) 1973, Dosja (më tej: D.) 60, fl. 1-4. Raport i Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar sekretarit të Komitetit Qendror, Ramiz Alia, mbi komentet e elementëve armiq lidhur me problemet e revolucionarizimit të kulturës dhe artit, zëvendësministri i Punëve të Brendshme Feçor Shehu.

⁴ *Po aty*, fl. 2.

⁵ *Po aty*, fl. 1.

“Udhëheqësit tanë e kanë katandisur keq gjendjen, nuk pyesin fare për hallet e popullit. Si nuk u gjend një dorë e fortë që të kishte zhdukur kryeministrin, i cili së bashku me të tjerët e kanë kthyer vendin në një shtet afrikan...”.⁶ Diku më tutje pohohet nga informacionet e besuara dhe përgjimet e kësaj ministrie se “po të mos ekzistonin tre udhëheqësit kryesorë, të tjerët i kanë sytë nga Perëndimi...”.⁷ “Gjendja është për të qarë, po na i shtrëngojnë rripat. Prenë emisionet italiane në televizion, kjo është datë e zezë në historinë e kulturës së Shqipërisë”, flitej me zemërim për aksionin izolues të stacioneve televizive italiane, jugosllave, greke e më gjerë. “Në Shqipëri është krijuar një situatë e rëndë për shkak të masave që merren kundër rinisë, e cila kërkon liri dhe kontakte me botën e jashtme...”⁸

Pikërisht ky zemërim që ndihej ngado duhej mbytur. Kritikën e Enver Hoxhës, më 9 janar të vitit 1973, vetëm pak ditë pasi kishte përfunduar Festivali i 11-të Kombëtar i Këngës në Radio-Televizion si edhe diskutimi i tij në mbledhjen e zgjeruar të komunistëve të organizatës bazë të partisë të Komitetit Qendror të PPSH-së (më datë 15 dhe 16 mars të po atij viti) me temë: “Lufta kundër shfaqjeve të huaja në art e kulturë dhe ndikimi i tyre në të gjithë jetën e vendit”⁹ dhe më pas ajo në Plenumin III të KQ të PPSH-së, u ndoqën nga një sërë analizash në institucionet e ndryshme qendrore e vendore të partisë dhe pushtetit ekzekutiv. Më 20 shkurt 1973, një grup instruktorësh të Komitetit Qendror të PPSH-së u deleguan për ndjekjen dhe zhvillimin e mbledhjeve të komiteteve të partisë së rajoneve 1, 2, 3, të Tiranës dhe Universitetit lidhur me punën ideologjike në sektorët e letërsisë, artit dhe kulturës.¹⁰ Ndërsa nga raporti i Reis Maliles, i deleguari i Komitetit të Partisë të Rajonit nr. 1 Tiranë, lidhur me Festivalin e 11-të të Këngës në RTSH dhe ndikimin e muzikës perëndimore, më 6 mars 1973, në pikën C thuhej se “nga përgjegjësit në linjën e partisë të këtij festivali u bë

⁶ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 70, fl. 11-17. Informacion i Reis Maliles mbi mbledhjet e komiteteve të partisë së rajoneve 1, 2, 3, të Tiranës dhe Universitetit lidhur me punën ideologjike në sektorët e letërsisë, artit dhe kulturës.

⁷ *Po aty*.

⁸ *Po aty*.

⁹ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 962, fl. 1-9. Enver Hoxha, “Lufta kundër shfaqjeve të huaja në art e kulturë dhe ndikimi i tyre në të gjithë jetën e vendit”, fjala e mbajtur në aparatin e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, 15 mars 1973.

¹⁰ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 60, fl. 9-12.

autokritikë për indiferencën që patën në përgatitjen e tij dhe nuk u thelluan në shkaqet e kësaj gjendjeje”.¹¹

Në dokumentin “Konkluzione të Komitetit të Kulturës dhe të Arteve mbi ndikimet e huaja në fushë të kulturës dhe të arteve”,¹² Tiranë më 15 maj 1973, jepet një tablo e hollësishme mbi të ashtuquajturat “ndikime të ideologjisë së huaj borgjeze e revizioniste në fushën e kulturës e të artit”. Pas një parashtrimi të natyrës ideologjike përputhur klisheve e parashtrimeve të njohura politike të kohës, pohimit që i bëhet fillimisht krijimtarisë së vyer të artistëve, të cilët pasqyronin realitetin e kohës mbi bazën e traditës së shëndoshë, pasi theksohet edhe “përmbajtja e thellë dhe frymëmarrja e gjerë kombëtare që i ka bërë të pavdekshme shumë vepra të letërsisë dhe arteve tona”¹³ si tendencë e përgjithshme e tyre, më pastaj nis shqyrtimi kritik i kësaj krijimtarië. Tanimë theksohen deformimet dhe cedimet e saj si pasojë e presionit ideologjik të botës armike që i “tërbonin sukseset tona”; po kështu nënvizohet “mosvlerësimi i rrezikshmërisë së luftës ideologjike që bënin imperialistët dhe revizionistët kundër vendit tonë”,¹⁴ si dhe “kuptimi simplist i bllokadës dhe i luftës klasore, në kushtet e së cilës ne ndërtonim kulturën socialiste”.¹⁵ Sipas këtij raporti të organit qendror ekzekutiv në fushën e kulturës dhe të arteve, në krijimtarinë artistike ishte vërejtur largimi nga temat e mëdha të ditës, ngushtimi i këndit të vështrimit mbi problematikën e gjerë që ofronte aktualiteti revolucionar, mungesa e vërtetësisë jetësore, pasqyrimi i zbehtë dhe i shtrembër i realitetit, largimi nga tabani kombëtar, rendja pas imitimeve të huaja, formave dhe efekteve të jashtme etj.

Nëse do të bëhej një përjasje midis këtij raporti të Komitetit të Kulturës dhe të Arteve si institucioni shtetëror ekzekutiv kryesor i vendit, i nënshkruar nga kryetari i tij, Mantho Bala, dhe raportit të Komitetit të Partisë të rrethit Tiranë, drejtuar Komitetit Qendror të PPSH-së, mbi

¹¹ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 70, fl. 4. Informacion i Reis Maliles mbi mbledhjet e komiteve të partisë të rajoneve 1, 2, 3, të Tiranës dhe Universitetit lidhur me punën ideologjike në sektorët e letërsisë, artit dhe kulturës.

¹² *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 240, fl. 16-48. “Komiteti i Kulturës dhe i Arteve. Konkluzione. Mbi ndikimet e huaja në fushë të kulturës dhe të arteve në frymën e fjalimeve të fundit të shokut Enver”.

¹³ *Po aty*, fl. 16.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ *Po aty*, fl. 17.

reagimin e krijuesve pas diskutimit të fjalimeve të fundit të Enver Hoxhës, mbajtur në Tiranë më 18 qershor 1973, nënshkruar nga sekretari i Komitetit të Partisë Tiranë, Dashnor Mamaqi, dallohen fare qartë konstatimet e përbashkëta mbi të ashtuquajturin “devijim” të letërsisë dhe arteve nga realizmi socialist, ndikimi i tyre nga letërsia dhe arti i huaj liberal borgjezo-revizionist, imitimi i formave të dekadentizmit e modernizmit, si dhe marrja e masave për goditjen e elementit liberal dhe përmirësimin e gjendjes në krijimtarinë letrare artistike.¹⁶ E njëjta skemë shqyrtimi shihet gjithashtu edhe në informacionin e grupit të punës në Komitetin Qendror të PPSH-së, i datës 23 qershor 1973, mbi gjendjen në fushat e kulturës, letërsisë dhe arteve pas fjalimeve të fundit të Enver Hoxhës. Ngjashmëria dhe klisheja paraqitëse e strukturore e raportimit duket edhe tek informacioni i Komitetit të Partisë të rrethit Mat¹⁷ apo ai i rrethit Lushnjë.¹⁸ Janë po ato çështje sikurse edhe në raportet e tjera, po ai parashtrim, veçse gama e njerëzve të kritikuar, e veprave letrare artistike dhe e reagimeve, që kishin ndodhur sakaq në bashkësinë e shkrimtarëve dhe artistëve të vendit apo të rretheve përkatëse, është më e zgjeruar dhe më gjithëpërfshirëse. Tanimë lentja e kritikës kishte përfshirë edhe shkrimtarë e artistë të tjerë, si Dhimitër Shuteriqi, Vilson Kilica, Hamide Stringa, Ibrahim Uruçi si drejtues të gjeratëhershëm të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Të bën përshtypje p.sh. një fakt domethënës, ku thuhet se “ka tre-katër muaj që poetë të tillë, si S. Bejko, M. Zeqo, S. Mato, V. Qurku, N. Lako, A. Shehu, F. Arapi, V. Skënderi etj., nuk kanë botuar asnjë varg, ose rrallë ndonjë vjershë të dobët.”¹⁹ Kjo dëshmon mbi të gjitha frikën që kishte pushtuar qarqet krijuese nga masat shtypëse të cilat po aplikoheshin gjithandej, sidomos asaj pjese që kishte sjellë një

¹⁶ Shih *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 52, fl. 13-21. Raport i Komitetit të Partisë të rrethit Tiranë, drejtuar Komitetit Qendror të PPSH-së, mbi reagimin e krijuesve pas diskutimit të fjalimeve të fundit të Enver Hoxhës, firmosur nga Dashnor Mamaqi.

¹⁷ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 41, fl. 22. Informacion paraprak mbi disa konkluzione që dalin nga puna e deritanishme rreth dy fjalimeve të fundit të shokut Enver “Mbi zhvillimin e luftës ideologjike të partisë në art e letërsi dhe në edukimin ideoestetik të njerëzve”. Për Komitetin e Partisë të rrethit Mat, Mustafa Pajenka.

¹⁸ Shih *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 41. “Informacion mbi disa probleme në fushën e letërsisë, artit dhe kulturës që dolën nga diskutimet rreth fjalimeve të fundit të shokut Enver”. Sekretari i parë i KP të rrethit Lushnjë, Rrapi Gjermani.

¹⁹ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 52, fl. 3. Informacion i grupit të punës në Komitetin Qendror të PPSH-së mbi gjendjen në fushat e kulturës, letërsisë dhe arteve pas fjalimeve të fundit të Enver Hoxhës, 23 qershor 1973.

frymë të re në letërsi, veçanërisht në poezi. Dasia midis mendësisë së re në lëmin e letërsisë dhe mendësisë së vjetër, sikurse diferencimi që ishte bërë sakaq në qëndrimet ndaj brezit të vjetër dhe atij të ri të poetëve, duket edhe në konstatimin e mëposhtëm: “Është përhapur fjala se në këtë kohë paskan gabuar vetëm poetët e talentuar, ata që kërkojnë. Në shtyp shihen vetëm disa firma të autorëve të moshuar, si të A. Çaçit, M. Xhaxhiut, F. Gjatës, Ll. Siliqit e ndonjë tjetri”.²⁰

Krahas raporteve dhe informacioneve të përgatitura nga forumet e larta partiake dhe ato ekzekutive mbi gjendjen e letërsisë, arteve dhe kulturës, të tjera informacione vijnë nga burime jo mirëfilli zyrtare. Ato janë të detajuara, të përgatitura nga disa krijues me funksione në fushën e letërsisë dhe të arteve. Paçka se ato kanë një ngarkesë gjithësesi personale, shërbejnë për të plotësuar tablonë dhe për të kuptuar më në thellësi vetë fenomenin. I tillë është informacioni i shkruar nga kritiku Dalan Shaplllo mbi diskutimin e zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve lidhur me ndikimet e huaja në gjininë letrare të tregimit,²¹ ku burimet e ndikimeve të huaja te kjo gjini letrare vështrohen “te ndikimet e drejtpërdrejta të letërsisë së huaj me frymë të sëmure, si dhe njohja e sipërfaqshme e realitetit, mungesa e përvojës, por edhe rendja pas formave “të reja”, pas ndonjë “simboli” të papërligjur, pas psikologjizmit”.²² Ose raporti i Jakup Matos si instruktor i KQ të PPSH-së,²³ Hamide Stringës si sekretare e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve,²⁴ Ksenofon Dilos²⁵ etj.

Kritikat dhe qëndrimet e rrepta në raportin e Komitetit Qendror të PPSH-së ndaj letërsisë dhe arteve, nga rrafshi i përgjithshëm përfshinin më tej parashtrime më të hollësishme për deformimet, kufizimet, ndikimet e huaja, duke vijuar me nëndarjet e saj: a) në artin skenik; b) në

²⁰ *Po aty*.

²¹ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 289, fl. 12. Informacion i Dalan Shaplllos mbi diskutimin e zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, lidhur me ndikimet e huaja në gjininë letrare të tregimit.

²² *Po aty*.

²³ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 289, fl. 1-9. Informacion i Jakup Matos mbi diskutimin e zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve për dramaturgjinë.

²⁴ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 302, fl. 10-12. Raport i sekretares së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Hamide Stringa, mbi diskutimet e zhvilluara rreth ndikimeve të huaja në fushën e muzikës.

²⁵ *Po aty*, fl. 16. Informacion i Ksenofon Dilos mbi luftën kundër ndikimeve të huaja në artet figurative.

lëmin e kinematografisë; c) në fushën e muzikës; ç) në artet figurative; d) në letërsi; dh) në punën kulturore masive; e) në botime dhe f) kontrollin dhe hallkat miratuese të krijimtarisë.

Kudo shihet po e njëjta mënyrë e trajtimit dhe shikimit të situatës, duke marrë parasysh e duke iu referuar përherë udhëzimeve që lideri komunist jepte nëpër forumet e larta të partisë dhe të shtetit. Kudo kërkohen shfaqjet e liberalizmit në arte e kulturë, idetë dhe konceptet e gabuara estetike që vinin nga arti perëndimor, ndikimi i ideologjisë dhe estetikës siç etiketohej rëndom “borgjeze-revizioniste”. Kudo zotëronte një atmosferë e dhunshme kritike, etiketime dhe linçime veprash, artistësh, aktivitetesh kulturore-artistike. Në të gjitha raportet e grupeve të partiakëve të ndryshëm, në mbledhje, aktive partie, ministrish, në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, kudo ishte e njëjta gjuhë zotëruese: intoleranca ndaj çdo shfaqjeje liberalizmi, fajësimi i artistëve dhe i shkrimtarëve, goditja e veprave që sillnin risi dhe mënyra të reja të shprehjes artistike.

1.

Në nyjen e parë kritikohen disa drama të fundit të viteve '60 dhe fillimit të viteve '70 si “Historia e një nate” dhe “Njollat e murrme” të Minush Jeros, “Një copë rrugë” e Loni Papës dhe “Historia e një nate” e Kleanthi Dushës. Në këto drama e disa të tjera flitet për ndikime formaliste, nënvleftësimin e përmbajtjes socialiste, “unin” regjisorial që dëmton brendinë dhe kuptimësinë e veprës konkrete, shfaqjet e natyralizmit në aktrim, thjeshtëzimin; më tutje përmenden teorizimet e gabuara ku në tekst duhet “lënë diçka për t’u kuptuar edhe nga spektatori” duke i dhënë mendimet “në mënyrë të kamufluar”. Siç kuptohet, koncepte të tilla buronin nga shqyrtimet semiologjike të tekstit letrar dhe të vetë veprës teatrore, që ishin shtruar sakaq me forcë në gjysmën e dytë të shek. XX nga autorë të tillë të shquar, si Roland Barthes*, Jean Paul Sartre**, Albert Camus** etj. Kritika të tjera adresoheshin në nënvleftësimin e traditës duke e çmuar atë si arkaike dhe e kundërta, kur e vjetra merrej si e re dhe moderne, shfaqjet e

* Roland Barthes, eseist dhe kritik letrar francez (1915-1980), i njohur më së shumti me librin “The death of the author” (“Vdekja e autorit”), “Theori of structuralism” (“Teoria e strukturalizmit”) dhe “Theori of myth” (“Teoria e mitit”).

** Jean Paul Sartre (1905-1980), filozof dhe shkrimtar francez.

** Albert Camus (1913-1960), filozof dhe shkrimtar francez.

natyralizmit dhe thjeshtëzimit sidomos në artin e aktrimit, kërkimi i formës jashtë e përkundër përmbajtjes, një lloj “imanence” e formës e cila, siç thuhej, nuk “ka lindur si domosdoshmëri e përmbajtjes, përkundrazi, disa herë përmbajtjes i janë veshur forma të gatshme të huazuara”.²⁶

U kritikuan posaçërisht qëndrimet dhe idetë “anarkiko-liberale” të regjisorit Kujtim Spahivogli dhe të dramaturgut Ibrahim Uruçi. Sipas këtij raporti, kritika në arte “u adresua thuajse totalisht kundër konservatorizmit... se pati tendenca të theksuara liberale, të cilat inkurajuan shfaqjet e ndikimeve të huaja, gjë që tregoi se këta autorë harruan sensin klasor të kritikës letrare e artistike duke cenuar parimin themelor të realizmit socialist, partishmërinë proletare”.²⁷ Më tutje, raporti vijonte me kritika edhe ndaj punonjësve të Komitetit të Kulturës dhe të Arteve në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës, të cilët mbulonin drejtime e institucione të ndryshme të artit e kulturës në vend, duke filluar me Mustafa Kranten (muzikë), Kujtim Buzën (artet figurative), Esat Oktrovën dhe Miho Gjnin (teatër, ky i fundit u largua nga detyra për shkak të një artikulli mbi shfaqjen “Historia e një vajze”), Zenel Sulën (botime), Ruzhdi Matën (veprimtaritë kulturore-masive), Janaq Tokën (lëvizja amatore), Kleanthi Deden (muzetë) dhe drejtuesve kryesorë të këtij komiteti, Mantho Bala, Jakup Mato dhe Adem Sollaku. Në fund vijohej me masat që duheshin marrë për përmirësimin e gjendjes dhe luftën kundër ndikimeve të huaja në arte duke rreshtuar 11 të tilla, ku përfshiheshin hartimet e programeve të punës në çdo sektor, ngritja ideologjike, ideoestetike e kulturore e punonjësve të artit, studimi dhe evidentimi i traditave artistike e kulturore, bashkëpunimi me Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, vigjilenca te redaksitë e shtëpive botuese, goditja e teorizimeve të huaja, forcimi i kontrollit në bazë, riorganizimi i këshillave artistikë, kontrolli dhe ndihma ndaj Institutit të Lartë të Arteve dhe shkollave të artit, përsosja e informacionit artistik.²⁸

Një tjetër informacion i zgjeruar vjen nga sektori i teatrove dhe estradave profesioniste në Komitetin e Kulturës dhe të Arteve, ku jepen të dhëna mbi liberalizmin dhe ndikimet e huaja në këto institucione, duke

²⁶ *Po aty*, fl. 18.

²⁷ *Po aty*, fl. 34.

²⁸ *Po aty*, fl. 47-48.

u përqendruar sidomos te masat e marra kundër tyre.²⁹ Krahas kritikave për drama e shfaqje të paraqitura në informacionin e dhënë nga Mantho Bala, kryetar i Komitetit të Kulturës dhe të Arteve, përmenden për gabime, shtrembërime të realitetit, ndikime të huaja dhe përmbajtje të dobët edhe dramat “Një copë rrugë” e Loni Papës; “Stuhi në prill” e Skënder Luarasit; “Orfeu zbret në ferr” e Tenessi Uilliams në Teatrin Popullor; “Ishin të gjithë fëmijët e mi” të Artur Milerit në Teatrin e Korçës. Po kështu premiera estrade si “Buzëqeshja” (Tiranë), “Çaste gazmore” (Berat), “Tinguj gazmorë” (Korçë), “Parodi gazmore” (Durrës), “Variete gazmore” (Lushnjë), “Variete Nr. 2” (Shkodër), disa shfaqje estrade të regjisorit Bujar Kapexhiu etj. Në këtë raportim, vëmendja është përqendruar më shumë në problematikat dhe përmirësimin e mjeshtërisë së aktorit, regjisorit e scenografit, prirjet e teatrit dhe “keqkuptimet” e tij nga metodat artistike që ka aplikuar, huajtjet e bëra nga arti perëndimor, çështjet e repertorit, sigurimi i një partishmërie të lartë etj.

Në informacionin e Jakup Matos mbi diskutimin e zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve për dramaturgjinë, më 27 prill 1973, krahas paraqitjes së një tabloje mbi gjendjen e saj dhe arrijtet në drama të tilla, si “Cuca e maleve”, “Flakë në shtëpi”, “Njerëz mbi shkëmb”, “Fytyra e dytë”, “Shtëpia në rrugicë”, “Fisheku në pajë”, “Mosha e bardhë” etj., u konstatuan edhe shumë dobësi e shkelje të parimeve të realizmit socialist me paraqitjen e koncepteve regresive mbi jetën, historinë, shoqërinë, njeriun, tematika e ngushtë, kritika ndaj konservatorizmit nga pozitat e liberalizmit, prirjet ilustrative ndaj jetës, paraqitje kundërshtish në trajtë të paqartë e të turbullt, mbivlerësimi i formës në raport me përmbajtjen, i mjeteve shprehëse moderniste në raport me traditat e trashëguara në këtë gjini, teorizimet formaliste dhe largimet nga e vërteta dhe realiteti.³⁰

Në këtë mbledhje Dritëro Agolli vuri në dukje se “konvencioni i tepruar dhe reduktimi i personazheve, e bashkuar kjo me njohjen e pakët të jetës dhe problematikës së vendit, ngushtoi tematikën e dramës sonë në disa raste. Në përgjithësi mbetën dy tema të preferuara disi: lufta kundër burokratizimit dhe më shumë dashuria. Edhe nëse pati pak realizime në këto dy tema, duke u vërtitur mjaft rreth këtij qarku, u varfërua skema.

²⁹ AQSH, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 299, fl. 11-25. Informacion i sektorit të teatrove dhe estradave profesioniste në Komitetin e Kulturës dhe të Arteve, mbi liberalizmin e ndikimet e huaja në këto institucione si dhe masat e marra kundër tyre.

³⁰ Po aty, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 289, fl. 1-9. Informacion i Jakup Matos mbi diskutimin e zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve mbi dramaturgjinë.

Trekëndëshi i famshëm – Ai, Ajo, Ai – u bë tepër monoton. Mjafton të përmendim dramat “Një dimër i shkurtër” të Sheri Mitës, “Midis dy njerëzve” të Kiço Blushit, “Një shok i klasës sonë” të Kujtim Spahivoglit, “Historia e një vajze” e Kleanthi Dushës e ndonjë tjetër dhe të bindemi për këtë qark të ngushtë problematik”.³¹

Pasi kritikon dramën “Nuk kam mall për vjetërsira” të Fadil Paçramit, Kolë Jakova qëndron te drama “Historia e një vajze”. “Nuk kemi nevojë për mikrodrama, – thoshte ai, – drama që i përkasin jetës intime të dy-tre njerëzve dhe të tjerëve nuk u intereson fare, aq më pak nuk kemi nevojë për drama që predikojnë shthurjen morale të vajzës sonë siç predikon “Historia e një vajze”, e cila është fyerje për femrën tonë. Liberalët në mjaft raste kuptuan për konservatorizëm ligjet që rregullojnë jetën dhe marrëdhëniet në shoqëri. Ata u ngritën kundër këtyre ligjeve në mënyrë që të shkohej më shpejt në shthurje morale. Një erë të tillë të keqe bie dhe drama “Një shok i klasës sonë” e Kujtim Spahivoglit e ndonjë tjetër”.³²

Po e njëjta optikë vlerësimi ndaj jetës dhe njeriut shihet edhe te dramat “Studentja e vitit të fundit” e Ibrahim Uruçit apo “Midis dy njerëzve” e Kiço Blushit, ku predikohet “dashuria e lirë”, e ashtuquajtur e “madhe”. E vërteta e raportit dashuror dhe marrëdhëniet në familje paraqiten të deformuara. Ato duken sikur nuk kanë stabilitet, janë me themele të paqëndrueshme. “Pak ka gjetur vend trajtimi i masës si forcë kryesore lëvizëse e shoqërisë, – shkruhet më tutje në këtë informacion, – roli i saj në transformimet e mëdha socialiste. Mungon kështu drama e vërtetë popullore, me karakter epik, ku të pasqyrohej jo vetëm fizionomia e masës, por edhe lidhja e saj dialektike me figurat e heronjve tanë”.³³ Në mbledhje u kritikuan dukuri moderniste në dramaturgji, si mbivlerësimi i konvencionit dhe simbolikës, keqpërdorime të retrospektivave, copëzime të veprimit dhe karaktereve, fragmentarizëm dhe shthurje të dialogut, imitime të formave artistike dekadente. Si konkluzion i fundit u nënvizua se:

“Diskutuesit theksuan se mësimet e Partisë dhe fjalimet e fundit të shokut Enver janë një ndihmë e çmuar për dramaturgët tanë, si për gjithë punonjësit e tjerë të letërsisë dhe artit. Mjaft diskutues, si Teodor Laço,

³¹ *Po aty*, fl. 5.

³² *Po aty*.

³³ *Po aty*, fl. 6.

Kudret Velça, Fatos Kongoli etj., bënë autokritikë për mendime të padrejta të shprehura në shtyp për probleme të dramaturgjisë. Ndërsa në ndonjë diskutim si në atë të Miho Gjinit u vunë re prirje për të zvogëluar arritjet e dramaturgjisë sonë”.³⁴

Informacione të ndryshme, shpesh edhe për një vepër të caktuar duke identifikuar “gabimet e saj ideore”, shihen edhe në materiale të tjera. Bie fjala, informacioni i Andon Rudhës mbi një dramë të Kujtim Spahivoglit paraqitur në Klubin e Kulturës të Kombinatit të Tekstileve Stalin në Tiranë. Autori thekson se kjo dramë me titullin “Hapat e parë. Dhimbjet e fundit”, fillimisht me titullin “Kurvat e Kombinatit”, “me të vërtetë përmbajtja të revoltonte. Sido që titulli është ndryshuar, përmbajtja mbetet po ajo...”.³⁵ U ndaluan menjëherë disa vepra dramatike që ishin menduar të vihehin në skenë, duke u konsideruar me “gabime ideologjike”, ndër to drama “Grushti i fundit” e Namik Dokles, komedia “Miku i Namikut” e Dionis Bubanit, drama “Emra të shkrojtura mbi shkëmb” e Spiro Urumit, drama “Baltë e bar” e Loni Papës, drama “More Morana” e Ramiz Likes, drama “Shoqja K. e të tjerë” e Mexhit Prençit etj.³⁶

Kritika të rrepta adresohen për estradat, largimin e tyre nga tradita, ndikimet e artit të huaj, pëlqimet e natyrës së spektakleve televizive, parada e ngjarjeve, kufizimi i tematikës dhe problemeve, reduktimi i figurës artistike, prania e tepruar e konvencioneve në skenografi, kostume. Prej saj kërkohej me forcë të luante rolin si “gazetë folëse e partisë”.

2.

Kinematografia si art me ndikim të fuqishëm te masat e gjera, kërkohej të ishte më e qartë në idetë e saj dhe të mos krijonte “keqkuptime” e shtrembërime të realitetit, siç kishte ngjarë me filmin “Përse bie kjo daulle” me autorë Ksenofon Dilon e Piro Milkani, filmin “Gjurma”, ku “klasa punëtore në ndonjë episod paraqitet me brutalitet”,

³⁴ *Po aty*, fl. 9.

³⁵ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 288, fl. 43-44. Informacion i Andon Rudhës mbi një dramë të Kujtim Spahivoglit paraqitur në Klubin e Kulturës të Kombinatit të Tekstileve Stalin në Tiranë. Tiranë, më 7 shtator 1973.

³⁶ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 289, fl. 46-51. Informacion i zëvendësministrit Mantho Bala mbi disa vepra dramatike me shqetësime ideore, të cilat u parandaluan të vihen në skenë nga teatrot tona.

konflikti etër dhe bij është dhënë përmes një përfytyrimi të shtrembër. Filmi “Yjet e netëve të gjata” i Viktor Gjikës, i cili u hoq nga qarkullimi për arsyen se aty, sipas këtij raporti, nuk ishte partia që i ndërgjegjësonte njerëzit të dilnin partizanë, por “trashëgimi i trimërisë dhe shpirti luftëtar brenda guaskës së një familjeje. Filmi përshkohet nga natyralizmi, nga tmerri i luftës, absurditetet dhe rastësitë”.³⁷ Në lenten e kritikës futen edhe filmat “Kur zbardhi një ditë” (novela “Meçua”) dhe “Kapedani”. Ky i fundit goditet për hiperbolën komike. Siç shihet, në të dy filmat e përmendur në fund kritikët janë të anshme, të padrejta dhe abuzive, teksa koha vërtetoi të kundërtën duke i rivlerësuar si filma me fuqi artistike e realiste. Por, edhe kritika ndaj filmit “Yjet e netëve të gjata” bëhet nga një pozitë e ngushtë thellësisht ideologjike e skematike.

3.

Në nyjen kushtuar muzikës flitet për largimin nga tabani kombëtar dhe mosvlerësimi i folklorit si burim i pashtershëm frymëzimi. Ironizohet mendimi, i quajtur i “padenjë”, që koncerti për piano e orkestër i Feim Ibrahimit ishte larguar nga “çiftelia e mërzitshme”, siç kishte ironizuar dikush duke u tallur me praninë e pavend të folklorit në muzikën simfonike. Duke shmangur këngën dhe vallen popullore, sipas këtij raporti, hapësirën më të madhe muzikore të vendit e kishte zënë kënga e muzikës së lehtë me ritmin dhe elementet e saj shprehëse. Ritmi ishte mbivlerësuar në shumë shfaqje estrade, koncerte, emisione muzikore të radios, çka gjeti shprehje edhe në festivalin e 11-të të Këngës në Radio-Televizion. “Ky festival nuk ishte një fenomen i rastit, por rezultat i koncepteve të gabuara, i qëndrimeve liberale, që çuan deri në imitime të formave të shëmtuara të artit dekadent borgjez”.³⁸

Edhe në raportin e sekretares së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Hamide Stringa, mbi diskutimet e zhvilluara rreth ndikimeve të huaja në fushën e muzikës, flitet për asimilimin e pamjaftueshëm të modeleve të muzikës botërore si të shekullit të kaluar, ashtu edhe të shek. XX. Kritikohet koncepti liberal për të bërë muzikë “moderne”, “rinore”, moskuptimi i formës kombëtare në muzikë, dinamizmi i jetës dhe psikologjia e njeriut të ri, të cilat nuk lidhen me dinamizmin dhe pulsacionet e jashtme, thellimi dhe identiteti i gjuhës muzikore shqiptare,

³⁷ Po aty, fl. 19.

³⁸ Po aty, fl. 21.

mohimi i traditës, vlerësimi i folklorit si “tradicionalizëm dhe anakronizëm”, raporti mes novatores e traditës, roli i burimit popullor në krijimtarinë e kultivuar, mungesa e atmosferës krijuese dhe krijimi i konflikteve përçarëse etj.³⁹

4.

Në nyjen pasuese kushtuar arteve figurative theksohej ulja e kërkesave për realizimin e tablove tematike dhe kompozimeve që trajtonin problemet më të rëndësishme të jetës, duke u kushtuar hapësirë më shumë veprave me theksa lirikë dhe momenteve dashurore, peizazheve e natyrave të qeta. Në ekspozitën e pranverës së vitit 1973 konstatohej se “tabloja tematike u reduktua pothuajse në zero”.⁴⁰ Elementi suditës dhe shpërfaqjet e përcipta të tablove të realitetit, mosthelli në motivet e jetës së figurave të pasqyruara i kishte çuar artistët, sipas raportit, në kalimin e qetë të situatave, në format pllakateske, siç u vunë re në ekspozitën e 25-vjetorit të Çlirimit, ndërsa veprat “Zgjimi” i Nestor Jonuzit, “Radio Tirana” e Zamir Matit apo “Elektrifikimi” i Ali Osekut, “Pusi 542” i Edison Gjergos, “Autoportret” i Agim Zajmit ngriheshin mbi motive joreale. Ato u realizuan me mjete artistike të huazuara, çka kanë shkaktuar një eklektizëm në mënyrën e shprehjes piktorike. Është me interes të theksohet se nga ekspertët partiakë në krijimtarinë e artistëve të arteve figurative nuk lihej jashtë vëmendjes ajo që u quajt “krijimtaria e studiove”, ku përmendet veçanërisht natyra e qetë – kompozim i piktorit Maks Velo, që paraqet kafkën e njeriut pranë xhubletës shqiptare në një sfond të errët. Si rrugë zgjidhjeje kërkohej një mbështetje në traditat e folklorit dhe të etnografisë shqiptare, teksa motivet që vinin prej andej në këto arte ishin tepër të rralla. Artistët nuk e shihnin pasurimin e gjuhës së tyre piktorike duke shfrytëzuar burimet e këtij folklori, por i drejtonin sytë nga arti i huaj, duke mos e parë atë nga syri kritik dhe kriteri klasor. Duke luftuar teatralitetin, shkollarizmin, natyralizmin, pasqyrimin pasiv, artistët shpesh u mbështetën në kulturën librore të riprodhimeve, në imitimet natyraliste e moderniste duke eksperimentuar në studiot e tyre dhe duke humbur “kontaktin me realitetin”. Shfaqjet e ndikimeve të huaja, sipas

³⁹ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 302, fl. 22. Raport i sekretares së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Hamide Stringa, mbi diskutimet e zhvilluara rreth ndikimeve të huaja në fushën e muzikës.

⁴⁰ *Po aty*.

raportit, ishin vënë re edhe në artet e aplikuara, në skenografi, ilustrime librash e kopertina, në grafikën industriale, artin dekorativ, atë ornamental etj.

Lidhur me luftën kundër ndikimeve të huaja në artet figurative ka raportuar edhe piktori Ksenofon Dilo, ku ai paraqet disa autorë dhe vepra që i reflektojnë këto ndikime. Sipas tij, në krijimtarinë e piktorëve shpesh sundonte një manierë impresioniste, paqartësi të formës realiste, mungesë në thellimin dhe analizën e figurave e të ambientit (përmenden vepra të tilla, si “Çrrënjësja” e Skënder Kamberit; “Zgjimi aksionist” i Nestor Jonuzit; “Kur yjet mbushin qiellin” e Naxhi Bakallit; “Epoka e yjeve të mëngjesit” dhe “Pusi 542” të Edison Gjergos; “Radio Tirana” e Zamir Matit, peizazhe e portrete me kërkesa estetizante nga Ali Oseku, Llambi Blido, Alush Shima, Vilson Halimi, Qirjako Doni, Maks Velo ose disa punë të paqarta dhe kontradiktore të Edi Hilës, Arben Bashës, Nexhmedin Zajmit, Sali Shijakut etj. Po kështu në skulpturë disa shëmbëllime që vinin nga skulptura sovjetike, siç shihet te “Revolucioni marshon” e Shaban Hadërit, “Revolucioni marshon” e Thanas Papës, “Lart frymën revolucionare” e Muntaz Dhramit etj.⁴¹

Për gjendjen e grafikës dhe shkeljet e hasura aty bën fjalë edhe relacioni i Ksenofon Dilos, mbi diskutimin e zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve, lidhur me ndikimet e huaja në grafikën e librit, ku tanimë kritikohet “shija ekstravagante, moderniste, ku me kriter e pa kriter abstragohen format”, ku ndikimet në këtë lloj arti vijnë “si huazim i elementeve të grafikës – reklamë të mbushur me gjithfarë ngjyrash e formash shpesh pa ndonjë kuptim, pa ndonjë ide e përmbajtje, me stile germash shumë herë të marra pa kriter nga modelet e grafikës së huaj – reklamë të shpikura nga piktorët”, “prirja e karakterit komercial”, “gërshetimeve eklektike të stileve të ndryshme”, “mania për të thjeshtësuar apo komplikuar vizatimin dhe ngjyrat”, ndikimi nga “ekspresionizmi dekadent dhe kubizmi”, “manierizmi” etj.⁴²

Në raportin e Kujtim Buzës, si përgjegjës i sektorit të arteve figurative në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës, bëhet me dije se në artet figurative ishin vërejtur ndikime të huaja, mungesë e thellimit në përmbajtje, raportet e deformatuara midis traditës dhe novatorizmit, zbehja

⁴¹ Po aty, fl. 23-24. Informacion i Ksenofon Dilos mbi luftën kundër ndikimeve të huaja në artet figurative.

⁴² Po aty, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 296, fl. 11-15. Relacion i Ksenofon Dilos “Mbi grafikën e librit dhe luftën kundër ndikimeve të huaja”, 1973.

e realizmit në trajtimin e tablove të mëdha, zotërimi i soditjes në raport me thellimin në brendi, ide e domethënie etj.⁴³ Në këtë raportim, bie në sy hapësira e gjerë që u kushtohet disa koncepteve “liberale” të kritikut Andon Kuqali të shfaqura në artikujt e tij, ku vihet re tendenca e tij për një “luftë të pamëshirshme konservatorizmit, natyralizmit, letrarizmit, anakronizmit dhe minimizim të rrezikut liberal, të tendencave të huaja, pra, tendenciozitet në luftë kundër rutinës konservatore dhe zbutja e këtij qëndrimi parimor në luftë kundër shfaqjeve të huaja”.⁴⁴ K. Buza ka cituar edhe ide e mendime që e reflektojnë qëndrimin e kritikut A. Kuqali ndaj arteve figurative “duke luftuar kundër fenomeneve të jashtme demonstrative si dhe kundër skematizmit dhe kuptimit vulgar anekdotik të subjektit”.⁴⁵ Po kështu, ai citon edhe një mendim kritik e të guximshëm të A. Kuqalit për kohën, i cili shkruante: “Një kuptim dogmatik i artit dhe i rolit të tij si rrjedhim i koncepteve burokratike e ka kufizuar ndonjëherë tematikën dhe zhvillimin e disa gjinive... Për sa i përket temave janë inkurajuar dhe përkrahur në radhë të parë, ato me karakter përfaqësues e zyrtar. Në këtë mënyrë janë formuar skema, është kufizuar këndi i vështrimit”.⁴⁶

5.

Po i njëjti parashtrim e arsyetim vijon edhe në nyjen kushtuar letërsisë, ku flitet për disa krijime në fushën e poezisë dhe të prozës, të cilat vlerësoheshin me gabime, shqetësime të ngushta individuale, tema të “vogla” dhe intime pa frymëmarrje sociale dhe të paangazhuara ideologjikisht. Pati një rendje të theksuar pas temës së dashurisë. Në prozë, – shkruhej më tej në raport, – krijimtaria u përqendrua në ndarjet e lehta burrë-grua, me dashurinë e shkëputur nga jeta etj. Në tregimin “Fushata” të Sabri Godos u vu re prirja për deheroizimin në pasqyrimin e Luftës Nacionalçlirimtare, ku sundon paniku, dëshpërimi, çorganizimi. Tri vepra të Zydi Moravës ishin vlerësuar të pabotueshme, romani “E diela nuk është larg” i Dhimitër Xhuvanit kishte shfaqje të nxirjes së realitetit, romani “Shënimet e shkruara natën” i Sotir Andonit nuk e vinte

⁴³ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 302, fl. 18-21. Raport i Kujtim Buzës me titull “Disa probleme të arteve figurative në dritën e fjalimeve të shokut Enver”, Tiranë, më 19 prill 1973.

⁴⁴ *Po aty*, fl. 2.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 4.

⁴⁶ *Po aty*.

luftën në tonet optimiste e revolucionare, vepra “Vdekja e psalltit” e Spiro Gjirkondit shfaqte mëshirë për armikun, në poemën “Dielli dhe rrëketë” të Fasli Halitit kishte influenca të qarta të artit revizionist. Disa autorë ranë në prehrin e artit kozmopolit jashtë kohës dhe jashtë jetës shqiptare. Në poezi flitej për dashurinë universale, për një revolucion imagjinar, u la vargu tradicional, u kalua në abstragime dhe hermetizëm, çka u shpreh në mënyrë flagrante në librin poetik të Fatos Arapit “Më jepni një emër”, i cili u ndalua të botohej. Prirej të forta të hermetizmit kishte edhe libri poetik i Frederik Reshpjes “Në këtë qytet”, ku ndihej mania e formës. Sipas raportit “një ndikim negativ tek poetët tanë e sidomos tek të rinjtë ka ushtruar edhe poezia kosovare, e cila në përgjithësi vuante nga paqartësia, nga formalizmi dhe prirjet për t’u larguar nga perceptimi realist. Kështu p.sh. disa shfaqje të panteizmit poetik në poezinë tonë ishin identike me ato që ndesheshin në vjershat e autorëve kosovarë”.⁴⁷

Pasi paraqiten edhe disa devijime, shtrembërime e manifestime të koncepteve të shtrembra e formave të huajtura nga kultura borgjezo-revizioniste në fushën e veprimtarive kulturore masive, raporti dedukton në mendimin se “presioni i ideologjisë borgjeze e revizioniste në letërsi dhe arte dhe të gjitha ndikimet e tyre që mundën të depërtojnë tek ne nëpërmjet mjeteve të propagandës dhe komunikimit social, në ekzistencën e luftës së klasave brenda vendit, u dhanë shkas edhe disa mendimeve e teorizimeve për të përligjur në një formë ose në një tjetër qëndrime liberale ndaj shfaqjeve të huaja në krijimtarinë letrare artistike, në interpretim dhe ekzekutim”.⁴⁸

Kritiku Dalan Shaplllo jep një panoramë mbi diskutimin e zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve lidhur me ndikimet e huaja në gjininë letrare të tregimit.⁴⁹ Siç shihet, është po e njëjta logjikë vlerësuese që vepron kudo, si të thuash një përsëritje e disa ideve, mendimeve e qëndrimeve politike të shprehura më parë nga forumet e PPSH-së dhe fjalimet e Enver Hoxhës, të cilat riciklohen me ca fjalë të tjera, ose edhe me përsëritje të po të njëjtave konstatime. Në këtë diskutim pati një hapësirë të gjerë kritika ndaj dy tregimeve, “Provokacioni” i Ismail

⁴⁷ *Po aty*, fl. 23.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 24.

⁴⁹ Shih *po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 289. Informacion i Dalan Shaplllos mbi diskutimin e zhvilluar në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve lidhur me ndikimet e huaja në gjininë letrare të tregimit.

Kadaresë dhe “Fushata” e Sabri Godos. Edhe njëherë këtu u paraqit ideja lidhur me ndikimet e “humanizmit abstrakt”, “erotizmi i papërshtatshëm për letërsinë tonë”, “objektivizmi”, “mungesa e idealit”, “hermetizmi dhe errësimi i mendimit” etj.⁵⁰ Interesante është të pohohet se Ismail Kadare nuk bëri autokritikë dhe u largua nga mbledhja, ndërsa Sabri Godo e pranoi kritikën pjesërisht duke kundërshtuar artikullin e F. Zeqos botuar në gazetën “Drita” mbi tregimin e tij “Fushata”.⁵¹ Shpesh për vepra të veçanta janë bërë edhe relacione dërguar Komitetit Qendror të PPSH-së, sikurse janë ato për romanin e Petro Markos “Niku i Martin Gjinit”,⁵² drama “Historia e një vajze” e Kleanthi Dushës,⁵³ drama “Historia e një nate” e Minush Jeros⁵⁴ etj.

6.

Një tjetër problem, që lidhet me kontrollin partiak të krijimtarisë letrare artistike, ishte funksionimi edhe më i rreptë i hallkave të miratimit, pasuar nga masat shtrënguese, duke e bërë zinxhirin e administrimit dhe vetë procesin edhe më të vrazhdë. Kjo u reflektua te syçelja ideologjike për dramat që do të viheshin në skenë, librat që do të botoheshin, ekspozitat e arteve figurative që do të çelleshin, koncertet muzikore që do të jepeshin etj. Frika dhe përgjegjësia u rrit së tepërmi. Komisionet, këshillat artistikë, kolegjiunet letrare, recensimet, hallkat miratuese në forumet e partisë dhe hierarkinë e saj, në ato të pushtetit ekzekutiv, më tutje në mbledhjet e kolektivave krijuese, diskutimet dhe marrja e “mendimit të popullit” etj., u rimodeluan dhe u përforcuan si forma të kontrollit të shumëfishtë ndaj krijimtarisë, shkrimtarëve e artistëve. Kjo e futi letërsinë, artin, kulturën, botimet, shtypin në një darë të fortë me filtra të shumtë, një censurë dhe autocensurë të rreptë. Për çdo institucion dhe fushë arti u dhanë edhe udhëzimet e rregullat përkatëse: për botimet, për Kinostudion, për Teatrin e Operës dhe Baletit, për Radio-Televizionin, për teatrot, për estradat, për ekspozitat e arteve figurative dhe simbolet përkujtimore, për shtypin e përditshëm periodik.⁵⁵

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*.

⁵² *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 287, fl. 18-22.

⁵³ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 289.

⁵⁴ *Shih po aty*. Informacion i shkruar nga Miho Gjini.

⁵⁵ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 293, fl. 32-40. Raport i zëvendëskryetarit të Këshillit të Ministrave, Xhafer Spahiu dhe sekretarit të Komitetit Qendror të PPSH-së,

Masa të tilla u reflektuan menjëherë në jetën artistike e kulturore të vendit.⁵⁶

7.

Problem i rëndësishëm dhe me ndjeshmëri të mprehtë sociale në formimin e njerëzve dhe të shijeve që botimi i librave të shkrimtarëve të njohur nga letërsia botërore. Ndonëse ka qenë një çështje e shtrirë në kohë, problemi mori tërësi të mprehtë pikërisht në fushatën e egër që u ndërmor ndaj çdo të ashtuquajture “shfaqje të kulturës borgjeze perëndimore”. U ndaluan shumë tituj librash nga shkrimtarët e mirënjohur të botës. Në studimin e komisionit të kulturës në Komitetin Qendror të PPSH-së të vitit 1969 është dhënë gjendja dhe kriteret themelore për botimet në fushën e letërsisë së huaj. Të bën përshtypje aty ngushtësia e vështirë vlerësues dhe selektimi i rreptë mbi kriteret mirëfilli politike e ideologjike, që dëshmonin një vetëdije të ngurtë izolacioniste.⁵⁷ Po kjo politikë kufizuese dhe diskriminuese në fushën e botimeve të letërsisë botërore shfaqet edhe në vitin 1973, pas fjalimeve të Enver Hoxhës në fillimin e këtij viti.⁵⁸ Në një raport të Komitetit Qendror për botimet konsiderohet qëndrim liberal porositja pa kriteret ideologjike e librit të huaj, ku, ndër të tjera, përmenden autorë eminentë të letërsisë dhe mendimit botëror, si Prusti, Sartri, Sagani, Kafka, Solxhenicini, sikurse tituj të shumënjohur nga vepra të quajtura moderniste e dekadente. Kjo konsiderohej e gabuar.⁵⁹

Puna me botimet e librave nga autorët shqiptarë dhe autorët e huaj, shihet qartë në raportin e komisionit për letërsinë dhe artet në Komitetin Qendror të PPSH-së, firmosur nga Ali Abdihoxxha, i datës 13 prill 1973. Në gjithë frymën e tij zotëron qëndrimi kritik ndaj disa botimeve, si: libri

Ramiz Alia: “Orientime të Komitetit Qendror të PPSH dhe Këshillit të Ministrave për forcimin e kontrollit paraprak të krijimtarisë letraro-artistike”, Tiranë, më 6 dhjetor 1973.

⁵⁶ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 289, fl. 46-51. Informacion i zëvendësministrit Mantho Bala mbi disa vepra dramatike me shqetësime ideore, të cilat u parandaluan të vihen në skenë nga teatrot tona.

⁵⁷ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1969, D. 3, fl. 174-287. “Studim i komisionit të kulturës në Komitetin Qendror të PPSH-së mbi gjendjen dhe kriteret themelore për botimet në fushën e letërsisë origjinale dhe të huaj”, nënshkruar për grupin e studimit nga Ali Abdihoxxha.

⁵⁸ *Po aty*, F. 14/AP-Str., V. 1973, D. 962, fl. 1-9.

⁵⁹ *Po aty*, fl. 7.

“Zëra nga burime të nxehta” të Sabri Godos, romani “E diela nuk është larg” e Dhimitër Xhuvanit, “Hapësirë në dashuri” e Kiço Blushit, vëllimi poetik “Stinë pas stine” e Viktor Qurkut, “Më jepni një emër” e Fatos Arapit, “Në këtë qytet” e Frederik Reshpjes; ose libra të tjerë si “Ylberi”, “Pas shtrëngatës”, “Buzë dashurisë”, “Germa dashurie” etj.⁶⁰

8.

Veprimtaria demaskuese e linçuese që u ndërmor nga regjimi komunist ndaj krijuesve shqiptarë, të cilët kishin prirje dhe frymëzime liberale, u pasua me një fushatë të ashpër kritikash në shtypin e kohës dhe më pas me një sërë botimesh në fushën e mendimit estetik⁶¹ e të kritikës letrare artistike, ku merreshin në shqyrtim tezat e hedhura nga Enver Hoxha dhe citoreshin e ricitoreshin slogane të shkëputura nga veprat e tij dhe fjala e mbajtur në Plenumin IV.⁶² Këto botime në shumicën e rasteve patën karakterin e një shoshitjeje, selektimim vlerësimi dhe kritike të rreptë ndaj ideve, veprave dhe autorëve të ndryshëm. Qëndrimet partiake këmbëngulën fort për pastërtinë ideologjike marksiste-leniniste të brendisë së kulturës, artit dhe letërsisë së realizmit socialist,⁶³

⁶⁰ Po aty, F. 14/AP-Str., V. 1969, D. 3, fl. 174-287. “Studim i komisionit të kulturës në Komitetin Qendror të PPSH-së mbi gjendjen dhe kriteret themelore për botimet në fushën e letërsisë origjinale dhe të huaj”, nënshkruar për grupin e studimit nga Ali Abdihoxha.

⁶¹ Alfred Uçi, *Probleme të estetikës* (Tiranë: Naim Frashëri, 1976), 89-130, 141-184, 205-242 (Në këtë libër shqyrtoheshin raportet e artit të realizmit socialist me ideologjinë marksiste, metoda e realizmit socialist, të kuptuarit e mendimit kritik dhe teorik, modernizmi si shprehje e degjenerimit të kulturës artistike borgjeze e revizioniste, modernizmi si ndërgjegje mitologjizuese etj.).

⁶² Raqi Madhi, *Lufta e klasave në letërsi e arte në vendin tonë* (Tiranë: 8 Nëntori, 1984), 40-173 (Kreu I: Thellimi i revolucionit ideologjik e kulturor dhe zhvillimi i luftës së klasave në letërsi e arte; Kreu II: Thellimi i luftës së klasave në letërsi e arte. Shkatërrimi i grupit armiqësor të F. Paçramit e T. Lubonjës; Kreu III: Forcimi ideoestetik i letërsisë e i arteve bëhet nëpërmjet luftës së klasave).

⁶³ Tefik Çausi, *Për mendimin estetik të PPSH* (Tiranë: 8 Nëntori, 1983), 43-71, 98-117, 123-153. Autori shqyrton, ndër të tjera, fizionominë e artit të revolucionit, tiparet e artistit revolucionar, forcimin e bazave ideologjike të tij, konsolidimin e metodës së realizmit socialist, edukimin dhe riedukimin e krijuesve, forcimin e militantizmit në arte si edhe tema të tjera aktuale, si partishmëria, botëkuptimi, talenti, pastërtia ideologjike, udhëheqja e partisë si domosdoshmëri objektive për zhvillimin e artit socialist, ideologjia marksiste-leniniste dhe arti i huaj, arti si objekt dhe subjekt i luftës së klasave, natyra krijuese e metodës së realizmit socialist.

partishmërinë proletare si parimi kryesor i realizmit socialist,⁶⁴ raportin e jetës me krijimtarinë gjegjësisht të koncepteve ideologjike të PPSH-së,⁶⁵ e vërteta jetësore dhe e vërteta artistike, individualizimi i figurës përmes veprimit,⁶⁶ raportin e traditës me novatorizmin, pohimit dhe mohimit, kuptimin e heroit pozitiv,⁶⁷ karakterin kombëtar në letërsi dhe arte.⁶⁸ Për të ndërtuar një metodologji vlerësimi për letërsinë dhe artet e realizmit socialist duke u dhënë atyre një teori, si të thuash, “origjinale shqiptare”, mbështetur kryesisht në idetë e Enver Hoxhës, u botuan edhe tekste – manualë teorikë në fushën e estetikës.⁶⁹ Kritika e asaj kohe luajti rolin e një censure të rreptë për frenimin e prirjeve liberalizuese dhe të risive që mund të shfaqeshin në këtë fushë.⁷⁰ U ndalua çdo mendim, çdo veprim e çdo tendencë, e cila mund të sillte në arenën e ideve dhe sjelljeve të shoqërisë dëshirën për ndryshim. Ky plenum famëkeq pati pasoja shumë të rënda, të cilat u shtrinë në një periudhë mbi dhjetëvjeçare, gjer në vitet e fundit të jetës së Enver Hoxhës dhe vdekjen e tij më 1985.

Nga gjithë të dhënat e sjella falë raportimeve, informacioneve, mbledhjeve të institucioneve partiake e shtetërore mbi ndikimet e huaja në kulturë, letërsi dhe arte, vija e ashpër, intolerante, ndëshkuese dhe ekstremiste e PPSH-së shihet ngado. Klima e frikës, terrorit, goditjes së vrazhdë, e cila më pas do të vijonte me ndëshkime, largime nga puna, internime në rrethet dhe fshatrat e largëta, burgosje të jo pak artistëve, ritheksoi ashpërsinë e regjimit, karakterin konservator të tij, vetëmbylljen, dhunën, mbytjen e çdo nisme liberalizuese dhe

⁶⁴ Adriatik Kallulli, *Mbi partishmërinë proletare në letërsi dhe art* (Tiranë: 8 Nëntori, 1978).

⁶⁵ Dritëro Agolli, *Jeta në letërsi. Artikuj dhe studime* (Tiranë: Naim Frashëri, 1987), 5-42, 67-81.

⁶⁶ Xhezair Abazi, *Jeta dhe procesi letrar* (Tiranë: Naim Frashëri, 1984), 5-52, 100-120, 162-170.

⁶⁷ Adriatik Kallulli, *Në frontin e letërsisë* (Tiranë: Naim Frashëri, 1974), 69-133.

⁶⁸ Koço Bihiku, *Letërsia dhe koha, studime* (Tiranë: Naim Frashëri, 1982), 5-57, 84-101.

⁶⁹ Alfred Uçi, *Estetika, jeta, arti* (Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Politik, 1973) dhe Alfred Uçi, *Estetika*, vëll. I, II, III (Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 1989).

⁷⁰ Razi Brahimi, *Duke ndjekur procesin letrar* (Tiranë: Naim Frashëri, 1989), 30-41, 94-109, 130-139, 178-186 (ku trajtohen probleme nën optikën e Plenumit IV si Letërsia dhe artet – pasqyrë e luftës së klasave, heroi i ri dhe karakteri veprues i letërsisë, thelbi reaksionar i teorive çeroizuese, realizmi socialist si metodë artistike novatore, brendia socialiste e letërsisë dhe e artit etj.).

modernizuese të kulturës dhe arteve brenda vijave të kuqe të realizmit socialist, parimeve dhe ideologjisë komuniste në shfaqjet më dogmatike të tyre, të cilat vinin drejtpërdrejt nga lideri i PPSH-së, Enver Hoxha, me raprezaljet e njëpasnjëshme që ai do të ndërmernte gjatë gjithë viteve '70 e thua jse gjer në vdekjen e tij.

Përfundime

Cila ishte në fakt, arsyeja e vërtetë përse pikërisht në vitin 1973 u godit kaq ashpër kultura, letërsia dhe artet, duke gjetur, fabrikuar e shpallur shumë armiq të “rrezikshëm”, që kërkonin të devijonin kursin politik të PPSH-së drejt një politike më liberale e më tolerante?

Kur Hamza Koçiu i tha Todit vërejtjet e tij për dramën “Njollat e murrme”, Todi i tha: “Artisti i madh i shërben edhe borgjezisë, edhe revolucionit, dhe solli si shembull Tolstoin e Balzakun, domethënë që artisti qëndron mbi klasat”. Sigurisht, kjo linjë arsyetimi u konsiderua e papranueshme, ndonëse në thelb ishte e njëjtë me atë të Stalinit, i cili gati 40 vjet më parë, si rrallëherë, i doli në mbrojtje një shkrimtari të madh si Bulgakovi, vazhdimisht i përndjekur dhe i kërcënuar nga burokratët dhe kritikët më fanatikë e servilë të sistemit. Por kohët dhe nevojat e diktatorëve janë “kapriçoze”. Në rastin shqiptar, kësaj “gjuetie” iu shkua deri në fund dhe për disa pasojat ishin fatale.

Pra arsyet, më së pari, gjenden brenda fenomenit dhe karakterit të regjimit dogmatik e stalinist të PPSH-së, i cili herë pas here prodhonte enkas “armiq të brendshëm”, gjithmonë në kombinim me “armiqtë e jashtëm” (të cilët qenë, më së shumti, vendet e Europës Perëndimore dhe ato të hapësirës euroatlantike). Por një arsye tjetër, siç u provua më tutje, ishte frika dhe paranoja e diktatorit shqiptar ndaj kundërshtarëve të mundshëm politikë. Për këtë shkak, ai ndërmori një sërë masash për spastrimin dhe ndëshkimin e tyre, çka rezultoi me krijimin e një klime terrori dhe autarkie të plotë. Pas përjashtimit nga forumet e larta partiake të Fadil Paçramit dhe Todi Lubonjës, më tej goditja vijoi te Ministria e Arsimit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë dhe e Energjetikës, sektori minerar, nafta, vetëvrasja e Kryeministrit të vendit Mehmet Shehu, pushkatimi i Kadri Hazbiut, Feçor Shehut etj.

Burime dhe bibliografi:

Arkiva:

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)

Literaturë historiografike:

Abazi, Xhezair. *Jeta dhe procesi letrar*. Tiranë: Naim Frashëri, 1984.

Agolli, Dritëro. *Jeta në letërsi. Artikuj dhe studime*. Tiranë: Naim Frashëri, 1987.

Bihiku, Koço. *Letërsia dhe koha, studime*. Tiranë: Naim Frashëri, 1982.

Brahimi, Razi. *Duke ndjekur procesin letrar*. Tiranë: Naim Frashëri, 1989.

Çaushi, Tefik. *Për mendimin estetik të PPSH*. Tiranë: 8 Nëntori, 1983.

Indoktrinimi komunist përmes kulturës, letërsisë dhe artit (Dokumente historike), vëll. II (1969-1973). Përgatitën për botim Beqir Meta, Afrim Krasniqi, Hasan Bello, Instituti i Historisë dhe Fondacioni Konrad Adenauer. Tiranë: Emal, 2019.

Kallulli, Adriatik. *Mbi partishmërinë proletare në letërsi dhe art*. Tiranë: 8 Nëntori, 1978.

Kallulli, Adriatik. *Në frontin e letërsisë*. Tiranë: Naim Frashëri, 1974.

Madhi, Raqi. *Lufta e klasave në letërsi e arte në vendin tonë*. Tiranë: 8 Nëntori, 1984.

PPSH, Dokumenta kryesore, vëll. VI (1971-1975). Tiranë: 8 Nëntori, 1978.

Uçi, Alfred. *Estetika, jeta, arti*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Politik, 1973.

Uçi, Alfred. *Estetika*, vëll. I, II, III. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 1989.

Uçi, Alfred. *Probleme të estetikës*. Tiranë: Naim Frashëri, 1976.

ERJON PAPAGJONI

Institute of History / Academy of Sciences of Albania

THE “PURGES” IN THE FIELD OF LITERATURE, ARTS AND CULTURE IN 1973

S u m m a r y

At the beginning of the 70s of the last century in Albanian society, especially among young people, the need for change and openness to the Western world, to its culture and art, as well as to the joy of life was felt more and more. This trend was considered dangerous by the communist leadership

and its leader Enver Hoxha. For this reason, culture, literature and arts were penalized. As powerful influencing factors in people, extensive action was taken against them to strike at their natural tendencies to modernize. The decisions of the 4th plenum of the APS 1973 resulted in fact as a reprisal against artists, writers, creators, who were criticized, insulted, publicly humiliated and some of them were exiled and imprisoned. The purpose and political content of this plenum consisted in suppressing every tendency and manifestation of liberalism and so-called "foreign influences" in literature, arts and culture. When Enver Hoxha condemned the 11th Song Festival on Radio and Television at the beginning of 1973, numerous meetings and analyzes followed in the party forums in the months of January-June 1973, to reach the decisions of the IV Plenum, held on 26-27 June 1973. The unmasking and lynching activity undertaken by the communist regime was part of the extremism of the oppressive, intimidating, divisive policy towards Albanian creators with liberal tendencies and inspirations. The numerous publications that followed after this plenum assumed the character of a strict analysis and selection. The official critical thought of the time increased control over all published books, theatrical performances, films, musical creations, stage performances, etc. The reason why culture, literature and arts were hit was the fact that they were strongly influencing the general Albanian public. Their humanistic, emancipatory spirit was openly manifested in the need for more freedom of thought, for the cultivation of advanced aesthetic and artistic tastes, for the provision of a more beautiful and modern lifestyle, for tastes and affections towards the West, etc. The communist regime took strict measures, which resulted in the creation of a climate of terror. This blow to culture, literature and the arts was the ominous beginning of the retaliation that would follow in all areas for the asphyxiation of any pro-Western liberal tendencies.

MATERIALE SHKENCORE E KUMTESA

EDUART CAKA

Instituti i Historisë / Akademia e Shkencave e Shqipërisë

edicaka@hotmail.com

<https://doi.org/10.61773/kec8dq32>

LITERATURA E UDHËPËRSHKRIMEVE NË HISTORISHKRIMIN E HAPËSIRAVE KUFITARE: NJË ANALIZË E BURIMEVE PERËNDIMORE DHE LINDORE PËR ELBASANIN E SHEK. XVI-XVII*

Abstrakt:

Ndonëse në burimet historike përmendet si një qendër banimi e hershme, në të vërtetë Elbasani që njohim sot me fizionominë e vet, e ka zanafillën gjatë periudhës së vendosjes së sundimit osman në hapësirën shqiptare. Kështu, qyteti i rindërtuar prej Mehmetit II në verën e vitit 1466 thuhet për pesë shekuj do të bëhet njëra prej qendrave më të rëndësishme administrative, demografike e ekonomike të Shqipërisë për një periudhë pesëshekullore. Si një zonë e përshkruar që në kohët e hershme prej ushtrive, pelegrinëve, tregtarëve e udhëtarëve që frekuentonin rrugën e famshme Via Egnatia, Elbasani e ruajti këtë pozitë strategjike edhe gjatë periudhës osmane, duke u kthyer në një qendër urbane të klerikëve, tregtarëve, udhëtarëve e spiunëve të brendshëm e të huaj. Pikërisht kjo ka bërë që të formohet një literaturë e gjerë për Elbasanin. Në këtë artikull do të paraqesim një panoramë të qytetit të Elbasanit gjatë shek. XVI-XVII, e cila ishte një qendër e rëndësishme administrative e Shqipërisë por që njëkohësisht pozicionohej në një gjeografi kufitare duke qenë larg nga qendra, me përqendrim të burimeve dytësore sikurse janë librat e udhëtimeve. Analiza do të fokusohet te burimet perëndimore që japin informacion mbi qendrën në fjalë, por edhe ato lindore duke u ndalur tek të dhënat që jep udhëtari i mirënjohur osman i shek. XVII, Evlija Çelebiu.

* Kumtesë e mbajtur në “I. International Symposium on Evliya Çelebi: History and Culture of Travel”, Istanbul 5-7 October 2023.

Fjalë kyçe:

Periodha osmane, hapësira kufitare, Elbasani, udhëpërshkrime, Evlija Çelebiu.

Hyrje

Megjithëse gjetjet arkeologjike por edhe burimet historike e përmendin Elbasanin si një vendbanim të hershëm, qyteti që njohim sot e ka zanafillën te rindërtimi që Mehmedi II i bëri në vitin 1466.¹ Ekziston një literaturë e gjerë tashmë mbi mënyrën se si u rindërtua qyteti, për politikën popullore që osmanët ndërmorën këtu si dhe për ekuilibrat politikë, ushtarakë e ekonomikë që mbizotëruan në këtë hapësirë si rrjedhojë e ndërveprimit të aktorëve të rëndësishëm lokalë e rajonalë. Me këtë nënkuptojmë veçanërisht përpjekjet e Venedikut për të ndaluar pozicionimin e osmanëve pranë zotërimeve të tij dhe gjendjen e vështirë që po kalonte Skënderbeu që luftonte me osmanët për thuajse dy dekada.² Si përfundim, qyteti i themeluar me deportimin e më shumë se shtatëdhjetë familjeve që u sollën prej zonave përreth, brenda një shekulli do të kthehej në njërin prej qendrave më të mëdha demografike, ekonomike, politike e kulturore të Shqipërisë.³

¹ Në burimet e hershme, të cilat shkojnë pas në kohë deri në shek. II p. e. s., Elbasani përmendet si *Skampeis* (Scampia, Skampini). Për më shumë, shih Milan Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens, hauptsächlich während des Mittelalters* (Wien: Hölder-Pichler-Tempsky A.-G., 1924), 14; Hasan Ceka, “Nga historia e lashtë e Skampinit (Elbasanit)”, *Studime historike*, nr. 1 (1975): 147-151.

² Veçanërisht për përpjekjet e Venedikut për të ndaluar osmanët të vendosen në Elbasan dhe ndërtimin e kalasë prej këtyre të fundit, shih Aşık Paşazade, *Osmanoğulları'nın Tarihi*, Çev. Kemal Yavuz ve M. A. Yekta Saraç (İstanbul: MAS Matbaacılık, 2003), 251; Giannaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh* (Brescia: 1756), 455; Franz Babinger, *Aufsätze und Abhandlungen zur Geschichte Südosteuropas und der Levante*, vol. I (München: Schmidt & Klaunig Kiel, 1962), 203; *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëll. II, përgatitur nga Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pepo, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë (Tiranë: 1962), 345-346; Machiel Kiel, “İlbasan”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXII (İstanbul: TDV Yay., 2000), 79-81; Eduart Caka, “Vakëfet dhe funksioni i tyre në qytetin e Elbasanit gjatë shekullit XVII”, *Studime historike*, nr. 1-2 (2016): 100-102.

³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Illirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX), redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena,

Zhvillimi i shpejtë që përjetoi Elbasani gjatë shek. XVI lidhet me disa shkaqe, në krye të të cilave vjen pozita gjeografike. Prej shekujsh kjo hapësirë kishte qenë pjesë e itinerarit të ushtrive, karvanëve tregtarë, klerikëve, pelegrinëve, udhëtarëve e aventurierëve që ndiqnin të famshmen *Via Egnatia* për të mbërritur në qytetin e Kostandinit.⁴ Ndërsa tashmë, Elbasani nuk ishte vetëm një stacion i rëndësishëm që lidhte Durrësin e Shqipërinë me pjesët e brendshme të perandorisë për të mbërritur deri në Stamboll, por gjithashtu shërbente edhe si një stacion i ndërmjetëm për qytetet jugore shqiptare, si Berati, Gjirokastra, Vlora e Janina me ato të Veriut si Shkodra, Prizreni, Gjakova etj. Në të njëjtën kohë, Elbasani lidhej edhe me qendra të tjera të mëdha rajonale si Shkupi, Ohri, Manastiri e Selaniku. Kjo pozitë e rëndësishme gjeografike përbën edhe njërin prej faktorëve kryesorë që ndikuan në zhvillimin e qytetit.⁵

Funksionimi i Elbasanit si qendër sanxhaku, jo vetëm që shërbeu pozitivisht në zhvillimin demografik, ekonomik, politik e kulturor të qytetit, por bëri që këtu të vinin mjeshtër e zejtarë prej qendrave të ndryshme të sanxhakut, sikurse ishin nahijet e Durrësit, Çermenikës e Shpatit, prej të cilave gjithashtu silleshin në tregun e qytetit prodhimet bujqësore, blegtorale e detare duke krijuar një larmi të madhe. Kështu, krahas produkteve të detit dhe atyre të importit që vinin prej skelave të Durrësit e Bashtovës, nga zonat e ultësirës gjithashtu silleshin në tregun e Elbasanit edhe prodhime, si: kripë, ullinj, vaj ulliri, fruta, perime e varietete të ndryshme të grurit e misrit. Thua jse të ngjashme ishin edhe prodhimet që vinin prej zonës së Shpatit, ndërsa Çermenika, si hapësirë

2002), 548-549; Zija Shkodra, *Esnafet shqiptare (shek. XV-XX)*, Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: 1973), 28-32; Machiel Kiel, *Arkitektura osmane në Shqipëri (1385-1912)*, përktheu Klodiana Smalaj (Tiranë: AIITC, 2012), 137-138; Eduart Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social në Shqipërinë e periudhës osmane*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2021), 245.

⁴ Për pozicionin lidhës që kishte hapësira shqiptare ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes, duke shërbyer si një pikë e itinerarit të pelegrinëve qysh në kohët e hershme dhe për dëshmi të ndryshme mbi këtë çështje sa i përket periudhës së Mesjetës së Vonë dhe fillimit të kohës së re, shih Noel Malcolm, *Rebels, Believers, Survivors: Studies in the History of Albanians* (Oxford: Oxford University Press, 2020), 6-10.

⁵ Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: 1984), f. 233; Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre*, 272-276.

më e thyer, e furnizonte tregun e qytetit me produkte të blegtorisë. Pas viteve 1580 prodhimet e Elbasanit nisën të tregtoheshin në pazare të ndryshme të Rumelisë, ndërsa vetë qyteti në shek. XVII numëronte më shumë se 900 dyqane.⁶

Fuqizimi i një qendre të tillë administrative në qendër të Shqipërisë, do të bëhej shkak që qyteti të bëhej pjesë e itinerarit të udhëtarëve, tregtarëve, klerikëve e spiunëve të ndryshëm, të cilët do t'i jepnin qytetit vend në mesin e rreshtave që shkruan më pas. Kështu, Elbasanin e gjejmë të përshkruar si në shkrimet dhe relacionet e perëndimorëve, ashtu edhe në ato të autorëve osmanë.

Elbasani në burimet perëndimore të shek. XVI-XVII

Përkundër stabilitetit, ngadalësisë dhe vazhdimësisë që e karakterizonin qendrën, në hapësirat kufitare jeta paraqiste më shumë larmi. Kjo lidhej me faktin se kontrolli i qendrës ishte më elastik, por edhe për arsye se marrëdhëniet e ndërveprimi ndërmjet njerëzve që jetonin në të dyja anët e kufirit, paraqiste dinamizëm. Për shembull, ndonëse në kohët e thatësirave apo të luftës osmanët e kishin ndaluar tregtimin e misrit të venecianët, banorë ose qeveritarë lokalë e shkelën këtë ndalesë duke e eksportuar produktin në fjalë.⁷ E njëjta gjë vlente edhe për popullatën përtej Adriatikut. Kjo, mes të tjerash, edhe për faktin se një tregti e tillë sillte të ardhura më të mëdha. Por, arsyet e një ndërveprimi të tillë, nuk ishin mirëfilli pragmatiste. Kështu, veçanërisht katolikët që jetonin në hapësirat veriore të Shqipërisë, si rrjedhojë e përkatësisë së tyre fetare, ishin shumë më të lidhur me botën perëndimore, më konkretisht, me Vatikanin. Krahës klerikëve që shkonin për të kryer studimet teologjike, të tjerë u vendosën në Venecia ku u angazhuan në jetën ekonomike të këtushme.⁸

Veçanërisht pas pushtimit të Durrësit (1501) dhe Tivarit (1571), prezenca e shteteve perëndimore në këtë hapësirë, sidomos e Venedikut që kishte pasur zotërimet e veta këtu, kishte marrë fund dhe Perëndimi u përball me një terr informativ në lidhje me administrimin osman të rajonit, gjendje e cila do të zgjaste deri në fillimet e shek. XVII me

⁶ Për tregun, grupet esnafore dhe prodhimet e artizanëve elbasanas, shih: Shkodra, *Esnafet shqiptare*, 67; Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre*, 107.

⁷ Caka, *Vakëfet dhe ndikimi i tyre*, 225-226.

⁸ Shkodra, *Esnafet shqiptare*, 303-304.

hapjen e konsullatave të huaja tregtare në Perandorinë Osmane.⁹ Në një situatë të tillë dhe, përkatësisht në një kohë të brishtë kur shtetet perëndimore ishin në përpjekje të organizimit të një kryqëzate që do “t’i hidhte përfundimisht turqit jashtë Europës”,¹⁰ nevoja për të mësuar atë që ndodhte në “tokat turke” kishte më shumë rëndësi se përherë. Prandaj, raporte dhe relacione të kohës, të përpiluara prej klerikëve, udhëtarëve e tregtarëve mbartin rëndësi të veçantë për të kuptuar situatën në hapësira kufitare si ajo e Shqipërisë në kohën e përplasjes së perandorive të mëdha. Në këto tekste, ndoshta më ilustruesi prej të cilëve është ai i harruar prej kryepeshkopit të Tivarit, Vincent Zmajeviqit, pasqyrohet situata fetare në vend, aspekte demografike e klerikale që lidhen me këtë temë, çështje që kanë të bëjnë me qasjen e osmanëve ndaj popullatës vendëse,¹¹ mbi qytetet dhe gjeografinë e vendit si edhe të dhëna mbi popullatën në rastin e organizimit të një kryqëzate.

Edhe në rastin e Elbasanit, relacionet në fjalë nuk janë tekste që japin informacione të plota mbi qytetin, por të dhënat e përcjella në tekst konsistojnë në kuadër të temës që hartuesi i relacionit a letrës ka pasur për qëllim të hartojë. Për rrjedhojë, të dhënat për Elbasanin në këto tekste janë, diku një apo dy fjali, e diku tjetër një paragraf, të gjitha këto në kontekst të temës së parashtruar. Ndërkohë që, në traditën e *sejihatnameve*, sikurse do ta shohim edhe në rastin e Evlija Çelebiut, autori e përshkruan qytetin me hollësi duke i ndarë faqe të tëra. Në këtë kontekst, nëse do të shohim relacionet perëndimore të shek. XVII që flasin për Elbasanin, vërejmë se qyteti është trajtuar kryesisht në këto këndvështrime që po i paraqesim më poshtë:

a. *Konteksti politik e ushtarak*: në kohët kur Perandoria Osmane ishte e zhytur në kriza të karakterit politik ose ishte e dobësuar ushtarakisht, shtetet perëndimore tentonin të përfitonin nga situata dhe

⁹ Konsullata e parë që u hap në hapësirën shqiptare ishte ajo e Francës në vitin 1669, në qytetin e Durrësit. Pak kohë më vonë do të hapeshin edhe konsullatat e Venedikut, Anglisë, Holandës dhe Raguzës. Për më shumë, shih: Shkodra, *Esnaftet shqiptare*, 278.

¹⁰ Halil İnalçık, *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler ve Vesikalar*, I (Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1954), 2.

¹¹ Për relacionin në fjalë, shih *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-III-535, “Relacion i gjendjes së Shqipërisë dhe Serbisë të vizituara prej Vincent Zmajeviqit, kryepeshkop i Tivarit në vitin 1702 deri 1703”, vëll. II, përkthyer nga Injac Zamputi, Tiranë: 1988.

“t’i hidhnin turqit jashtë Europës”.¹² Duhet thënë se, gjatë këtyre shekujve në Europë ka ekzistuar vazhdimisht një plan i organizimit të një kryqëzate të madhe kundër osmanëve, motori organizues i së cilës kanë qenë me radhë, Vatikani, Spanja apo Austria. Ajo çka ka rëndësi për ne në këtë drejtim, është fakti se në të gjitha këto plane kryqëzatash, popujt e Ballkanit përllogariteshin si elementë ndihmës në luftën kundër osmanëve.¹³ Nëse do të kemi parasysh faktin se elementi përbashkues i këtyre planeve për kryqëzata ishte ai katolik, në hapësirën ballkanike vetëm shqiptarët dhe kroatët qenë më të lidhur me këto projekte. Këtë e vërejmë edhe nga relacionet që klerikë të ndryshëm dërgonin nga Shqipëria në drejtim të Vatikanit, ku krahas aspekteve fetare, në këto tekste jepeshin të dhëna informuese mbi potencialin që kishte kjo zonë për t’iu bashkëngjitur një kryqëzate të mundshme. Fjala vjen, në një letër që i dërgonte kardinalit Gozzadino në vitin 1621, peshkopi i Sapës dhe i Sardës, Pjetër Budi, shprehej se ky vend ishte i krishterë prej kohëve të hershme dhe se njerëzit e këtushëm qenë të gatshëm për të luftuar kundër osmanëve, me qëllim që të shpëtonin prej sundimit turk. Në të njëjtën letër, ai flet edhe për Elbasanin, ku shprehet se në këtë qytet jetonin bashkësi të krishtera.¹⁴ Po ashtu, në një relacion që dërgonte në vitin 1636, peshkopi i Zadrimës, Frang Bardhi theksonte se në rast të një lufte të mundshme, numri i luftëtarëve shqiptarë që mund t’u bashkoheshin ushtrive perëndimore mbërrinte deri në më shumë se 20 mijë trupa. Pasi përmend këtë të dhënë, ai jep informacione mbi ushtrinë osmane, duke u shprehur se këtu mund të vinte një trupë me maksimumi 40 mijë ushtarë

¹² Halil İnalcık, *Devlet-i ‘Aliyye: Osmanlı İmparatorluğu Üzerine Araştırmalar*, II (İstanbul: Türkiye İş Bankası, Kültür Yayınları, 2016), 184.

¹³ Për një studim të mirëfilltë në lidhje me integrimin e shqiptarëve brenda këtyre planeve për të hedhur osmanët prej Europës, shih Ardian Muhaj, *Projekte kundërosmane në shek. XVI-XVII mes fantazisë, interesit dhe realitetit*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë (Tiranë: Botimet albanologjike, 2022); Gjithashtu shih Noel Malcolm, *Agjentë perandorakë: Një familje shqiptare në botën mesdhetare të shekullit të gjashtëmbëdhjetë*, përktheu Kastriot Myftiu (Tiranë: Dudaj, 2015); Peter Bartl, *Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Osmane; Mbi çështjet e luftës antiturke në kapërcyell të shek. XVI dhe XVII*, përktheu Pëllumb Xhufi (Tiranë: Dituria, 2011).

¹⁴ *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, vëll. I (1610-1634), përkthyer dhe përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Gjuhësisë (Tiranë: 1963), 301-303.

dhe se hyrja e tyre në hapësirën shqiptare ishte e mundur vetëm përmes Elbasanit.¹⁵

b. *Konteksti fetar dhe kulturor*: në letrat dhe relacionet e dërguara prej klerikëve shqiptarë drejt Vatikanit, elementi fetar zë vendin kryesor. Kjo lidhet me dy shkaqe: e para ka të bëjë me faktin se tekstet në fjalë ishin shkruar me motive fetare dhe, së dyti, feja ishte qendra e jetës politike, sociale e kulturore për periudhën që po flasim. Për rrjedhojë, edhe këto relacione përmbajnë informacione mbi organizimin kishtar në Shqipëri, problemet me të cilat përballeshin klerikët e bashkësia dhe detaje të ngjashme mbi gjendjen e komunitetit katolik që jetonte në këtë gjeografi. Në kontekst me temën e trajtuar, herë-herë hasim përshkrime të qyteteve ku jetonte kjo bashkësi, fjala vjen për Shkodrën, Lezhën, Krujën etj. Por, për Elbasanin nuk gjejmë dot të dhëna pasi këtu jetonin “turqit dhe skizmatikët”, pra myslimanët dhe ortodoksët.¹⁶ Parë në këtë këndvështrim, informacionet mbi Elbasanin janë më të pakta krahasuar me qytetet më në Veri, porse burimet flasin vetëm për 17 kisha katolike që ekzistonin në fshatrat që vareshin prej Elbasanit.¹⁷

Një tjetër element që duhet përmendur sa i përket komunitetit katolik të Elbasanit, ishin edhe *kripto-kristianët* që jetonin në pjesën e Shpatit. Madje, ekzistenca e fenomeneve të tilla, ku pjesëtarë të bashkësisë së krishterë nisën të prezantoheshin në jetën publike si myslimanë ndërsa në të vërtetë ishin të krishterë, vrulli i islamizimit dhe problematika të tjera që vëreheshin në organizimin kishtar, e detyruan Vatikanin të ndërmernte hapa seriozë në këtë drejtim, masa të cilat u konkretizuan me urdhrin e Papës Klementi XI për mbajtjen e një kuvendi të përgjithshëm që u mbajt në Lezhë më 1703.¹⁸

c. *Konteksti ekonomik*: në fondet arkivore perëndimore, më saktësisht ato italiane, një pjesë e të cilave është përkthyer e botuar edhe në gjuhën shqipe, ekzistojnë dokumente të shumta edhe në lidhje me

¹⁵ *Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623-1653)*, transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputti (St. Gallen: Albanisches Institut, 2015), 143-145.

¹⁶ *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, vëll. II (1634-1650), përkthyer dhe përgatitur nga Injac Zamputti, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Gjuhësisë (Tiranë: 1965), 235.

¹⁷ *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore*, II, 235-237.

¹⁸ *Kuvendi i Arbënit (Romë 1706)*, Tekst kritik – përgatitur dhe pajisur me shënime si dhe me konkordancat leksikore nga Bardhyl Demiraj (Shkodër: Botimet françeskanë, 2012).

aspekte ekonomike e tregtare. Kështu, nëse në raportet kryesore që bajli venecian dërgonte prej Stambolli preken më shumë çështje të marrëveshjeve tregtare ndërmjet shteteve apo problematika të importit e eksportit, raportet e dërguara prej autoriteteve lokale përmbajnë tematika më të prekshme sikurse janë çështjet e kontrabandës. Për shembull, në këto relacione flitet për produkte si: misri, vaji, leshi, lëkura, lëndët drusore etj. që vendësit ua shishnin anijeve perëndimore, në krahun tjetër jepen informacione për armë e municione që futeshin fshehurazi në hapësirën shqiptare prej aktorëve të huaj, të cilat do të përdoreshin prej popullatës vendëse në raste të rebelimeve.¹⁹

Krahas përfaqësuesve diplomatikë dhe klerikëve, për shekujt në fjalë mund të evidentohet edhe një grup i vogël udhëtarësh a kronistësh që e kanë vizituar hapësirën shqiptare, duke na dhënë informacione mbi të.²⁰ Përshkrimi më i gjatë mbi Elbasanin për këtë kohë, ndoshta është ai i botuar për herë të parë prej S. Ljubić-it, të cilit i referohen thuajse të gjitha studimet mbi këtë qytet. Kështu, sipas këtij raporti, qyteti shtrihej mbi një fushë të gjerë, kishte mure të mëdha por që ishin të dobëta, kalaja ishte në formë drejtkëndore dhe kishte brenda lagje të shumta. I njëjti autor shprehet gjithashtu se europianët e quanin atë *Terra Nuva*, ndërsa bizantinët *Neokastro*.²¹

¹⁹ Në një raport që bajli i Korfuzit dërgonte në dhjetor të vitit 1595, shprehej se nga Pulja e Italisë ishin kontrabanduar armë, të cilat do të përdoreshin për mbështetjen e kryengritjes në Himarë. Për më shumë, shih *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë (1593-1602)*, vëll. II, përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: 1990), 72-73.

²⁰ Me këtë nënkuptojmë relacionin e përgatitur nga Jovan Kotović në fundin e shek. XVI mbi udhëtimet që kishte kryer, si edhe të dhënat që gjenden në *Geographia-n* e Philippus Cluverius-it mbi historinë, qytetet dhe kulturën e shqiptarëve. Për më shumë, shih *Dokumente të shekujve XVI-XVII*, II, 247-262.

²¹ "... e poi s'entra nelle belle e fruttifere pianure della citta d'Elbassan detta come di sopra, Terrs nuova, la qual citta e di buon circuito, posta in pianura, e di mille fuogbi de Turchi, e ha intorno un grandissimo borgo de Turchi e christiani; é luocho mercantile abbondantissimo di tutte le cose. La terra ha le mure, torre in forma quadra con un fosso, ma tutte debole, ne si fanno guardia de e notte, ne si serrano le porte, e vi sono tante fontane, che oltre li condotti d'aqua per uso delle case particolari, che quasi tutte hano aqua viva. Dentro la cita vi sono rode de mollini dale aque condotte di fuora puoco lontane..." Shih Sime Ljubić, "Ízvještaj god. 1570 o Arbanaskoj", *Starine*, XII, Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti (Zagreb: 1880), 198.

Elbasani në *Sejihatnamenë* e Evlija Çelebiut

Ndryshe nga informacionet e parashtruara më lart, Evlija Çelebiu paraqet një informacion tejet të zgjeruar dhe të hollësishëm mbi qytetin e Elbasanit. Ai do ta vizitonte këtë qendër të rëndësishme urbane në gjysmën e dytë të shek. XVII, duke ndarë plot pesëmbëdhjetë faqe tekst për përshkrimin e detajuar të këtij vendi,²² aspekte të cilat po i përmbledhim shkurtimisht në disa pika kryesore:

a. *Fizionomia e qytetit dhe aspektet gjeografike*: pasi bën një përshkrim të detajuar të kalasë, Çelebiu vijon me paraqitjen e pjesës së varoshit duke folur për lagjet e këtushme dhe konakët e bukur të parisë së qytetit. Kronisti osman shprehet se Elbasani kishte 28 lagje (18 myslimane, 10 të krishtera), se banorët e tij ishin vendës dhe se nuk kishte asnjë të huaj. Në vijim, duke iu referuar regjistrit të ket'hydasë së qytetit, shprehet se këtu kishte plot 1 150 shtëpi e saraje, duke nxjerrë në pah madhësinë e Elbasanit gjatë shek. XVII.²³ Autori nuk ndalet vetëm në pjesën e qytetit, por edhe në klimën, terrenin, burimet ujore, vendet e bukura dhe veçori të tjera gjeografike që e karakterizonin këtë hapësirë, qasje të cilën e sheh në të gjithë veprën e Çelebiut. Në rastin e Elbasanit, ai thekson se, si rrjedhojë e klimës së mirë që e karakterizonte këtë vend, njerëzit e tij ishin të shëndetshëm dhe se toka ishte e favorshme për kultivimin e të gjitha produkteve.²⁴

b. *Ekonomia dhe prodhimet*: nisur nga kushtet e mira gjeografike, Çelebiu shprehet se në këtë zonë kultivoheshin të gjitha llojet e frutave e të perimeve. Por ai shprehet se më së shumti në hapësirën e Elbasanit prodhohej gruri, elbi e thekra.²⁵ Ai tregon për bollëkun dhe produktet cilësore që nxirreshin në tregun e Elbasanit, ku 900 dyqanet e këtushme

²² Evlija Çelebi *Seyahatnamesi*, C. 8 (İstanbul: Orhaniye Matbbası, 1928), 716-730; Gjithashtu, shih Robert Dankoff & Robert Elsie, *Evliya Çelebi in Albania and adjacent regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)* (Leiden: Brill, 2000); Evlija Çelebi, *Shqipëria: para tre shekujsh*, përkthyer nga Sali Vuçiterni (Tiranë: Besa, 2000).

²³ Evlija Çelebi *Seyahatnamesi*, 719.

²⁴ *Po aty*, 723-725.

²⁵ Për detajet, shih *po aty*, f. 725.

shisnin objektet më të mira. Ndërsa në tregun e madh që mbahej të dielën, njerëzit vinin në grupe të mëdha nga të katër anët e sanxhakut.²⁶

c. *Vakëfet dhe feja*: Evlija Çelebiu jep informacione me rëndësi mbi objektet fetare dhe ato të bamirësisë që gjendeshin në qytetin e Elbasanit. Fillimisht, ai përmend faktin se qyteti kishte plot 46 xhami e mesxhide, ndërsa më pas paraqet të dhëna të hollësishme mbi ato më kryesoret. Në vijim përshkruan veprat e mëdha të bamirësisë që ishin ndërtuar prej institucioneve të vakëfeve.²⁷

d. *Njerëzit dhe jeta shoqërore*: Çelebiu përshkruan me hollësi mënyrën e jetesës së banorëve të Elbasanit, veshjet e tyre, marrëdhëniet ndërmjet njerëzve dhe aspekte të tjera të jetës shoqërore. Duke u ndalur te klima e favorshme që kishte kjo zonë, Çelebiu shprehet se njerëzit ishin të shëndetshëm, madje shprehet se edhe ata që e kishin kapërcyer moshën njëqindvjeçare, qenë në formë të mirë.²⁸ Pasi përshkruan veshjet e burrave dhe të grave, kronisti osman numëron edhe emrat më të përdorur për fëmijët. Nisur nga fakti se banorët e qytetit ishin të gjithë shqiptarë, ai thekson se njerëzit këtu flisnin shqip, se një pjesë e madhe njihte edhe turqishten, se dijetarët zotëronin edhe persishten dhe tregtarët komunikonin në greqisht e italisht.²⁹ Konstatimi i fundit është tejet i rëndësishëm, pasi tregon qartësisht ndërveprimin që elitat e qytetit kishin me të dyja botët, atë perëndimore dhe lindore.

Në *Sejahatname* gjenden të dhëna mbi jetën shoqërore në qytetin e Elbasanit. Krahas të dhënave mbi medresetë, shkollat dhe daru'l-kurratë e këtushme, ai shprehet se njerëzit e merrnin dijen e kulturën edhe në teqetë dhe xhamitë, duke shtuar se dijetarët ishin njerëz me dije të thelluara. Çelebiu veçon traditën poetike dhe numrin e madh të poetëve që kishte Elbasani, duke theksuar se kjo qendër urbane ishte e zhvilluar në aspektet e artit dhe të kulturës. Më tej, ai flet për shëtitorët, vendet ku

²⁶ Ai shprehej se tregu ishte i shtruar me kalldrëm, se në cepin e kalldrëmit kalonin kanalet e ujit që freskonin vendin dhe se njerëzit tregtonin nën hijen e pemëve të gjata që lartësoheshin në të dyja anët e kalldrëmit. Shih *po aty*, 723-725.

²⁷ Për detajet, shih *po aty*, 721; Kiel, *Arkitektura osmane*, 139.

²⁸ *Evliya Çelebi Seyahatnamesi*, 728-729.

²⁹ Evlija Çelebiu i tërheq vëmendjen interesi i madh që popullsia e qytetit kishte ndaj dijes dhe poezisë. Sikurse thekson vetë ai, muret e jashtme të xhamisë së Sinan Pashës qenë të mbushura me poezitë dhe shënimet e udhëtarëve grekë, arabë e persë, sa këtu ishte e pamundur të gjeje një hapësirë të pashkruar. Për këtë arsye, ai shprehet se historianët e kishin quajtur Elbasanin *Dar-i Shuara*, pra vendi i poetëve. Shih *po aty*, 721.

mund të shkohej për piknik, madje shton se këtu gjendeshin edhe gjashtë kafene, në të cilat kalonin kohën njerëzit e artit e të kulturës.³⁰

Si përfundim, Çelebiu e përshkruan Elbasanin si një vend të zhvilluar, të bukur e me kulturë. Madje, ai e cilëson qytetin për nga bukuria, si njërën prej qendrave më të bukura të Rumelisë, duke thënë se, ashtu sikurse Antepi është “nusja” e Anadollit për nga bukuria, “e stolisura” e Rumelisë është qyteti i Elbasanit.³¹

Analiza e burimeve

Ndonëse deri sot është zhvilluar një traditë e studimeve mbi figurën e *Elvija Çelebiut* dhe veprën e tij, *Sejahatname-në*, relacionet dhe raportet që gjenden në arkivat perëndimorë e që trajtojnë hapësirat shqiptare për periudhën që trajtuam, kanë mbetur thuajse të pastudiuara. Ndonëse një pjesë e konsiderueshme e tyre janë përkthyer dhe botuar, kryesisht prej Injac Zamputit e Giuseppe Valentinit, dhe janë përdorur prej historianëve të periudhës, në aspektin e historisë sociale e urbanistike, ato mbeten ende të pashfrytëzuara. Nisur prej faktit se kjo është vetëm një kumtesë, këtu u ndalëm vetëm në rastin e qytetit të Elbasanit gjatë shek. XVI-XVII, duke u përpjekur të evidentojmë se si e pasqyrojnë dokumente të tilla jetën në hapësirat kufitare osmane. Kështu, nisur prej informacioneve të dhëna më lart nga raporte e relacione të ndryshme mbi qytetin e Elbasanit dhe të dhënave që gjejmë në *Sejahatnamenë* e Evlija Çelebiut për të njëjtën periudhë, e kemi të lehtë të evidentojmë disa pika që nxjerrin në pah ndasitë dhe pikëtakimet e burimeve të ndryshme, të së njëjtës kohë, mbi të njëjtin vend.

Në pamje të parë, elementi kryesor që spikat në vrojtimin e burimeve, është arsyeja e përpilimit të teksteve. Evlija Çelebiu, i cili në pjesën kryesore të vendeve që ka vizituar ishte ngarkuar edhe me detyra shtetërore, e ka përdorur këtë mundësi për të përshkruar të gjitha hapësirat që ka parë. Ndërsa relacionet e lartpërmendura, megjithëse përmbajnë edhe përshkrime të vendeve, janë hartuar kryesisht me një qëllim, ku kryesisht dominon aspekti fetar. Si Çelebiu ashtu edhe hartuesit e relacioneve në fjalë, pjesa kryesore e të cilëve janë klerikë, i përkasnin asaj që osmanët e quanin si shtresa “ilmije”, pra e dijetarëve.

³⁰ *Po aty*, 723.

³¹ *Po aty*. 716.

Në rastin e përshkrimit të hapësirave gjeografike, qasja e hartuesve është e ndryshme. Nëse në *Sejihatname* është pasqyruar me detaje qyteti me të gjitha elementet e tij urbanistike, gjeografike, arkitekturore e sociale, relacionet e lartpërmendura i përmendin hapësirat urbane, pra qytetet, në kontekst të misionit me të cilin kishin mbërritur këtu. Ndonëse në plan të parë ata paraqesin informacionet mbi gjendjen e kishës dhe organizimin e bashkësisë, në vijim gjithnjë shtojnë pikat më të dobëta që osmanët kishin në këto vende, gatishmërinë e njerëzve për t'iu bashkuar një kryengritjeje të mundshme dhe potencialin ushtarak e njerëzor të këtyre zonave në një fushatë të përgjithshme antiosmane.

Kjo qasje reflektohet edhe në detajet e teksteve. Kështu, nëse Çelebiu kur flet për një vend të caktuar i përshkruan në vija të përgjithshme të dhënat për banorët e krishterë që jetonin aty, për myslimanët ndalet në detaje duke i përshkruar hollësisht parinë e vendit, bamirësinë, veprat e kultit, dijetarët dhe të gjithë faktorët e tjerë që duhen theksuar. Të njëjtën qasje vërejmë edhe në relacionet e lartpërmendura, ku për qendrat e banuara prej myslimanëve ndalen në vija të përgjithshme, ndërsa flasin me detaje për gjendjen e bashkësisë së krishterë, objektet e kultit, problematikat që kishin si komunitet etj. Parë nga ky këndvështrim, leximi i të dyja teksteve do të rezultonte plotësuese në formësimin e panoramës dhe kuptimin e gjendjes.

Krahasimi i burimeve është tejet interesant për ata që shkruajnë mbi historinë urbane. Nëse Çelebiu flet për madhësinë që kishte qendra, në tekstet e relacioneve del në pah dinamizmi dhe elasticiteti që kishin hapësirat rurale. Kur Çelebiu flet për madhësinë e shtetit, veprat e rëndësishme arkitekturore që janë ndërtuar, ai nuk flet për përplasjet që ndodhnin në zona të caktuara apo rebelimet që i bëheshin qeverisë lokale e qendrore diku tjetër. Për rrjedhojë, hulumtimi i të dy llojeve të këtyre burimeve na del përpara edhe si mënyra më e mirë krahasuese që do të na çonte drejt një historishkrimi sa më të mirë të hapësirave kufitare gjatë periudhës së sundimit osman.

Përfundime

I themeluar në gjysmën e shek. XV, Elbasani u zhvillua brenda një kohe të shkurtër duke u bërë njëra prej qendrave më të rëndësishme të Shqipërisë vetëm një shekull më vonë. Në këtë kumtesë u përpoqëm të pasqyrojmë këtë zhvillim që arriti qyteti në fjalë duke shfrytëzuar ato që

mund të konsiderohen si burime dytësore, pra letra, relacione, raporte e tekste udhëtimesh, të cilat nuk përmbajnë saktësinë e burimeve arkivore. Nisur nga pozita gjeografike si një zonë kufitare, përbërja fetare dhe rëndësia e madhe strategjike që kishte, përshkrimi dhe trajtimi i hapësirave shqiptare në këto burime dytësore, jo vetëm që na ndihmon në plotësimin dhe analizimin e burimeve të dorës së parë, por na pasqyron edhe mentalitetin e kohës, të cilin e gjejmë të reflektuar më së miri në këto dokumente.

Burime e bibliografi:

Arkiva:

Arkivi i Institutit të Historisë (AIH)

- A-III-535, “Relacion i gjendjes së Shqipërisë dhe Serbisë të vizituara prej Vincent Zmajeviqit, kryepeshkop i Tivarit në vitin 1702 deri 1703”, vëll. II, përkthyer nga Injac Zamputi, Tiranë 1988.

Literaturë historiografike:

Paşazade, Aşık. *Osmanoğulları'nın Tarihi*, Çev. Kemal Yavuz ve M. A. Yekta Saraç. İstanbul: MAS Matbaacılık, 2003.

Babinger, Franz. *Aufsätze und Abhandlungen zur Geschichte Südosteuropas und der Levante*, v. I. München: Schmidt & Klaunig Kiel, 1962.

Bartl, Peter. *Ballkani Perëndimor midis monarkisë spanjolle dhe Perandorisë Osmane; Mbi çështjet e luftës antiturke në kapërcyell të shek. XVI dhe XVII*. Përktheu Pëllumb Xhufi. Tiranë: Dituria, 2011.

Biemmi, Giammaria. *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh*. Brescia: 1756.

Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, vëll. II. Përgatitur nga Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pepo. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë: 1962.

Caka, Eduart. “Vakëfet dhe funksioni i tyre në qytetin e Elbasanit gjatë shekullit XVII”, *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2016: 99-113.

Caka, Eduart. *Vakëfet dhe ndikimi i tyre social në Shqipërinë e periudhës osmane*. Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2021.

Ceka, Hasan. “Nga historia e lashtë e Skampinit (Elbasanit)”, *Studime historike*, nr. 1. Tiranë: 1975: 147-151.

- Dokumente për historinë e Shqipërisë [1623-1653]*. Transkriptuar e përkthyer nga Injac Zamputti. St. Gallen: Albanisches Institut, 2015.
- Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë (1593-1602)*, vëll. II. Përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: 1990.
- Çelebi, Evlija. *Shqipëria: para tre shekujsh*. Përkthyer nga Sali Vuçiterni. Tiranë: Besa, 2000.
- Evliya Çelebi *Seyahatnamesi*, C. 8. İstanbul: Orhaniye Matbbası, 1928.
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet 20 të shek. XIX). Redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: Toena, 2002.
- İnalcık, Halil. *Devlet-i ‘Aliyye: Osmanlı İmparatorluğu Üzerine Araştırmalar*, II. İstanbul: Türkiye İş Bankası, Kültür Yayınları, 2016.
- İnalcık, Halil. *Fatih Devri Üzerinde Tetkikler ve Vesikalar*, I. Ankara: Türk Tarih Kurumu Basımevi, 1954.
- Kiel, Machiel. “İlbasan”, *TDV İslam Ansiklopedisi*, C. XXII. İstanbul: TDV Yay., 2000.
- Kiel, Machiel. *Arkitektura osmane në Shqipëri (1385-1912)*. Përktheu Klodiana Smalaj. Tiranë: AIITC, 2012.
- Kuvendi i Arbënit (Romë 1706)*. Tekst kritik – përgatitur dhe pajisur me shënime si dhe me konkordancat leksikore nga Bardhyl Demiraj. Shkodër: Botimet françeskane, 2012.
- Ljubić, Sime. “İzvještaj god. 1570 o Arbanaskoj”, *Starine*, XII. Zagreb: Jugoslavenska Akademija Znanosti i Umjetnosti, 1880.
- Malcolm, Noel. *Agjentë perandorakë: Një familje shqiptare në botën mesdhetare të shekullit të gjashtëmbëdhjetë*. Përktheu Kastriot Myftiu. Tiranë: Dudaj, 2015.
- Muhaj, Ardian. *Projekte kundërosmane në shek. XVI-XVII mes fantazisë, interesit dhe realitetit*. Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë. Tiranë: Botimet albanologjike, 2022.
- Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, vëll. I (1610-1634). Përkthyer dhe përgatitur nga Injac Zamputi, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë: 1963.
- Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shekullin XVII*, vëll. II (1634-1650). Përkthyer dhe përgatitur nga Injac Zamputi. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Gjuhësisë. Tiranë: 1965.
- Dankoff, Robert & Robert Elsie. *Evliya Çelebi in Albania and adjacent regions (Kosovo, Montenegro, Ohrid)*. Leiden: Brill, 2000.

Šufflay, Milan. *Städte und Burgen Albaniens, hauptsächlich während des Mittelalters*. Wien: Hölder-Pichler-Tempsky A.-G., 1924.

Shkodra, Zija. *Esnafet shqiptare (Shek. XV-XX)*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: 1973.

Shkodra, Zija. *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: 1984.

EDUART CAKA

Institute of History / Academy of Sciences of Albania
edicaka@hotmail.com

S u m m a r y

TRAVELOGUE LITERATURE IN THE HISTORIOGRAPHY OF BORDERLANDS: AN ANALYSIS OF WESTERN AND EASTERN SOURCES FOR THE CITY OF ELBASAN IN THE 16TH-17TH CENTURIES

Founded in the mid-15th century, Elbasan developed within a short time, becoming one of the most important centers of Albania just a century later. In this paper, we attempted to reflect this development that the city in question achieved by utilizing what can be considered secondary sources, namely letters, relations, reports and travel texts, which do not contain the accuracy of archival sources. Given its geographical position as a border area, its religious composition and the great strategic importance it had, the description and elevation of Albanian spaces in these secondary sources not only helps us to complement the analysis of first-hand sources, but also reflects the mentality of the time, which we find best reflected in these documents.

NEKROLOGJI

HYSEN KORDHA **(6 shkurt 1941 – 3 korrik 2024)**



Më datë 3 korrik 2024 u nda nga jeta në moshën 83-vjeçare, prof. dr. Hysen Kordha. Ai lindi më 6 shkurt 1941 në Stanicë të Beratit. Aty kreu shkollën fillore. Arsimimin e vijoi më pas në qytetin e Beratit, ku edhe përfundoi arsimin e mesëm pedagogjik. Pas diplomimit u emërua mësues në vendlindje, kurse në vitin pasues u vendos në postin e drejtorit të shkollës 7-vjeçare të Kutallisë. Për disa vjet punoi në seksionin e arsimit në Berat. Në moshën 26-vjeçare, në vitin 1966 u regjistrua për të kryer studimet e larta në Universitetin e Tiranës në Fakultetin Histori-Filologji, dega Histori-Gjeografi, të cilin e përfundoi në vitin 1971. Në nëntorin e atij viti u angazhua në një grup pune që do të hartonte historikun e qarkut të Beratit. Në vijim, pas kësaj pune u vendos në Tiranë dhe u bë pjesë e Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave (krijuar në vitin 1972).

Në gjysmën e parë të viteve '80, Hysen Kordha, tashmë jo një studiues i thjeshtë, por kandidat i shkencave, u përfshi në Sektorin e Enciklopedisë Shqiptare dhe nën drejtimin e doktorit të shkencave, Xhevat Lloshi, u ngarkua të përgatiste Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, i cili u botua në vitin 1985.

Në hartimin e botimit të ri të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë), vëllimi I – 2008, vëllimi II – 2008, vëllimi III – 2009, dr. Hysen Kordha ishte redaktor shkencor për fushat: Arkeologji, Histori e lashtë, Histori e Mesjetës dhe e Rilindjes, Histori bashkëkohore, Mbrojtja, Rendi, Histori ushtarake, Kultura popullore, Artet, Kultura, Sociologji dhe Filozofi.

Në të dyja këto botime madhore që kërkonin përkushtim, skrupulozitet, komunikim të niveleve të larta etike me bashkëpunëtorët

dhe autorët e zërave, kolegu ynë i nderuar H. Kordha bëri më të mirën që kërkonte detyra e tij, duke lënë përshtypje të paharrueshme tek të gjithë ata që bashkëpunuan me të.

Ndërkohë gjatë viteve 1970-1980, ai vetë ose në bashkëpunim realizoi disa botime interesante, përkatësisht:

- *Revolucioni i qershorit 1924 në kujtimet e bashkëkohësve*, përgatitur së bashku me Paskal Dhimitrin, Xhevat Repishtin, red. Jeton Ostreni, Tiranë: 8 Nëntori, 1974.
- *Çështje të lëvizjes demokratike dhe revolucionare shqiptare në vitet 1921-1924*, botim i Institutit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave, Tiranë, 1977.
- *Shoqëria "Bashkimi" (1922-1925)*, përgatitur së bashku me Tefta Gjolekën, red. Fatmira Aliaj, Tiranë: 8 Nëntori, 1987.

Në bashkëpunim me Sali Hidrin përgatiti për botim kujtimet e av. Hysen Myshketa të titulluara, *Kujtime e shënime pak edhe si historike*, Durrës-Leçe: Shtëpia Botuese "Acustica", 1999.

Në veprimtarinë studimore botuese të prof. H. Kordhës, gjatë viteve 1974-2007, numërohen edhe 23 artikuj, kumtesa e dokumente të botuara në revistën "Studime historike", organ i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave.

- "Veprimtaria politike demokratike-revolucionare e dr. Sezai Çomos në vitet 1919-1924" etj., *Studime historike*, nr. 2, 1974.
- "Disa të dhëna mbi gjendjen ekonomiko-shoqërore të vendit në prag të Revolucionit të Qershorit, 1924", *Studime historike*, nr. 4, 1985.
- "Themelimi i shoqërisë "Bashkimi" dhe veprimtaria e saj gjatë periudhës 13 tetor 1922 – 20 prill 1924", *Studime historike*, nr. 3, 1986.
- "Kongresi i Lushnjës në historiografi", *Studime historike*, nr. 2, 1990.
- "Dokumente për lëvizjen demokratike gjatë viteve 1921-1924", *Studime historike*, nr. 3-4, 1999.
- "Parlamenti shqiptar – institucionalizim i unitetit politik shtetëror dhe i demokracisë parlamentare shqiptare", kumtesë e mbajtur në simpoziumin shkencor kushtuar 80-vjetorit të mbledhjes së Këshillit të Parë Kombëtar Shqiptar, Tiranë, 27 mars 2000, *Studime historike*, nr. 1-2, 2000.

- “Teqetë, vatra të mësimit të gjuhës shqipe”, kumtesë e mbajtur në simpoziumin shkencor “Bektashizmi dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare”, zhvilluar në Tetovë, më 26 nëntor 2005, botuar në *Studime historike*, nr. 1-2, 2006.

Prof. Hysen Kordha ishte një mik i mirë dhe ne kolegët e bashkëpunëtorët e tij nuk mund të mos e kujtojmë edhe për marrëdhëniet shumë njerëzore dhe humorin të cilin ai e pëlqente.

Prof. Hysen Kordha u nda nga jeta duke lënë te kolegët dhe bashkëpunëtorët, natyrisht te familja e tij, një zbrazëti që ndihet.

Gjithsesi, ai la pas kujtimin e bukur të njeriut korrekt e të dashur dhe te familjarët bashkëshortin dhe prindin e përkushtuar.

Marenglen VERLI

<https://doi.org/10.61773/x0b5hh22>

In memoriam
PROF. DR. LIMAN RUSHITI
(1942-2024)



Më 29 shtator 2024, në moshën 82-vjeçare ndërroi jetë prof. dr. Liman Rushiti. Liman Rushiti lindi më 25 qershor 1942 në fshatin Sazli të komunës së Ferizajt. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen në shkollën ekonomike “Faik Konica”, në Ferizaj. Studimet i vazhdoi në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, Dega e Historisë, të cilat i mbaroi më 18 shtator 1968. Në vitin 1975 mbrojti tezën e magjistraturës në Universitetin e Prishtinës me titull “Rregullimi administrativ dhe territorial i Kosovës 1918-1941”. Në po të njëjtin Universitet mbrojti më 25 janar 1980 tezën e doktoratës me titull “Lëvizja Kaçake në Kosovë 1918-1928”. Profesor doktor, Liman Rushiti, në vitin 1981 mori titullin e lartë shkencor, “Profesor Inordinar” dhe në vitin 1987 mori titullin “Profesor Ordinar”.

Në marrëdhënie të rregullt pune në Institut ishte nga 1 dhjetori i vitit 1967, ku punoi derisa u pensionua në vitin 2007. Pra, për 40 vjet aq sa punoi në Institutin e Historisë ai kontribuoi në ndriçimin e ngjarjeve dhe të personaliteteve të rëndësishme nga historia e popullit shqiptar, duke dhënë kontribut të çmueshëm në historiografinë shqiptare. Profesor Limani ishte pjesë e redaksive të ndryshme shkencore. Ka botuar pesë vepra të cilat janë:

1. *Lëvizja Kaçake në Kosovë (1918-1928)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 1981 dhe ribotuar me plotësime më 2016;
2. *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918*, Prishtinë: Rilindja, 1986;
3. *Kujtime për Lëvizjen Kaçake*, Prishtinë, 2003;
4. *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës 1878-1941*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2004;
5. *Dromca jete*, Prishtinë, 2023.

Duhet të theksohet fakti se prof. dr. Liman Rushiti ishte anëtar i redaksisë për monografinë me titull “Ferizaj”, e cila është në botim e sipër.

Krahas këtyre monografive, prof. dr. Liman Rushiti ishte edhe bashkautor i disa librave të tjerë historikë e enciklopedikë, si dhe i disa teksteve shkollore. Ndër veprat më të rëndësishme ku ishte bashkautor janë:

1. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë – Instituti i Historisë, 2007;
2. *Fjalori Enciklopedik i Kosovës*, I-II, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2018.

Gjithashtu ishte pjesëmarrës në shumë kongrese dhe simpoziume të zhvilluara në qytetet shqiptare si në Prishtinë, Tiranë, Shkup, Ferizaj, Vushtrri etj., dhe jashtë vendit në qytetet si në Beograd, Zagreb, Sarajevë etj. Është autor i mbi 200 punimeve shkencore nga fusha e historisë të botuara në revistat më të njohura shkencore në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe vende të tjera të rajonit. Disa nga punimet shkencore të prof. dr. Liman Rushitit të botuara në revistat shkencore të vendit janë: në revistën “Kosova” të botuar nga Instituti i Historisë – *Rregullimi administrativo-territorial i Kosovës gjatë viteve 1918-1929*, Kosova, Nr. 1, 1972, 243-260; *Problemet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare* në gazetën “Drita” të Sofjes, Nr. 3, Sofje: 1974, 241- 260; *Vështrim i shkurtër i situatës politike në Kosovë (1912-1915)*, Kosova, Nr. 12, 1983, 177-194; *Gjendja ekonomike dhe politike në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore*, Kosova, Nr. 15, 1986, 87-106; *PKJ në Kosovë në zgjedhjet komunale për Konstituant të 28 nëntorit 1920*, Kosova, Nr. 16, 1987, 57-68; *Rezistenca e shqiptarëve ndaj politikës asimiluese e shfarosëse serbo-malazeze*, Kosova, Nr. 22/23, 2000/2001, 2003, 175-198; *Rezistenca e popullit shqiptar kundër pushtuesve serbo-malazezë 1912-1914*, Kosova, Nr. 24/25, 2002/2003, 2003, 161-170; pastaj në revistën “Vjetar” të botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës (1929-1941)*, Vjetar, Nr. 12-13, 1976/1977, 1981, 43-76; *Dëbimi i shqiptarëve nga qarku i Prizrenit 1919-1922*, Vjetar, Nr. 27-28, 2002, 311-317; *Ibrahim Lutfiu*, Vjetar, Nr. 29-30, 2003, 367-378; *Komiteti Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës dhe Lëvizja Kaçake*, Vjetar, Nr. 39-40, 2008, 409-415 etj.

Profesori u nda nga jeta më 29 shtator 2024, në Prishtinë, i rrethuar nga familjarët dhe u varros më 2 tetor 2024 në vendlindjen e tij, në varrezat e fshatit Sazli të komunës së Ferizajt.

Skënder LUTFIU

<https://doi.org/10.61773/10vv3c65>

